monumentet



DO NOT COPY

18. 1979

DO NOT COPY

Kopertina e parë. **Monumenti i Agonotetëve shek. II. e.s. – Apoloni (Pas restaurimit)**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

18, 1979

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës

Adresa e redaksisë: Rruga Alqi Kondi nr. 7

kopje | Formati 70 x 100/12 | Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri» – Tiranë, 1980

PASQYRA E LËNDËS

DO NOT COPY

ARTIKULLI

Faqe

Pirro THOMO

Restaurimi i banesës së «Piktorit të Popullit» Vangjush Mio në Korçë 5

Koço ZHEKU

Rishtyllëzimi i pamjes kryesore të Monumentit të Agonoteteve në Apoloni 29

Lazër PAPAJANI

Teatri i qytetit ilir në Klos të Mallakastrës dhe punimet restauruese në të. 43

Hasan NALLBANI

Mozaiku i Baptisterit të Butrintit, ndërtimi i njëkohëshëm 57

Prof. Dhimitër S. SHUTERIQI

Mbi disa vizatime rupestre mesjetare pranë Rubigut dhe mbi disa motive skulpturore popullore në Mirditë. 65

Dilaver KURTI

Kala e qyteza të panjohura në Mat 77

Aleksandër MEKSI

Restaurimi përforcues në Xhaminë e Beqarëve në Berat. 93

Emin RIZA

Arkitektura dhe restaurimi i kullave të Dervish Aliut në fshatin Dukat (Vlorë) 105

Valentin VOSHTINA

Dy kulla me sharapot në rrethin e Matit. 121

Ali MUKA

REÇENSION

Mbi albumin «Gjirokastra qytet Muze» – Përgatitur nga Emin Riza, fotot nga Refik Veseli, formulimi artistik nga Faruk Zarshati. (Shtëpia botuese «8 Nëntori» Tiranë, 1978) f. 190. 125

Valter SHTYLLA

Ndërtime të vjetra inxhinierike në Krujë. 135

Kronika të punimeve restauruese për vitin 1978. 149

TABLES DES MATIERES

L'ARTICLE

Page

Pirro THOMO

Restauration de la maison du «Peintre de Peuple» Vangjush Mio à Korçë. 5

Koço ZHEKU

Renforçage par piliers de l'aspect principal du monument des Agonothètes à Apollonie. 29

Lazër PAPAJANI

Le théâtre de la ville illyrienne à Klos de Mallakaster et les traveaux de restauration qui y ont été effectués 43

Hasan NALLBANI

La mosaïque du Baptistère de Butrint, une construction simultanée 57

Prof. Dhimitër S. SHUTERIQI

A propos de certaines peintures rupestres moyenâgeuse à proximitée de RUBIG et de certains motifs sculpturaux populaires de la region de Mirditë. 65

Dilaver KURTI

Forteresses et citadelles inconnues dans le district de Mat. 77

Aleksandër MEKSI

Restauration à des fins de consolidation de la mosquée des «Beqar» à Berat 93

Emin RIZA

L'architecture et la restauration des tours de Dervish Aliu dans le village de Dukat (Vlorë) 105

Valentin VOSHTINA

Deux tours à «Sharapot» dans le district de Mat. 121

Ali MUKA

RECENSION

De l'Album «GJIROKASTRA – VILLE MUSEE» – Preparée par Emin Riza, photos de Refik Veseli, rédacteur artistique Faruk Zershati (Editions «8 Nëntori». Tirana 1978) p. 190 125

Valter SHTYLLA

Des anciennes constructions d'ingénierie à Kruja 135

Chronique des travaux de restauration pour 1978. 149

DO NOT COPY

Pirro THOMO

DO NOT COPY

RESTAURIMI I BANESËS SË «PIKTORIT TË POPULLIT» VANGJUSH MIO NË KORÇË

Banesa e piktorit të popullit Vangjush Mio ndodhet në një nga «mëhallat» e vjetra të «Varoshit» të Korçës. Ajo ishte kthyer në galeri ku ishin ekspozuar veprat e piktorit. Në gjendjen ekzistuese banesa mbante gjurmët e ndryshimeve dhe rindërtimeve të herëpasherëshme, të cilat ja kishin humbur pamjen fillestare banesës. Nga ana tjetër banesa ishte në gjëndje teknike të keqe, gjë që kërkonte ndërhyrje restauruese. Duke u nisur nga të dhënat gojore dhe disa elemente të ruajtur, krijohej bindja se kjo banesë i përkiste një tipi të vjetër, ekzemplarë të të cilit janë të rallë në qytetin e Korçës, dhe ato të pakta që kanë mbetur, përgjithësisht janë mjaft të transformuara. Pra duke u nisur nga funksioni i ndërtesës dhe gjendja e saj, në vitin 1977 u ndërmorën punime restauruese. Gjatë këtyre punimeve, duke depërtuar në thellësi të monumentit u zbuluan mjaft të dhëna që hidhnin dritë mbi karakterin tipologjik dhe morfologjik të këtij tipi të vjetër të banesës Korçare, të panjohur plotësisht deri në këtë kohë.

Këto rethana përcaktuan dhe kriteret bazë nga u udhëhoqëm për restaurimin e kësaj banese, rezultatet e të cilit do të paraqiten në këtë artikull.

Gjëndja para restaurimit

Banesa është dy katëshe me planimetri në formën e shkronjës «L». (TAB. I). Hyhet drejtpërdrejtë nga rruga në hajatin e banesës dhe më tej në oborrin e shtruar me pllloça guri dhe të rrethuar me mure. Në të djathtë të hyrjes ndodhet pusi.

Kati përdhes ka dy ambiente, ndër të cilët vetëm njëri përdoret për banim. Ky ambient ka hyrje nëpërmjet hajatit të ngushtë përpara tij, ku del dhe një dritare e madhe. Ambienti është i thjeshtë, me tavan dërrase, oxhak, ndërsa pjesën fundore e mbyll një musandër e thjeshtë. Poshtë këtij ambienti gjysëm i futur në truall është qilari i zahireve, i cili ndriçohet dhe ajroset nga dy dritare që dalin në hajat. Ambienti i dytë i katit përdhes është sajuar më vonë, duke u ndarë nga hapësira e hajatit me një mur tulle, dhe përdoret si depo. Këtu janë dhe shkallët që zbresin për në qilarin e zahireve. Në hajat janë vendosur gjithashtu dhe shkallët për në katin e dytë.

Kati i sipërm përbëhet prej tre ambienteve kryesore dhe koridorit të ngushtë ndërlidhës. Ambienti nga ana perëndimore siç duket do të ketë shërbyer si dhomë miqsh. Portën e ka të punuar, të qarkuar me fashatura dërrase të profiluara e të rethuara me një kornizë në formë harku, ku janë daltuar ornamente me shpendë dhe bimë (Fig. 1). Kompozimi i dhomës është karakteristik për banesat qytetare të shekullit të kaluar. Në pjesën fundore është ndërtuar musandra, një pjesë e të cilës krijon një parahyrje për në dhomë (Fig. 2). Përballë musandrës është ndërtuar oxhaku, me kamare të vogla anash tij dhe po në atë mur janë hapur më vonë dy dritare nga mer dritë ambienti (Fig. 3). Në muret kalojnë fashatura dërrase, të cilat formojnë një rjet katroresh, lidhen me musandrën dhe qarkojnë niket e një dollap-muri me kanata të gdhëndura. Tavani ka fushën e suvatuar dhe një kube në mes, në fundin e së cilës është montuar një pllakë dërrase e gdhendur. Anash tavani, mbas kalimit të lakuar nga sipërfaqet vertikale të mureve kornizohet nga fashatura të gjëra dërrase. Gjithashtu në të katër qoshet e tavanit janë vendosur trekëndësha dërrase, ku janë daltuar motive bimore (Fig. 4).

Ambienti tjetër nga ana lindore, krahas të parit, kohët e fundit ishte kthyer në studio të piktorit. Portën e hyrjes e ka më të vogël e më të thjeshtë nga ajo e dhomës së pritjes (Fig. 5). Përballë portës, ndo-

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4

dhet nikja e oxhakut e cila ka përbri dy dollapë muri, me kanata të gdhendura cekët, ndërsa raftet në pjesën e sipërme vishen me një gdhendje në formë azhuri (Fig. 6). Në faqen lindore është hapur një dritare e madhe, dhe anash saj dy dollapë të ngushtë e të hapur. Edhe në këtë dhomë, janë të pranishëm fashaturat prej dërrase në murin jugor që kornizojnë dollapet. Në pjesën fundore të dhomës, mbi shkallët, është krijuar një nike intime e piktorit, e ndriçuar nga një dritare që del mbi rrugë dhe një tjetër mbi hapësirën e shkallëve.

Në ndryshim me ambientin e parë, studjoja ka tavan dërrase, me një rozetë të madhe tetëkëndëshe në mes (Fig. 7), të formuar nga një pllakë e gdhendur në formë azhuri dhe e qarkuar nga fashatura të gjëra të profiluara. Qoshet e tavanit janë të thje-



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8

shta, të krijuara nga fashaturat e dërrasës dhe fusha e trekëndëshave është e mbushur nga një rjetë listelash të holla. Rreth 1 m. larg hyrjes tavani krijon një ndërprerje dhe të dy pjesët kanë ndryshim në formulimin dekorativ. Pjesa e ngushtë e tavanit, tej kornizës është e thjeshtë me dërrasa. Studjoja ndahet nga korridori nga një perde dërrasash.

Ambienti i tretë nga ana veriore e koridorit, ka karakter të ndryshëm në trajtimin e tij nga dy të parët. Ai është i veçuar nga ato dhe ngrihet drejtpërdrejt mbi hajatin e hyrjes së katit përdhe. Ndriçohet nga tri dritare të mëdha në faqen perëndimore, që dalin në oborin e banesës (Fig. 8). Tavani është i suvatuar dhe në përgjithësi është i zhveshur nga elementë të tjerë arkitektonikë e dekorativë. Dritaret janë të veçuara nga njera tjetra, të qarkuara si nga jashtë ashtu dhe nga brenda me fashatura të holla anash, ndërsa nga sipër me një fashaturë të gjerë që përfundon me një kornizë të dalë. Kanatat janë dyshe me hapje vertikale mbi njëra tjetrën.

Koridori ndërlidhës i ambienteve ka tavan dërrase. Ndriçohet nga dy dritare të mëdha që dalin në oborrin e banesës, ndërsa një e tretë sheh në anën perëndimore (Fig. 9). Në pjesën fundore të tij është sajuar një ambient i vogël.

Trajtimi arkitektonik i jashtëm i banesës është përgjithësisht i thjeshtë. Pamja kryesore lindore, që del në rrugë është e varfër me elementë arkitektonikë. Në të dalin vetëm dy dritare dhe porta e hyrjes, e gjithë faqja është e suvatuar (Fig. 10). Nga një varfëri e tillë, krijohet përshtypja e një muri të verbër që fsheh edhe strukturën e brendëshme të banesës. Disi më të pasura janë pamjet nga obori, që gjallërohen nga hajati i hapur dhe dritaret në ka-



Fig. 9



Fig. 10

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

Fig. 13



tin e dytë. Çatia e mbuluar me tjegulla vendi përfundon në një strehë të hapur, të dalë mjaft tej rafshit të mureve nga zgjerimi i trarëve të tavanit. Bishtat e strehës janë të gdhëndura, por profili i tyre ndryshon në mbulesën e çdo ambienti.

Nga ana teknike banesa ishte në gjëndje mjaft të degraduar. Lënda e çatisë në pjesën më të madhe ishte e kalbur. Kjo kishte sjellë deformime mjaft të dukëshme në tavanet e dy ambienteve kryesore. Strukturat mbajtëse të ndarjes së kateve kishin pësuar cedime dhe përkulje. Si rrjedhim dyshemeja e studios dhe ajo e koridorit kishin shmangje të mëdha nga rrafshi horizontal. Dëmtime serjoze u vunë re edhe në muraturën prej guri në katin përdhe, në qoshen juglindore të banesës, ku muri i lidhur me baltë e breza druri kishte dhënë shtytje. Në përgjithësi strukturat mbajtëse prej druri paraqiteshin mjaft të dëmtuara.

Të dhënat nga sondazhet dhe zhveshjet

Nga të dhënat gojore që mundëm të mbledhim paraprakisht rezultoi se banesa kishte pësuar transformime të herëpasherëshme. Ndryshime të rëndësishme pësoi ndërtesa mbas tërmetit të vitit 1930, dhe më vonë, për nevoja jetese nga vetë banorët. Një fotografi e vjetër e familjes, ndonse e fragmentuar mbështeste plotësisht të dhënat gojore, se banesa ka qënë e tipit të hapur me çardak të ngushtë që sheh nga oborri (Fig. 11).

Të dhënat e grumbulluara na dhanë një ide të përgjithshme mbi karakterin tipologjik të banesës. Por këto të dhëna duheshin saktësuar, duhej të zbuloheshin materiale të tjera faktike, të cilat do të qartësonin më tej idenë e formuar, që të hidhnin dritë qoftë mbi karakterin tipologjik, qoftë në atë morfologjik, pra në trajtimin e çdo elementi kompozicional, arkitektoniko-konstruktiv dhe dekorativ. Ky saktësim do të përcaktonte në fund të fundit shkallën e ndërhyrjeve restauruese, si dhe vërtetësinë e restaurimit.

Koridori. U fillua me zhveshjen e suvatimeve në koridorin e ngushtë në murin verior të saj. (Tab. II), për të vërtetuar në se ruheshin elementë të çardakut të dikurshëm apo jo. U vu re se suvatimi nuk ishte origjinal, d.m.th. me teknikën e vjetër me shtresë baltë me kashtë dhe me një patinim të hollë gëlqereje. Gjithashtu dhe çatmaja me paretka dërrase nuk ishte e mbërthyer me gozhdë kovaçi, sipas teknikës së vjetër, por me gozhdë të reja, ose «gozhdë fabrike». Mbas heqjes së veshjes së re me paretka u zbuluan tre kollona druri me «jastekë» ose kapitele të gdhendur (Fig. 12). Kapitelet ishin origjinale, prej pishe, por

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 16



Fig. 15

mjaft të dëmtuar. Nga shtyllat ajo e mesit ishte origjinale prej lisi me qoshe të gdhendura.

Faqja tjetër përmbante elementë të vjetër më të shumtë. Edhe kjo faqe ruante ndarjen me katrorë të kornizuar me fashatura dërrase, të njëllojtë me ato të ambientit të banimit (Tab. II). Dy nga këta katrore ishin të zënë me kallama (Fig. 13), ndërsa pjesët e tjera me paretka dërrase të mbërthyera me gozhdë kovaçi, pra sipas teknikës së vjetër. Largimi i veshjes me kallama nxori në dritë dy hapësira dritaresh të dikurshme (Fig. 14), nga ndriçohej dhoma nëpërmjet çardakut. Në këto hapësira ruheshin të pa prekura kasat e dritareve. Kasat me ndarjet e tyre jepnin të qartë strukturën e hapësirës së dritës, e cila përbëhej nga kanati i dritares me xhama dhe kanati prej dërrase, të dy këta elementë me rëshqitje horizontale në hapësirën e lënë për këtë qëllim ndërmjet dy parateve të çatmasë. Vrimat e hapura në kasë dhe coprat e drurit të mbetura në to dëshmonin se hapësirat e dritës ishin të paisura në pjesën e jashtëme me një kafaz kuadratik druri (Fig. 15).

Në këtë faqe u zbuluan gjithashtu dhe dy dritare të vogla, rrafsh me dyshemenë, prej nga mirte dritë dhe ajrosej ambienti poshtë në katin përdhes. Këto dritare ishin të thjeshta, të mbrojtura nga shufra hekuri vertikale.

Heqja e petavrave dhe dërrasave nxorën në pah konstruksionin mbajtës të çardakut. Mbi kollonat në hajat kalonte trau mbajtës gjatësor, mbi të cilin mbështeteshin trarët tërthorë të çardakut ose trarët e dyshemesë. Trarët tërthorë dilnin tej rafshit të traut gjatësor dhe të gjithë i kishin kokat e prera (Fig. 16). Mjaft prej tyre përmbanin shenjat e një gdhendjeje që dëshmonin për një përpunim dekorativ të tyre





Fig. 24 Fig. 25



Fig. 26

shme u shoqëruan nga sondazhet edhe në anën e jashtëme. Hapja e suvasë në këtë faqe zbuloi fashaturat që kornizonin bllokun e dritareve. Ky bllok mbyllej në bashkimin e çatmasë me qoshen e murit jugor, për të cilin dëshmonte zgjatimi i fashaturës së sipërme, prerja në një kënd 45° e saj, si dhe një ton i errët në paretkat e çatmasë, në vëndin ku mbërthehej fashatura vertikale (Fig. 23). Niveli i fashaturave të zbuluara në anën e jashtëme përputhej plotësisht me nivelin e atyre të anës së brëndëshme.

Faqja jugore e studios nuk dha ndonjë element të ri. Përkundrazi zhveshja e faqes perëndimore zbuloi gjurmët e dy nikeve të mëdha për dollape muri (Fig. 24), një oxhak në pjesën qëndrore dhe dy kamare anash tij (Fig. 25), të gjithë këta elementë të murosur. Gjurmët e suvasë në faqet e këtyre elementëve na dhanë të kuptojmë se dikur ato kanë qenë në funksionim dhe në një kohë të dytë janë mbyllur, duke ndërtuar elementë të tjerë në murin jugor.

Siç u vu re dhe më sipër gjurmë të qarta dëshmonin për ekzistencën e musandrave në pjesën veriore të ambientit por elemente të tij që të jepnin mundësinë e një rikonstruksioni nuk kishin mbetur.

Ambienti mbi pus. Në pamjen e jashtëme veriore ruheshin elementë të dy dritareve, të cilat ishin të zëna. Mbasi u hapën doli se ato kishin të njëjta përmasa dhe përpunim me dritaret e faqes perëndimore. Ndonëse faqja lindore në vështrimin e parë nuk ruante asnjë gjurmë, heqja e suvasë nxori në dritë dy dritare, një oxhak dhe nike anash tij (Fig. 26).

Zhveshjet në këtë ambient na dhanë të dhëna edhe mbi teknikën e ndërtimit dhe dyshemetë e ndodhura në të. Kështu p.sh. në çatmanë perëndimore si paretka gjënden shumë elementë të përpunuar, elementë këto të ripërdorura nga dritaret, dollapët, fashaturat, listelat e tavaneve etj. të dikurshme. Në ndryshim me këtë faqe çatmaja ndarëse e koridorit ishte origjinale. Konstruksioni përbëhej prej dy trarëve me vrima ku futeshin kunjat e shtyllave vertikale. Kjo çatma vazhdonte mbi nivelin e tavanit, duke krijuar një kallkan ndarës në hapësirën e çatisë.

Hajati. Këtu bëmë sondazhe në bazamentin e kollonave prej druri të hajatit për të përcaktuar kuotën fillestare të hajatit dhe mënyrën e mbështetjes të kollonave. Bazamenti përbëhej nga një themel i vazhduar. Mbi themel ishin vendosur gurë me vrima, të cilat shërbenin si bazamente të kollonave prej druri (Fig. 27). Kollonat origjinale prej lisi kishin të gdhëndura në fundet e tyre kunja. Distanca ndërmjet bazamenteve përcaktoi hapësirën ndërmjet kollonave. Qoshja ndërmjet dy drejtimeve të themeleve ishte prishur, duke vendosur në këtë vënd, në një kohë të vonë, një kollonë prej guri (Fig. 28).

Pamjet e jashtëme. Përveç sondazheve të kryera në pjesët e jashtëme, për të cilat u bë fjalë më sipër, me interes janë dhe të dhënat e përfituara

DO NOT COPY

nga zhveshja e pjesës tjetër të faqes lindore. Një suvatim i trashë kishte fshehur fakturën origjinale të muraturës. Muratura e ndërtuar me gurë të çregullt, e lidhur me baltë dhe e përforcuar me breza druri ishte fugatuar me gëlqere, duke lënë në dukje vetëm një pjesë të gurëve.

Në pjesën qëndrore të faqes lindore, në përfundim të koridorit ose hapësirës së shkallëve, u zbuluan dy radhë me trarë druri, të vendosur njeri mbi tjetrin, të prerë rrafsh me murin (Fig. 29). Mbyllja e muraturës me çatma në këtë pjesë ishte e mëvonëshme. Nga ana tjetër një konstruksion i tillë na sygjeronte për ekzistencën e një qoshku të dalë, të mbajtur nga bishta druri.

Çatia. Zbulimi i çatisë na njohu me konstruksionin e saj dhe me ndryshimet që ka pësuar. Mbi të tre pjesët kryesore, dmth mbi çdo ambient, nuk ishte i njëjti konstruksion. Mbi «dhomën e pritjes» kalojnë katër trarë të mëdhenj. Në ta janë mbërthyer bishtat që krijojnë radhën e parë horizontale të strehës së çatisë.

Trarët e tavanit të çardakut dhe studios ishin vendosur rreth 60 cm. larg njëri tjetrit dhe dilnin rreth 50 cm. tej rafshit të murit, për të krijuar strehën e çatisë. Profilimi i kokëve të bishtave të strehës mbi çardak dhe dhomës të pritjes ishte i ndryshëm me atë të strehës mbi studion. Në çatinë e ambientit mbi pus dukej që ishte bërë një rikonstruksion i përgjithshëm, duke zëvendësuar pa kriter të gjithë elementët e vjetër. Bishtat e strehës së çatisë ishin bashkangjitur me trarët e tavanit dhe ishin përpunuar mjaft dobët.

Konstruksioni i çatisë ishte me «ura», dmth me radhë trarësh horizontale të mbajtur nga baballëkë, mbi të cilat mbështeteshin «makazet» ose binarët tërthorë. Qoshja jugëperëndimore e çatisë ruante strukturën fillestare të paprekur. Këtu vihej re se të gjithë «makazet» janë të prerë rafsh me përfundimin e strehës horizontale të çatisë (Fig. 30).

Gjetje të rastit. Të tilla gjetje, siç e vumë në dukje dhe më sipër, u gjetën me shumicë. Por nga ato që nuk ndodheshin në vëndin e tyre, disa elementë paraqisnin interes të veçantë për të ndriçuar disa pika ende të errta në morfologjinë e banesës.

Një copë binari e gdhendur dhe me kllapë saktësoi mënyrën e bashkimit të parmakut me kollonat e çardakut. Gjithashtu u gjendën elementë të parmakut, një pjesë e binarit të sipërm me kllapa dhe disa binarë vertikalë me kunja në të dy krahët. Këto elementë përcaktonin plotësisht rikonstruksionin e parmakut të çardakut.

Disa copa binarësh të gdhendur me përmasa të

DO NOT COPY



Fig. 27



Fig. 28



Fig. 29

DO NOT COPY



Fig. 30

njëjta, me planin e prerjes që formonte një farë këndi me fibrat, na bënin të mendonim se këto do të ishin pjesë të prera nga radha e dytë e strehës të çatisë (Fig. 31). Dhe me të vërtetë seksioni i këtyre binarëve është i njëjtë me atë të «makazeve» të qosheve origjinale të çatisë, ndërsa plani i prerjes të të dy pjesëve, «makazeve» dhe copave, përputhej plotësisht. Në këtë mënyrë u përcaktua se streha e çatisë ishte dyfishe dhe se për radhën e dytë të strehës ekzistonin përmasat e daljes, profili i gdhendjes dhe distanca ndërmjet bishtave.

Dy trarë me kokë të gdhendur dhe me dy kllapa në të njëjtën distancë të gjetura në çati përcaktonin daljen e qoshkut nga plani i murit lindor (Fig. 31).

Së fundi u gjetën një pjesë e mirë e një kanati dritareje me përmasat e hapësirave të dritareve të studios, me të gjithë elementët përbërës prej druri dhe metalike, si dhe një dritare origjinale me përmasat e hapësirave të dhomës së pritjes. Dritarja ishte me përvazo të gjëra, me kanale që përfshinin brenda tyre xhamat.

Vlerësimi i sondazheve dhe zhveshjeve dhe përcaktimi i ndërhyrjeve restauruese.

Të dhënat paraprake të mbledhura, të mbështetura dhe të plotësuara në përfundim të sondazheve dhe zhveshjeve qartësuan tërësisht karakterin e banesës, me të gjithë elementët e saj përbërës.

Fazat e ndërtimit. Pa marë në konsideratë ndryshimet e bëra gjatë këtij shekulli dhe meremetimet e herëpasherëshme, si mbylljen e çardakut, prishjen e qoshkut, mbylljen e dritareve në pamjen lindore dhe hapjen e një dritareje të madhe në vend të tyre, zënjen e nikeve etj. rezulton se banesa ka kaluar nëpër disa faza të rëndësishme ndërtimi.

Ndër pjesët më të vjetra të mbetura duhet të



Fig. 31

jetë pjesa perëndimore e banesës, d.m.th. dhoma e pritjes, ambienti jashtë tij dhe çardaku me hajatin përpara. Studjoja duhet të jetë e një faze të dytë, fazë kjo që lidhet me ndryshime në kompozimin e përgjithshëm të ambientit. Gjatë kësaj janë mbyllur oxhaku dhe dollapet në murin perëndimor dhe janë hapur elementë të tillë në faqen jugore. Gjithashtu është ndryshuar konstruksioni i çatisë dhe së bashku me të profili i gdhendjes së strehës.

Ambienti mbi pus i takon një faze të tretë ndërtimi. Nuk mund të themi me siguri në se ky ambient është shtresë në volumin fillestar, apo transformim i ndonjë ambienti ekzistues. Sidoqoftë trajtimi i këtij ambienti është bërë në frymën e kohës së vet. Këto trajtime si ambiente me shumë dritare, me një trajtim të tillë të dritareve të veçuara dhe të përpunuara secila më vete, si dhe me një thjeshtësi në trajtimin e brendësisë fillojnë e takohen në Korçë gjatë viteve 50 – 60-të të shekullit të kaluar.

Lidhur me datimin e fazës së dytë mendojmë se data e zbuluar 1841, lidhet pikërisht me ndryshimet e bëra në këtë fazë, megjithëse data është e pikturuar në rozeten e tavanit të dhomës së pritjes. Por të njëjtën datë e gjejmë të shënuar në kanalin prej dërrase që i përket hapësirave të dritares të studios.

Ndërsa faza e parë me të dytën ka ndryshime, fryma e trajtimit është e njëjtë. Kjo varet në trajtimin e elementëve arkitektonikë e dekorativë, në qarkimin e mureve dhe dollapëve me fashatura dërrase, në bllokun e pashkëputur të dritareve edhe në pamjet e jashtëme, në konstruksionin e tyre etj. tipare këto që nuk i gjejmë më të aplikuara në banesat e tjera pak të mëvonëshme, siç është një banesë e datuar në vitin 1842 në afërsi të kësaj banese, ndonëse ka mjaft elementë të ngjashëm.

Kriteret e ndjekura për restaurimin e banesës. Të dhënat e mbledhura dhe të zbuluara na lejonin tashmë të mendonim për disa kritere që do të ndiqnim për restaurimin e kësaj banese. Në radhë të parë duhej marë në konsideratë data 1841. Kjo është një nga datat më të hershme të zbuluara deri tani në banesat e Korçës. Nga ana tjetër banesa është e një tipi, ekzemplarët e të cilit nuk kanë mbetur të shumtë deri në ditët tona. Prandaj kthimi i saj me gjendjen fillestare do të krijonte një pikë referimi të sigurtë për studimet e mëtejshme reth karakterit të banesës Korçare në gjysmën e parë të shek. XIX.

Siç e pamë banesa në kohë ka pësuar ndryshime të rëndësishme ndër të cilat tre fazat kryesore të ndërtimit janë më të formuara. Ndryshimet kanë prekur dhe janë grupuar kryesisht në pjesë të caktuara të kompozimit planimetrik dhe ato bartin në



Fig. 32

vetvehte elementë të ndryshëm të kohës. Nga ana tjetër, të dy fazat e para ndonëse kanë ndryshime ndërmjet tyre, trajtimi i tyre është mjaft i përafërt. Ndërsa faza e tretë del si volum i shkëputur nga dy të parat dhe nuk cënon unitetin arkitektonik të gjithë banesës. Si të tilla ato na duken me vlerë për ti ruajtur dhe ndërmjet tyre të dokumentohen tiparet arkitektonike të periudhave të ndryshme. Gjithashtu dhe të dhënat e nxjera gjatë sondazheve dhe zhveshjeve e bënë të mundur në një masë të madhe sigurie rikonstruksionin e tri fazave kryesore të ndërtimit (Tab. III).

Duke patur parasysh destinacionin e ardhëshëm të banesës, si galeri arti e veprave të piktorit (Fig. 32), u lanë në gjendjen e gjetur disa elementë, të cilët ishin ndryshuar mbas fazës së tretë të ndërtimit. Ndër to janë shkallët për në katin e dytë, megjithse u grumbulluan të dhëna mbi vendin dhe formën e tyre të dikurshme si dhe u la pa prishur nikja imtime e piktorit në studio.

Këta faktorë përcaktuan detyrat e ndjekura për restaurimin e kësaj banese. Punimet restauruese nda-

DO NOT COPY



Fig. 33



Fig. 35



Fig. 34

hen pra në punimet e konsolidimit të strukturave të dëmtuara dhe në punime vlerësuese, për t'i rikthyer monumentit gjendjen në fund të fazës së tretë të ndërtimit. Ndryshimet e bëra mbas fazës së tretë janë plotësisht të mundëshme. Nga këto vendosëm që të çlirohej banesa nga shtesat ose mbylljet me dritare, nike, oxhake etj. të hapej çardaku, të rikonstruktohej qoshku, të riformulohej pamja lindore, të plotësohej radha e dytë e strehës, të sistemoheshin elementë të tjerë të veçantë si parmaku i çardakut, rozetat e dritareve, kanatat dhe kapakët e dritareve, trajtimi i muraturës nga jashtë etj.

Punimet konsoliduese të konstruksionit u përqëndruan në muraturë, në rindërtimin e një pjese të murit lindor dhe përfundimin e muraturës në murin jugor, në strukturat prej druri që ishin mjaft të dëmtuara, në rikonstruksionin e çatisë, të çatmasë lindore, në tavanet e ambientëve kryesorë dhe të çardakut e hajatit, në dyshemetë e ambienteve si dhe në zëvendësimin e mjaft elementëve të veçantë të dëmtuar rëndë. Gjatë këtyre punimeve, me qenë se në kompozimin planimetrik nuk u vu dorë, një kujdes i veçantë iu kushtua ripërtëritjes të elementëve morfologjikë të banesës. Çdo element u përpunua simbas modelit të vjetër të gjetur dhe, për ta bërë më bindës restaurimin, për çdo element u lanë pjesë të vjetra si dëshmi e ndërtimit të hershëm (Tab. IV, V, VI). Kështu të tilla pjesë të vjetra janë lënë në elementët e prekur më tepër, si në strehët e çatisë, në kolonatën e hajatit dhe çardakut, në tavanet e ambienteve, në dritaret, në parmakun e çardakut. (Tab. VII) etj. së bashku me elementët e tjerë të paprekur, si dyer, fashatura, dritare, rozetat e tavaneve etj.

DO NOT COPY



Fig. 36



Fig. 37



Fig. 38

DO NOT COPY

Vlerësimi i banesës mbas restaurimit

Banesa është vënë në mbrojtje shtetërore për vlerat e saja të karakterit historik, si banesa e piktorit të mirënjohur, artistit të popullit Vangjush Mio. Por mbas punimeve restauruese dolën në dritë dhe vlerat e padiskutueshme dhe në planin arkitektonik (Fig. 33).

Banesa është e tipit të hapur me hajat në katin përdhes (Fig. 34) dhe me çardak në katin e dytë (Fig. 35). Lidhja ndërmjet kateve ka qenë me shkallë të thjeshta, të përbërëra prej dy trarëve që mbanin shkelsat prej dërrase. Hapësira e shkallëve hapej në dyshemenë e çardakut. Hapësira e ngushtë e çardakut i jep këtij më tepër karakterin e një ambienti ndërlidhës. Ai shtjellohet përpara ambientëve të banimit, të cilat nxjerin në çardak dyert, ndërsa dhoma e pritjes edhe dritaret (Fig. 36). Në fund të çardakut shkëputet dhe del mbi rrugë qoshku i mbyllur (Fig. 37).

Banesa del me një faqe në rrugë duke marë pjesë aktive në formulimin e saj (Fig. 38). Pamja e banesës nga ana lindore gjallërohet nga dritaret e shumta në katin e sipërm, qoshku i dalë mbi rrugë, nga trajtimi dekorativ i elementëve konstruktivë, si streha e dalë dhe e gdhendur e çatisë, faktura e muraturës dhe kombinimi me elementët prej druri. Elementët drusore janë të pranishëm si në pamjet e brëndëshme ashtu dhe në ato të jashtëme. Dritaret nuk qëndrojnë të veçuara, por lidhen me njëra tjetrën (Fig. 39), duke lënë edhe sipërfaqe të plota e të bardha dhe krijojnë në këtë mënyrë një brez unik të pasur në të gjithë sipërfaqen e murit. Një brez i tillë gjallëron mjaft dhe pamjen lindore, ku megjithse mbizotëron muratura e gurit; nëpërmjet të planeve dhe volumeve është aritur në një zgjidhje të goditur arkitektonike.

Karakteristikë në formulimin arkitektonik është se konstruksioni mbajtës prej trarësh dhe kollonash është i zbuluar dhe se çdo element konstruktiv prej druri është i përpunuar nga ana dekorative. Tek kapitelet e kollonave, vetë kollonat, bishtat mbajtës të çardakut (Fig. 40) dhe qoshet, si dhe tek bishtat e strehës së çatisë ndonse ndjehet përkujdesja për trajtimin e tyre dekorativ, ky trajtim nuk e konfondon aspak funksionin e tyre primar si elemente konstruktivë.

Çardaku hapet nga ana e oborrit. Megjithëse me përmasa të vogla, ai arrin të krijojë një lidhje të ngushtë si nga ana figurative ashtu dhe funksionale,

8672



Fig. 39

duke krijuar një tërësi hapësirore: oborri, çardaku dhe më tej ambienti i banimit që hap dritaret në çardak e hajat.

Pjesmarja e banesës në formulimin e rrugës duke nxjerë një faqe në të, ngjeshja e banesave me njera tjetrën, e diktuar nga ekonomizimi i truallit e ndërtimit, janë disa nga karakteristikat e banesës korçare. Këto kanë kushtëzuar dhe daljen e detyruar të çardakut, në këtë rast nga ana veriore, një orientim ky jo fort i zakonshëm për këtë element.



Fig. 40

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESA E PIKTORIT VANGJUSH MIO - KORÇE

GJENDJA PARA RESTAURIMIT



PAMJE PERENDIMORE



PAMJE LINDORE



PLANIMETRIA E KATIT II



PLANIMETRIA E KATIT I



PODRUMI



BANESE E PIKTORIT VANGJUSH MIO KORÇE
DETAJE TE NDRYSHME NE KATIN E II TE DALA PAS SONDAZHEVE



FAQJA "A"



FAQJA "C"





FAQJA "B"



FAQJA "E"

FAQJA "D"





FAQJA "F"

DO NOT COPY

DO NOT COPY



BANESE E PIKTORIT VANGJUSH MIO
GJENDJA PAS RESTAURIMIT

PLANIMETRIA E KATIT I



PODRUMI



PLANIMETRIA E
KATIT PERDHES

DO NOT COPY

BANESA E PIKTORIT VANGJUSH MIO
KORÇE GJENDJA PAS RESTAURIMIT



PRERJE A-A



DETAJ DRITAREJE

BANESA E PIKTORIT VANGJUSH MIO - KORÇE
GJENDJA PARA RESTAURIMIT

PRERJE A-A





PRERJE B-B

0 1 2 3 m.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESE E PIKTORIT VANGJUSH MIO
KORÇE - GJENDJA PAS RESTAURIMIT



PAMJE LINDORE



PRERJE B-B

0 1 2 m.

DO NOT COPY



KONSTRUKSIONI I STREHES DYSHE



DETAJ I KONSTRUKSIONIT TE ÇARDAKUT

BANESE E PIKTORIT
VANGJUSH MIO
GJENDJA PAS RESTAURIMIT



STREHA E ÇARDAKUT



KONSTRUKSIONI I QOSHKUT



DETAJ "B"



DETAJ I ÇASTEKUT



DETAJ "C"



DETAJ "Ç"



KORNIZA E STREHES



TAVANI I ODES MIRE



ELEMENTE TE ÇARDAKUT

Pirro THOMO

DO NOT COPY

RESTAURATION DE LA MAISON DU PEINTRE VANGJUSH MIO A KORÇE

RESUME

La maison du peintre Vangjush Mio, artiste du peuple, se trouve dans un des anciens quartiers du «Varosh» de Korçe. Elle avait été convertie en galerie pour y exposer les ouvrages du peintre. A son état précédant, les travaux de restauration, elle conservait les traces des changements qu'elle avait subis dans le temps et des reconstructions successives, qui en avaient altéré l'aspect initial. Par ailleurs, cette habitation se trouvait dans un mauvais état technique, ce qui imposa la nécessité d'intervenir par des travaux de restauration. En nous fondant sur les témoignages des gens du pays et sur certains éléments conservés encore, nous avons formé la conviction que nous étions en présence d'un type d'habitation ancien, dont les exemplaires sont rares dans la ville de Korçe et, même ceux qui existent encore, ont généralement subi des transformations profondes. Ainsi, partant de la fonction de cette habitation et de son état, en 1977 furent entamés les travaux de restauration. Au cours de ces travaux, en pénétrant dans la profondeur du monument, nous avons découvert une foule de données servant à éclaircir le caractère typologique et morphologique de ce type ancien d'habitation pour la ville de Korçe, entièrement inconnu jusqu'alors.

Ces circonstances ont déterminé aussi les critères essentiels de sa restauration, dont les résultats sont illustrés par l'auteur dans cet article.

Les données préliminaires recuillies, en plus des données obtenues à la suite des sondages et des autres opérations effectués, ont éclairci entièrement le caractère de cette habitation, avec toutes ses composantes.

Les phases de construction. *En dehors des changements intervenus durant ce siècle et des réparations successives, entre autres la fermeture du* tchardak, *la destruction du* qoshk, *le fait d'avoir boucher les fenêtres qui donnaient vers l'est et d'avoir ouvert à leur place une grande fenêtre, d'avoir clôturer les niches, il ressort que cette habitation a connu diverses phases de construction importantes.*

La partie occidentale de cette habitation comprend les anciennes pièces qui en sont restées, et ce sont le salon, la pièce hors de celui-ci et le tchardak *ayant par devant un hayat. L'atelier de l'artiste doit appartenir à une deuxième phase de construction, qui a entraîné des modifications dans la composition générale de la pièce. Au cours de cette phase ont été bouchées la cheminée et les armoires à mur aménagées dans le mur ouest, en les reproduisant cependant sur la face méridionale. Par ailleurs, la construction du toit et le profil des auvents ont connu, eux aussi, des modifications.*

La pièce, qui surmonte le puits, appartient à une troisième phase de construction. On ne peut affirmer avec certitude si cette pièce est une adjonction faite au volume initial, ou s'il s'agit de la modification de quelque autre chambre. Néanmoins, la pièce en question a été traitée dans l'esprit de l'époque. Les chambres sont à plusieurs fenêtres, chacune d'elles est traitée séparément, l'intérieur aussi est simple; c'est là le style caractéristique des années '50'60 du siècle passé à Korçe.

Quant à la datation de la deuxième phase, nous pensons que la date de 1841, quoique mise à jour dans la rosette du plafond de la salle de réception, se rapporte justement aux modifications effectuées durant cette phase. Cette date figure aussi dans la cannelure de bois de la fenêtre de l'atelier de l'artiste.

Quoique la première phase diffère de la seconde, leur traitement se caractérise par un esprit identique. En témoignent le traitement des éléments architectoniques et décoratifs, les murs e les armoires qui sont entourées de planchettes ornementales, les fenêtres qui constituent un bloc ininterrompu même de l'extérieur, etc. Ce sont là des traits que l'on ne retrouve plus même dans les habitations construites quelques années plus tard, exemple le cas d'une maison construite en 1842 à proximité de la précédente, bien qu'elles aient plusieurs éléments communs entre elles.

Domain

Les critères suivis pour la restauration de l'habitation. *Les données recueillies par les gens du pays et celles obtenues directement sur place, nous ont créé la possibilité de définir les critères à suivre pendant les travaux de restauration. Tout d'abord il fallait prendre en considération la date de* 1841. *C'est là une des dates les plus anciennes découvertes à ce jour dans les habitations de Korçe. Par ailleurs, nous sommes en présence d'un type de maison dont les exemplaires sont devenus rares de nos jours. Aussi le fait de faire revenir cette habitation à son état initial ne pouvait pas ne pas constituer un point de référence pour l'étude plus approfondie des traits de l'habitation type de Korçe dans la prmière moitié du XIX*e *siècle.*

Comme nous venons de le dire, cette maison a connu des modifications importantes qui peuvent se résumer en trois phases principales. Ces modifications concernent princpalement certaines pièces de la composition planimétrique, elles portent en soi les divers éléments de l'époque. Par ailleurs, les deux premières phases, quoique non identiques entre elles, se caractérisent par un traitement presque égal. Alors que la troisième phase se caractérise par un volume disticnt des deux autres, qui n'affecte pas cependant l'unité architectonique de toute l'habitation. De ce fait, à notre avis, ce sont là des éléments de valeur qu'il convient de conserver, d'autant plus qu'ils nous permettent de documenter les traits architectoniques de différentes périodes. Par ailleurs, les données obtenues à travers les sondages et les autres opérations nous ont permis de documenter encore mieux les trois différentes phases de reconstruction (Tab. III).

Compte tenu de la destination future de cette habitation, en tant que galerie d'art des ouvrages du peintre (Fig. 32), nous n'avons pas touché à certains éléments, qui avaient subi des modifications après la troisième phase de construction. De leur nombre mentionnons l'escalier menant au deuxième étage, bien que nous ayons recueilli des données sur leur disposition et leur forme antérieures, la niche intime du peintre dans son atelier.

Ces facteurs ont déterminé les tâches qui ont été mises en oeuvre pour la restauration de cette habitation. Les travaux de restauration se répartissent donc en travaux de consolidation des structures détériorées et en travaux de mise en valeur, afin de faire revenir cette habitation à l'état qui était le sien à la fin de la troisième phase de construction. Les modifications effectuées après la troisième phase peuvent être entièrement éliminées. Aussi, il a été décidé de libérer l'habitation des adjonctions ou d'ouvrir les fenêtres, les niches, les cheminées, etc. bouchées, d'ouvrir le tchardak, *de reconstruire le* qoshk, *de reformuler la façade est, de compléter la deuxième rangée des auvents, de procéder à l'arrangement des autres éléments particuliers comme la rampe du* tchardak, *les rosettes des fenêtres, les battants et les couvercles des fenêtres, le traitement de la maçonnerie extérieure, etc.*

Les travaux de consolidation ont concerné principalement la maçonnerie, la reconstruction partielle du mur est et la conclusion de la maçonnerie du mur sud, la réparation des structures de bois particulièrement endommagées, la reconstruction du toit, de la paroi est, des plafonds des pièces principales ainsi que du tchardak *et du* hayat, *des planchers des différentes pièces, et la substitution des éléments gravement endommagés. Au cours de ces travaux on n'a pas touché à la composition planimétrique, aussi un soin extrême a-t-il été consacré à la recomposition des éléments morphologiques de l'habitation. Chaque élément a été traité suivant l'ancien modèle récupéré et, pour rendre la restauration plus convaincante, dans chacun d'eux on a laissé des anciens éléments en tant que témoignage de la construction antérieure (Tab. IV, V, VI). De tels éléments anciens ont été laissés dans les éléments les plus gravement touchés, exemple les auvents du toit, la colonnade du* hayat *et du* tchardak, *les plafonds des différentes pièces, les fenêtres, la rampe du* tchardak *(Tab. VII), etc., ainsi que d'autres éléments non détériorés comme portes, planchettes, fenêtres, rosettes de plafond, etc.*

Mise en valeur de l'habitation après sa restauration. — *Cette habitation, en raison de ses valeurs de portée historique et en tant qu'habitation de l'illustre peintre Vangjush Mio, artiste du peuple, a été placée sous la protection de l'Etat. Mais les travaux de restauration ont mis en lumière les valeurs indiscutables de cette maison sur le plan architectonique aussi (Fig. 33).*

Nous sommes en présence d'une habitation de type ouvert, à hayat *au rez-de-chaussée (Fig. 34) et à* tchardak *au deuxième étage (Fig. 35). Les deux étages communiquent entre eux à travers un escalier de facture simple, comportant deux poutres qui supportent les marches. L'ouverture de l'escalier donnait sur le plancher du* tchardak. *L'espace étroit du* tchardak *en fait plutôt une pièce intermédiaire. Il se développe par devant les pièces de l'habitation, dont les portes s'ouvrent sur le tchardak, alors que le salon donne sur celui-ci ses fenêtres aussi (Fig. 36). Dans la partie terminale du* tchardak, *un* qoshk *fermé fait saillie et donne sur la rue (Fig. 37).*

Une seule des façades de la maison donne sur la rue et participe activement à sa formulation (Fig. 38). Du côté est l'aspect de la maison devient plus vive en raison des nombreuses fenêtres du premier étage et du qoshk *qui donnent sur la rue, en raison du traitement décoratif des éléments de construction, comme les auvents en saillie agrémentés du toit, la facture de la maçonnerie combinée à des éléments de bois. Les éléments de bois on les retrouve à l'exterieur comme à l'intérieur. Les fenêtres ne sont pas séparées les unes des autres, mais reliées entre elles (Fig. 39); on relève aussi des surfaces entières blanches, qui créent ainsi une bande unique très réussie sur tout le parement du mur. Cette bande donne plus de vie à toute la façade orientale, bien que celle-ci soit de maçonnerie de pierres; à travers les plans et les volumes, les constructeurs populaires ont réussi à trouver une solution architectonique réussie.*

La formulation architectonique se caractérise par le fait

que la construction portante des poutres et des colonnes n'est pas couverte et que chaque élément de construction en bois est travaillé du point de vue de la décoration. En dépit du soin accordé au traitement décoratif des chapiteaux des colonnes, des colonnes elles mêmes, des bouts portants du tchardak (Fig. 40) et de ses angles, ainsi que des extremités de l'auvent du toit, les éléments de construction conservent entièrement leurs fonctions primaires.

Le tchardak regarde du côté de la cour. Bien que de dimensions petites, il réussit à créer un lien étroit du point de vue figuratif comme du point de vue fonctionnel, en constituant un espace bien délimité: la cour, le tchardak et, un peu plus loin, la pièce destinée à être habitée dont les fenêtres s'ouvrent sur le tchardak et le hayat.

La participation de l'habitation à la formulation de la rue, en y exposant une de ses faces, les maisons qui tiennent l'une à l'autre, afin d'épargner le terrain de construction, – voilà certaines des traits de la maison type de Korçe. Ce sont justement ces caractéristiques qui ont conditionné la position imposée en saillie du tchardak, en l'occurance du côté nord, une orientation qui n'est pas habituelle pour cet élément.

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

DO NOT COPY

RISHTYLLËZIMI I PAMJES KRYESORE TË MONUMENTIT TË AGONOTETEVE NË APOLONI

Monumenti i Agonoteteve, zbuluar shumë vjet më parë, bënte pjesë në një kompleks arkitektonik, ndërtuar rreth shekujve të parë të erës sonë. Ai përfaqësonte një monument përkujtimor dhe shërbente njëkohësisht për mbledhje dhe çfaqje kulturore-artistike. Një mbishkrim i gdhendur në gurët e arkitraut të kolonadës, në gjuhën greke, bën të njohur se monumenti ka qënë ndërtuar, në kujtim dhe për nder të Villio Valentino Furio Prokulus, nga vëllai i tij i cili ishte funksionar i lartë i qytetit të Apollonisë.

Për vetë funksionet e tij, ky monument kishte një zgjidhje arkitektonike origjinale, pamja kryesore ka qenë trajtuar në bazë të parimeve të arkitekturës monumentale greko-romake kurse pjesa tjetër e ndërtesës dallohet për lidhje të ngushta me arkitekturën e ndërtimeve shoqërore romake. Në pamjen kryesore është përdorur orderi korintik me një dekoracion plastik të pasur, karakteristik për periudhën e fundit të përdorimit të tij në arkitekturën e lashtë. Monumenti ka një planimetri në formë drejtkëndore, me dy ambjente kryesorë, portikun të vendosur para hyrjes kryesore në tërë gjerësinë e ndërtesës dhe një sallë të madhe, brenda së cilës ishte ndërtuar një podium i shkallëzuar në formë patkoi.

Portiku i mbyllur, në dy krahët e shkurtëra, kishte një kolonadë mermeri, me katër kollona të lira dhe dy të mbështetura në antet (muret e qosheve anësore). Para hyrjes kryesore të monumentit janë ndërtuar me gurë të gdhendur shkallët që zenë vend në gjithë gjatësinë e kolonadës. Pamja kryesore e monumentit përfundon me një fronton të rrethuar nga një kornizë trekëndore, dekoruar me motive floreal e zoomorf të gdhëndura me mjeshtëri të përkryer.

Nga gërmimet arkeologjike[1] monumenti i Agonotetëve u gjet i rrëzuar nga një tërmet i fuqishëm, ndoshta nga tërmeti i vitit 345, i cili bëri dëmet e mëdha që shkaktoi në qytetet bregdetare të Adriatikut, përmendet nga shumë autorë të vjetër. Lëkundje të fuqishme sizmike me shtytje në drejtim të veriut e kishin rrëzuar njëherazi të gjithë konstruksionin e pamjes kryesore, disa metra larg mbi rrugën para monumentit. Ky monument arriti deri në ditët tona, thuajse në gjëndjen që doli në përfundim të gërmimeve arkeologjike.

Punimet e rishtyllëzimit të pamjes kryesore të monumentit të Agonoteteve u paraprinë nga një studim analitik që kemi bërë mbi gjëndjen, konstruksionin dhe arkitekturën e këtij monumenti. Studimi i botuar në faqet e kësaj reviste disa vjet më parë[2] shërbeu për hartimin e projektit të restaurimit dhe ndihmoi në mënyrë të dukëshme gjatë zbatimit të punimeve restauruese.

Projekti i restaurimit i bazuar në kritere shkencore parashikonte që vlerësimi arkitektonik i monumentit, nëpërmjet rishtyllimit të pamjes kryesore të tij, në radhë të parë të ishte në masën e kërkesave të domosdoshme për ndalimin e dëmtimeve të mëtejshme dhe njëkohësisht rishtyllëzimi të qëndronte në harmoni të plotë sa me rrënojat arkeologjike aqë edhe me ambjentin natyror (fig. 1, 2, 3) që rrethon monumentin.

---

1) Monumenti i Agonoteteve është zbuluar nga arkeologu francez Leon Rey. Rezultatet e gërmimeve ky autor i ka përmbledhur në një artikull të botuar në revistën Albania në vitin 1935.

2) K. Zheku, Monumenti i Agonoteteve Monumentet 4, 1972, f. 7-23.

DO NOT COPY



PAMJE KRYESORE (*Rikonstruksion*)



PLANIMETRIA E PORTIKUT

0 1 2 3 4 5m

Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

Në këtë punim kemi për qëllim të japim në mënyrë të përmbledhur, punimet e restaurimit të kryera në këtë monument si edhe rezultatet e arritura në përfundimin e këtyre punimeve*).

Gjëndja në të cilën ndodhej, për një kohë shumë të gjatë i shpërndarë në ambjent të hapur, ky monument me vlerë arkeologjike dhe arkitektonike, kërkonte një ndërhyrje të menjëhershme në dy drejtime kryesore (fig. 4, 5). Në radhë të parë, ishte problemi i konsolidimit të mureve perimetrale të ndërtesës si dhe nevoja e domosdoshme e rishtyllëzimit të kolonadës së portikut në pamjen kryesore. Në të dy rastet qëllimi kryesor ishte që të ruhej në kondita normale e të sigurta gjithçka trashëgohej nga ky monument, dhe njëkohësisht të viheshin në dukje të gjitha vlerat arkeologjike dhe arkitektonike të tij.

Elementet konstruktivë dhe arkitektonikë të gjetur e të lënë në vendin e rrëzimit nën veprimin e agjentëve atmosferikë nuk mund të shpëtoheshin nga dëmtimi i vazhdueshëm veçse me rivendosjen e tyre në vendet fillestare.

Ribashkimi i gjithë këtyre elementeve në një tërësi arkitektonike kërkonte domosdo edhe zëvendësimin e elementeve që mungonin ose që ishin të dëmtuar aqë shumë sa që nuk mund të ripërdoreshin si elemente konstruktivë. Në projektin e restaurimit theksohej se elementet që ishin të mangut, të ripunoheshin me përmasat e elementeve origjinalë të humbur por në forma të thjeshta pa imituar dekoracionin plastik, dhe me materialet e kohës sonë për tu dalluar me një herë nga pjesët origjinale (fig. 6).

Punimet e restaurimit për rishtyllëzimin e kolonadës së portikut dhe konsolidimit të mureve perimetrale të ndërtesës së monumentit të Agonoteteve u kryen gjatë viteve 1974-1978, duke punuar me ndër-

*) Ilustrimet grafike janë përpunuar nga autori dhe tushuar nga F. Guralumi, fotografitë nga autori, R. Veseli dhe H. Çollaku.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

prerje në periudha të ndryshme[3]. Gjatë vitit 1974 u punua për konsolidimin e blloqeve të gurëve të cilët u gjetën pjesërisht të dëmtuar ose të thyer në dy-tre pjesë. Në një sektor të veçantë u bë përgatitja e të gjithë elementeve konstruktivë e arkitektonikë për zëvendësimin e atyre që nuk u gjetën në vëndin e rrëzimit.

Për rastin e parë, blloqet e gurëve që u gjetën të plasur ose të thyer, u ngjitën duke përdorur si lidhje, kunja ose ganxha hekuri të fiksuara me plumb të shkrirë. Këto lidhje, në shumicën e rasteve u vendosën në brendësi të secilit bllok. Ka pasur edhe raste që sipas nevojës janë bërë lidhje me ganxha hekuri të vendosur në sipërfaqe të bloqeve të thyer. Lidhësat metalikë të përdorur kanë qenë në numër dhe përmasa të ndryshme sipas vëllimeve të blloqeve të dëmtuar.

Blloqet me dekoracione të kornizave të frontonit të cilët u gjetën të dëmtuar në pjesën e mbrapme të tyre u plotësuan në përmasat dhe vëllimin origjinal, me beton të armuar duke inkastruar shufra hekuri në masën e gurit të ruajtur. Këto plotësime u bënë vetëm në pjesët e mbrapme të pa dekoruara dhe ishin

3) Punimet e restaurimit u kryen nën drejtimin e autorit, nga Ateljeja e Tiranës me pjesëmarrje direkte të specialistëve dhe punëtorëve të mirëmbajtjes së monumenteve që punojnë në Apolloni.

DO NOT COPY

të domosdoshëm sa për vendosjen e secilit bllok në vendin përkatës aqë edhe për të krijuar mbështetje të sigurtë të blloqeve të radhëve të mësipërme. Blloqet e gurëve të cilët ishin të thyer pjesërisht në faqet e tyre të dukëshme, siç ishte rasti i blloqeve të qosheve të mureve të pamjes kryesore u lanë të pa plotësuar sigurisht në ato raste ku gjëndja e tyre nuk paraqiste rrezikshmërinë e dëmtimit të mëtejshëm nën presionin e peshave të gurëve që do të mbanin sipër tyre.

Në këtë mënyrë u riaftësuan të gjithë ata elementë konstruktivë e arkitektonikë që siç thamë u gjetën të dëmtuar, të plasur ose të mangët në vëllim, me përmasat origjinale.

Në sektorin e ngritur për përgatitjen e elementeve konstruktivë e arkitektonikë të parafabrikuara me beton arme, gjatë vitit 1974 u arrit që të prodhohen trupat e kollonave, kapitelet bazamentet që mungonin sikurse edhe të gjithë blloqet që duheshin për ringritjen e qosheve të mureve të pamjes kryesore të monumentit. Në përgatitjen e këtyre elementeve u respektuan përmasat ekzakte të parashikuara në projektin e rishtyllëzimit.

Pa hyrë në hollësi të proçeseve teknik të përdorur, shtojmë se në përbërjen e betonit, zhavorin e zakonshëm prej lumi e zëvendësuam me çakëll të thyer nga gurë gëlqerorë të bardhë. Këtë zëvendësim e bëmë për dy arësye. Në radhë të parë për të evituar gropëzimet eventuale që mund të shkaktoheshin gjatë gdhëndjes së faqeve të dukëshme dhe së dyti për të kaluar nga ngjyra e errët e betonit të zakonshëm në një ngjyrë neutrale gri të hapur që të qëndronte në harmoni me ngjyrën e materialit të gurtë të pjesëve origjinale.

Një ndër problemet kryesore në radhën e punimeve restauruese, ishte edhe konsolidimi i mureve perimetralë të ndërtesës dhe në veçanti i qoshes veriperëndimore të pamjes kryesore të monumenteve (fig. 7). Zgjidhja e mënyrës së përforcimit të kësaj qosheje dhe në përgjithësi të murit ballor mbi të cilën do të mbështetej konstruksioni i rishtyllëzimit të kolonadës, kërkonte që së pari të bëhej verifikimi i gjendjes së tyre deri në thellësi të themelit. Për këtë qëllim u gërmuan në të dy anët e murit kanale të ngushtë 0.50 m (fig. 8). Për të evituar dëmtimin eventual të shtresave kulturale, gërmimet u kufizuan në masën më të domosdoshme. Materiali arkeologjik që u zbulua u depozitua pranë fondeve të muzeut të Apolonisë.

Në përfundim të gërmimit të këtyre kanaleve të cilët arritën deri në 2 m thellësi, u konstatua se muri ballor ishte i plasur dhe i çvendosur në drejtimin veriperëndimor. Më tepër e dëmtuar paraqitej qoshja



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10

e veriperëndimit e cila u gjet e çvendosur me gjithë themel rreth 25 cm larg vendit të saj fillestar.

Kjo gjendje kërkonte një ndërhyrje të gjithanëshme, së pari u bë përforcimi i themelit dhe zgjerimi i bazës mbështetëse të tij nëpërmjet një shtrese betoni të armuar, në gjithë gjatësinë e murit ballor dhe qoshes veriperëndimore. Kanalet që u hapën në të dy anët e mureve u mbushën me mur buto-beton deri në lartësinë e sipërfaqes së tokës. Kështu që mbeturinat e murit u përfshinë brenda konstruksionit të ri të përforcimit.

Qoshja veriperëndimore e cila siç thamë ishte e çvendosur, u prish dhe u rindërtua në vëndin dhe drejtimet e duhura. Rindërtimi i saj u bë deri në lartësinë sa u vendosën të gjithë gurët origjinalë kurse pjesa tjetër u ndërtua me beton. Për të arritur që të evitohen në të ardhmen çarje apo spostime të tjera u ndërtua një brez beton arme në mes të bërthamës së murit. Ky brez u vendos duke filluar nga 2/3 e gjatësisë së murit ballor dhe deri në lidhjen e tij me murin e brendëshëm të portikut (fig. 9).

Rindërtimi i bazamentit mbështetës të kollonave (stilobatit) në pjesën që ishte i prishur u bë me shtresë betoni me përmasat lartësi e gjerësi dhe simbas profilit origjinal të ruajtur në qoshen veri lindore. Shtojmë këtu se qoshja verilindore ishte në gjendje mjaft të mirë. Në anën e brendshme të kolonadës ruhej deri në lartësinë e stilobatit, kurse në anën e jashtëme rindërtimi i saj filloi që nga sipërfaqja e tokës.

Në këtë mënyrë u krijua baza mbështetëse e domosdoshme dhe e sigurtë: mbi të cilën filloi ndërtimi për rishtyllëzimin e kolonadës dhe mureve të dy qosheve të pamjes kryesore të monumentit.

Rivendosja e elementeve konstruktivë e arkitektonikë origjinale dhe atyre të parafabrikuara filloj së pari me rivendosjen, në anën verilindore, të bazamentit të kolonës i vetmi origjinal i cili u gjet pak i spostuar nga vëndi i tij fillestar (fig. 10).

Ky bazament u vendos në vendin e tij në të thatë, sikurse ishte vepruar edhe në të kaluarën. Bazamenti u lidh me bllokun origjinal të stilobatit me anën e kunjave metalikë duke përdorur gropat dhe kanalet e derdhjes së plumbit që ishin përdorur në të kaluarën.

Është rasti të theksojmë se gjetja e këtij bazamenti, siç thamë, të plotë ishte me rëndësi të veçantë sepse nëpërmjet tij ne patëm mundësinë që të zgjidhim drejt dhe saktë formën e madje edhe përmasat e dy kolonave anësore të kolonadës së portikut.

Vendosja e këtyre kolonave të mbështetura në muret e qosheve të pamjes kryesore dhe përmasat e tyre pak më të mëdha se kolonat e tjera me sa dimë janë **unikale.**

DO NOT COPY



Fig. 17 a



Fig. 17 c



Fig. 17 b

fabrikuara. Sipër kolonave, u vendosën kapitelet nga të cilat tre ishin origjinalë dhe tre të tjerët të parafabrikuar. Lidhjet horizontale dhe vertikale të blloqeve në muret e qosheve si edhe të trupave të kolonave me bazamentet e kapitelet u bënë nëpërmjet ganxhave dhe kunjave metalikë të fiksuar me plumb të shkrirë.

Ringritja e kolonave dhe e mureve anësorë deri në lartësinë e kapiteleve përbënte fazën e parë të punimeve konsoliduese e restauruese që u zhvilluan gjatë viteve 1974-75 (fig. 14).

Faza e dytë e punimeve të rishtyllëzimit filloi në verën e vitit 1976 me vendosjen e arkitraut të kolonadës. Ky arkitra i cili ruhej në gjithë gjatësinë e tij përbëhej nga shtatë blloqe. Këto ishin vendosur nga një bllok për secilën hapësirë të mbështetur në aks të çdo kollone dhe dy të tjerë në muret e dy qosheve. Në përgjithësi blloqet ishin të thyer e të mangut në pjesët ekstreme të tyre, dhe nuk ruanin të plota gjatësinë e tyre fillestare, të domosdoshme për të mbuluar hapësirat ndërmjet kolonave. Shtojmë se blloku i mesit të arkitraut 2.80 m i gjatë që mbulonte hapësirën qendrore të kolonadës, përveç dëmtimeve në anët ekstreme të tij, u gjet edhe i thyer në dy pjesë. Në këto rrethana, blloqet e këtij arkitrau nuk ishin më të sigurtë për tu përdorur si element konstruktiv në strukturën e rishtyllëzimit të kolonadës të monumentit të Agonoteteve. Për këto arësye në projektin e restaurimit parashikohej që blloqet e arkitraut të viheshin secili në vendin e tij dhe të mbështeteshin mbi një konstruksion metalik në formë «T» të

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19

vendosur së mbrapthi në gjithë gjatësinë e arkitraut. Meqënë se profili i kërkuar në këtë rast, kishte përmasa jashtë standarteve të përdorura zakonisht, u arrit që të përgatitej duke përdorur dy profile «L» (200 x 200 x 20 m/m) të vendosur kurriz më kurriz dhe të salduar në pjesën e sipërme. Në këtë mënyrë profili metalik i krijuar arriti përmasat 400 x 200 x 40 m/m përmasa të cilat ishin të mjaftueshme dhe të sigurta për të mbajtur të gjithë peshën që i takonte arkitraut origjinal[4]. Konstruksioni metalik u vendos me shpinë mbështetur mbi kapitelet dhe u fiksua me kunja hekuri në aksin e sejcilit prej tyre. Kurse në të dy ekstremet u lidh me armaturën e kolonave të qosheve (fig. 15). Në këtë mënyrë, struktura e rindërtuar deri në lartësinë mbështetëse të arkitraut të kolonadës u arrit që të lidhet sa në drejtimin vertikal aqë edhe në atë horizontal. Kjo lidhje ishte nga ana tjetër e domosdoshme edhe për vetë faktin se rishtyllëzimi i pamjes kryesore të monumentit ishte i pjesëshëm dhe për më tepër i ngritur më shumë në drejtimin vertikal.

Në zgjidhjen e mënyrës së vendosjes dhe formës së këtij konstruksioni u muar parasysh fakti që aty të ishte një shtesë sa më pak e dukëshme. Për këtë qëllim të gjithë blloqet e arkitraut origjinal u gdhëndën dhe u sharruan në pjesën e poshtëme të tyre, në formën e një kanali 22 cm të thellë dhe 5 cm të gjerë. Ky kanal shërbeu për të arritur që secili bllok të mbështetej në profilin metalik dhe nga ana tjetër vetë profili të inkastrohej tërësisht brenda tyre. Në këtë mënyrë konstruksioni metalik mbeti i dukshëm vetëm në pjesën e poshtëme të arkitraut (fig. 16).

Në vazhdim punimet u përqëndruan në rindërtimin e frontonit të kolonadës, i cili në pjesën më të madhe ruante thuajse të gjithë blloqet e gurëve origjinalë. Në këtë rast fillimisht u vendosën blloqet me dekoracione të kornizës horizontale dhe me radhë blloqet e fushës së timpanit, të kornizave anësore dhe së fundi me vendosjen e blloqeve të simës u arrit rindërtimi i gjithë frontonit (fig. 17 – a – b – c).

Sikurse vihet re në rindërtimin e frontonit në afërsi dhe në krahun e djathtë të kulmit të tij është lënë pa plotësuar, për aqë sa kishin të mangut blloqet e fushës së timpanit si edhe të kornizës së pjerët. Plotësimi i këtyre boshllëqeve me blloqe të tjerë nuk u bë sepse zevendësimi i tyre nuk ishte i domosdoshëm pra edhe i papraktikueshëm në raste të tilla.

4) Lidhur me problemet konstruktive që dilnin në projektin e restaurimit jemi konsultuar me Ingj. konstruktorë L. Strazimiri dhe V. Vjero. Me këtë rast i shprehim falenderimet tona për ndihmën që na dhanë.

Gjatë fazës së tretë u kryen punimet për restaurimin e shkallëve si edhe i pjesës të dëmtuar në muhet perimetralë të ndërtesës së monumentit.

Shkallët të ndërtuara në gjithë gjatësinë e kolonadës, me blloqe gurësh të gdhendur u gjetën të dëmtuara në pjesët ekstreme të gjatësisë së tyre. Rrethi i sipërm i tyre mungonte tërësisht dhe pjesët e ruajtura kishin lëvizur dhe rrëshqitur nga vendi fillestar. Për këto arësye ato u çmontuan dhe u rindërtuan në një bazament të ri. Blloqet e gurëve të shkallëve u ribënë me blloqe gurësh të gdhendur simbas lartësisë dhe profilit të shkallëve të vjetra (fig. 18). Duhet të përmëndim këtu se për pjesët e humbura me qënë se ishin si sasi e vëllime të vogla në këtë rast u përdor guri në vend të betonit.

Restaurimi i pjesëve të dëmtuara të mureve perimetralë si edhe rindërtimi i pjesshëm i tyre u krye duke përdorur tulla të pjekura në vënd. Tullat u vendosën në vazhdim të rreshtave të tullave të vjetra dhe vetëm në faqet e dukshme të mureve, kurse bërthama e mureve u mbush me gurë të vegjël të zhytur në llaç gëlqere të bollshëm. Ndërhyrja e jonë edhe në këtë rast u bë me qëllim që të parandalohet dëmtimi i mureve dhe nga ana tjetër planimetria e ndërtesës së monumentit të bëhet më e kuptueshme. Rindërtimi pjesërisht i mureve anësorë prej tulle kryer në të dy qoshet e ndërtuar me blloqe të parafabrikuara u bë me qëllim për të bërë lidhjen e qosheve të rindërtuar dhe njëkohësisht të shërbente si kontraforte në strukturën konstruktive të rishtyllëzimit të kolonadës.

Me përfundimin e punimeve restauruese që u kryen për rishtyllëzimin e pamjes kryesore të monumentit të Agonoteteve mendojmë se janë arritur qëllimet kryesore (Fig. 19). Gjatë kryerjes të punimeve të restaurimit në këtë monument u fitua një eksperiencë e cila do të na ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të restaurimit të monumenteve të vendit tonë. Në pamjen që na paraqitet ky monument sot tregon për një arritje të meritуar të vlerave arkitektonike e artistike të tij. Në kompozimin arkitektural të rishtyllëzimit të këtij monumenti, është dokumentuar gjithçka trashëgohej nga lashtësia dhe elementet e integruar në të janë në harmoni me tërësinë dhe të mirëdallueshëm, si nga format e thjeshta ashtu edhe nga materiali.

Monumenti i Agonoteteve në pamjen e sotme, bëhet një dëshmitar i vërtetë i traditave të shquara, të qytetit të Apolonisë, në fushën e arkitekturës antike. Restaurimi i këtij monumenti dëshmon gjithashtu për kujdesin e madh që tregohet në vendin tonë për të nxjerrë në dritë dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore si prona të përbashkëta me vlera të mëdha për kohën tonë dhe brezat e ardhshëm.

PHOTOCOPY

Koço ZHEKU

DO NOT COPY

L'ANASTYLOSE DE L'ASPECT PRINCIPAL DU MONUMENT DES AGONOTHETES A APOLLONIE

RESUME

Le monument des Agonothètes, qui a été mis à jour il y a plusieurs années, faisait part d'un complexe architectonique construit dans les premiers siècles de notre ère. C'était un monument commémoratif qui servait aussi de lieu de réunions et de représentations culturelles et artistiques. Une inscription gravée sur les pierres de l'architrave de la colonnade, en langue grecque, indique que le dit monument a été construit pour honorer le souvenir de Villio Valentino Furio Proculus, de la part de son frère, haut fonctionnaire de l'administration de la ville d'Apollonie.

De par sa fonction, ce monument se caractérise par une solution architectonique originale; son aspect principal étant traité selon les principes de l'architecture monumentale gréco-romaine, alors que le reste de l'édifice maintient des liens étroits avec l'architecture des édifices romains de caractère social. Sa façade principale reflète l'ordre corinthien avec une riche décoration plastique, qui caractérise la dernière période de son emploi dans l'architecture ancienne. En ce qui concerne la planimétrie, elle est à angle droit pour ce qui regarde les deux pièces principales, le portique étant disposé devant l'entrée principale tout au long de la largeur de l'édifice et une grande salle ayant à son intérieur un podium échelonné en forme de fer à cheval.

Le portique fermé sur ses deux côtés courts, était pourvu d'une colonnade de marbre, avec quatre colonnes libres et deux autres s'appuyant sur des antes. Par devant l'entrée principale du monument, tout au long de la colonnade, il y avait un escalier de pierres équarries. L'aspect principal du monument se termine par un fronton cerné d'une corniche triangulaire, dont la décoration vraiment réussie comporte des motifs floraux et zoomorphes.

Les fouilles archéologiques ont montré que le monument des Agonothètes s'était écroulé par suite d'un puissant tremblement de terre, peut-être le tremblement de terre de l'an 345, que nombre d'auteurs anciens mentionnent en raison des grands dégâts qu'il a provoqué dans les villes s'étirant le long des côtes de l'Adriatique. Des puissantes secousses sismiques avec des poussées en direction nord ont provoqué l'effondrement subit de toute la construction de la façade principale, à quelques mètres de distance de la route passant devant le monument. Ce monument est arrivé jusqu'à nos jours presque à l'état de sa mise en lumière à la fin des fouilles archéologiques.

L'anastylose de l'aspect principal du monument des Agonothètes ont été précédés par une étude analytique de son état, de sa construction et de son architecture. Cette étude, publiée sur les pages de cette revue il y a quelques années, a contribué à l'élaboration du projet de restauration et à sa mise en oeuvre.

Se fondant sur des critères scientifiques, le projet de restauration prévoyait la mise en valeur de ce monument sur le plan architectonique, à travers de l'anastylose de son aspect principal par des piliers, et cela dans la mesure des exigences indispensables pour prévenir des dégâts ultérieurs et de façon à ce que l'anastylose fut effectué en pleine harmonie tant avec les ruines archéologiques qu'avec l'environnement du monument.

Dans la communication présente l'auteur illustre brièvement les travaux de restauration effectués et les résultats obtenus.

Vu son état et le fait qu'il était disséminé dans un milieu ouvert, ce monument de valeur archéologique et architectonique exigeait une intervention immédiate dans deux directions principales. Tout d'abord, se posait le problème de la consolidaton des murs périmétraux de l'édifice ainsi que la nécessité de renforcer par des piliers la colonnade du portique dans l'aspect principal. Dans les deux cas, le but principal auquel visait la restauration était celui d'assurer des conditions normales et certaines à tout ce que nous avions hérité de ce monument, tout en mettant en relief toutes ses valeurs archéologiques et architectoniques.

Les éléments de construction et architectoniques récupérés se trouvant là où ils s'étaient effondrés et pour en éviter l'endommagement ultérieur dû à l'action des agents atmosphériques, il fallait sans autre les remettre à leur place initiale.

Pour réaliser le réassemblage de tous ces éléments dans un tout architectonique, il fallait absolument remplacer les éléments qui manquaient ou qui avaient été détériorés au point

de n'être plus utilisables comme éléments de construction. Quant aux éléments qui manquaient, dans le projet de restauration il était souligné qu'il fallait les retravailler dans les dimensions des éléments originaux qui avaient disparu, mais sous des formes simples et sans en imiter la décoration plastique, et avec des matériaux de nos jours, afin de pouvoir les distinguer facilement des parties originales.

Les travaux de restauration relatifs à l'anastylose de la colonnade du portique et à la consolidation des murs périmétraux de l'édifice du monument des Agonothètes furent effectués dans les années 1974-1978, avec quelques intervalles dans des périodes différentes. On commença par consolider les blocs de pierre partiellement endommagés ou brisés en deux ou trois pièces. Dans un secteur à part furent préparés tous les éléments de construction et architectoniques qui ne furent pas retrouvés à l'endroit de l'effondrement.

Les blocs décorés des corniches du fronton, ayant subi des dégâts, furent complétés en béton armé dans les dimensions et le volume de l'original. Quant aux blocs dont les parements décorés étaient en partie abîmés, on les laissa tels quels.

Dans le secteur qui avait été mis sur pied pour la préparation des éléments de construction et architectoniques préfabriqués en béton armé, nous avons réussi à produire des fûts de colonnes, des chapitaux et les socles qui manquaient, ainsi que tous les autres blocs nécessaires à refaire les angles des murs de la façade principale du monument; et cela, en respectant les dimensions exactes prévues par le projet de l'anastylose.

Un problème important dans le complexe des travaux de restauration était aussi celui de la consolidation des murs périmétraux de l'édifice, et particulièrement de l'angle nord-ouest de l'aspect principal du monument. Le choix de la méthode de l'anastylose de cet angle, et en général du mur frontal sur lequel on allait adosser la construction de la colonnade, exigeait tout d'abord la vérification de leur état jusque dans les profondeurs des fondations. C'est à cette fin que des deux côtés furent creusés des canaux d'une largeur de 0.50 m. Pour éviter la détérioration éventuelle des différentes couches culturelles, on s'efforça de limiter au maximum les travaux de terrassement.

Après avoir creusé ces canaux jusqu'à une profondeur de 2 m, on constata que ces lézardes sillonnaient le mur frontal et que celui-ci s'était déplacé en direction nord-ouest. L'angle nord-ouest, qui s'était déplacé avec ses fondations d'environ 25 cm. de son emplacement initial, résulta avoir subi le plus de dégâts. Aussi fallait-il y intervenir immédiatement, en renforçant ses fondations et en en élargissant le soubassement.

Puis on procéda à la reconstruction du stylobate des colonnes dans la partie qui avait été endommagée, en créant de la sorte un soubassement solide pour pouvoir entamer le renforçage par piliers de la colonnade et des murs dans les deux angles de l'aspect principal du monument.

La mise en place des éléments de construction et architectoniques, originaux et préfabriqués, a été commencée du côté nord-est en replaçant le socle de la seule colonne originale qui avait été trouvée légèrement déplacée de son emplacement initial (Fig. 9).

Puis on procéda à la reconstruction des murs des deux angles extrêmes de l'aspect principal. D'abord les travaux concernèrent l'angle nord-est, qui conservaient encore des traces anciennes jusqu'à la hauteur du stylobate et une bonne part des blocs de pierre à proximité de l'endroit de leur effondrement.

Les blocs en béton armé, employés pour la reconstruction de ces murs, ont été produits selon la forme et les dimensions des blocs originaux.

Après la construction de ces murs, les colonnes préfabriquées en béton armé furent remises à leur place en ordre. En ce qui concerne les fûts des colonnes originales, on n'en conservaient encore que deux pièces seulement, dont l'une avait été trouvée à proximité de l'angle nord-ouest; probablement, elle appartenait à la deuxième rangée et venait tout de suite après la colonne de l'angle nord-ouest. Quant à l'autre, elle avait été déplacée de son emplacement initial et appartenait à la partie supérieure du fût à cannelures d'une colonne. Dans ces conditions, nous avons pensé qu'il serait opportun de compléter ces deux pièces pour en faire un fût à soi dans la rangée des autres fûts de colonnes préfabriquées. Puis on posa sur les colonnes les chapitaux, dont trois originaux et trois autres préfabriqués. La liaison horizontale et verticale des blocs dans les murs des angles, ainsi que des colonnes avec les linteaux des chapitaux, fut réalisée au moyen de crampons et de pieux métalliques fixés avec du plomb fondu.

La deuxième phase l'anastylose commença par la mise en place de l'architrave de la colonnade. Cette architrave, que l'on conservait dans toute sa longueur, comprenait sept blocs, un pour chaque ouverture entre les colonnes. En général ces blocs étaient brisés et non complets à leurs extrémités, en plus ils ne conservaient pas leur longueur initiale, ce qui est indispensable pour couvrir l'espace séparant une colonne de l'autre. Le bloc central de l'architrave, d'une longueur de 2.80 m et qui couvrait l'espace central de la colonnade, outre les dégâts à ses extrémités, était brisé en deux parties. Dans ces conditions, les blocs de cette architrave n'offraient aucune garantie de sécurité en vue de leur utilisation comme éléments de construction dans la structure de renforçage de la colonnade du monument des Agonothètes.

Selon le projet de restauration, les blocs de l'architrave il fallait les disposer chacun à sa place en les adossant à une construction métallique en forme de «T» disposée à l'envers tout au long de l'architrave. Etant donné que le profilé nécessaire à cette fin correspondait à des dimensions non standard, on a utilisé deux profilés en «L» (200 x 200 x 20 mm.) disposés côte à côte et soudés dans leur partie supérieure. Ainsi le profilé métallique en question atteint les dimensions nécessaires pour affronter toute la charge que supportait l'architrave origi-

DO NOT COPY

nale. La construction métallique fut adossée aux chapitaux et fixée avec des pieux de fer à l'axe de chacun des chapitaux. Quant à ses deux extrémités, elles furent reliées à la carcasse des colonnes angulaires. Il a été possible ainsi de fixer, tant en direction verticale qu'en direction horizontale, la structure reconstruite jusqu'au niveau d'appui de l'architrave de la colonnade. Par ailleurs, l'anastylose de l'aspect principal du monument étant partiel et se dressant surtout en direction verticale, il était indispensable d'assurer cette liaison.

Quant au choix de la méthode concernant la disposition et la forme de cette construction métallique indispensable au renforçage de l'architrave originale, nous avons tenu compte du fait que cette adjonction fût le moins visible possible. A cette fin, tous les blocs de l'architrave originale furent équarris et sciés dans leur partie inférieure, en formant un canal d'une profondeur de 22 cm. et d'une largeur de 5 cm. Grâce à ce conal, il a été possible d'adosser chaque bloc au profilé métallique et de permettre au profilé aussi à s'encastrer entièrement dans ces blocs. En conséquence, la construction métallique n'était visible que dans la partie inférieure de l'architrave.

Ensuite tous les travaux furent centrés sur la reconstruction du fronton de la colonnade, dont les blocs de pierre étaient presque conservés dans leur grande majorité.

Pendant la troisième phase furent entamés des travaux pour la restauration de l'escalier et de la partie endommagée des murs périmétraux de l'édifice du monument.

La restauration des parties endommagées des murs périmétraux, ainsi que leur reconstruction partielle, furent réalisées avec des briques cuites dans le pays. Ces briques furent placées à la suite des rangées de briques anciennes et seulement dans les parements extérieurs, alors que le noyau des murs a été rempli de petites pierres plongées dans du mortier de chaux. Dans ce cas aussi notre intervention visait à prévenir la détérioration des murs et à rendre plus compréhensible la planimétrie de l'édifice du monument. Quant à la reconstruction partielle des murs latéraux avec des briques, et cela précisément dans les deux angles construits de blocs préfabriqués, elle visait à assurer la liaison des angles reconstruits et à servir, dans le même temps, comme contreforts de la structure de renforçage de la colonnade.

A l'issue des travaux de restauration effectués par l'anastylose de l'aspect principal du monument des Agonothètes, l'auteur est d'avis que les principaux objectifs fixés ont été atteints. L'aspect actuel du monument montre que ses valeurs architectoniques et artistiques ont été mises dignement en relief. La composition architecturale du renforçage documente tout ce que nous avons hérité de l'antiquité, en plus les éléments qui y ont été intégrés s'harmonisent bien avec l'ensemble du monument et se distinguent soit par leurs formes simples que par les matériaux qui ont été utilisés.

A son aspect actuel, le monument des Agonothètes est un témoin authentique des traditions remarquables de la ville d'Apollonie dans le domaine de l'architecture ancienne; sa restauration montre combien grand est le soin que l'on consacre chez nous à la mise en lumière et à la conservation dans des conditions privilégiées de l'héritage culturel, en tant que patrimoine commun de grande valeur des générations présentes et futures.

DO NOT COPY

Lazër PAPAJANI

DO NOT COPY

TEATRI I QYTETIT ILIR NË KLOS TË MALLAKASTRËS DHE PUNIMET RESTAURUESE NË TË

Gërmimet arkeologjike të kryera në qytetin ilir të Klosit në Mallakastër gjatë viteve 1973--1976 kanë nxjerrë në dritë disa monumente të panjohura më parë. Ndërmjet tyre një monument me karakter shoqëror është edhe teatri i tij (Fig. 1). Forma e harkuar në një pjesë të kodrës si edhe disa mbushje me çakëll na patën tërhequr vëmendjen duke paramenduar në këtë vend një teatër. (Fig. 2). Sondazhi në formë kanali tërthor me gjatësinë e harkut nxori në dritë gjurmët e radhës së parë të shkallares së teatrit të qytetit.

Teatri është vendosur në pjesën më të lartë të qytetit, në verilindje të majës më të lartë të kodrës, në një vend që i plotëson kushtet e nevojshme. Para tij terreni zbret me pjerësi të madhe dhe mbas një largësie pak a shumë të vogël, afërsisht 60-70 m në vijë të drejtë, mbyllet me murin rrethues të qytetit. Nga lindja shtrihet një tarracë, në vazhdimin e së cilës ndodhet portiku që së bashku me teatrin, ndoshta edhe me godina të tjera të pazbuluara, formonte një ansambël ndërtimesh shoqërore (TAB. I).

Vendi për ndërtimin e teatrit është zgjedhur në një formacion shkëmbor. Formën e harkuar ai e ka marrë nëpërmjet heqjes së blloqeve të gurëve, të cilat



Fig. 1



Fig. 2

duhet të kenë shërbyer për ndërtime të tjera. Gjithashtu formacioni me shtresa deri në njëfarë mase i ka ndihmuar ndërtuesit në punën e tyre për nxjerrjen e blloqeve dhe në formimin e radhëve të shkallareve (theatronit). Vendi është zgjedhur në pjesën më të ulët të majës së kodrës. Si pasojë në krahun lindor kodra ka qenë më e ulët sesa në krahun tjetër. Kjo pjesë është rrethuar me mur duke fituar lartësinë natyrore të krahut më të lartë, ndërsa boshllëku është mbushur me çakëll për vendosjen e blloqeve të shkallareve. Në këtë mënyrë janë barazuar të dy krahët e kodrës dhe është krijuar plotësisht forma dhe lartësia e nevojshme që kërkonte ndërtimi i teatrit. (Fig. 3, Tab II, a).

Në zgjedhjen e vendit për vendosjen e teatrit ndërtuesit duhet të kenë pasur parasysh disa kondita si drejtimin e dritës, të erërave etj., por ajo që ka përcaktuar përfundimisht drejtimin e tij ka qenë kryesisht pozicioni i përshtatshëm i kodrës. Kështu që edhe në Greqi dhe në Azi të Vogël këto kanë orientime të ndryshme, në Delfi, Athinë dhe Priena shkallarja është me ballë nga jugu, në Epidaur nga veriu, në Parga nga lindja, në Milet nga jugperëndimi etj.[1] Vendosja dhe drejtimi i teatrit në Klos është veri-jug. Në krahasim me teatrit në Apoloni[2], Butrint dhe në Bylis[3], ku shkallaret janë drejtuar nga perëndimi, ai i Klosit është drejtuar nga veriu. Përballë tij shtrihet një pamje e bukur. Nëpër luginën e përroit të Marushës, shikimi shkon shumë larg ndërsa në perëndim të luginës dhe paralel me të, zgjatet kodra e qytetit fqinjë të Bylisit. Ky orientim i teatrit në Klos jo vetëm që lejonte që shfaqjet të shikoheshin pa u penguar nga dielli në çdo orë të ditës, por dielli, duke kaluar prapa spektatorëve, e ndriçonte më së miri proskenën.

Drejtimi i erërave në pjesën më të madhe është nga jugu dhe perëndimi, kështu që edhe në këtë rast teatri ishte pak a shumë i mbrojtur prej tyre, me përjashtim të erërave të ftohta të dimrit që janë me drejtim nga veriu.

Ashtu si të gjithë teatrot e botës antike edhe teatri i zbuluar në qytetin ilir në kodrën e fshatit Klos (Nikaia), përbëhet prej dy pjesësh kryesore: shkallares dhe skenës. Skena ndahet përsëri në dy pjesë të tjera proskena në pjesën e përparme dhe skena pra-



Fig. 3

1) M.I. Greçina, Stadioni, Kiev 1957, f. 14 fig. 12; f. 15, f. 13, f. 24, fig. 27, fig. 16, fig. 14, f. 38, fig. 43, f. 25, fig. 28.

2) A. Mano. **Rezultatet e kërkimeve për zbulimin e teatrit antik në Apoloni.** Buletin Arkeologjik 1971, fq. 94-99.

3) C. Prashniker. **Muzakhia und Malakastra.** Wien 1920 f. 82, fig. 33.

DO NOT COPY

pa saj, e cila shërbente si ambient ndihmës për mbajtjen e veshjeve dhe për përgatitjen e aktoreve për shfaqje.

Monumentin sot e trashëgojmë në një gjendje tepër të dëmtuar. Shkallarja e ruan të plotë dhe në mënyrë të rregullt formën e saj, por me përjashtim të radhës së parë, që ruhet në gjendje të mirë, radhët e tjera janë të dëmtuara. Prej tyre ruhet në shkëmb vetëm vendi i gdhendur ku vendoseshin bllokët e tyre (fig. 4), ndërsa prej blloqeve sot ruhet vetëm një i shkëputur. Proskena dhe skena janë në gjendje edhe më të dëmtuar, ndërsa orkestra ruhet pak më mirë, mbasi si dysheme e saj ka shërbyer shkëmbi i gdhendur rrafsh që nuk duhet të ketë qenë i veshur me blloqe ose rrasa guri, pasi në të nuk shihet asnjë shenjë veshjeje. Ajo ka një diametër prej 11.30 m dhe formën e një gjysmërrethi të plotë.

Radha e parë e shkallares ka shërbyer për uljen e spektatorëve të klasave të larta të shoqërisë. Lartësia e saj është 0.42 m dhe gjerësia 0.34 – 0.40 m. Në ndryshim me radhët e tjera të teatrit ajo ka një mbështetëse për shpinën. Nën të ndodhet një radhë më e vogël, 0.32 m e lartë nga sheshi i orkestrës, që ka shërbyer për mbështetjen e këmbëve të spektatorëve të radhës së parë. Bllokët e kësaj radhe janë gdhendur thjesht në formë kubike, ndërsa ato që shërbenin për ulje janë pak të harkuara me pjesën e poshtme më të ngushtë (Tab. II.e). Në përgjithësi mbështetja e shpinës është së bashku me bllokun. Në rastet kur mbështetësja është e shkëputur, pjesa e pasme e bllokut është thelluar 7-8 cm për vendosjen e saj. Ndenjëset e kësaj radhe në teatrot e mëdhenj të antikitetit janë punuar me profile dhe zbukurime të ndryshme. Në teatrin e Bylisit ato janë punuar me shumë kujdes, në mënyrë të veçantë ato të pjesës qendrore[4], ndërsa në teatrin në Klos janë punuar thjeshtë dhe pa diferencim të pjesës qendrore (Fig. 5).

Mbas radhës së parë ndodhet një korridor për lëvizjen dhe shpërndarjen e vizitorëve nëpër radhët e teatrit. Ky nuk ka pasur gjerësi të njëjtë në të gjithë gjatësinë e tij: pranë hyrjes është 0.60 m i gjerë dhe në mes të gjatësisë 0.90 m. Korridori ka qenë i shtruar me rrasa guri me trashësi 9 cm. (fig. 6).

Në krahasim me nivelin e vendit të uljes të radhës së parë, rrasat janë vendosur rreth 8-10 cm më lart, vendosje kjo që shërben për të forcuar mbështetjet që janë të shkëputura nga blloku kryesor.

Shkallëzimet e shkëmbit të kodrës kanë qenë të veshura me bllokë të punuara për këtë qëllim. Ato



Fig. 4



Fig. 5

4) N. Ceka, Teatri i Bylisit (dorëshkrim në arkivin e bërth. shk. ark. të Fierit).

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

kanë qenë blloqe dhe pllaka gëlqerori të butë që punoheshin lehtë me daltë. Në ndryshim me blloqet e shkallëve të shumë teatrove dhe stadiumeve të kësaj kohe që janë punuar me disa lloj profilesh, blloku i vetëm, i gjetur nga shkallët e sipërme të këtij teatri, tregon se ato kanë qenë të punuara thjesht: vetëm në pjesën e sipërme ka një kornizë të drejtë pak të dalë, ku lexohet germa E (fig. 7). Një rast tjetër në vendin tonë të vendosjes së gërmave në faqen e dukshme të blloqeve të shkallareve e shikojmë edhe në stadiumin e Amanties, qëllimi i të cilave duhet të jetë i njejtë për të dy rastet[5].

Nga shqyrtimi i gjurmëve në shkëmb kuptohet se edhe shkallët e tjera të teatrit kanë qenë ndërtuar në të njëjtën mënyrë si radha e parë me vend të veçantë për ulje dhe të veçantë për vendosjen e këmbëve. Ndryshimi qëndron se në to nuk duhet të kenë pasur mbështetëse për shpinën, mbasi gjurmë të saj nuk dallohen në bllokun e vetëm që kemi gjetur nga shkallët mbi korridor të teatrit. Po kështu edhe vendi për mbështetjen e këmbëve nuk duhet të ketë qenë aq i lartë sa ai i radhës së parë. Vendet ku shihen këto gjurmë janë rreth 0.10 m të larta (fig. 4).

Si në teatrin e Apolonisë dhe të Butrintit, po kështu edhe në ato të Greqisë, Azisë së Vogël etj. ashtu edhe në stadiumet e kësaj periudhe një mënyrë e tillë ndërtimi nuk takohet. Në pjesën më të madhe, si në teatro ashtu edhe në stadiume, vendi për mbështetjen e këmbëve është më i thelluar në krahasim me atë për uljen e spektatorëve, por ka edhe raste ku ato nuk diferencohen si në teatrin e Butrintit, ku blloku ka një nivel, nga shkalla e shtatë e sipër, dhe në shkallët e stadiumit në Amantie.

Në shkëmbin që formon dyshemenë e orkestrës, para bllokut që shërben për mbështetjen e këmbëve, në të gjithë gjatësinë e harkut është gdhendur një kanal me thellësi 5-6 cm dhe gjerësi 30 cm. Po në nivelin e kanalit është gdhendur edhe pjesa tjetër ku janë vendosur blloqet e kësaj radhe. Kanali ka shërbyer për grumbullimin dhe largimin e ujërave të shiut që zbritnin nga shkallaret si edhe nga vetë sheshi i orkestrës.

Kjo pjesë e teatrit, duke filluar nga kanali, blloqet për vendosjen e këmbëve, vendin e uljes, mbështetëset për shpinën dhe korridorin prapa tij, është e njohur dhe e ngjashme me teatrin në Megalopol të Arkadisë[6].

5) S. Anamali, **Rezultatet e gërmimeve në stadiumin antik të Pllogës,** B.I.SH. 1958, 2, fq. 95-108.
6) V Dorfpfeld, E. Reisch, Das Griechische theater, Athen, 1896 fq. 135 fiq. 55.

DO NOT COPY

Numri i përgjithshëm i shkallëve sot nuk mund të përcaktohet nëpërmjet gjurmëve në shkëmb, por kjo mund të dalë nga matja e lartësisë së përgjithshme të shkallares së teatrit prej 8 m. Në raport me lartësinë e një radhe prej 0.45 m, del që teatri ka pasur afërsisht 17 radhë. Matjet dhe llogaritjet në lartësinë mesatare të një radhe të shkallares treguan se në të mund të zënë vend afërsisht 50 veta, kështu që në teatër mund të rrinin afërsisht deri në 800 veta.

Prej proskenës dhe skenës sot nuk ka mbetur asnjë fragment arkitekture. Për zhdukjen e tyre, përveç faktorëve të tjerë, ka influencuar edhe terreni i pjerrët që shtrihet prapa skenës. Në shkëmbin e kodrës ku mbështetej bazamenti i proskenës dhe skenës sot shihen mjaft të qarta vendet e gdhendura ku kalonin muret e themeleve (Fig. 8). Gjithashtu dallohen dhe kufizimet anësore dhe ai fundor i skenës. Duke u mbështetur në këto gjurmë, mund të nxjerrim madhësinë e saj dhe të formojmë një ide të plotë dhe të saktë mbi planimetrinë, për vendosjen e proskenës, skenës dhe portës që lidhte këto dy pjesë (Tab. II, a). Në bazë të tyre mund të japim edhe një rikonstruksion të saktë të planimetrisë së kësaj pjese të teatrit (Tab. III. b).

Bazamenti që ruan gjurmët në krahasim me dyshemenë e orkestrës është 0.94 m më poshtë, ndërsa bazamenti i proskenës është gati në një nivel. Në pjesën tjetër, në atë të skenës, shkëmbi shkon duke u ulur derisa në nivelin 1,76 m, në krahasim me bazamentin e proskenës, vendoset themeli i murit fundor të skenës (Fig. 9). Ndërtuesit janë detyruar të ulen në këto nivele si për proskenën dhe për muret e skenës për të gjetur një bazament sa më të qëndrueshëm në shkëmbin e kodrës për themelet që do të vendosnin aty (Tab. II a, c, d).

Gjatësia e proskenës ka qenë 10.60 m, pak më e vogël nga diametri i orkestrës. Themeli i saj është vendosur në dy kanale paralele të gdhendura në shkëmb me gjerësi 0.50-0.60 m, aq sa gjerësia e murit, me thellësi 5-15 cm. (Tab. II, a).

Distanca ndërmjet këtyre dy kanaleve tregon se hapësira ose gjerësia e proskenës që përfshihet ndërmjet kolonave dhe murit fundor është 1.65 – 1.70 m. Muri që formonte fasadën e proskenës duhej të ngrihej në formë xokoli duke e kaluar pak nivelin e dyshemesë së orkestrës, pastaj vazhdonte me kollona. Në këtë lartësi ka qenë edhe dyshemeja e proskenës. Pjesa tjetër në verilindje të saj lartësohej me mur të plotë duke krijuar në këtë mënyrë një ambient të vogël, të mbyllur me hapësirë afërsisht 2 x 2 m. Ky ambient lidhej me proskenën me një portë anësore, gjurmët e së cilës tregojnë se ka qenë afërsisht 1 m e gjerë. Po kështu dhe në krahun tjetër, në perën-



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY

dim muri duhet të ketë vazhduar i drejtë, duke mbyllur në këtë mënyrë ekstremin e shkallares. Gjurmët e këtij muri ndiqen deri në 2.50 m nga hapësira me kolona e proskenës, ndërsa muri fundor i saj që e ndan me skenën ka qenë i mbyllur deri në pjesën e sipërme. Në këtë mur, në distancë 2.90 m nga muri i anës verilindore ndodhej porta e vetme që lidhte proskenën me skenën. Në vendin e portës shkëmbi nuk është gdhendur në formë kanali si në pjesët ku ngrihej muri (Tab. II a). Kjo gjë ndodh mbasi muri që do të vendosej mbi të do të ishte i ulët, nuk do të kishte peshë të madhe dhe si pasojë nuk do të kishte rrezik për të lëvizur.

Simbas gjurmëve gjerësia e portës është 1.08 m, Afërsisht këtë gjerësi (1.10 m) ka edhe porta e vogël në teatrin e Dionisit në Athinë[7].

Në të gjithë teatrot e botës antike portat që lidhin proskenën me skenën janë të vendosura në hapësirën ndërmjet dy kolonave. Duke ditur këtë fakt, duke pasur njëkohësisht edhe gjurmët e vendosjes së portës që lidhte proskenën me skenën, mund të caktojmë numrin e kolonave në ballin e proskenës si edhe largësitë ndërmjet tyre. Distanca 2.90 m prej qoshes së murit deri aty ku fillon porta, tregon se ka dy hapësira dhe dy kolona me largësi nga aksi në aks, afërsisht 1.50 m. Porta me gjerësi 1.08 m është vendosur përballë hapësirës së tretë, d.m.th. ndërmjet kolonës së dytë dhe të tretë. Duke e ndarë të gjithë gjatësinë e proskenës prej 10.60 m në 1.50 m, del që ajo të ketë pasur gjashtë kolona dhe shtatë hapësira ndërmjet tyre. Në rast se diametrin e kolonave e marrim rreth 0.50 m, del që hapësirat e dritës ndërmjet tyre të kenë qenë afërsisht 1 m. Duke u nisur nga gjerësia e portës prej 1.08 m, mendojmë se hapësira ndërmjet kolonës së dytë dhe të tretë, përballë saj, të ketë qenë më e madhe nga hapsirat e tjera. Një rast i tillë shihet edhe në teatro të tjerë të antikitetit, në teatrin e Dionisit në Athinë, ku të gjitha kolonat e tij janë me largësi nga aksi në aks 1,27 m, ndërsa përballë portës së vogël 1.95 m dhe portës më të madhe 2.54 m[8].

Për të nxjerë lartësinë e kolonave nuk mund të bazohemi në asnjë gjurmë, por duke u mbështetur në ndërtime të këtij lloji në stilin dorik, të cilit mendojmë se mund t'i takojë edhe ky teatër, mendojmë se kolonat duhet të kenë qenë afërsisht 3 m të larta. Këtë lartësi kanë kolonat, edhe në teatrin e Dionisit në Athinë si edhe ato të Megalopolit në Arkadi[9].

Përveç gjurmëve të gdhendura në shkëmb në muret anësore të skenës ruhen edhe disa blloqe të plota. Gjatësia e saj është 10.60 m, sa ajo e proskenës, ndërsa gjerësia ose thellësia 4.70 m.

Në ndryshim me pjesën më të madhe të teatrove të botës antike që janë me nga dy hyrje (parodos), në teatrin e qytetit mbi Klos kemi vetëm një hyrje që ndodhet në anën verilindore në drejtim të tarracës ku ndodhet portiku. Hyrja kalon ndërmjet murit mbajtës të mbushjes për vendosjen e shkallëve dhe murit të plotë të proskenës. Prej këndej një pjesë e vizitorëve kalonin në orkestër për t'u ulur në radhën e parë, ndërsa pjesa më e madhe e tyre kalonte me anë të dy-tri këmbëve shkalle në korridor për t'u shpërndarë në shkallët e tjera. Gjurmë shkallësh kalimi që ta përshkonin shkallaren në formë rrezesh për shpërndarjen e spektatorëve në radhët e shkallares nuk kemi mundur të dallojmë.

Gjurmët e përmendura më sipër në shkëmb si në pjesën e shkallares, po kështu edhe në atë të proskenës, dhe skenës na japin mundësinë e rikonstruksionit hipotetik të teatrit në përgjithësi. Për sa i takon skenës, duke u mbështetur në teatrot e shekullit III p.e.sonë, periudhë në të cilën mendojmë të jetë ndërtuar edhe teatri në Klos, janë me dy kate, kështu që nuk përjashtohet mundësia, që ajo të ketë patur edhe një kat të dytë (Tab. III, a). Shkallët për tu ngjitur në katin e dytë mund të kenë qenë në ambientin e vogël në anë të proskenës.

Gjatë zbulimit të teatrit blloqet e murit mbajtës u gjetën të rrëzuara. Presioni i dheut mbushës si edhe lëvizjet tektonike e kishin prishur ekuilibrin e murit dhe blloqet patën rënë në korridorin e hyrjes.

Pastrimi i dheut që mbulonte blloqet u krye me shumë kujdes. Blloqet u gjetën në ato vende ku kishin rënë që në fillim. Ndërmjet tyre kishte edhe blloqe që ishin thyer dhe dekompozuar, të cilët u takonin radhëve të sipërme të murit. Këto blloqe kanë rënë të parat në tokë dhe janë thyer nga goditjet e blloqeve të radhëve të tjera që kanë rënë herë mbas here mbi to.

Muri ishte rrëzuar plotësisht dhe blloqet e radhës së parë u gjetën të lëvizur dhe nuk e ruanin linjën e drejtë. Gjatë pastrimit blloqet nuk u luajtën nga vendet e tyre. Pozicioni në të cilin kishin rënë si edhe moslëvizja e tyre bëri që secilit bllok të vendoset në vendin e vet pa vështirësi dhe me saktësi, megjithëse muri fillimisht ishte plotësisht i rrëzuar. Pastrimi i vendit ku do të vendosej radha e parë tregoi se kjo mbështetej mbi një bazament të qëndrueshëm; që ishte shkëmbi natyral i kodrës. Gjatë lëvizjes së blloqeve doli që një pjesë e tyre janë me mbishkri-

7) V. Dorfpfeds, E. Reisch. **Vep. cit.,** Tab. V.
8) V. Dorfpfeld, E. Reisch. **Vep. cit.** Tab. V.
9) Po aty, f. 138, fig. 55.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

me. Vendosja e blloqeve nëpër vendet e tyre bëri që muri të kalonte në drejtimin fillestar. Radha e parë u plotësua me blloqe në të gjithë gjatësinë e murit 21.70 m (Tab. II, b). Një trakt prej 15-16 m në mes të gjatësisë së tij u ngrit në trekatër, radhë blloqesh, që arrinë në 2 m në pjesën më të lartë (fig. 10). Në bazamentin e tij dallojmë tri kontraforte të vendosura 3.20 – 3.40 m larg nga njëra-tjetra. Kontrafortet nuk kanë vazhduar në të gjithë lartësinë e murit, por kanë shërbyer për forcimin e bazamentit të tij. Ato ngrihen në dy blloqe lartësi. Gjatë procesit të punimeve për restaurimin e murit u vu re se muri, para se të rrëzohej, ka qenë i rindërtuar. Gjatë rindërtimit disa mbishkrime qenë vendosur së mbrapi, disa të tjera qenë gdhendur në pjesën e mbishkrimit pjesërisht sipas rastit për t'u vendosur në mur (fig. 11), ndërsa disa blloqe janë vendosur në kontraforte, duke mbuluar pjesërisht mbishkrimin. Në pjesën më të madhe mbishkrimet janë dekrete për dhënien e së drejtës personave të ndryshëm së bashku me familjet e tyre që të vendosen dhe të jetojnë brenda në qytet. Njëri prej tyre është një dekret që njofton dhënien e lirisë një skllavi. Në to përmenden emrat e kryetarëve të qytetit si dhe të drejtuesve ushtarakë.

Krahu tjetër i këtij muri kthen me kënd të drejtë nga jugu në formë të shkronjës L me faqe drejtuar nga lindja. Ruhet deri në 10 m gjatësi dhe vetëm blloqet e themelit. (Tab. II, a).

Muri mbajtës është ndërtuar me një paret me blloqe prej guri të butë gëlqeror, që punohet lehtë me daltë. Ato janë me faqe të sheshta, në pjesën më të madhe kuadratike, me anë të punuara me 45°. Janë vendosur në rreshta të drejtë izodomikë me lartësi rreth 0.46 m dhe me shkallëzime të rralla.

Qeramika e zbuluar gjatë gërmimit të teatrit ishte e përzier, e grumbulluar mbas rrënimit, nga rrëshqitjet e shtresave kulturore që ndodhen në pjesën e sipërme të kodrës, kështu që ajo nuk mund të merret si bazë për datimin e teatrit. Për caktimin e kohës së ndërtimit jemi mbështetur te mbishkrimet që i takojnë sh. III p.e.re.

Ndërtimi i teatrit në qytetin antik mbi kodrën e fshatit Klos (Nikaia) si edhe në qytetin fqinjë Bylis, që janë kaq afër me njëri-tjetrin, jo më tepër se një gjysmë ore larg, tregon për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të këtyre dy qyteteve ilire. Përveç kësaj, ngritja e tyre si edhe mbishkrimet e gjetura në blloqet e murit, të cilat bëjnë fjalë për dhënien e qytetarisë (Politeas) personave dhe familjeve të tyre për të jetuar në qytet, dëshmon se këtu nuk kemi një dyqytetësh me dy lagje të vendosura në dy kodra pranë, por me dy qytete të veçanta nga njeri tjetri, ku secili ka pasur jetën e vet administrative, ekonomike, politike dhe kulturore. Me këtë nuk përjashtohet origjina e qytetit të Bylisit si pasojë e zgjerimit të qytetit të Nikajës, banorët e të cilës u vendosën në

kodrën pranë. Për njëfarë kohe ato duhet të kenë jetuar në një dy qytetësh, por Bylisi, i vendosur në një kodër me sipërfaqe banimi më të madhe, afërsisht 27-30 ha, por me një mbrojtje natyrore jo aq të sigurt, u zhvillua më tepër duke ia kaluar qytetit nënë, aq sa në sh. III p.e.sonë, kohë që i takojnë mbishkrimet si edhe ndërtimi i teatrit, secili jeton si qytet më vete. Po kështu duhet të pranojmë se në zhvillimin e shoqërisë skllavopronare qyteti i Bylisit u bë qëndra e fisit dhe e koinonit të bylinëve ku përfshihej edhe qyteti në Klos (Nikaia), i cili e ruan autonominë politiko-administrative dhe kulturore. Mund të themi gjithashtu se nuk mund të ndërtohej nga një teatër në secilën prej dy lagjeve të një qyteti, kur dimë se në to shkonin për të parë shfaqje edhe banorët e qendrave pranë dhe kur një pjesë e madhe e qyteteve ilire nuk e kanë pasur një ndërtim të tillë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

QYTETI ILIR NE KLOS



DO NOT COPY


TEATRI
NE QYTETIN ANTIK NE KLOS
PRERJE 2-2
d
1
3
2
1
a
e
DETAJ "a"
detaj "a"
c
PRERJE 3-3
3
2
b
PRERJE 1-1
0 1 2 3 4 5 m.



a



Rikonstruksion
a) Pamje e përçjithshme
b) Planimetria

b

DO NOT COPY

Lazër PAPAJANI

DO NOT COPY

LE THEATRE DE LA VILLE ILLYRIENNE A KLOS DE MALLAKASTËR ET LES TRAVAUX DE RESTAURATION QUI Y ONT ETE EFFECTUES

RESUME

Les fouilles archéologiques effectuées dans la ville illyrienne de Klos à Mallakaster, pendant les années 1973-1976, ont porté à la découverte de certains monuments dont on ignorait l'existence. De leur nombre fait part aussi un monument de caractère social, le théâtre de la ville.

Ce théâtre se dresse dans la partie la plus élevée de la ville, sur un terrain rocheux, qui est cependant, la partie la moins élevée du somment de la colline. De ce fait, le versant de la colline est moins élevé que son autre versant. Cette partie est cernée de murs, qui atteignent la hauteur naturelle de l'aile plus haute, alors que l'espace vide est rempli de cailloutis afin de pouvoir y poser les blocs des gradins du théâtron. C'est de la sorte qu'on a pu égaliser les deux versants de la colline.

Dans le choix du terrain sur lequel a été construit le théâtre, ses bâtisseurs ont certainement tenu compte de certaines conditions comme la direction de la lumière, des vents, etc., mais ce qui a définitivement déterminé sa direction a été la position appropriée de la colline. L'emplacement comme la direction du théâtre de Klos est Nord-sud. Par rapport aux théâtre d'Apollonie, de Butrint et de Bylis, où les degrés du théâtron se dirigent vers l'ouest, à Klos celui-ci regarde en direction nord. Face au théâtre s'étend une vue agréable.

Comme tous les théâtres du monde antique, le théâtre mis à jour dans la ville illyrienne surmontant la colline du village de Klos (Nikaia), comprend deux pièces principales: les degrés du théâtron et la scène. La scène, elle aussi, comprend deux pièces: le proscenium dans sa partie antérieure et la scène derrière celui-ci.

A son état actuel ce monument est gravement endommagé, à l'exception de l'enceinte des spectateurs qui conserve entièrement et régulièrement sa forme originale; toutefois, ici aussi, sauf les degrés du premier rang, les degrés des autres rangs sont dans un mauvais état. Il n'existe dans la roche que l'endroit creusé pour y installer leurs blocs de pierre (Fig. 2), et, quant aux blocs de pierre, il n'en reste qu'un seul et non à sa place.

Le premier rang de degrés était destiné aux spectateurs appartenant aux hautes classes de la société de l'époque. Il est haut de 0.42 m et large de 0.34-0.40 m. A la différence des autres rangs du théâtre, il est pourvu d'un appui pour le dos. Au dessous de celui-ci, vient un rang plus petit, à 0.32 m. du niveau de l'orchestre, dont les spectateurs se servaient pour y poser leurs pieds. Les blocs de ce rang sont creusés simplement en forme de cube, alors que les blocs sur lesquels s'asseyaient les spectateurs sont légèrement en arc et avec leur partie inférieure plus étroite (Fig. 3). En général le dossier du siège fait partie intégrante du bloc.

Après le premier rang vient un couloir pour le mouvement et la répartition des spectateurs dans les autres rangs du théâtron. Les différents échelons de la roche de la colline étaient revêtus de blocs de pierre travaillés à cette fin. A la différence de plusieurs théâtres et stades de l'époque, à Klos les blocs sont travaillés simplement: seulement dans leur partie supérieure on relève une corniche droite légèrement en saillie, où l'on lit la lettre. E.

Dans la roche constituant le plancher de l'orchestre, par devant le bloc servant d'appui aux pieds, on avait creusé un canal d'une profondeur de 5 à 6 cm. pour recueillir les eaux pluviales et les éloigner.

Il est difficile de déterminer aujourd'hui le nombre global des gradins à travers les traces restées sur la roche, mais pour ce faire il suffit de mesurer la hauteur générale de l'enceinte du théâtre qui est de 8 m. Compte tenu du fait que la hauteur d'un rang était de 0.45 m., il ressort que le théâtre a dû avoir approximativement 17 rangs. Le mesurage et le calcul de la hauteur moyenne d'un rang de l'enceinte ont montré que près de 50 personnes y pouvait prendre place, aussi il résulte que ce théâtre, avait une contenance d'environ 800 personnes.

Actuellement on ne conserve pas même un fragment architectural du proscenium et de la scène. Dans la roche de la colline où s'appuyait le soubassement du proscenium et de la scène, on peut voir encore clairement les endroits creusés par où passaient les murs des fondations. On relève aussi les parties latérales et terminales de la scène. A partir de ces traces, nous pouvons dégager ses dimensions et sa planimétrie. Et sur la base de ces données, nous pouvons reconstruire avec exactitude la planimétrie de cette partie du théâtre.

Le soubassement comportant les traces indiquées plus haut se trouve, par rapport au plancher de l'orchestre, à 0.94 m. au-dessous du niveau de celui-ci, alors que le soubassement

du proscenium presque au même niveau. Dans l'autre partie, c.-à.-d. dans la scène, la roche va diminuant au point qu'à 1,76 m. de hauteur, par rapport au soubassement du proscenium, se trouvent les fondations du mur terminal de la scène.

Le proscenium avait une langueur de 10.60 m, qui est légèrement inférieure au diamètre de l'orchestre. Ses fondations reposent sur deux canaux parallèles creusés dans la roche avec une largeur de 0.50-0.60 m, qui est egale a la largeur du mur dont la profondeur est de 5 à 15 cm.

La distance entre ces deux canaux montre que l'ouverture ou la largeur du proscenium comprise entre les colonnes et le mur terminal est de 1.65-1.70 m. Dans ce mur, à 2.90 m du mur nord-est, avait été aménagée la seule porte reliant le proscenium et la scène. Là où se trouve la porte, la roche n'a pas été creusée en forme de canal comme dans les autres parties où s'élève le mur. Selon les traces existantes, la porte avait une largeur de 1.08 m.

Dans tous les théâtres du monde antique les portes faisant communiquer le proscenium et la scène sont aménagées dans l'ouverture de deux colonnes. A partir de ce fait et en considération aussi des traces laissées par la porte reliant entre eux le proscenium et la scène, nous pouvons déterminer le nombre des colonnes dans la partie frontale du proscenium et la distance séparant les unes des autres. La distance de 2,90 m depuis l'angle du mur jusqu'à l'endroit où commence la porte, indique qu'il y avait ouvertures et deux colonnes séparées d'une distance d'environ de 1.50 m d'un axe à l'autre. La porte, dont la largeur est de 1.08 m, se trouve face à la troisième ouverture, c'est-à-dire entre la deuxième et la troisième colonne.

Pour calculer la hauteur des colonnes nous ne disposons pas de traces, mais considérant les autres constructions de même genre en style dorique, auxquelle à notre avis, doit appartenir ce théâtre aussi, nous pensons que la hauteur de ces colonnes était d'environ de 3 m.

Outre les traces relevées dans la roche, les murs latéraux de la scène comportent quelques blocs entiers. Elle a une longueur de 10.60 m, égale donc à celle du proscenium, alors que la largeur ou profondeur de la scène est de 4.70 m.

A la différence de la plupart des théâtres du monde antique ont deux entrées (parados), ici, dans le théâtre de la ville de Klos, il n'y a qu'une seule entrée aménagée sur le côté nord-est en direction de la terrasse où se trouve le portique. Cette entrée traverse le mur de soutènement des gradins et le mur entier du proscenium. Nous n'avons pas pu relever des traces d'escalier de passage traversant le théâtron, et cela en forme de rayons, pour assurer le passage des spectateurs aux divers rangs de l'enceinte.

Les traces mentionnées plus haut dans la roche, tant dans l'enceinte que dans le proscenium et la scène, nous permettent de procéder à la reconstruction hypothétique de ce théâtre en général.

Les fouilles effectuées ont montré que les blocs du mur de soutènement s'étaient écroulés. Nous avons procédé avec les soins nécessaires au nettoyage de la terre couvrant ces blocs.

Le mur s'était écroulé entièrement. Pendant le mouvement des blocs, nous avons constaté que quelques-uns d'entre eux portaient des inscriptions. La mise en place des blocs a redonné au mur sa direction initiale. Dans les fondations de ce mur on relève trois contreforts placés à 3.20-3.40 m de distance l'un de l'autre. Ces contreforts ne se prolongent pas dans toute la hauteur du mur, ce qui signifie qu'il servaient à renforcer ses fondations. Ils s'élèvent à une hauteur de deux blocs. Pendant le processus de restauration de ce mur, nous avons constaté qu'il avait été reconstruit précédemment. Pendant la reconstruction, certaines inscriptions avaient été placées à l'envers et on y avait ajouté aussi d'autres inscriptions.

La céramique mise à jour pendant les fouilles effectuées dans le théâtre appartenant à différentes couches culturelles, du fait qu'elle a été recueillie parmi les matériaux éboulés de la partie supérieure de la colline, nous ne pouvions pas évidemment nous fonder sur elle pour la datation du théâtre. Pour définir la date de ce monument, nous nous sommes appuyés sur les inscriptions qui appartiennent au IIIe siècle av. n.è.

La construction d'un théâtre dans la ville antique surmontant la colline du village de Klos (Nikaia) et d'un autre dans la ville voisine de Bylis, qui sont très peu distantes l'une de l'autre, pas plus de demie heure de route à pied, témoigne en faveur de l'essor économique et culturel de ces deux cités illyriennes. Par ailleurs, leur emplacement et les inscriptions figurant sur les blocs de pierre des murs, inscriptions à travers lesquelles est accordé le droit de cité (politeas) à des particuliers et à leurs familles, témoigne qu'en l'occurence nous n'avons pas affaire à un bipolis avec deux quartiers s'érigeants sur deux collines peu distantes l'une de l'autre, mais avec deux villes particulières séparées l'une de l'autre, chacune d'elles ayant son administration et un système économique, politique et culturel distinct. Toutefois, il se peut fort bien que la ville de Bylis ait été fondée par suite de l'élargissement de la ville de Nikaia, dont les habitants s'établirent dans la colline avoisinante. Ces deux cités ont dû constituer pour un certain temps une bipolis, mais Bylis, surplombant une colline ayant une surface d'habitation plus grande, d'environ 27-30 ha, et une défense naturelle cependant pas si sûre, a connu un plus grand développement que la ville au dessous, au point qu'au IIIe siècle av. n.è., période à laquelle correspondent les inscriptions et la construction du théâtre, chacune de ces deux cités conduisait une existence autonome. De même, nous devons admettre que pendant le développement de la société d'esclavage la ville de Bylis devint le centre du clan et du koinon des Byliens, duquel faisait part aussi la ville de Klos (Nikaia), tout en conservant son autonomie politique-administrative, et culturelle. On peut également affirmer que l'on ne pouvait construire un théâtre dans chacun des deux quartiers de la même ville, lorsque celui-ci était fréquenté aussi par les habitants de cités voisines et que dans une bonne part des cités illyriennes manquait un ouvrage culturel semblable.

Document

DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

DO NOT COPY

MOZAIKU I BAPTISTERIT TË BUTRINTIT
NDËRTIM I NJËKOHËSHËM

Gjatë një ekspedite restauruese të kryer disa vjet më parë në mozaikun e baptisterit të Butrintit[1], kemi vënë re disa gjurmë ndërhyrjesh. Periodizimi i fazave të ndryshme të tyre do të përbënte një interes të veçantë studimi. Duke marrë shkas nga këto ndërhyrje u nxitëm të vrojtojmë me kujdes shtresën fillestare të mozaikut, marëdhëniet e tija me arkitekturën si dhe natyrën e gurëve dhe karakterin stilistik të dekoracionit që ai paraqet.

Në botime të ndryshme janë bërë përshkrime të mozaikut si dhe janë shprehur mendime për karakterin, periudhën e ndërtimit dhe destinacionin e tij[2]. Për baptisterin dhe mozaikun e dyshemesë së tij ka bërë një studim arkeologu Italian L.M. Ugolini. Në analogji me mozaikët e Nikopolisit, me mozaikët e pallatit të Teodorikut në Ravenë, fragmentet muzive në Ankonë të Italisë etj, ai e daton mozaikun e Baptisterit në sh. V-VI të erës sonë[3]. Në këtë studim ay shkruan se... «harmonia e së përgjithëshmes së mozaikut ndërpritet vetëm në dy pika... në vazhdim vertikalisht në sektorin korespondues të hyrjes së mozaikut me dy ndërhyrje muzive që coptojnë me forcë uniformitetin dhe stilin e gjithë dekorit e që duken përnjëherë se janë të një periudhe më të vonshme duke përmbajtur qartësisht kuptimin e simboleve më karakteristike kristiane» dhe po aty më tej vazhdon... «skenat duket se janë futur për të konsakruar vendin, që ndoshta fillimisht ishte profan, me paraqitjen e eukaristisë dhe pagëzimit të njohura tashma si simbole në gjithë artin primitiv kristian[4].

Kjo pikpamje pasqyrohet edhe në gjithë botimet e tjera të mëvonëshme si dhe në tekstin e historisë së Shqipërisë[5].

Qëllimi i studimit tonë është një vështrim dhe konkluzion krejt i ndryshëm nga ay i njohur dhe shprehur deri sot për të dy skenat e eukaristisë të cilat mendohen si ndërhyrje që kanë coptuar unitetin dekorativ e stilistik të mozaikut, si dhe një pikpamje e ndryshme lidhur me destinacionin fillestar të ndërtesës dhe mozaikut «ndoshta profan» siç shprehet Ugolini apo «pagan» sikurse e gjejmë në tekstin e historisë së Shqipërisë dhe botime e shkrime të tjera, në të cilat shprehet qartë mendimi, se kjo ndërtesë pagane u çfrytëzua më vonë duke shtuar skenën e eukaristisë dhe vendin e pagëzimit për qëllime të tjera. Natyrisht një vështrim më i plotë i monumentit në tërësinë e tij në lidhje me arkitekturën dhe elementet e tjerë, do të plotësonte më mirë kuadrin e studimit. Gjithashtu shtrirja e vështrimit edhe në pjesët e tjera përbri monumentit apo dhe marrëdhëniet me objekte të tjera të kësaj periudhe, me karakter gjithashtu fetar, do të hidhnin dritë të plotë mbi këtë objekt me shumë interes të artit dhe arkitekturës paleokristiane në vendin tonë. Ky kuadër natyrisht mbetet për t'u plotësuar dhe thelluar në studime të tjera.

1) Në verën e vitit 1974 u kryen disa punime konsolidimi mbi shtresën e mozaikut të baptisterit të Butrintit. Masat restauruese të ndërmara nga sektori i artit të Institutit të Monumenteve të Kulturës nën udhëheqjen e autorit prekën disa zona të dëmtuara, duke bërë përforcime dhe disa plotësime.

2) S. Anamali — S. Adhami **«Mozaikë të Shqipërisë»** Album 1974, faqe 13.

3) L. M. Ugolini. **Il Battistero di Butrinto** Rev. di arch. crist. Roma, 1934.

4) L. M. Ugolini **Po aty** f. 270, 282.

5) Historia e Shqipërisë Tiranë 1967, 146.

DO NOT COPY



Fig. 1

Mozaiku i baptisterit të Butrintit është një paraqitje figurative muzive, tipike për shek. V dhe VI-të, kur arti kish humbur mjaft nga monumentaliteti i shekujve të parë të kristianizmit dhe prirej drejt paraqitjeve më tepër ornamentale ku vëndin e figurave e skenave kryesore e zënë elementet dekorative të shpërndarë me shumicë dhe të reduktuar në përmasa.



Fig. 2

Mozaiku i baptisterit me ndërtimin e shumë skenave të shpërndara nëpër medalionet rrethore, figurat e vogla dhe elementet e shumtë dekorativ është një rast tipik i largimit nga ky monumentalitet (fig. 1). Vendosja e një numri të madh figurash zomorfe me funksione simbolike si dhe motivet vegjetale e gjeometrike, si elementë plotësues, pa ndërtuar një skenë qendrore e kryesore të kompozimit në përmasa qartësisht të diferencuara, është karakteristikë e dekoracionit të mozaikut. Në këtë rast figurat e skenës së eukaristisë nuk bëjnë asnjë përjashtim nga karakteri simbolik i gjithë figurave të tjera (fig. 2), por ato ruajnë natyrisht në dimensione të reduktuara një vend kryesor e qendror në sistemin e përgjithshëm të dekorit.

Në zgjidhjen figurative të mozaikut, skena e eukaristisë nuk është një ndërprerje e dhunshme e sistemit të rrathëve që dekorojnë në mënyrë rrethore dyshemenë, për arsye se distanca midis dy unazave rrethore ku është ndërtuar skena, nuk plotëson vendin që nevojitet për të vendosur dy ose tre unaza të tjera, që normalisht duhet të kenë qënë prishur, po të pranojmë që sistemi i rrathëve është ndërprerë për të ndërtuar më vonë skenën e eukaristisë.

bazën e skenës së eukaristisë të cilat mjaft mirë lidhen me paraqitje të tilla që gjënden në pjesët e ndryshme të dekorit.

Pra jo vetëm mozaiku është konceptuar e ndërtuar fillimisht në një karakter e kompozim të tillë ku sistemi i rrathëve i lë vëndin në pjesën korresponduese të hyrjes, dy skenave muzive me paraqitjen e simboleve qartësisht kristiane, por edhe zgjidhja planimetrike e ndërtesës me një sistem të tillë rrethor me dy rradhë kollonash cilindrike e një basen rrethor në mes është një ndërtim i njëkohëshëm fillimisht i konceptuar për të qënë një baptister pa pësuar më vonë asnjë modifikim të destinacionit fillestar.

DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

DO NOT COPY

LA MOSAÏQUE DU BAPTISTERE DE BUTRINT UNE CONSTRUCTION SIMULTANEE

RESUME

Au cours d'une expédition de restauration effectuée il y a quelques années dans la mosaïque du baptistère de Butrint, nous avons relevé des traces d'une restauration précédente. La définition de la date de ces différentes phases de restauration est d'un grand intérêt. Partant de ces interventions, nous avons observé attentivement la couche initiale de la mosaïque, les rapports de celle-ci avec l'architecture ainsi que la nature des pierres et le caractère stylistique de la décoration qu'elle représente.

Dans différentes publications on trouve des descriptions de cette mosaïque, ainsi que des opinions sur le caractère, la période de construction et la destination de cet ouvrage. L'archéologue italien L.M. Ugolini a publié un écrit sur le baptistère de Butrint et la mosaïque de son plancher. En analogie avec les mosaïques de Nicopolis, avec les mosaïques du palais de Théodoric à Ravenne, les fragments de muses à Ancône (Italie), etc., cet auteur attribue la mosaïque du baptistère de Butrint aux Ve-VIe siècles de notre ère. Il écrit: «... l'harmonie générale de la mosaïque est interrompue à deux seuls points... en direction verticale, dans le secteur correspondant à l'entrée de la mosaïque, par deux interventions de muses qui morcellent l'uniformité et le style de tout le décor et qui apparaissent tout de suite appartenir à une période postérieure, tout en préservant clairement la signification des symboles plus caractéristiques chrétiens». Et plus loin: «... les scènes ont été évidemment introduites pour consacrer l'endroit, qui, au commencement, était peut être profane, et cela en présentant l'eucharistie et le baptême désormais reconnus comme symboles de l'art chrétien primitif dans son ensemble».

Un point de vue analogue reflètent aussi tous les autres écrits postérieurs ainsi que le manuel d'histoire de l'Albanie.

Or notre étude vise un but différent: elle tend à donner un aperçu de la situation et à aboutir à une conclusion opposée à celle admise et exprimée jusqu'à ce jour sur les deux scènes de l'eucharistie, que l'on considère comme une intervention qui a rompu l'unité décorative et stylistique de la mosaïque, ainsi qu'à formuler un point de vue différent en ce qui concerne la destination initiale de cet édifice et de la mosaïque «peut être profane», comme s'exprime Ugolini, ou «païenne», comme il est dit dans le manuel de l'histoire d'Albanie et d'autres écrits à ce sujet, qui expriment clairement l'idée que cet édifice païen a été employé à d'autres fins plus tard en y ajoutant la scène de l'eucharistie et les fonts du baptème. Evidemment, un aperçu plus complet du monument dans son ensemble en relation à l'architecture et à d'autres éléments, ainsi que l'étude des autres éléments situés à son voisinage ou encore de ses rapports avec d'autres objets de cette même période, de caractère également religieux, auraient éclairci plus à fond cet objet de grand intérêt de l'art et de l'architecture paléochrétiens chez nous. C'est là naturellement une tâche qui sera menée à bien par les études qui seront effectuées à l'avenir.

La mosaïque du baptistère de Butrint est une reproduction figurative de muses, typique pour les Ve et VIe siècles, alors que l'art avait suffisamment perdu son caractère monumental des premiers siècles du christianisme et tendait vers des représentations de caractère plutôt ornemental, où les figures et les scènes principales furent remplacées par des éléments décoratifs répartis en abondance et dans des proportions réduites.

La mosaïque du baptistère qui comprend plusieurs scènes introduites dans les médaillons circulaires, des petites figures et maints éléments décoratifs est un cas typique de son éloignement du caractère monumental (Fig. 1). La présence d'un bon nombre de figures zoomorphes à fonctions symboliques, ainsi que de motifs floraux et géométriques, en tant qu'éléments complémentaires, sans édifier une scène centrale et principale de composition dans des proportions clairement différenciées, — voilà quelle est la caractéristique de la décoration du mosaïque.

Download

En l'occurence les figures de la scène de l'eucharistie ne s'écartent point du caractère symbolique de toutes les autres figures (Fig. 2), mais conservent naturellement dans des dimensions réduites une place principale et centrale dans le système général de la décoration.

Quant à la solution figurative de la mosaïque, la scène de l'eucharistie ne constitue pas une rupture violente d'avec le système des anneaux qui décorent de façon circulaire le plancher, et cela parce que la distance entre les deux anneaux circulaires, où est reproduite la scène, ne complète pas l'endroit nécessaire à placer deux ou trois autres anneaux, qui, normalement, doivent avoir été détruits, si nous admettons que le système des anneaux a été interrompu pour mettre en place plus tard la scène de l'eucharistie. Ce fait de grand intérêt est complété par une série d'autres arguments, comme le défaut des traces de l'entrelacet connectif des anneaux limitant la scène, qui se clôt régulièrement sans aucun signe de restauration successive (Fig. 3). D'autres phénomènes analogues sont la terminaison du motif de la feuille stylisée qui accompagne le système des anneaux par une figuration en forme de la lettre «S», qui indique sa fin et non son prolongement; la construction technique analogue de toute l'adjonction de la mosaïque ainsi que le défaut d'une ligne dans la zone de la scène qui est redoublée dans les autres parties (élément laissé à dessein par le mosaïste pour avoir plus de place pour la scène). On relève ce même phénomène sur les côtés de l'autre scène surmontant l'eucharistie, à sa droite, où est reproduite une branche de lierre (Fig. 4), motif qui a été employé par le mosaïste pour compléter l'espace vide qui lui est resté dans la composition de la scène déplacée. Le motif du lierre est travaillé avec les mêmes petites pierres que l'on retrouve dans le système des anneaux. Si nous suivons le motif d'une bande en forme de «queue de chien», qui encadre toute la périphérie des médaillons répartis dans le champ central de la mosaïque, nous allons voir qu'il est interrompu juste au point où il rejoint des deux côtés les bordures de la zone où a été construite la scène de l'eucharistie, sans avoir naturellement aucune trace de restauration.

Non seulement les deux scènes de l'eucharistie sont conçues comme des compositions se rapportant au caractère initial de l'édifice en tant que lieu de baptème, mais encore le bassin central de forme cylindrique qui se dresse au centre du champ circulaire est de construction simultanée avec le décor de la mosaïque, sans en affecter dans l'ensemble la composition. La décoration environnant le lieu du baptème comprend une bande circulaire dont le motif comporte des anneaux entrelacés les uns avec les autres délimitant le lieu du baptème, et cela par une bordure double et sans aucune trace d'interruption ou de restauration successive. Les socles des colonnes avec leurs profils, parfois de forme irrégulière, eux aussi, sont contournés entièrement par la couche de la mosaïque, ce qui signifie que cette construction circulaire comportant un système de huit colonnes double a été conçue dès le début comme baptistère.

Naturellement, il se peut fort bien que certains matériaux, par exemple des colonnes ou encore des pierres aient été prélevées d'un autre édifice «peut-être païen», mais en l'occurence il est question d'un réemploi des matériaux de construction et non pas de la destination initiale de l'édifice.

Par ailleurs, la disposition de la scène de l'eucharistie correspond à l'entrée de la salle, dont on ne peut mettre en doute la direction, car les deux coqs des médaillons respectifs sont placés vis-à-vis l'un de l'autre, ce que l'on ne relève pas dans les autres figures des anneaux où celles-ci sont disposées les unes après les autres (Figs. 5-6). La disposition des figures des oiseaux face au système des anneaux contrebalance apparemment l'entrée et fait de cette scène le motif central du décor de la mosaïque.

A son état actuel la mosaïque dans son ensemble, et tout particulièrement la scène de l'eucharistie, ont subi des interventions qui ont accru la gamme des couleurs ainsi que la dimension et la nature des petites pierres. Les traces de restauration sont évidentes dans la composition du mortier employé, qui est d'une couleur plus claire. On relève des traces de restauration non seulement dans les deux scènes correspondantes, verticalement par rapport à l'eucharistie, mais encore dans les autres parties du décor, par exemple dans les médaillons du deuxième cercle, qui limite le mur latéral de la salle circulaire située vis-à-vis de la scène de l'eucharistie. Dans ces médaillons, aux figures des faisans ont été ajoutées des pierres aux nuances jaunes, bleus et verts, que l'on ne retrouve pas dans les figures des autres médaillons, à l'exception de celles reproduites dans la scène de l'eucharistie.

Partant du fait que les restaurations ont été effectuées dans des mesures et des périodes différentes, de temps à autre, à notre avis les deux scènes correspondantes de l'eucharistie sont des restaurations complètes réalisées plus tard. Par ailleurs, la mosaïque du baptistère se caractérise d'un décor typique des Ve-VIe siècles reproduisant des animaux et d'autres symboles zoomorphes, qui, avec la scène de l'eucharistie et le lieu du baptème, ont servi à des fins religieuses non seulement pendant les Ve-VIe siècles mais encore plus tard, pendant le moyen âge. Les deux scènes de muses sont des restaurations effectuées plus tard, à partir peut-être d'une scène plus ancienne ou même modifiée, mais toujours dans une zone conçue et composée initialement en tant que place principale et centrale de la composition. La restauration a affecté entièrement les deux scènes correspondantes verticales soit sur le plan de la structure et des matériaux d'appui que de la nature chromatique des petites pierres employées. Du point de vue stylistique les deux scènes cherchent à s'intégrer entièrement dans le style et le caractère linéaire de la décoration prédominante dans la mosaïque, naturellement en y introduisant des nuances nouvelles soit sur le plan technique que stylistique, par des apports plus recherchés et élaborés, par des lignes complètes plus exactes et d'une plus grande finesse. La liaison stylistique avec

les autres parties de la mosaïque est plus évidente dans les deux figures de faisans ou d'oiseaux reproduites dans la scène de l'eucharistie, qui combient assez bien avec les représentations semblables figurant dans les autres parties du décor.

Donc non seulement la mosaïque a été conçue et construite initialement avec un caractère et une composition semblables, où le système des anneaux cède la place, dans la partie correspondante de l'entrée, aux deux scènes de muses avec la reproduction de symbole clairement chrétiens, mais encore la solution planimétrique de l'édifice suivant un tel système circulaire avec deux rangées de colonnes cylindriques et un bassin circulaire au milieu est une construction simultanée conçue dès le début pour être un baptistère et qui n'a subi dans le temps aucune modification de sa destination initiale.

DO NOT COPY

Prof Dhimitër S. SHUTERIQI

DO NOT COPY

MBI DISA VIZATIME RUPESTRE MESJETARE PRANË RUBIGUT DHE MBI DISA MOTIVE SKULPTURORE POPULLORE NË MIRDITË

Në Rubig të Mirditës ruhet një nga monumentet më të vjetër mesjetarë të Shqipërisë, ndonëse i dëmtuar shumë, kisha e Sh. Shelbuemit (Salvatori), pjesë e manastirit me të njëjtin emër, në një shkëmb mbi lumin e Fanit. Qëndron ende në këmbë absida me disa afreska të tipit bizantin përbrenda saj. Manastirin, murgjërit katolikë të Perëndimit (sigurisht jo benediktinët, siç është thënë, sepse ata nuk ishin formuar ende si urdhër) e kanë shtënë në dorë që përpara vitit 1214[1]. Kjo mund të ketë ngjarë që në pjesën e dytë të shek. XII, pas vitit 1167, kur peshkopata e Arbërit, në të cilën bënte pjesë manastiri, dihet se i përket tanimë kryepeshkopatës katolike të Tivarit, e krijuar në fillim të shekullit. Më parë se të vendosen në Rubig klerikët perëndimorë, aty ka sunduar riti ortodoks.

Është shkruar shpesh mbi Sh. Shelbuemin e Rubikut, mbi interesin historik që ai paraqet, si dhe mbi interesin artistik. Për datimin e kishës, gjer më sot, nuk janë nxjerrë përfundime të kënaqshme. Sigurisht ajo nuk i përket vitit 1272, sikundër ka qenë pretenduar nga Ippeni[2]. Që ajo është më e vjetër se viti 1214, për këtë nuk kemi dyshim. Nga ana tjetër, nuk është e lehtë të përcaktohet kurdoherë koha e prishjeve dhe e rindërtimeve, jo të plota, që ka pësuar kisha që nga shek. XIII e këndej. Data 1272 është dhënë sipas një mbishkrimi që edhe sot lexohet mbi afreskat e absidës[3]. Prej një rileximi të hollësishëm që i kemi bërë në vend mbishkrimit, me sy, duke e fotografuar disaherë e duke e vizatuar gjithashtu, arritëm në përfundimin se ai mbishkrim i përket vitit 1254,[4] pra, një çasti më të hershëm. Ky përfundim nuk bie të ndesh me mendimin sipas të cilit afresket e Rubigut u përkasin viteve 1260-72[5], ndonëse nuk na duket se ka të dhëna që të vendosen kaq ngushtësisht në kohë ato afreska, veç në qofshin të vitit 1254.

Çka thamë mbështetet edhe nga një tjetër dokument rubigas, një mbishkrim i kishës, që tani nuk ekziston, po që motit e shënoi misionari i huaj B. Orsini, i cili e regjistroi si mundi dhe që ne e kemi deshifruar[6]. Ky mbishkrim flet për djegjen e faltores

1) Dh. Shuteriqi, **Duke rilexuar një mbishkrim të shek. XIII,** «Ylli», Tiranë, Maj 1964, 25.

2) Th. Ippen, **Die Gebirge des nordwestlichen Albaniens,** Wien, 1908; po ai, **Još nešto starine crkvama u Šasu i Rubik,** Sarajevo 1902, po ai, **Stare crkve ne ruževine u Albaniji,** Sarajevo, 1901.

3) Th. Ippen, **po aty,** Shih dhe D. Fabianich, Storia dei frati minori, Zara, 1869, II, 241; Dh. Dhamo, **Piktura e vjetër murale e kishës së Rubikut** «Studime historike», Tiranë, 1964, nr. 2, 93.

4) Dh. S. Shuteriqi, **po aty.**

5) Dh. Dhamo, **po aty.**

6) Sipas një relacioni të ipeshkvit të Lezhës, Bernardo Orsini **Geografia ecclesiastica dell'Albania,** Roma, 1934, 20; Dh. S. Shuteriqi, **Edhe një herë mbi disa çështje të Arbërit** «Buletini Shkencave shoqërore», Tiranë, 1958, nr. 3, 47-8; po ai, **Një mbishkrim i Arbërit (1190-1216) dhe mbishkrime të tjera gjetur në Mirditë,** «Studime historike», 1967, nr. 3, 147, shën. 25, ku saktësohet edhe më mirë data e mbishkrimit; **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** Tiranë, 1962, II, 45, ku riprodhohet shqip dokumenti.

së Rubigut nga kapedani i Arbërit, Andrea Vrana, emri i këtij zbulohet kështu për herë të parë, midis 1 shtatorit 1265 dhe 22 shkurtit 1266[7]. Me sa kuptohet, kisha nuk u dogj e tërë dhe një vëzhgim i vëmëndshëm në vend tregon se edhe mbishkrimi i vitit 1254 u bë mbi një tjetër më të moçëm, i cili nuk lexohet, po që ka lënë gjurmë. Kështu vërtetohet se kisha ka pësuar disa dëmtime, apo se janë bërë punime më se një herë në të (1254, mbas 1265-66). Afreskat e saj të sotme i përkasin kohës përpara djegjes që i bëri zoti i Arbërit, Andrea Vrana, djegje prej së cilës absida shpëtoi jo keq.

Nga këta pak shënime mund të shihet se lufta fetare, ose lufta politike në platformë fetare, midis kishave të Perëndimit e të Lindjes në Rubig, po, siç do ta shohim, edhe midis tyre dhe herezisë që ekzistonte në vend, ka qenë e fortë në Mirditë në shek. XIII. Ajo do të vazhdojë gjatë edhe më pas. Mirditorët vetë e kanë djegur kishën e Rubigut edhe rreth vitit 1629[8].

Del se Mirdita ishte së hershmi një nga ato krahina të quajtura **«bazilikane»** (mbretërore), që Bizanti i qeveriste me një strateg të posaçëm të perandorit. Një krahinë e tillë ishte p.sh., Bazilikata e Italisë. Në një dokument të vitit 1426, manastiri i Sh. Aleksandrit (Llezhdrit) mbi Orosh, që është quajtur «S. Alessandro de Albania»[9] apo «S. Alexandro maior de Albania»,[10] dhe që bënte pjesë në peshkopatën e Arbërit (episcopatum arbanensem, albanensi dieocesi), quhej edhe **«S. Alexandri in Basilicano Arbanensi** diocesis».[11] Fakti ka rëndësi të madhe, sepse tregon që shteti i parë feudal shqiptar i njohur, ai i Arbërit, në të cilin bënte pjesë edhe Mirdita, siç vërtetohet prej një mbishkrimi të tij që ne atje kemi gjetur dhe e kemi rindërtuar u krijua në vise të cilave Bizanti u jepte një rëndësi të posaçme përpara fundit të shek. XII. Këto vise, edhe më pas, do të loznin role të rëndësishme në Arbër, me derën e Blinishtëve, të njohur që nga pjesa e dytë e shek. XIII[13], dhe me derën e Dukagjinëve, e cila, me sa duket, jo vetëm që e mori këtë emër në po atë kohë[14], por edhe ishte pasardhëse e princërve të parë të njohur të Arbërit, e Progonit dhe e djemve të këtij, Gjinit e Dhimitrit (1190-1216),[15] me ata që i pasuan e që dihen gjer më sot, një Golem (1253)[16] dhe një Andrea Vrana (1265-66).

Vendosja e katolicizmit në Shqipëri solli trazime të mëdha që nga shek. XII e këndej. Në këto trazime, rol të madh luajti edhe herezia mesjetare e quajtur «e re», që plasi në shek. X në Ballkanin qendror e lindor, që pati një përhapje të shpejtë e të gjerë edhe në vendin tonë. Deri në shek. XIV, dokumentohet se ajo është e përhapur mirë në Arbër[17]. Me këtë ndeshje lidhet, me siguri, emri i një fortifikate të vogël mesjetare, mbeturinat e së cilës (mure, saranxhë) shihen sot në një lartësi tjetër përmbi kishën e Rubigut. Fortifikata quhet **«Kalaja e xhudhejve»** d.m.th. e judejve. Judej, ndër ne, ka pasur rrallë dhe vetëm nëpër qytete, ku tregtonin. Po toponime me emrin **«xhudhi», «xhodhi»,** në Shqipëri të Veriut e veçanërisht në Mirditë, ka disa[18]. Me këtë emër, besimi popullor përfytyroi një si përbindësh

---

7) Dh. S. Shuteriqi, **Një mbishkrim i Arbërit,** 147, shën. 25.

8) I. Zamputi, **Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII, Tiranë,** 1963, I, 401; kuptohet se djegia ka qenë bërë me kohë dhe jo fill përpara marsit 1629, kur datohet relacioni.

9) **Acta et diplomata res Albaniae Mediae aetatis illustrantia,** L. Thaloczy, C. Jirecek, E. Sufflay, Vindobonae, 1913, nr. 653, shën. 1.

10) N. Iorga, **Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades,** Paris, 1399, II, 270.

11) **Po aty,** II, 25. Tjetër herë nuk del ky fakt. Shih edhe M. Sufflay, **Die Kirchenzustande im Vortürkischen Albanien** Illyrisch-Albanesische Forschungen», Leipzig, 1916, I, 213, shën. 5.

13) Dh. S. Shuteriqi, **Një mbishkrim i Arbërit,** 131. Mbishkrimi u gjet në fshatin Gëziq të Mirditës, te kisha e Sh. Mërisë së Ndërfandës. Atë e kishte zbuluar më parë Ippeni (shih **Stare crkve**), porse jo të gjithë; ai bëri një përpjekje riprodhimi dhe nuk arriti ta interpretonte.

14) **Po aty,** I, nr. 455; ducem Ginum Tanuschum, më 1281.

15) Dh. S. Shuteriqi, **Një mbishkrim i Arbërit,** 143, 147-8, Dukagjinët kishin të njëjtën stemë (shqiponjën njëkrenore) me princërit e parë të njohur të Arbërit.

16) Sipas Gjergj Akropolitit, bot. Leipzig 1903, I, 91.

17) **Anonymi descriptio Europae Orientalis,** bot. O. Gorka, Cracoviae, 1917, 25-29; **Burime historike,** II, 110-11, (përkthimi shqip).

18) E. Çabej, **Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe** «Studime filologjike», Tiranë, 1968, 88; po ai. **Studime gjuhësore,** Prishtinë, 1977, V, 154; M. Tirtja, **Rrënoja të vjetra në Mirditë** «Bashkimi», Tiranë, 26. VIII. 1971, jep si toponime: Gurët e xhodhive, Farka e xhodhive, Prroska e xhodhive. «Xhudhi» haset shpesh te Buzuku.

DO NOT COPY

keqbërës e të frikshëm[19]. S'ka dyshim se është një ofiq, të cilin kisha katolike ua vuri heretikëve, që ishin armiq të saj. Kjo gjë në Rubig vërtetohet edhe nga një tjetër anë.

Kalaja e xhudhejve ruan grykën e lumit të vogël që mban emrin Rubik e që, duke buruar në malin e Molungut apo të Zhupës së Lezhës, përshkon krahinën e Bulgrit, ish-bajrak[20], për tu derdhur në Fan nën qytetin e Rubigut, që emrin e mori motit nga lumi, se vendësit i kanë thënë Bulshizë (emri përdoret sot për fshatin mbi atë qytet). Kalaja është në grykën e lumit, në bregun verior të këtij. Në bregun jugor, në një lartësi gati të njëjtë, gjendet edhe një fortifikatë tjetër mesjetare që ruan grykën e lumit (atë s'e kemi vizituar). Pra, hyrja në thellësi të Bulgrit, ku është fshati që mban emrin kuptimplotë Katund i vjetër, — këndej kalon një rrugë e moçme dhe e rëndësishme, që lidhte Lezhën me brendësinë e Shqipërisë drejt Lindjes, deri në Prizren e tutje, — ishte e fortifikuar. Katundi i vjetër është një vend i banuar që së hershmi. Gjeturinat arkeologjike, që nga ilirët, hasen shpesh në ato anë, si në Rubik vetë e te kisha, në Rrasfik fill në Jug të qytetit dhe gjetiu.

Që më 1508-10, kur kemi të parën dëshmi vendase mbi krahinëzën përreth Rubigut, kjo mban emrin «*Bulgari*» dhe kështu do ta gjejmë përherë në shekujt që erdhën[21]. Me emrin «bulgri», perëndimorët quanin në Mesjetë heretikët ballkanas, sepse herazia gjeti përhapje të madhe në Maqedoni e Thrakë në shek. X-XIII. Klerikët e ardhur nga Perëndimi e të vendosur në Rubig patën të bëjnë aty me heretikë dhe me ta u ndeshën. Katundi i vjetër ishte një qendër heretikësh, me krahinëzën e tij. Klerikët e huaj i quajtën ata «bulgri» dhe ky emër i mbeti vendit. Po kështu i quajtën edhe «xhudhej», pra, «të pabesë», judenj, dhe ky emër i mbeti një kalaje të atij vendi.

Te Kalaja e xhudhejve, pikërisht në një faqe disi të pjerrët të shkëmbit mbi të cilin është ndërtuar fortifikata, shihen vizatime rupestër (fig. 1). Për ta nuk dimë të jetë shkruar tjetër herë ose të jenë përmendur. Janë vizatime shumë primitivë, me bojë të bardhë e fort të qëndrueshme (gëlqere?). Aty ku ngjyra është shuar, ka mbetur gjurma e saj e murrët mbi shkëmb. Midis vizatimeve dallohen mirë dy kry-



Fig. 1

19) E. Çabej, **Studime gjuhësore,** V. 154, citon M. Lambertz, **Albanesische Märchen,** Wien, 1922, 26 vj.

20) Tek emri «Zhupë» kemi kujtimin e një feude mesjetare ose e një ndarje administrative mesjetare, ku sundonte një «zhupan» (titull sllav për titullin latin «kont»). Gjatë sundimit osman, zotërit e vendit i ruajtën privilegjet e hershëm dhe u quajtën «bajraktarë», dhe ndarja administrative ose feuda «bajrak».

21) M. Barletius, **Historia de vita et rebus gestis Scanderbegi,** Romae 1508-10, lib. 12: Mons Bulgari: K. Steimetz, **Eine Reise durch die Hochländergau Oberalbaniens,** Wien, 1904, 50, shën. 5; dokument i vitit 1595: nel paese di Fanda, Bulgari e sopra Ales-

POOR COPY

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 4



Fig. 3



Fig. 5

sio; për pjesën e parë të shek. XVII, I. Zamputi, **Relacione,** I dhe II, treguesit e emrave: janë disa raste; M. Shufflay, **Povijest sjevernih Arbanasa** (Arkiv za arbanasku starinu, Beograd, 1924, 40; gli Albanesi montanari, cioe Mirditi, Bolgari, Seliti, situati sopra Alessio); **Koncillio Kuvendi i Arbënit,** Romae, 1706, 77; e Bulgaret bot. lat., po atë vit, 53: de Bulgaris; D. Farlati, **Illyricum sacrum,** Venetiae, 1817, VII, 366: Monasteria Rebichiense prope pagum Bulgarorum; H. Hecquard, **Histoire et description de la Haute Albanie ou Guégarie,** Paris (1858), 247; Boulgaro, etj.

qa, njëri i thjeshtë e tjetri diçka i stolisur (Tab. I nr. 1,2). Janë përfytyruar edhe dy njerëz, njëri majtas e tjetri djathtas. Ky i drejton të parit një hark me shigjetë, duke drejtuar, nga ana e kundërt, edhe një tjetër hark me shigjetë (Tab. I. nr. 4). Mbi shkëmb shihet edhe një vizatim, të cilin nuk e kemi riprodhuar këtu. Midis tij dallohet një hark i tretë. Janë edhe dy-tre vizatime të tillë primitivë, Njëri prej tyre duket të përfytyrojë një bukë të ndarë në 6 pjesë (Tab. I, nr. 3). Numri 6 është një si numër magjik i heretikëve ballkanas.

Dy simbole, me siguri, sundojnë në këta vizatime: kryqi, d.m.th. feja, dhe harku, d.m.th. lufta. Të dy këta simbole flasin për luftën fetare që bëhej në këto anë midis kishave të Perëndimit e të Lindjes, si dhe midis tyre dhe herezisë. Vetëm këtë përfundim themi se mund të nxjerrim nga vëzhgimi i vizatimeve mbi faqen e shkëmbit në Kalanë e xhudhejve në Rubig.



Fig. 6





Fig. 7

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

A janë këta vizatime punë të klerikëve katolikë apo të heretikëve? Kjo nuk mund të thuhet me siguri. Po dihet se heretikët ishin kundër kryqit, pra, kryqat s'duhet të jenë bërë prej tyre. Punë e tyre mund të jenë përfytyrimet e të dy njerëzve, njëri prej të cilëve vret tjetrin me shigjetë. Ky është një vizatim i tipit magjik dhe heretikët kishin trashëguar shumë nga besimet e lashta që kristianizmi përpiqej t'i zhdukte. Kur të huajt u vendosën në Rubig, lufta u ndez midis tyre dhe vendësve. Vizatimet që bënë të dy palët te shkëmbi nën kala, në lartësinë përmbi kishë, flasin për atë ndeshje të përgjakshme.

Interesi i kësaj ndeshjeje kuptohet se është shumë më i thellë: arbëreshët i qëndronin depërtimit fetar e politik perëndimor. Kleri katolik ishte pararendës i mbretërve të përtejdetit, që do të shkelnin vendin tonë në shek. XIII, me Manfredin Hohenshtaufen të Sicilisë (1258) e sidomos me Karlin I Anzhu të Napolit, i cili do ta shpallte veten «Rex Albaniae» më 1272. Dihet qëndresa që ky gjeti në Shqipëri, edhe në viset e Mirditës vetë, p.sh., ndër Blinishtët që përmendëm.

Le të ndalemi pak te ndonjë veçori e artit popullor ashtu si paraqitet ky sot në Mirditë, për të pasur disa elemente krahasimi dhe argumentimi.

Në Katund të vjetër, te varrezat e kishës së Sh. Gjergjit, mund të shohësh kryqa ku përfytyrohen koka njerëzish të suazuar në ta, apo kryqa të suazuar në motive të vjetër florealë (Fig. 2). Kisha është e vitit 1809 dhe varret më të rinj, edhe të 4-5 dhjetëvjetorëve të parë të shekullit tonë. Te një varr që ende ruhet në Mërkurth, midis Kurbneshit e Lurës, varr i viteve 40 të shekullit tonë, është skulpturuar së pari një njeri me duart të hapura, i vdekuri, dhe i është vënë edhe pushka në dorë e libri nën dorën tjetër (Fig. 3). Kemi të skulpturuar pastaj zogun, simbol të vajit (Fig. 4), kalin, delen, ibrikun e kafes dhe filxhanat, simbole të pasurisë, fisnikërisë dhe bujarisë (Fig. 4,5,6). Vizatime dhe skulptura të tilla, dhe jo vetëm në varre, njihen nëpër gjithë Veriun dhe ndonjëherë kanë qenë riprodhuar[22].

Motivet e vjetër (dielli, hëna, yjet, zogu, motivet, florealë) janë përzier, me kohë, me të rinjtë. Në një kullë të katundit Fang, sot seli e administratës së kooperativës, në anën e majtë të lumit të Fanit pak nën Rubig, kullë e vitit 1924, balli me të dy dyert karakteristike të kullave mirditore, është pasuar me motivin e shpatës apo të shqiponjës dykrenore të flamurit tonë, shqiponjë që e gjejmë edhe në ballin e mermertë të një kulle të viteve 40 në qytetin e Rrëshenit (Fig. 7). Dhe pranë këtyre motiveve të rinj, ata të vjetër të yll e hënës, që nuk duhen marrë domosdo për osmanë (Fig. 8, Fang), si dhe motive florealë të vjetër (Fig. 7,8,9).

Është gjithë një traditë e lashtë, s'ka dyshim, e lashtë shumë, që ka pësuar ndryshime dhe pasurime gjatë shekujve, gjer në ditët tona.

Bën përshtypje, le ta shënojmë, mjeshtëria e gdhendësve të gurit në këto anë, mjeshtëri e trashguar brez pas brezi. Vihet re ajo në harqet e por-

22) Ndër të tjerë: E. Durham, **High Albania,** London 1909, 47, vizatime kryqash e njerzish në një shtëpi zjarri malësie; njerëzit janë vizatuar pikërisht si te skulptura që përfytyron të vdekurin në varrin e përmendur të Mërkurthit; ata simbolizojnë, ndofta, pleqtë që më s'janë të fisit; në f. 52, foto. e një varri në Shkrel, me motivin e kalit, si në varrin e Mërkuthit; f. 54, motivi i zogut që qan mbi një kryq të drunjtë varri, si në Mërkurth.

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

tave (Fig. 7, Rrëshen) dhe të dritareve (Fig. 10, Fang), apo në motivet e ndryshëm florealë e në kokat e njerëzve.

Mund të përfundohet se në motivet e vjetër antropomorfë, florealë etj. ka edhe një traditë të moçme dhe të gjatë të herezisë mesjetare, traditë që e hasim, bie fjala, edhe në Bosnje. Atje, mbi gurë të mëdhenj varresh, bloqe të tërë, përfytyrohet i vdekuri (Fig. 11) dhe shihen suazime florealë zbukurimi, të përafërt me tanët (Fig. 12). Duhet të kemi të bëjmë me një traditë shumë të lashtë e të përbashkët, parakristiane, e parasllave, e trashiguar në dy treva ilire. Që herezia, me luftën e saj kundër kishave zyrtare dhe me ruajtjen e traditave pagane, ndikoi që të mbijetojnë e të zhvillohen ndër shekuj disa motive arti për të cilët folëm, kjo duket e qartë.

Vlera etnografike e objekteve nuk është e paktë. Njohja e zhvillimit historik të artit popullor të gdhendjes në gur, p.sh. në anët e Mirditës dhe të malësive të Veriut, paraqet shumë interes.

Shkurt, në Mirditë, në disa vizatime rupestër që duhet t'u përkasin shek. XII-XIII, në disa motive të skulpturës popullore, hasim gjurmat e herezisë mesjetare që ka ekzistuar dhe është përhapur në mbarë Shqipërinë e shek. X-XIV, që u zhduk mbas pushtimit osman. Ajo herezi bëri luftë në të dy krahët, me kishat e Lindjes e të Perëndimit dhe me ideologjitë e tyre. Ishte një formë e protestës dhe e qëndresës kundër sundimit të huaj të vendit, në platformën fetare, ashtu siç ngjiste shpesh gjatë Mesjetës.

I shkruam këto pak rreshta për të mbështetur, në mënyrë të tërthortë, tezën tonë mbi shkrimin e shqipes në Mesjetë, në shek. XIV e lart, — libra shqipe dokumentohet të ketë pasur që më 1332, pra; edhe më parë, — tezë sipas së cilës herezia qe edhe ajo një shtytje për ta shkruar gjuhën amatare, qoftë kur, për nevojat e veta fetare, atë e shkruan arbëreshët heretikë kundër kishave të huaja, qoftë kur ajo u shkrua nën ndikimin e ndonjë kishe të huaj, p.sh. kisha latine në shek. XIV e lart (sipas dëshmisë së vitit 1332), ndofta dhe kisha bizantine (po të mbështetemi te «Perikopeja e pashkëve» me alfabet grek dhe në dialekt jugor, që një palë e mbajnë për të shek. XIV dhe një palë për të shek. XV-XVI).



DO NOT COPY

Prof. DH. S. SHUTERIQI

DO NOT COPY

A PROPOS DE CERTAINES PEINTURES RUPESTRES MOYENAGEUSES A PROXIMITE DE RUBIG ET DE CERTAINS MOTIFS SCULPTURAUX POPULAIRES DE LA REGION DE MIRDITE

RESUME

A Rubig, district de Mirdite, on peut encore admirer, bien que gravement endommagée, l'église du Saint-«Sauveur, partie intégrante du monastère portant le même nom et se dressant sur un rocher qui surplombe le fleuve Fan. A l'intérieur de ce temple, l'abside, avec certaines fresques de type byzantin, est encore à sa place. Des moines catholiques de rite occidental (et non certes pas des bénédectins, comme on l'avait affirmé, car ils ne s'étaient pas encore constitués en ordre) ont du avoir mis la main sur ce monastère bien avant 1214. Cela a dû se produire dès la deuxième moitié du XIIe siècle, après 1167, alors que l'évêché d'Arbër, duquel dépendait ce monastère, relevait de l'archévêché catholique de Tivar dont la fondation remonte au commencement de ce siècle. Avant l'établissement des ecclésiastiques occidentaux à Rubig, cette région se trouvait sous la domination du rite orthodoxe.

On a écrit souvent à propos de l'église du Saint-Sauveur de Rubig, de l'intérêt historique et artistique qu'elle présente. Quant à sa datation, on n'a pas encore abouti à des conclusions satisfaisantes. Evidemment, elle n'appartient pas à l'année 1272, comme le prétend Ippen. Il est hors de doute qu'elle est antérieure à 1214. Par ailleurs, il n'est pas facile toujours de déterminer la date des destructions et des reconstructions, non complètes, que ce monument a enregistrées depuis le XIIIe siècle et par la suite. La date 1272 a été avancée selon une inscription que l'on peut encore lire sur une fresque de l'abside. A la suite d'une lecture nouvelle et plus minutieuse de cette inscription faite sur place, de visu, en la photographiant à plusieurs reprises et en en reproduisant le dessin, nous avons abouti à la conclusion qu'elle appartient à l'année 1254, donc, à une date antérieure. Cette conclusion ne contredit pas l'opinion selon laquelle les fresques de Rubig appartiennent aux années 1260-72, bien qu'à notre avis, faute de données, on ne peut en déterminer si strictement la date de peinture, sauf si elles sont de l'année 1254.

Ce que nous venons d'affirmer est étayé par un autre document qui a été trouvé à Rubig; il s'agit d'une inscription de l'église, qui n'existe plus actuellement, mais qui a été relevée à l'époque par le missionnaire étranger B. Orsini, qui l'a enregistré tant bien que mal et que nous venons de déchiffrer. Cette inscription fait état de l'incendie du temple de Rubig par le capitaine d'Arber, Andrea Vrana, dont le nom apparait ainsi pour la première fois, entre le 1er septembre 1265 et le 22 février 1266. A ce qu'il semble, l'église n'a pas été incendiée entièrement, car un examen attentif sur place montre que l'inscription de 1254 a été reproduite sur une plus ancienne, qui est illisible, mais dont on peut voir les traces. Ainsi il est démontré que cette église a subi maints dégâts, ou encore qu'elle a été l'objet de plusieurs reconstructions (1254, et plus tard en 1265-66). Les fresques que l'on peut observer actuellement appartiennent à la période antérieure à l'incendie provoquée par le seigneur d'Arbërie, Andrea Vrana, incendie qui a épargné jusqu'à un certain point l'abside.

Ce peu de notes montrent que la lutte religieuse, ou encore la lutte politique à partir d'une plate-forme religieuse, entre les églises de l'Occident et celles de l'Orient à Rubig, mais aussi, comme nous allons le voir, la lutte entre ces deux rites et l'hérésie qui existait dans le pays, était assez intense dans la région de Mirdite au XIIIe siècle. Cette lutte s'est prolongée dans le temps. En effet, les habitants du pays ont incendié eux même l'église de Rubig vers l'an 1629.

Il ressort donc qu'à l'époque Mirdita était une de ces régions appelées «basilicates» (royales), que Byzance gouvernait par le truchement d'un stratège spécial de l'empereur. Telle était par exemple le Basilicata d'Italie. Dans un document de 1426, le monastère de Saint-Alexandre à Orosh, que l'on nomme aussi «S. Alessandro de Albania» ou «S. Alexandro maior de Albania», et qui faisait part de l'évêché d'Arbërie (episcopatum arbanensem, albanensi dieocesi), est appelé aussi «S. Alexandri in Basilicum Albanensi diocesis». C'est là un fait important, car il montre que le premier Etat féodal albanais connu, celui d'Arbërie, duquel faisait part la Mirdita aussi, comme cela est attesté d'une inscription de l'église que nous avons reconstruite, a été constitué dans des contrées que Byzance considérait importantes avant la fin du XIIe siècle. Ces contrées, même plus tard, joueront un rôle de premier plan dans l'Arbërie, et cela à travers la famille des Blinisht, qui se sont faits un renom dès la deuxième moitié du XIIIe s., et la famille des Dukagjinas, lesquels, à ce qu'il parait, prirent non seulement ce nom à cette

même époque, mais étaient aussi des descendants des premiers princes d'Arbërie, Progon et ses enfants, Gjin et Dhimitër (1190-1216), ainsi que de ceux qui les suivirent et que l'on connaît jusqu'à ce jour, Golem (1253) et Andrea Vrana (1265-66).

L'établissement du catholicisme en Albanie provoqua de grandes perturbations depuis le XIIe siècle et par la suite. Dans le cadre de ces perturbations, un rôle de premier plan revient aussi à l'hérésie moyenâgeuse appelée «nouvelle», qui connut une grande diffusion, rapide, même chez nous. Les documents indiquent que cette hérésie s'est largement diffusée en Arbërie jusqu'au XIVe s. C'est à cet affrontement, certes, que se rattache le nom d'une petite fortification moyenâgeuse, dont les débris (murs, citerne) se voient aujourd'hui sur une autre éminence surmontant l'église de Rubig. Cette fortification s'appelle «Forteresse des Juifs». De Juifs, chez nous, il y en avait très peu et seulement dans les villes, où ils s'occupaient de commerce. Mais des toponymes avec le nom de «xhuxi», «xhodi», dans l'Albanie du Nord et particulièrement dans la Mirdite, on en trouve quelques-uns. Par ce nom, la croyance populaire imaginait un monstre malfaisant et terrible. Il est hors de doute qu'il s'agit d'un surnom que l'église catholique attribua aux hérétiques, qui étaient ses ennemis. Cela est attesté à Rubig par un autre fait aussi.

La forteresse des Juifs protège l'embouchure du petit fleuve qui porte le nom de Rubig, dont les eaux jaillissent de la montagne appelée Molung ou Zhupë de Lezha, puis traversent la petite région de Bulgre, un ex-baïrak, pour se jeter dans le Fan au-dessus de la ville de Rubig, qui a pris à l'époque son nom de ce fleuve, car les gens du pays l'appelait Bulshize (ce nom est employé aujourd'hui pour indiquer le village qui surplombe la ville). La forteresse s'érige à l'embouchure du fleuve, sur la rive septentrionale de celle-ci. Sur la rive méridionale, à une hauteur presque égale, se trouve une autre fortification moyenâgeuse qui protège l'embouchure du fleuve (que nous n'avons pas visité). Ainsi donc, l'entrée vers les zones internes de Bulgre, où se situe le village au nom significatif de Katund i vjetër (l'ancien village) et d'où passe une route ancienne et importante, qui reliait jadis Lezha à l'intérieur de l'Albanie en direction est, jusqu'à Prizren et même plus loin, était fortifiée. Katundi i vjetër est un lieu fortifié depuis fort longtemps. Des objets d'origine illyrienne, on n'en trouve souvent dans cette région, soit à Rubig que dans l'église, voir même à Rrasfik immédiatement au sud de la ville et ailleurs.

Dès 1508-10, alors que nous avons le premier témoignage local à propos de la petite région aux alentours de Rubig, celle-ci est appelée «Bulgri» nom que nous retrouvons sans cesse dans les siècles successifs. Par le nom de «bulgri», les Occidentaux appelaient au moyen âge les hérétiques des Balkans, car l'hérésie trouva un terrain fertile en Macédoine et en Thrace aux Xe-XIIIe siècles. Les ecclésiastiques venus d'Occident et qui s'établirent à Rubig, eurent des ennuis de la part des hérétiques et s'affrontèrent avec ceux-ci. Katundi i vjetër était un centre des hérétiques dans cette petite région. Les ecclésiastiques étrangers les appelèrent «bulgri» et plus tard ce nom resta au pays. Ils furent appelés aussi «xhudej» (= Juifs), donc, «infidèles», et ce nom est porté maintenant par une forteresse du pays.

Dans la forteresse des Juifs, juste sur une des faces un peu escarpée de la roche sur laquelle se dresse la fortification, on relève des peintures rupestrs (Fig. 1). Nous ignorons si elles ont été jusqu'à ce jour l'objet d'études ou si on les a même mentionnées. Ce sont des peintures très primitives, de coloration blanche et très solide (peut être de la chaux?). Là où la couleur n'éxiste plus, on y relève ses trâces noirâtres. Parmi les dessins on distingue bien deux croix, dont l'une simple et l'autre quelque peu agrémentée (Fig. 1, NN^oo 1, 2). Il y a aussi deux hommes, l'un à gauche et l'autre à droite. Celui-ci pointe sur le premier la flèche de son arc, qui, à son tour, fait la même chose (toujours Fig. 1, N° 4). Sur la roche on relève un autre dessin, que nous n'avons pas reproduit ici. On distingue un autre arc. Il y a aussi deux ou trois autres dessins tout aussi primitifs. Apparemment un d'eux représentait un pain divisé en 6 pièces (la même figure, N° 3). Le nombre 6 est un nombre magique pour les hérétiques des Balkans.

Deux symboles, certainement, prédominent dans ces dessins; la croix, c'est-à-dire la religion, et l'arc, c'est-à-dire, la guerre. Ces deux symboles expriment la lutte religieuse qui était menée en ces lieux entre les églises d'Occident et d'Orient, ainsi qu'entre elles et l'hérésie. C'est la seule conclusion que nous pouvons dégager de l'observation des dessins figurant sur la face de la roche de la Forteresse des Juifs à Rubig.

Ces dessins sont-ils l'oeuvre d'ecclésiastiques catholiques ou des hérétiques? On ne peut répondre par l'affirmative à coup sûr. Mais on sait que les hérétiques étaient contre la croix, d'où les croix ne peuvent être leur ouvrage. Les deux hommes, dont l'un tue l'autre avec une flèche, est vraisemblablement la besogne des hérétiques. C'est là un dessin de type magique, car les hérétiques avaient hérédité maintes choses des anciennes croyances que le Christianisme s'efforçait de liquider. Lorsque les étrangers s'établirent à Rubig, la lutte s'engagea entre eux et les gens du pays. Les dessins réalisés par les deux parties dans la roche au-dessous de la forteresse, sur une éminence surmontant l'église, témoignent de cette lutte sanglante.

L'intérêt de cet affrontement, il va de soi, avait un sens beaucoup plus profond; les Arbëresh s'opposaient à la pénétration religieuse et politique de l'Occident. Le clergé catholique était l'avant-coureur des rois d'outre-mer, qui allaient piétiner notre pays au XIIIe siècle, avec Manfred Hohenschtaufen de Sicile (1258) et surtout avec Charles Ier d'Anjou de Naples, qui se fit proclamer «Rex Albaniae» en 1272. On sait la résistance qu'il a affronté en Albanie, même dans les contrées de la Mirdite, par exemple de la part des Blinisht que nous venons de mentionner.

Arrêtons-nous quelque peu sur quelques particularités de l'art populaire comme il se présente de nos jour à Mirdite,

Doktoratë

afin d'avoir certains éléments de confrontation et d'argumentation.

A Katund i vjetër, au cimetière de l'église de Sh. Gjergj, on peut voir des croix présentant des têtes d'hommes (photo 1) ou bien des motifs floraux (photo 2). Cette église est attribuée à l'année 1809, alors que les tombes qui s'y trouvent sont plus récentes; elles appartiennent aux années '40-'50 de notre siècle. Dans une tombe encore conservée à Mërkurth, entre Kurbnesh et Lura, attribué aux années '40 de notre siècle, on y voit sculpté d'abord un homme aux mains ouvertes, le mort, ayant un fusil dans une mains et un livre dans l'autre (photo 3). On y voit sculpté d'autres objets aussi, entre autres un oiseau, symbole des larmes (photo 4), un cheval, une brebis, une cafetière et des tasses à café, symboles de l'opulence, de la noblesse et de la munificence (photos 4, 5 et 6). De pareils dessins et sculptures, et non seulement sur les tombes, on les retrouve presque partout dans le Nord du pays, parfois même sous la forme de simples reproductions.

Avec le temps, les anciens motifs (le soleil, la lune, les étoiles, l'oiseau, les motifs floraux) se sont entremêlés aux motifs nouveaux. Dans une kulla du village de Fang, actuellement siège de l'administation de la coopérative, sur la rive gauche du fleuve Fan, quelque peu au dessous de Rubig, kulla construite en 1924, sa façade, ainsi que les deux portes caractéristiques des kulla de Mirdita, est ornementée du symbole de l'épée ou de l'aigle bicéphale de notre drapeau national; une aigle analogue nous la retrouvons sur la façade de marbre d'une kulla construite dans les années '40 dans la ville de Rreshen (photo 7). Et à côté de ces motifs nouveaux, nous retrouvons les anciens motifs que sont l'étoile et la lune, que nous ne devons pas absolument considérer comme ottomans, ainsi que des motifs floraux (photos 7, 9).

Il est hors de doute que c'est là une tradition ancienne, voir très ancienne, qui a subi des modifications et s'est enrichie à travers les siècles jusqu'à nos jours.

Il convient de signaler la maîtrise des graveurs du pays dans l'art de travailler la pierre, art qui a été transmis de génération en génération. Cette habileté ressort surtout dans le travail des arcs des portes (photo 7, Rreshen) et des fenêtres (photo 10, Fang), ou encore dans les différents motifs floraux et les têtes d'hommes.

D'où la conclusion qu'il existe une ancienne tradition de l'hérésie moyenâgeuse dans le domaine des motifs anthropomorphes, floraux, etc., tradition que l'on rencontre aussi, par exemple dans la Bosnie. Ici sur de grandes pierres tombales, des blocs entiers, on peut voir la figure du mort (photo 11) et d'autres décors floraux, qui ressemblent beaucoup aux nôtres (photos 12). Nous avons affaire sans doute a une tradition très ancienne et commune, préchrétienne, précédant l'arrivée des Slaves, que deux contrées illyriennes ont hérité. Il est clair donc que l'hérésie, par sa lutte contre les églises officielles et par la conservation des traditions païennes, a influé la survivance et le développement à travers les siècles de certains motifs artistiques dont il a été question plus haut.

Il convient de relever aussi la valeur ethnographique de ces objets. La connaissance de l'évolution historique de l'art populaire de la gravure sur pierre, par exemple dans la Mirdite et la zone montagneuse du Nord, est d'un grand intérêt.

Bref, dans la région de Mirdite, dans certaines peintures rupestres qui doivent appartenir aux XIIe-XIIIe siècles, comme dans certains motifs de la sculpture populaire, on relève des traces de l'hérésie moyenâgeuse qui a existé et s'est propagée dans toute l'Albanie depuis le Ve jusqu'au XIVe siècle, date qui correspond à l'occupation ottomane et à la fin de ce phénomène. A l'époque l'hérésie a mené la lutte sur les deux fronts, à la fois contre les églises d'Orient et d'Occident ainsi que contre leurs idéologies. C'était là une forme de protestation et de résistance contre la domination du pays par les étrangers, en ce qui concerne la plate-forme religieuse, comme cela se produisait souvent au moyen âge.

Nous avons écrit ces quelques lignes pour étayer indirectement notre thèse sur l'usage de la langue écrite albanaise dès le moyen âge, depuis le XIVe siècle et plus tard, — car les documents indiquent qu'il y a eu des livres albanais dès 1332, donc, même avant, — thèse selon laquelle l'hérésie a constitué une incitation à employer la langue maternelle, soit pour satisfaire des nécessités religieuses, comme ce fut le cas des Arbëresh hérétiques dans leur lutte contre les églises étrangères, soit sous l'influence de quelque église étrangère, par exemple l'église latine au XIVe siècle et plus tard (selon le témoignage de l'an 1332) ou encore l'église byzantine (si nous nous appuyons à la «Péricopée des Pâques» en alphabet grec et dans le dialecte méridional, que d'aucuns attribuent au XIVe siècle et d'autres au XVe-XVIe).

DOKUMENT

DO NOT COPY

Dilaver KURTI

DO NOT COPY

KALA E QYTEZA TË PANJOHURA NË MAT

Krahina e Matit është një ndër krahinat më të pasura me monumente të vendit tonë. Gjurmimet dhe gërmimet më të shumta janë bërë në drejtim të kulturës tumulare. Kështu gjatë viteve 1952-1960 u gërmuan 35 tuma ilire[1], që u pasuan nga gërmime të tjera të më vonëshme[2]. Edhe në fushën e vendbanimeve të fortifikuara janë kryer gërmime në kalanë mesjetare të Stellushit[3], kalanë ilire të Xibërit[4], po kështu gërmime janë kryer dhe bazilikën e Suçit[5].

Në gjurmim të hartës arkeologjike të Matit, midis viteve 1964-1967, gjurmuam rrënojat e kalave e të qytezave në Mat, të cilat i trajtuam në një kumtim të shoqëruar me një hartë arkeologjike[6] kurse më vonë botuam në shtypin periodik disa artikuj informativë.

Në këtë studim do të bëjmë fjalë mbi disa kala e qyteza të panjohura të cilat gjinden në Shkopet, Bruç, Cërunjë, Gur i Bardhë dhe Komsi. Konkretisht ato janë qyteza e Ferrë-Shkopetit, Kalaja e Shkopetit, Qyteza e Bruçit, Kalaja e Cërujës, Kalaja e Gurit të Bardhë dhe Qyteza e Komsisë[7].

Në këtë trajtesë do mundohemi të përshkruajmë monumentet dhe gjetjet e rastit aq sa lejojnë mundësitë e një vrojtimi informativ dhe do të japim mendimin tonë edhe rreth identifikimit të tyre. Përshkrimin do ta nisim nga veriu drejt jugut, ashtu sikurse shtrihen këto monumente (fig. 1) në të dy krahët e pellgut të Matit, rrëzë vargmaleve ku janë qafat dhe kalojnë rrugët kryesore.

QYTEZA E FERRË-SHKOPETIT

Mbi bashkimin e Fandit me lumin e Matit, gjindet lagjia Ferrë e katundit Shkopet. Në lindje të saj në kuotën rreth 600 m. mbi nivelin e detit gjinden

1) S. Islami, H. Ceka, F. Prendi, S. Anamali, **Zbulime të kulturës ilire në luginën e Matit;** «BSHSH», 1, Tiranë, 1955, f. 110-135, S. Islami, H. Ceka. **Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilire në territorin e Shqipërisë,** «Konf. I Stud. Alb.» Tiranë, 1965, f. 446-454, Tab. XI-XVI.

2) D. Kurti, **Të dhëna të reja mbi kulturën ilire të tumave të Matit.** Kuvendi I Studimeve Ilire, Vol. I, Tiranë 1974, f. 307-320; D. Kurti **Përhapja e tumave ilire në Mat,** Iliria VII (në shtyp). Midis viteve 1971-1979 kemi gërmuar e studjuar në Mat 7 tuma në Burrel, 1 në Karicë, 1 në Komsi, 1 në Midhe, materialet janë të pa botuara.

3) S. Anamali, **Kalaja e Varoshit në Mat-Stellushi, një hallkë e sistemit mbrojtës të Skënderbeut,** Konf. II Stud. Alb.» Tiranë 1969, Vol. I, f. 249-253; D. Kurti, **Diskutim rreth kumtesës S. Anamalit Kalaja e Varoshit në Mat-Stellushi, një hallkë e sistemit mbrojtës të Skënderbeut** konf. II stud. Alb. Tiranë, 1969, I, f. 608.

4) D. Kurti; **Një qytet i lashtë ilir në Mat,** «Studime Historike», 1, Tiranë 1967 f. 183-187, S. Islami, **Kalaja ilire e Xibërit,** «Konf. II stud. Alb». Vol. II, Tiranë 1969, f. 315-319.

5) D. Kurti, S. Duka, **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit,** «Buletini Arkeologjik», 5, Tiranë 1975, f. 124-135.

6) D. Kurti, **Gjetje arkeologjike në Mat, Materiale të Sesionit Arkeologjik,** Tiranë 1968, f. 93-106, Tab. XX.

7) Midis tyre janë vizituar para nesh, nga S. Islami, A. Mano vendbanimi shpellor i Bruçit, që gjendet nën qytezë dhe kalaja e Gurit të Bardhë nga S. Anamali, kurse pas nesh ato janë bërë objekt vrojtimi nga D. Komata e S. Duka e të tjerë.

DO NOT COPY



Fig. 1

rrënojat e një qyteze, që njihen me emërin kala. Lartësia në fjalë është një fortesë shkëmbore (fig. 2) trualli i së cilës zë një sipërfaqe rreth 2-3 ha 200 m. të gjatë dhe 100 m. të gjerë të zgjatur nga veriu në jug. Në veri të qytetit është një qafë nëpër të cilën kalon një rrugë. Mundësi ngjitje ka dhe në anën jugore, kurse anët e tjera janë të prera e shkëmbore. Pikërisht këto të dy anë të mundëshme për kalim ndërtuesit i kanë fortifikuar me mure.

Muret shtrihen në përputhje me terrenin dhe zënë anën veriore e jugore, por më të gjata dhe të ruajtura janë ato në veri, ku gjindet dhe porta, e cila e lidhte qytezën me qafën dhe rrugën. Muret e anës veriore kanë gjatësi 65 m dhe zënë fill tek maja shkëmbore, e cila ngrihet lart si një kullë vrojtimi, duke zbritur poshtë me drejtim veri-jug, me gjatësi 12 m. Këtu ato ndërpriten nga porta 2 m e gjërë dhe në vazhdim ndjekin po atë drejtim edhe 16 m. të tjera, duke u kthyer në përputhje me terrenin nga lindja në perëndim edhe 35 m. Muret e anës jugore mbyllin dy kreshtat e truallit në formë lugthi me një gjatësi 30 m.

Muret e anës veriore janë të ruajtura më mirë (Fig. 3) lartësia e tyre shkon deri 2 m. Gjatë mureve rrethuese nuk pamë asnjë gjurmë kulle mbrojtëse. Muret janë ndërtuar me gurë e blloqe shkëmborë gëlqerorë me forma poligonale, me madhësi mesatare e të vogël, të papërpunuar. Ndërtuesit i kanë dhënë më tepër rëndësi faqes së jashtëme, duke nxjerë anët e sheshta në pah. Gjerësia e mureve



Fig. 2

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

shesh për hyrje. I gjithë ambienti ka pesë kthina, dy nga 4 x 6 m. një 4 x 4.30 m. dhe dy të tjerat në veri, sejcila nga 4 x 8 m. Ndërtimi i ambientit është bërë me gurë gëlqerorë të papunuar, të lidhur në të thatë. Kujdes i është kushtuar ballit të banesës (fig. 7). Ai ka një gjatësi prej 28 m. dhe gjerësi 3 m. dhe formohet nga dy mure. Muri i parë është 2 m. i gjërë dhe për ndërtimin e tij është treguar më tepër kujdes duke përdorur gurë të mëdhenj. Mbi të mbështet muri i mbrendëshëm i banesës me gjerësi 0.90-1 m. që e rrit trashësinë e murit në 3 m. Muret e tjerë anësorë kanë trashësi 0.80 m., kurse të kthinave 0.70 m. Duke gjykuar nga terreni dhe funksioni, muri frontal ka shërbyer si bazament për nivelimin e terrenit dhe lartësia e tij, duke gjykuar nga rrënojat, i ka kaluar 3 m. Muret e tjerë kanë shërbyer si xokol mbi të cilën ka qënë ndërtuar mbistruktura prej druri.

Poshtë ambientit të parë gjëndet ndërtesa e dytë, me përmasat 45 x 7 m. (Fig. 6, B) e cila është më e ruajtur se e para, me një lartësi të murit frontal deri në 2.50 m. Teknika e ndërtimit është e njëjtë: me gurë gëlqerorë të punuar në të thatë, me dimensione 1.20 x 0.90 x 0.50 m., 0.75 x 0.50 x 0.40 m. etj. Muri ballor (Fig. 8) me gjerësi 45 m. është i ndërtuar me dy këmishë që formohen me mure guri me gjerësi 0.80 m. kurse boshllëku në mes është mbushur me gurë të ndryshëm, duke arritur edhe këtu gjërësia e murit 3 m. Muret e tjerë edhe këto kanë po ato përmasa si tek ambienti i parë. E gjithë ndërtesa ndahet në tre kthina, dy anësoret me përmasat 4 x 9.5 m., kurse e mesmja 4 x 26 m. Ndën ambientin e dytë gjëndet një i tretë (Fig. 6 C) me përmasat 5 x 10 m. Ndryshe nga dy të sipërmet, muri ballor këtu ka gjerësi 0.90 m., anësoret 0.80, dhe kthinat 0.70 m. Si tek të dy të sipërmet muri mbështetës mungon, pasi terreni është i sheshtë. Teknika e ndërtimit është e njëjtë dhe ambienti ndahet në dy kthina nga 4 x 5 m. Në tre ambjentet e sipërme është përdorur e njëjta teknikë ndërtimi, trashësia e mureve është e njëjtë, vetëm se tek dy të parët për shkak të terrenit janë ndërtuar mure përforcuese për të niveluar terrenin mbi të cilët është mbështetur ndërtesa, gjë që tek i treti mungon. Gjykuar nga veçoritë e përbashkëta ato i përkasin një teknike dhe periudhe ndërtimi.

E gjithë hapësira ku janë ngritur ndërtesat kap një sipërfaqe prej 596 m^2 dhe perimetër 232 m. Në truallin e mësipërm nuk gjetëm asnjë objekt apo fragment arkeologjik.

Në shpatin jugor të masivit (fig. 5 a), pikërisht mbi tunelin, në mezin e shkëmbit gjëndet një mbishkrim prej pesë shkronjash (fig. 9). Mbishkrimi është skalitur me daltë në faqen e sheshtë të shkëmbit. Leximi është i vështirë dhe aq më tepër fotografimi i pamundur. Kështuqë përsa i përket leximit, shqipërimit dhe për pasojë datimit, paraqet vështirësi për shkaqet e sipërme dhe nuk mund të shprehim mendim.

Zbulimet në një sërë qytetesh ilire si në Amantia,

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

Irmaj, Zgërdhesh, Lis, Antigone, Rosujë[12] etj. shënojnë analogji me godinat e Shkopetit, si për nga teknika e ndërtimit, trajta e tyre katërkëndëshe dhe përmasat.

Në dritën e këtyre të dhënave nuk mund të shprehim mendim në se jemi para një kalaje ku janë ngritur godina në periudhën ilire, në se kemi të bëjmë me vazhdimësinë e kësaj tradite në periudhat e mëvonëshme, apo ndofta jemi para një kompleksi ndërtimesh me karakter kulti.

QYTEZA E BRUÇIT. Në veri të Bruçit, zbret Prroi i Blazit, degë e djathtë e Urakës dhe kjo e fundit afluent i djathtë i Matit. Vetë Blazi përbëhet nga dy prrenj, ai i Blazit dhe i Valit. Pikërisht mbi bashkimin e Valit me Blazin gjindet një shpat i prerë shkëmbor (fig. 10), mbi të cilin në kuotën 556 m mbi nivelin e detit shtrihet një rrafsh ku ndodhen rrënojat e Shën-Kollit. Ekstremin më jugor të rrafshit, që përkufizohet nga të dy anët nga shpatet e dy përrenjve, ndërtuesit e kanë zënë me mure duke e kthyer në një vendbanim të fortifikuar në trajtën e një trekëndëshi.

Në shpatet jugperëndimore gjenden tri shpella me emërin Shpella e Këputës ose Valit, Shpella e Pllumbave dhe Shpella e Blazit. E para dhe e fundit kanë 153 dhe 54 metra gjatësi. Në shpellat e sipërme ka gjurmë banimi që nga epoka e neolitit e deri në mesjetë[13]. Në gojën e popullit qyteza njihet me emërin «Qyteza e Skënderbeut» dhe rreth saj fliten shumë legjenda. Atje ka dhe një sërë toponimesh që banorët i lidhin me Skënderbeun dhe mesjetën e mesme.

Ndërtuesit i kanë shfrytëzuar kushtet natyrore të vendit për të kthyer hapsirën në një vendbanim të fortifikuar. Për këtë qëllim kanë ndërtuar një mur 160 m të gjatë, nga krahu i djathtë i Blazit në krahun e majtë të Valit. Gati në mesin e këtij muri ndodhen gjurmat e një kulle përforcuese, përmasat e së cilës nuk kapen për shkak të bimësisë. Aty duket ka qënë dhe porta, pasi ndeshëm një qoshe. Muri i qytezës është i ndërtuar me gurë fushe e prroi të lidhur me llaç gëlqereje. Trashësia e tyre shkon nga 1.60 – 2 m. Lartësia në ekstremin perëndimor ku lidhet me shkëmbin është 2 m ndërsa pjesa tjetër është rrafshuar me tokën. Në kuotën më të lartë të truallit të qytezës duken gjurmët e një murane me diametër 13 m, që mesaduket fsheh rrënojat e një kulle vrojtimi. Si mbrenda dhe jashtë hapsirës së fortifikuar duken gjurma rrënojash banesash të ndërtuara me gurë e gëlqere. Janë të qarta konturet e një banese me formë katërkëndëshe me përmasa 6 x 6 m dhe trashësi muresh 0.70 m.

Në truallin e qytezës sidomos në shpatet e saja, gjetëm fragmente të ndryshme enësh që shkojnë nga periudha e I e hekurit deri në mesjetë, midis tyre dhe tulla me trashësi 5 cm. Nga ana tipologjike ky vendbanim ka ngjashmëri me vendbanimin shpellor të Trenit në Korçë. Poshtë tij gjinden shpellat, kurse

12) S. Anamali, **Amantia,** Iliria II, Tiranë 1972, f. 80, F. Prendi Dh. Budina, **Kalaja e Irmajt,** po aty, f. 30, S. Islami, **Qyteti ilir në Zgërdhesh,** po aty f. 199, F. Prendi, K. Zheku, **Qyteti ilir i Lisit,** po aty, f. 223, Dh. Budina, **Antigonea,** po aty, f. 261-293; N. Ceka, **Gërmime në qytetin ilir të Rosujës,** Iliria I, Tiranë 1971, f. 54.

13) Në vitet 1978-1979 F. Prendi e Zh. Andrea kanë ndërmarrë gërmime të rregullta arkeologjike në këto shpella, rezultatet e të cilave ende nuk janë botuar.

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

sipër qyteza. Gjetjet e hershme të qytezës, ndofta kanë të bëjnë me forma banimi më të hershme që gjënden ende nën tokë.

Në dritën e të dhënave të sotme fortifikimin e Bruçit e datojmë në periudhën e vonë antike, por në gjysmën e dytë të shek. XV jeta në të mer fund. Kështu një dokument turk i vitit 1467 fshatin ku gjindet qyteza e shënon me emërin Mirjash, kurse fshatin kufitar me emërin që ka dhe sot Laç duke i inkuadruar në vilajetin e Urakës në Mat, por për qytezën nuk flet asgjë. Një burim kishtar i shek. XVII e shënon emërin e fshatit Bruç sikurse e ka sot, por edhe ky nuk flet gjë për qytezën[14].

KALAJA E CËRUJËS. Cëruja ndodhet në rrëzë të malit Balgjajt, në kufi me Patin, Bërshin, Pleshën dhe Bejën. Mbi lagjen Rrasë së Cërujës, ndodhet rrënoja e një kalaje të vogël me emërin Kalaja e Skënderbeut. Kalaja është në terracën e dytë me lartësi 600 m midis Sheut të Cërujës dhe Prroit. Kodra e kalasë ndonse dominuese mbi hapsirën poshtë saj, nuk ka mbrojtje natyrale të fortë. Ajo gjindet mbi një kreshtë kurrizore (fig. 11), që degëzohet në dy të tjera që zbresin drejt prroit dhe fshatit. Në jug shpatet janë të thepisura kurse në anët e tjera vendi zbret gradualisht.

Rrënojat e kalasë shtrihen me drejtim lindje-perëndim në përshtatje me terrenin. Në lindje duken mbeturinat e një ambjenti, ndofta kulle, me formë katërkëndëshe me përmasa të jashtme 9 x 7 m dhe të mbrendshme 5 x 3 m. Në perëndim të saj shihen konturet e dy ambjenteve të tjera me përmasa 9 x 5 dhe 20 x 5 m. Si ambjentet dhe muret rrethuese janë ndërtuar me gurë të zakonshëm të lidhur me llaç gëlqereje. Në anën veriore konturet e murit rrethues, kapen në një gjatësi prej 65 m (fig. 12). Ato shtrihen në formë harku në përputhje me terrenin nga cepi lindor deri në majën perëndimore tek ambjenti i fundit. Trashësija e mureve është 1.80-2 m. Nën murin rrethues në një hapsirë prej 54 m dhe gjerësi 5 m shquhet një vazhdë gurësh, që me sa duket i përket murit rrethues të rrënuar. Në jug siç duket muret e ambjenteve kanë luajtur edhe rolin e murit rrethues pasi terreni ka mbrojtje natyrale dhe nuk ka patur nevojë për dy palë mure.

Në truallin e kalasë, sidomos tek ambjenti i fundit në perëndim, gjetëm fragmente të dy tipeve tjegullash. Midis tyre ka fragmente me trashësi 2-3.5 cm të zbukuruar në shpinë me valëzime të bëra me gishtat e dorës. Tipi tjetër është më i thjeshtë me trashësi 1.5 cm i ngjashëm me tjegullat e fazës së fundit të rindërtimeve në Petralbë.

Teknika e ndërtimit të mureve të kalasë së Cërujës dhe përmasat e tyre përkojnë me ato të Bruçit, Stellushit, Petralbës në Mat, ç'ka dëshmon se ato janë të një kohe dhe i përkasin mesjetës. Kalaja ka qenë një kala e vogël feudale mesjetare. Legjenda e lidh me emërin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut por asnjë dokument nuk e shënon në këmbë kalanë për kohën e Skënderbeut. Edhe defteri i 1467 ndonse jep emrin e fshatit Cërujë nuk shënon asgjë për kalanë[15].

Poshtë kalasë në dy tarracat e fundit në anën

14) S. Pulaha, **Lufta shqiptaro-turke në shek. XV (Burime Osmane),** Tiranë, 1968 f. 334.
I. Zamputi; **Relacione** II, Tiranë 1965, dok. 36 (45), 63 (9v).
15) S. Pulaha, **Vep. cit.,** f. 358-360.

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

e prroit, mbi kanalin vaditës, ndeshëm gjurmët e një vendbanimi të hapur ilir, ku gjetëm fragmente të shumta enësh prej balte. Në lagjen Rrasë është një tumë ilire, kurse në një vend me emërin Vila është gjetur qeramikë ndërtimi e periudhës së vonë antike.

Ndërtimi i kalasë u kushtëzua në këtë vend, nga kalimi dhe kryqëzimi pranë saj i dy rrugëve më rëndësi. Njera nisej nga Petralba, kalonte tek Pazari i Urës-Klos, Stragj, Zgjon, Kllumë, Kodra e Qimes, Qafë Vijë, Cërujë, Rrapi i Çelës, Qyteza Allamanit, Lisi Tolje, Qyteza Shkamit, Gjalish, Lusa e Lisdane, Vinjoll dhe Stellush, rrugë mjaft komunikuese, gjatë së cilës gjenden dhe kalldrëme. Rruga tjetër që niste nga Cëruja kalonte pranë kalasë për në Qafë-Portë, Qermi Butë, Fushë Qeth, Shkalla e Drenit, Balgjaj, Qafë Kllogjën, Bulqizë-Dibër..

PETRALBA. Midis katundeve Guribardhë e Fushat të Matit, gjëndet një kreshtë malore prej formacionesh gëlqerorësh që arrin lartësinë 778 m mbi nivelin e detit. Pikërisht natyra gjeologjike e vendit ka determinuar në dhënien e emërit katundit Guri i Bardhë. Kuota e sipërme në veriperëndim e juglindje pritet nga Lezedra e Thilapati, degë të majta të lumit Mat, kurse në perëndim e lindje shtrihen katundet Guri i Bardhë e Fushat.

Në anën veriperëndimore të kuotës, mbi dy maja brijë Lezedrës gjënden rrënojat e një kalaje që populli e quan Kalaja e Skënderbeut (fig. 13). Në majën e dytë mbi Lezedër ka qenë kështjella e kalasë (fig. 14). Këtu terreni është tepër i thepisur dhe me shpate të pakalueshme. Në një gjatësi prej 50 m dhe gjerësi 10-15 m. janë kryer ndërtime me karakter fortifikues. E gjithë kjo lartësi në përputhje me terrenin, ka qenë mbrojtur me mure rrethues. Në anën lindore gjurmët e murit janë të qarta për 12 m gjatësi e 2 m gjerësi (fig. 15). Ngjitur këtij muri paralel me të, duken gjurmët e një muri tjetër me trashësi 2.20 m. Mbrenda mureve rrethuese të fortesës ruhen gjurmët e tre ambjenteve dhe një kulle. Midis tyre një çisternë me brinjë katrore 2.50 m dhe një kullë rrethore me diametër 5 m trashësi muresh 1.40-1.90 m dhe lartësi të ruajtur 3.30 – 5.30 m. (fig. 16).

Midis dy majave gjëndet një qafë me mundësi depërtimi, shpatet e së cilës për të ndaluar kalimin janë përforcuar me mure mbrojtëse dhe hapsira midis tyre ka shërbyer për ndërtimin e banesave të qytetit. Në anën perëndimore gjurmët e murit ruhen në dy shpatet e qafës me gjatësi 3 e 6 m gjerësi 0.90-1.10 m dhe lartësi 3 m. Në bazë të konturеve dikur ky mur ka qenë 32 m i gjatë; Pikërisht mbi të dhe nënë të gjejmë me shumicë fragmente enësh qeramike.

Në anën veriore të kullës rrethore në lindje nga Fushati, duket se ka qënë dhe porta e kalasë. Vendi mbrohej nga një mur tjetër, me trashësi 2 m që vijon nga perëndimi drejt lindjes. Pas 18 m duket një kullë katërkëndëshe me përmasat 7 x 4.50 m. Më tej muri vazhdon edhe 16 m të tjera ndërsa në skajin lindor kthen nga veriu edhe 12 m. I gjithë ky mur është ndërtuar mbi një xokolaturë me trashësi 2.80 m ndoshta themel nga i cili 0.80 m dalin nga ana e jashtëme e murit. Midis kullës rrethore dhe pikës kthimit murit lindor ka mure e rrënoja, por natyra e tyre nuk kapet. Siç duket këtu, midis dy kullave ka qënë hyrja, porta e kalasë. Të gjitha ndërtimet e kryera në këtë kala janë me gurë me përmasa të vogëla e mesatare, por ato nuk i përkasin një periudhe ndërtimi, pasi ka pasur rindërtime të mëvonëshme. Më i hershëm duket muri mbrojtës në lindje, atij i



Fig. 15



Fig. 16

është kushtuar më tepër kujdes, gurët kanë përmasa më të mëdha dhe në mbeturinat e tij nuk duken gjurmë rindërtimi.

Ekzistenca e dy palë mureve paralel në fortesë, tregon për një rënim dhe rindërtim me përmasa më të vogëla, gjë që vërtetohet nga prania e tjegullave të përdorura si lëndë ndërtimi në cepin jugor të murit rrethues të fortesës. Qeramika e mbledhur në truallin e kalasë ndonse tepër e fragmentuar tregon për një kohë të gjatë jete të kalasë që nga periudha e vonë antike deri në mesjetën e mesme.

Gjurmët e zbuluara jashtë kalasë në periferi të saj flasin për një vazhdimësi jete intensive. Në Lugun e Arrave edhe sot ruhet në popull toponimi me emrin Dyqanet e Venedikasve. Po kështu ruhen rrënoja në Vërrith, Mrugate, Gurrëz, Fierzë, Kodrën e Pazarit, mbeturina të dy kishave dhe nuk mungojnë gjetjet e shumta arkeologjike.

Kalaja vetë ka qenë e vogël dhe për madhësinë e saj vjen pas asaj të Stellushit në Mat. Por po të merret në kompleks vendbanimi i hapur me kalanë del se jemi para një qendre të rëndësishme. Ndërtimi i saj në këtë pikë u kushtëzua nga kalimi i rrugës të rëndësishme, që niste nga Durrësi antik, Shkalla Tujanit, Qafë Murrizi duke u ndarë në dy degë: Njera në Qafë Shkallë, bri kalasë ilire të Xibërit për Mat. Kurse e dyta nga Guri Bardhë, Plani Bardhë, Qafë Buelli për Dibër. Në itinerarin e rrugës së parë poshtë kalasë ilire të Xibrit në Dars duken mbeturinat e një rruge (fig. 17) me kalldrëme gurësh. Kurse nëpër rrugën e dytë vetëm në Gur të Bardh ruhen në këmbë pesë ura me hark. Në këto kushte, Petralba, duke qenë një vend kyç dhe i ekspozuar midis dy rrugëve, bëri të mundur që mbi bazën e një vendbanimi të hapur të lindi një stacion rrugor, siç dëshmon dhe toponimi Mansai. Me rrënimin e braktisjen e kalasë ilire të Xibrit, që është përkundruall Petralbës ju dha shkas zgjerimit vendbanimit dhe më vonë ndërtimit të kalasë.

Historiografia e jonë e lidh ndërtimin e kalasë me lindjen e principatave feudale shqiptare shek. XIII-XIV[16]. Një ndër këto principata me zë në Mat që ajo e Kastriotëve me në krye Gjon Kastriotin, i cili i rrezistoi me të madhe invazionit turk. Një ndër kryengritjet më të mëdhaja të tij që ajo e vitit 1430. Megjithatë domenën e tij, Matin, ai mundi ta ruante përsëri si një tokë të lirë të cilën turqit e quajtën Juvanili (Tokat e Gjonit). Nga burimet mësojmë se këtë vit Gjon Kastrioti kishte në këmbë gjashtë kala, prej të cilave katër u rrënuan kurse dy ngelën në këmbë[17]. Mendimi ynë është se këto kala duhen kërkuar mbrenda kufijve të atëhershme të zotërimeve të Gjon Kastriotit-Matit, pasi ai i kishte lëshuar zotërimet e tjera. Për dy kalatë në këmbë F. Noli mendon se janë Kruja dhe Sfetigrafi[18]. Por në kundërshtim me këtë hipotezë është fakti se jashtë Matit numëri i kalave në këmbë është më i madh se dy, kurse në këtë trevë ngelën vetëm dy, Petralba dhe Stellushi, të cilat i përmend Barleti dhe i shënon në Mat[19]. Prandaj të

16) **Historia e Shqipërisë**, Tiranë 1959, f. 233-234.
17) **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë**, II, Tiranë 1962, f. 234-235.
18) F. Noli, **Gjergj Kastrioti Skënderbeu**, 1405-1468, Tiranë, 1967, f. 76.
19) M. Barleti, **Historia e Skënderbeut**, Tiranë 1964, f. 77, 80.

DO NOT COPY



Fig. 17

gjithë të dhënat vërtetojnë se këto të dy kala janë Petralba dhe Stellushi. Përsa i përket kalave të rrënuara problemi është i vështirë.

Ndërtimi i Petralbës është më i hershëm se vetë sundimi i Kastriotëve, pasi Barleti nuk i njeh për themelonjës, por e lidh ndërtimin e kalave që pushtoi Skënderbeu më 1443 me kohën pas dyndjeve të fiseve barbare[20]. Gërmimet arkeologjike të bëra në Stellush[21], Petrelë[22], Krujë[23] dhe gjetjet në truallin e Petralbës e vërtetojnë këtë thënie të Barletit. Petralbën e ndeshim për herën e parë tek Barleti mbrenda viteve 1443-1467, pra të lidhur me luftën shqiptaro-turke të shek. XV. Emërimi në trajtat Petram Albam për Gur të Bardhë dhe Petralba për Gurabardh[24], vendosja e saj në Mat, përshkrimi fizik, egzistenca e një kalaje me emërin e Skënderbeut në Gur të Bardhë, e kanë identifikuar atë me Petralbën e Barletit[25]. Ky fakt vërtetohet edhe nga një dokument turk i 1467[26]. Po t'i referohemi më gjerë Barletit dhe të shprehemi me gojën e tij, ai thotë: «Petralba është një qytet në Mat, i ndërtuar në majë të një mali i vogël, por që s'i trembet, me gjithëkëtë, përveçse urisë, asnjë fuqije armike. Veç kësaj, lumi i Matit, që rrjedh rrëzë malit, duket se ia shton këtij vendi jo më pak bukurinë se sa fuqinë mbrojtëse dhe dobinë... Skënderbeu mbante ngaherë togje të dendur luftëtarësh për ruajtjen e saj dhe vetë qytetin e kishte pajisur si jo më mirë me burra, armë dhe ushqime për çdo rast»[27]. Burimet historike dhe gojdhana popullore e shënojnë Petralbën si një ndër kalatë më në zë të Kastriotëve në Mat. Aty thuhet se Gjon Kastrioti veronte në Petralbë dhe se aty ka lindur dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu[28]. Traditën e të jatit e ndoqi dhe i biri. Fill pas pushtimit të saj më 1443, Skënderbeu vendosi aty një garnizon ushtarak dhe më vonë i kushtoi kujdes të madh për vetë pozitën kyçe që zinte. Pas Betejës së Drinit më 1448 kundra venedikasve, burgosi në Petralbë dy komandantët kundërshtarë që zuri rob Andrea Humoin dhe Simon Vulkathanin[29]. Në rrethimin e parë të Krujës më 1450 Skënderbeu e përforcoi Petralbën me roje, komandantë e nozullime[30].

Duke ndjekur traditën e të jatit, Gjonit, Petralba u bë vatër e ndejës së Skënderbeut dhe e familjes së tij. Barleti pohon se pas betejës së Modricës më 1451, Skënderbeu së bashku me Hamzanë dhe pak shokë shkoi në Petralbë. «Atje ai kishte lënë të shoqen që në fillim të verës, gjë që pastaj e bëri gjatë gjithë mbretërimit të tij»[31]. Gojdhëna jo vetëm që e pohon këtë, por shton se këtu lindi edhe i biri i Skën-

20) M. Barleti, **po aty** f. 81.
21) S. Anamali, **Stellushi qytet i Skënderbeut në Mat,** Studime Historike 4, Tiranë 1967, f. 105-112.
22) D. Komata, **Petrela – një parafortesë e Krujës në luftërat e Skënderbeut,** konf. II Stud. Alb. vol. I, Tiranë 1969, f. 285-309.
23) D. Komata **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike 1978 në Krujë,** Sesioni shkencor Arkeologjik i v. 1978, Iliria VII (në shtyp).
24) M. Barleti, **po aty,** f. 80.
25) H. Ceka, **Vrejtje mbi disa të dhëna topografike rreth luftërave të Skënderbeut sipas Barletit,** BSHSH 3, Tiranë 1952, Historia e Shqipërisë, vol. I, Tiranë 1959, f. 233.
26) S. Pulaha **po aty** f. 326.
27) M. Barleti, **po aty,** f. 80, 300.
28) D. Kurti, Petralba, Drita 19 mars 1967.
29) M. Barleti, **po aty,** f. 155.
30) M. Barleti, **po aty,** f. 245.
31) M. Barleti, **po aty,** f. 300.

DO NOT COPY

derbeut – Gjoni[32]. Kjo duhet pranuar si e vërtetë, pse Gjon Kastrioti lindi më 1456 dhe Barleti thotë se para betejës së Albulenës më 1457 Skënderbeu «mori nga Petralba gruan dhe fëmijtë» dhe i vendosi në Krujë[33]. Kjo pasi siç duket ishte i mirë informuar se Hamza Kastrioti do të kalonte nëpër Mat. Më tej Petralba nuk iu dorëzua këtij dhe ndaloi depërtimin armik nëpër Qafë-Murrizë për në Krujë. Ashtu si Hamza Kastrioti edhe renegati Ballaban Pasha prej Mati, në inkursionin e tij të parë më 1465 vuri në shenjë Matin. Por Skënderbeu si vendosi kampin në Petralbë, me 8 mijë kalorës e 4 mijë këmbësorë i doli para në Vajkal të Bulqizës dhe e dërmoi[34].

Burimet nuk flasin më për Petralbën, por dhe i vetmi dëshmues i saj Barleti jep një kuadër të plotë mbi pozitën, rëndësinë dhe rolin që ajo luajti vetëm gjatë kohës së Skënderbeut. Pas vdekjes së Skënderbeut edhe Petralba pësoi fatin e kështjellave të tjera shqiptare, të cilat pas një lufte e rezistence të gjatë u pushtuan dhe rrënuan prej turqve. Më vonë burimet ndonse flasin për Gurin e Bardhë nuk shënojnë asgjë për kalanë[35]. Megjithëse u rrënua, emëri i saj dhe i Skënderbeut nuk u harruan dhe arritën deri në ditët tona.

KOMSIA. Pesë kilometra në jugperëndim të qytetit të Burrelit, rrëzë vargmalit Skënderbeg ndodhet Komsia. Ajo kufizohet me Muzhakën, Midhën dhe Gërmanin. Në një nocion më të qartë, Komsia, është një terracë midis Zallit Germanit dhe Sheut të Thatë. Mbi Komsi në anën jugore, gjendet një majë që i rri asaj si rroje me emrin Maja e Stragjut dhe lartësi 1047 m mbi nivelin e detit (fig. 18). Në gojën e popullit ajo njihet me emërin thjeshtë Komsia, por dikur quhej Qyteza apo Fusha e Komsisë. Në vetë atë dhe rrethinat e saj ka gjurmë të shumta arkeologjike.

Banorët dëshmojnë se vetë Komsia ka pasur rrënoja banesash dhe kalldrëme, prandaj quhej dhe qytezë. Por gurët e saj u morën në vitet 20 e 30 të shekullit tonë për ndërtimin e rrugës Krujë-Burrel dhe vetë qytetin e Burrelit. Megjithatë në Komsi kanë ngelur gjurmë që dëshmojnë për egzistencën e një qyteze.



Fig. 18

Në rradhë të parë shkatërrimit i kanë shpëtuar tumat dhe varrezat e sheshta. Në rrjedhën e majtë të Zallit Germanit përkundruell Komsisë, tuma e Midhës që si zanafillë i përket shek. XVI-XV p.e.s., është ripërdorur si varrezë në shek. V-IV p.e.s.[36]. Në vetë truallin e Komsisë ka tre tuma ilire. Njera prej tyre i përket shek. XV-XIV p.e.s.[37]. Kurse tjetra ka dhënë objekte të fazës II-të e III-të të hekurit të hershëm[38]. Në vendin ku u ndërtua Uzina e Ferrokromit doli një nekropol i periudhës së vonë antike[39] ndërsa në veri të Uzinës, 200 m larg saj, buzë zallit, ruhen gjurmët e disa godinave. Ne mundëm të kapim konturet e një ambjenti me përmasat 15 x 10 m që kishte qeramikë ndërtimi të periudhës antiko-mesjetare dhe një mur me gjatësi 75 m, ndërtuar me gurë e gëlqere. Kufi me Komsinë në Muzhakë kanë qenë rrënojat e një monumenti paleokristian dhe e gjithë fusha e Muzhakës ka qeramikë ndërtimi e objekte të periudhës vonë antike e të mëvonshme.

Në anën lindore të Majës Stragjut ruhet toponimi Dera e Qytezës. Në kurrizin që zbret drejt Zallit Frankthit duken njera pas tjetrës gjurmët e tri kullave të rrënuara rrafsh për tokë. Kurse në anën veriore të tyre një vazhdë muri të rrënuar rrafsh me tokë. Kjo pikë dominuese dhe e fortifikuar tregon që këtu kemi pasur një pikë vrojtimi që kontrollonte rrugën që vinte nga Qafë-Shtama për në Komsi.

Fotokopje

32) D. Kurti, **Kastriotët nëpërmjet legjendave,** Bashkimi 7 Maj 1967; **Petralba,** Drita 19 Mars 1967, **Petralba – Kalaja e Skënderbeut në Mat,** Bashkimi 14 Mars 1471.
33) M. Barleti, **po aty,** f. 367.
34) M. Barleti, **po aty,** f. 463.
35) I. Zamputi, **Relacione,** I, dok. 5 (80, 81), dok. 36 (40) 63 (11), 64, 79 (85).
36) D. Kurti, **Përhapja e tumave...**
37) D. Kurti, **Po aty.**
38) D. Kurti, **Kodërvarreza ilire e Komsisë,** «Buletini Arkeologjik» 4, Tiranë 1974, f. 166-170.
39) D. Kurti, **Nekropoli i Komsisë,** Iliria VIII (në shtyp)

Në lindje të Muzhakës në vendin Qafë Porta depërtonte rruga e sipërme. Në rrjedhën e sipërme të Zallit Germanit dhe mbi Majën e Stragjut janë toponimet Farka, Ara e Prroi i Xhoprenit me mbeturina punimi metalesh. Nëpër Komsi kalonte rruga shumë e rëndësishme që nisej nga Dyrrahu e fushat bregdetare për në Zgërdhesh, Qafë-Shtamë, Komsi, Burrel, Lis, Stellush, Dibër e Kosovë.

Nga këto rrënoja i përkasin mesjetës së mesme rrënojat e kullës vrojtimit tek Dera e Qytezës, të cilat banorët e lidhin me kohën e Skënderbeut, rreth të cilit tregojnë shumë legjenda, sidomos për Skënderbeun, Vojsavën dhe Mamicën[40]. Të gjitha këto flasin për egzistencën e një qyteze në Komsi. Vetë emri i vendit, dëshmon për një stacion, që rrjedh nga titulli «komes». Për egzistencën e një qyteze në Komsi dëshmon edhe Ippen por nuk jep hollësira për to, pasi nuk e pa vetë[41]. Autori antik Prokopi i Cezares, në traktin e tij «Mbi ndërtimet» shënon në Epirin e Ri të rindërtuar nga perandori Justiniani fortesën Kome[42]. Më tej në gjeneallogjinë e Muzakajve përmendet vendi Komi krahas Randisisë. Kjo e fundit sipas nesh është Rranxa e Matit ku gjëndet Komsia, që më vonë shënohet Misioni i Randisisë, që nis nga Derveni i Mirditës, rrëzë maleve deri në Gur të Bardhë të Matit[43]. Vetë Komsia deri më 1922 ka qenë qendër tregu për njësinë etnografike të Rranxës në Mat. Banorët e këtushëm trashëgojnë deri në ditët tona një ndër zejet më të lashta të punimit të enëve të baltës me thurje me të cilat furnizojnë gjithë Matin. Të gjitha këto janë në favor të tezës për egzistencën e një qendre qytetare në Komsi.

*
* *

Duke i shtuar dy kalave të njohura në Mat, asaj të Xibërit dhe Stellushit edhe fortifikimet e Ferrë Shkopetit, Shkopetit, Bruçit, Cërujës, Petralbës, dhe Komsisë, numëri i tyre arrin në tetë. Ato janë një zinxhir me tetë hallka dhe formojnë një kordon mbrojtës të Matit. Fortifikimet gjënden në Qafa dhe rrugët e rëndësishme për në Mat. Si të tilla kanë patur karakter të dyfishtë si qendra ekonomiko-administrative dhe mbrojtëse. Përveç tyre, duhet shënuar se në Mat ka edhe gjurmë të tjera kalash e qytezash të panjohura si duhet. Kështu mund të përmëndim qytezat në: Gjoçaj, Groshot-Dukagjin (Arba), Shlli, Kurqelaj, Kurdari, Klos, Gurrë, Domë, Shehri në Kokërdhok, vendbanimet e hapura të periudhës së vonë antike me përmasa të mëdha në Sheshin e Ahmatit Baz, Banja e Arrikut, Suç e të tjera të cilat duhen gjurmuar e studjuar.

Nga këto kala e qyteza janë të periudhës ilire ajo e Xibërit, Ferrë-Shkopetit dhe Shkopetit. I përkasin periudhës antike të vonë e mesjetare Bruçi, Stellushi, Cëruja, Petralba dhe Komsia.

Midis gjashtë kalave të Gjon Kastriotit në vitin 1430 do të rendisnim për dy në këmbë Stellushin e Petralbën, midis katër të rrënuarave, nëse do i provojnë gërmimet e ardhëshme arkeologjike, Bruçin, Cërujën dhe Komsinë. Kurse e katërta mbetet për t'u gjurmuar.

Me rrënimin e këtyre kalave e qytezave pas shek. XV, Mati nuk pati një qendër qytetare dhe treg unik, por mbeti i ndarë në katër njësi të mëdha Prelë, Rranxë, Përteujt dhe Krye-Mat sejcila me tregun e vet.

Document Copy

40) D. Kurti, **Po aty**
41) Ippen, **Die Gebirgen des NW Albaniens,** Wien, 1908 f. 72, «Pranë katundit Komsia, në udhën nga Mati për në Krujë nga Qafa e Shtamës simbas të thënave gjënden gërmadhat e një qyteti të dikurshëm».
42) Proc. de aed. IV, 4 fortesa Kome.
43) I. Zamputi, **Relacione** II, dok. 79 (85).

Dilaver KURTI

DO NOT COPY

FORTERESSES ET CITADELLES INCONNUES DANS LE DISTRICT DE MAT

RESUME

Le district de Mat est une des régions les plus riches en monuments de notre pays. Les nombreuses investigations et fouilles effectuées ont concerné principalement la culture tumulaire. C'est ainsi que durant les années 1952-1960 ont été 35 tumuli illyriens et plus tard d'autres encore. Par ailleurs, dans le domaine des agglomérations urbaines fortifiées ont été effectuées des fouilles, notamment dans la forteresse moyenâgeuse de Stelush, dans la forteresse illyrienne de Xibër et dans la basilique de Suç. Dans cette communication l'auteur traite de certaines forteresses et citadelles inconnues jusqu'à ce jour, entre autres la citadelle de Ferre-Shkopet, la forteresse de Shkopet, la citadelle de Bruç, la forteresse de Cernje, la forteresse de Gur i Bardhë et la citadelle de Komsia.

LA CITADELLE DE FERRE-SHKOPET

A l'est du quartier Ferre du village de Shkopet, à environ 600 m d'altitude du niveau de la mer, se trouvent les ruines d'une citadelle que les gens du pays appellent forteresse. On y peut accéder des côtés nord et sud, tandis que dans les autres directions le terrain est escarpé et rocheux. Les constructeurs ont fortifié de murs ces deux accès à la citadelle. Il s'agit de murs construits avec des blocs de roche calcaire non équarris, de forme polygonale et de dimension moyenne et petite. Les constructeurs ont centré leur attention principalement sur la face extérieure de ces murs, en en faisant ressortir les côtés plats. La largeur de ces murs varie de 2 à 3 m. Les blocs du côté nord sont de dimension 1 x 0.30 x 0.20 m et même moindre. Du côté sur le mur manque complètement, il n'en reste que des traces et un tronçon avec un bloc de dimensions 1.15 x 0.90 x 0.45 m.

Sur le terrain de la fortification ont été trouvés divers fragments de récipients. De leur nombre des fragments en vernis noir luisant, que nous avons trouvé dans le tronçon méridional du mur, puis des fragments d'amphore et d'autres récipients. L'attention est attirée surtout par une pierre ponce agrémentée avec le motif des aiguilles du pin.

Ces trouvailles appartiennent à la période de culture urbaine des IVe-IIe siècles av. n.è.

Au pied de l'éminence, où se dresse la citadelle, s'étend une plaine couverte d'un bois de cornouillers. C'est ici que nous avons rencontré des traces d'habitations, dont l'une aux dimensions évidentes de 6 x 4 m et avec des murs d'une épaisseur de 0.80 m. Dans ce cas aussi les murs sont à pierres sèches. Dans l'environnement ont été trouvés divers fragments de récipients et de céramique de construction, entre autres, des tuiles, briques, scories de métaux, qui appartiennent aux premiers siècles de notre ère et à la basse antiquité.

Au nord de cette étendue, au pied d'une éminence rocheuse, se trouve un cimetière. Ici les tombes sont construites avec des pierres et des dalles. Dans l'une d'elles ont été trouvés 5 squelettes, dont 4 regroupés à part dans un côté. Le dernier squelette était accompagné d'un inventaire comprenant des bagues et des anneaux de bronze. Du point de vue typologique comme de l'inventaire recueilli sur place, il ressort que cette tombe appartient au haut moyen âge, c'est-à-dire au VIIe-XIIe siècles. A l'ouest du cimetière, sont éparpillées les ruines d'une église appelée Shen-Gjergj, dont les murs comportent des fragments de céramique utilisés comme matériau de construction.

Entre cette église et le cimetière ancien se trouve la seule source d'eau du pays que ses habitants appellent Kroi i Skanderbeut *et l'attribuent à George Kastrioti-Skanderbeg.*

A la lumière de ces fouilles, on peut aboutir à la conclusion d'être en présence d'une agglomération urbaine ouverte située au-dessous de l'habitation fortifiée.

Selon la technique des murs et des trouvailles, il ressort que cette citadelle qui a rempli la fonction d'acropole appartient à la période urbaine illyrienne des IVe-IIe siècles av. n.è.

Les ruines s'étendant dans la partie inférieure témoignent de la continuité de la vie dans la basse antiquité. Les tombes moyenâgeuses font remonter cette datation au haut moyen âge, alors que l'église et le cimetière nouveau appartiennent à une période allant de la moitié du moyen âge jusqu'à nos jours.

Dans son ouvrage «Synecdemus», écrit au VIe siècle av. n.è., Héracle, outre les neuf villes, mentionne dans l'Epire nou-

veau les villes de Listron et Skeupton. Au IXe siècle de notre ère, Costantin Porchyrogenète indique ces villes dans le Thème de Durés. Alors que le rapporteur Mark Skura (XVIIIe siècle) écrit qu'au pied de Trodine (la Throdhne actuelle) il y avait une ville appelée Skuontes. Dans le haut Lisistrom nous avons identifié la ville de Lis du Mat, mentionnée comme cité et centre ecclésiastique relevant de Durrës, qui n'est autre que le Stelush, moyenâgeux. Etant donné que ces deux villes sont mentionnées trois fois de suite, l'une après l'autre, et partant de la ressemblance du nom de Skeupton de la période antique et moyenâgeuse avec celui du Shkopet actuel où se trouve la citadelle, il se peut que cette citadelle appartienne à la ville antique-moyenâgeuse de Skeupton.

LA FORTERESSE DE SHKOPET

Juste là où se trouve le canon de Shkopet et la digue de la centrale hydro-électrique, dans le cours droit du fleuve Mat se dresse un massif rocheux couvert de ruines, que les gens du pays appellent ruines de Koke Malç, en souvenir d'un des sages de la période de Skanderbeg.

Ce massif est escarpé de tous les côtés, on y peut accéder seulement du côté est. C'est justement dans ce sentier que l'on peut suivre les traces d'un mur de pierres qui n'existe plus de nos jours, car ces pierres ont été utilisées pour d'autres constructions. Sur le terrain escarpé en direction ouest se trouvent les ruines de trois habitations, disposées sur la pente l'une après l'autre. Ces trois constructions se caractérisent par la même technique, l'épaisseur des murs est égale, à la seule différence que chez les deux premières en raison de la nature du terrain il y a des murs de soutènement afin de niveller le terrain sur lequel s'érige l'habitation, éléments de construction qui manquent dans la troisième maison. Partant des traits communs, il ressort que ces habitations se caractérisent par la même technique et appartiennent à la même période de construction.

Sur le versant méridional de ce massif, juste au-dessus du tunnel, au milieu de la roche il y a une inscription de cinq lettres. Elle a été ciselée sur la face plate de la roche, toutefois sa lecture présente des difficultés et il est impossible de la photographier. En conséquence, nous ne pouvons exprimer une opinion à propos de sa datation.

Les découvertes faites dans une série de villes illyriennes comme Amantie, Irmaj, Zgërdhesh, Lis, Antigone, Rosnje, etc., présentent des analogies avec les habitations de Shkopet tant sur le plan de la technique de construction que de leur forme quadrangulaire et leurs dimensions.

LA CITADELLE DE BRUÇ

Dans la partie nord de Bruç coule le torrent de Blaz, affluent droit de l'Urak qui, à son tour, est l'affluent droit du fleuve Mat. Le torrent même de Blaz comprend deux torrents, le Blaz proprement dit et le torrent de Val. Au point de jonction du Blaz avec le torrent de Val, il y a un versant escarpé au-dessus duquel, à 556 m d'altitude du niveau de la mer, s'étend un plateau où se trouvent les ruines de Shen Koll. L'extrémité méridionale de ce plateau, limitée des deux côtés par les versants des deux torrents, a été bouchée par les constructeurs de murs, en le convertissant en une agglomération urbaine fortifiée de forme triangulaire.

Les gens du pays connaissent cette citadelle sous le nom de «Citadelle de Skanderbeg» et l'imagination populaire a inventé une foule de légendes à son sujet. Nous y trouvons aussi une série de toponymes, que les habitations du pays rattachent à la personne de Skanderbeg.

Sur le terrain de la citadelle, notamment sur ses versants, ont été trouvés divers fragments de récipients allant de la première période du fer jusqu'au moyen âge.

Du point de vue de la typologie, cette agglomération urbaine ressemble à l'agglomération urbaine des cavernes de Tren à Korçe. Dans sa partie inférieure se trouvent les cavernes de Keput ou de Val, puis la Caverne des colombes et celle de Blaz, alors que la citadelle se dresse dans sa partie supérieure. Les anciennes trouvailles mises à jour ici se rattachent probablement à des formes d'habitation encore plus anciennes qui n'ont pas été fouillées. A la lumière des données actuelles, la fortification de Bruç, nous l'attribuons à la basse atiquité, alors que la vie se termine ici dans la deuxième moitié du XVe siècle.

LA FORTERESSE DE CERRUJE

Au-dessus du quartier Rrase du village de Cerruje se trouvent les ruines d'une petite forteresse appelée Forteresse de Skanderbeg. La colline sur laquelle s'élève la forteresse occupe une position dominante, en débit de cela elle n'offre pas une défense naturelle solide. La forteresse surmonte une crête convexe se ramifiant en deux autres crêtes, qui descendent vers le torrent et le village.

Les ruines de la forteresse s'étendent en direction est-ouest en conformité avec le terrain. A l'est, on voit les débris d'une pièce, peut-être d'une tour, de forme quadrangulaire et aux dimensions extérieures de 9 x 7 m. A l'ouest, on relève les contours de deux autres pièces respectivement de dimensions 9 x 5 m et 20 x 54 m. Du côté nord, les contours du mur d'enceinte sont visibles sur une longueur de 65 m. Ils s'étendent sous forme d'arc, conformément au terrain, de l'extrémité orientale jusqu'à la cime occidentale où se situe la dernière pièce. L'épaisseur des murs varie de 1.80 à 2 m. Sur le terrain de la forteresse, et particulièrement dans la dernière pièce en direction ouest ont été trouvés des fragments de deux types de tuiles. De leur nombre, certaines ont une épaisseur de 2 ÷ 3,5 cm. et leur partie ronde est agrémentée d'ondulations faites avec les doigts de la main. L'autre type de tuiles, d'une facture plus simple, a une épaisseur de 1,5 cm. et ressemble aux dernières tuiles utilisées à Petralba pendant la reconstruction.

DO NOT COPY

PO NOT COPY

La technique de construction des murs de la Forteresse de Cerruje et leurs dimensions correspondent à celles des forteresses de Bruç, Stelush, Petralb, du district de Mat, ce qui signifie que ces ouvrages fortifiés sont contemporains et appartiennent au moyen âge.

PETRALBA

Entre les villages de Guribardhe et de Fushat, dans la région de Mat se dresse une crête montagneuse de formation calcaire, à une altitude de 778 m du niveau de la mer. La côte N.-O. de cette formation est coupéée par le Jezedra et sa cote S.-E. par le Thilapat, tous deux affluents gauches du fleuve Mat, alors qu'en direction est et ouest s'étendent les villages de Gur i Bardhë et de Fushat.

Du côté N.-O. de la côte, sur deux cimes de biais au fleuve Jezedra se trouvent les ruines d'une forteresse que le peuple appelle Forteresse de Skanderbeg. Sur la deuxième cime surplombant le Jezedra se trouvait le château de la forteresse. Ici le terrain est très escarpé et avec des versants inaccessibles. Sur une longueur de 50 m et une largeur de 10 à 15 m, on avait mis en place des ouvrages fortifiés. A l'intérieur des murs d'enceinte de la forteresse sont conservées encore les traces de trois pièces et d'une tour. Entre celles-ci, il y a une citerne de forme carrée dont les côtés ont une longueur de 2.50 m et une tour circulaire d'un diamètre de 5 m; l'épaisseur des murs est de 1,40 ÷ 1.90 m et la hauteur conservée est de 3,30-5.30 m.

Entre les deux cimes mentionnées plus haut se trouve un col accessible, dont les versants ont été renforcés de murs défensifs pour en interdire le passage, alors que l'espace séparant l'une cime de l'autre a été utilisée pour construire les maisons de la ville. Du côté ouest les traces du mur son conservées dans les deux versants du col sur une longueur de 3 et 6 m, une largeur de 0.90 ÷ 1.10 m et une hauteur de 3 m. Partant des contours, il ressort qu'autrefois ce mur avait une longueur de 32 m. C'est justement au-dessus et au-dessous de ce mur que nous avons récupéré une foule de fragments récipiants en céramique.

Dans la partie nord de la tour circulaire, à l'est du village de Fushat, où apparemment, se trouvait la porte de la forteresse, il y a un mur de fortification d'une épaisseur de 2 m qui s'étend de l'ouest à l'est puis à 18 m de distance se dresse une tour quadrangulaire de dimensions 7 x 4.50 m.

Toutes les constructions mises en place dans cette forteresse sont de pierres aux dimensions petites et moyennes, mais elles n'appartiennent pas toutes à la même période de construction, ce qui s'explique par les reconstructions effectuées successivement. La céramique recueillie sur place, bien que fragmentaires, témoigne en faveur de la continuité de la vie dans cette forteresse depuis la basse antiquité jusqu'à la moitié du moyen âge.

Les traces découvertes hors de la forteresse, dans sa périphérie, parlent pour une continuité de vie intense. A Lug i Arrave, de nos jours encore, existe parmi le peuple le toponyme de Dyqanet e Venedikasve (= Les boutiques des Vénitiens). La présence de ruines à Verrith, Murgate, Gurrez, Fierze, Kodra e Pazarit, les débris de deux églises et les nombreuses trouvailles archéologiques témoignent on ne peut mieux en faveur de cette thèse.

En réalité cette forteresse était assez petite et, par ses dimensions, elle vient tout de suite après la forteresse de Stelush à Mat. Mais considérant dans son ensemble l'agglomération urbaine ouverte avec sa forteresse, on s'aperçoit qu'on est en présence d'un centre important. Sa construction à ce point a été conditionnée par la présence de la route importante qui commençait dans l'ancienne Durrës, en passant par Shkalla e Tujanit, le col de Murrize, pour bifurquer ensuite en deux embranchements, dont l'un à travers le col de Shkalla passait à côté de la forteresse illyrienne de Xiber en direction de Mat, et l'autre traversait Gur i Bardhe et le col de Buell en direction de Diber.

Dans ces conditions, Petralba, de par sa position clef à proximité de deux routes, s'est convertie vraisemblablement d'agglomération urbaine ouverte en station routière, comme le témoigne aussi le toponyme de Mausai.

Notre historiographie rattache la construction de cette forteresse à la naissance des principautés albanaises durant les XIIIe-XIVe siècles. De leur nombre figure aussi la principauté de renom des Kastriot dans la région de Mat, avec Gjergj Kastrioti-Skanderbeg à sa tête. Petralba, pendant les guerres qui opposèrent les Albanais aux Turcs au XVe siècle sous la direction de Skanderbeg, a joué un rôle important en tant que maillon essentiel dans le système défensif des Kastriot contre les envahisseurs turcs et en tant que foyer de la famille des Kastriot.

KOMSI

Komsi se situe à 5 kilomètres au sud-ouest de la ville de Burrel, au pied de la chaîne de montagnes portant le nom de Skanderbeg. Elle est délimitée par Muzhak, Midhe et German. Pour se faire une idée plus claire, Komsi représente une terrasse qui s'étend entre Zalli i Germanit et Sheu i Thatë. Du côté sud elle est surmontée par une cime, la cime de Stragju, à une altitude de 1047 m du niveau de la mer. Les gens du pays l'appellent tout simplement Komsi, mais autrefois elle était connue sous le nom de Citadelle ou Plaine de Komsi. Dans la citadelle elle-même et ses alentours, on relève une foule de traces d'intérêt archéologique.

Les habitants du pays racontent qu'à Komsi même il y avait dans le temps des débris d'habitations et de pavés, c'est pourquoi on l'appelait citadelle aussi. Dans cette zone ont été mis à jour des tumuli et des tombeaux plats. Sur le courant gauche de Zalli i Germanit, face à Komsi, se trouve le tumulus de Midhne dont les origines remontent aux XVIe-XVe siècles av. n.è., mais qui a été réemployé comme cimetière aux

Ve-IVe siècles av. n.è. Sur le terrain de Komsi même il y a trois tumuli illyriens. L'un d'entre eux appartient aux XVe-XIVe siècles av. n.è., tandis que dans l'autre on a trouvé des objets attribués à la IIe et à la IIIe phases de l'ancien fer. A proximité de Komsi, dans le village de Muzhak ont été mis à jour des ruines et un monument paléochrétien; dans toute la plaine de Muzhak il y a de la céramique de construction appartenant à la basse antiquité et aux périodes successives.

Du côté est de la cime de Stragju, on conserve encore le toponyme Dera e Qytezës (=*la Porte de la Citadelle). Dans la chaîne qui descend vers Zalli de Frankth, on relève successivement les traces de trois tours en ruines au ras de sol, alors que dans leur partie septentrionale on distingue la continuation d'un mur écroulé au ras de sol. Ce point dominant et fortifié montre que nous sommes en présence d'un point d'observation contrôlant la route qui conduisait de Qafe-Shtame à Komsi. Ce dernier centre était traversé aussi par la route importante qui, partant de Dyrrach et des plaines du littoral, menait à Zgërdhesh, Qaf-Shtame, Komsi, Burrel, Lis, Stelush, Dibër et Kosove. Tous ces faits témoignent qu'il existait une citadelle à Komsi. Le nom même du lieu s'exprime en faveur de la présence d'une station qui dérive du titre «Komes». L'existence d'une citadelle à Komsi est attestée aussi par Procope de Césarée dans son traité «Des constructions», où il mentionne la forteresse de Kome parmi les ouvrages fortifiés mis en place par l'empereur justinien pendant la reconstruction du Nouveau Epire. En plus, dans la généalogie des Muzak il est question du lieu Komi de pair à Randisi. Quant à Randisi, selon l'avis de l'auteur, c'est la contrée de Rranxa e Matit où se trouve Komsi et qui plus tard figure sous le nom de Mission de Randisi; cette contrée s'étend de Derven de Mirdite, en longeant les montagnes, jusqu'à Gur i Bardhë du district de Mat. Komsi, elle aussi a servi de centre commercial à l'unité ethnographique de Rranxe dans le district de Mat. Les habitants du pays ont conservé jusqu'à nos jours un des métiers les plus anciens, la production de récipients d'argile agrémentés de motifs variés qu'ils fournissaient à toute la région de Mat.*

o
o o

En ajoutant aux deux forteresses connues de Mat, celles de Xiber et de Stelush, les fortifications de Ferre-Shkopet, de Shkopet, Bruç, Ceruje, Petralba et Komsi, on finit par constater qu'elles constituaient un cordon défensif de la région de Mat. De ce fait elles ont eu un caractère double, c'est-à-dire que c'étaient à la fois des centres économiques-administratifs et de défense.

En outre, il convient de relever que dans la région de Mat il y a d'autres traces de forteresses et de citadelles qui ne sont pas connues comme il convient. Mentionnons de leur nombre les citadelles de Gjoçaj, Groshot-Dukagjin (Arba), Shlli, Kurqelaj, Kurdar, Klos, Gurre, Dom, ainsi que la citadelle de Shehr à Kokerdhok; les agglomérations urbaines ouvertes de la basse antiquité aux dimensions grandes et qui se trouvent à Shesh i Ahmatit, Baz, Banja e Arrikut, Suç et ailleurs. Tous ces monuments seront l'objet d'investigations et d'études dans le futur.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

RESTAURIMI PËRFORCUES NË XHAMINË E BEQARËVE NË BERAT

Xhamia e Beqarëve ndodhet në pjesën e poshtëme të lagjes Mangalem të Beratit, buzë rrugës kryesore të qytetit, rrethuar në anët e tjera nga rrugicat e lagjes[1]. Siç tregon qartë vetë emërtimi i xhamisë, ajo i ka shërbyer rufetit të Beqarëve të kallfave të esnafeve të ndryshme të qytetit. Ky ishte një bashkim i zejtarëve të pamartuar që kryente njëkohësisht edhe shërbimin e policisë së qytetit dhe atë të rojeve të natës në Pazar[2].

E ndërtuar në teren të pjerët ajo rezulton me gjysëm kat, duke qënë vetë xhamia në katin (fig. 1). Si ndërtesë ajo përbëhet prej dy vëllimesh nën të njëjtën çati, vëllimi kryesor në anën jugore që ka një portik tre arkadash në pjesën e poshtëme dhe hajati me arkada në anën veriore. Kati përbëhet nga salla e lutjeve dhe hajati. Salla e lutjeve ngrihet mbi një sistem tregalerish mbuluar me qemer cilindrik pjesërisht nën dhe, të cilat hapen në anën jugore me një sistem harqesh mbi kolona prej rotullash guri. Mbi kolonat mbështeten edhe katër harqe të vegjël që dalin nga muret e galerive duke krijuar kështu një sipërfaqe të lirë prapa kolonave. Ky fakt të bën të mendosh se ambientet e galerive janë përdorur si dyqane apo depo duke qënë të mbyllura pas harqeve të vegjël me konstruksione të lehta që nuk kanë arritur deri në ditët tona. Edhe pjesa nën hajatin është shfrytëzuar për bodrume duke e ndarë më dysh me hyrjet nga lindja dhe perëndimi. Mbulimi i këtyre dy ambienteve është bërë me qemere cilindrikë.

Hyrja për në sallën e lutjeve bëhet nga ana veriore nëpër hajat, nëpërmjet një rrugine në nivel më



Fig. 1

të ulët se dyshemeja e vetë hajatit (fig. 2). Porta e sallës është theksuar nëpërmjet trajtimit të përbashkët të portës mbuluar me hark dhe dritares kuadratike mbi të. Elementet e veçantë të tyre janë punuar me kujdes me gurë të gdhendur. Salla vetë është me pla-

1) Sipas mbishkrimit që ruhet në të rezulton të jetë pikturuar në vitin 1827. Z. Shkodra **Problemi i kallfës në sistemin e esnafeve shqiptare** B.U.SH.T., S.SH.SH., 1, 1967, 73. Konf. II e studimeve Albanologjike, II, Tiranë 1969, 83.

2) Z. Shkodra, **vep. cit.** 13.

nimetri thuajse kuadratike me përmasa 11,00 + 11,25 x x 9.63 + 10.00 m. Salla ishte e mbuluar me çati druri, të rindërtuar në vitin 1961, tavani nën konstruksionin e së cilës mungonte, por qenia e tij ishte e padyshimtë sepse ruheshin pjesë të kornizës së suvatuar që e lidhte me muret anësorë. Salla ndahej në dy pjesë nëpërmjet një arkade mbi shtylla druri me seksion katror, duke ndarë pjesën në të cilën zakonisht ishte mafili dhe ku ndodhet edhe kalimi për në minaren (Tab. I, 1). Në faqen veriore gjendet mihrabi dhe katër dritare në dy rradhë. Në faqet lindore dhe perëndimore dritaret janë po në dy rradhë me nga tre dritare për secilën rradhë. Dritaret më nga veriu i murit perëndimor, brenda arkadës së hajatit, ruajnë simetrinë e ndërtimit të brendshëm të sallës. Gjithashtu katër dritare në dy rradhë janë dhe në të dy anët e portës së hyrjes për në sallë. Në formulimin e brendshëm të sallës së lutjeve rol jo të vogël lot edhe piktura murale e cila ndodhet në dy breza horizontalë në pjesën e sipërme të mureve[3]. Piktura është dekorative me ornamente bimore, në panele të ndara nga njëri tjetri me bordura të ngjyrosura. Brezi i sipërm, që është dhe më i gjerë, arin deri në fillimin e dritareve të sipërme ndërsa brezi i poshtëm deri pak mbi dritaret e poshtëme (Tab. II, 6). Me përsëritjen e motiveve të përafërta, piktura lot rol jo të vogël në njësimin e brendësisë dhe perceptimin më të lehtë të saj.



Fig. 2

Hajati në anën veriore shtrihet më tepër se sa muri verior i sallës së lutjeve, duke e shpënë më tej tendencën për zmadhimin e portikëve, që shihet në Berat dhe në portikun e xhamisë Mbret, për të shërbyer më mirë hajati si një ambient i dytë për faljen e besimtarëve. Kështu hajati qarkohet me arkada të plota nga anët veriore, lindore dhe perëndimore, si dhe me harqe të veçantë në anën jugore, në pjesët ku lidhet vëllimi i sallës me arkadat. Në anën veriore me gjerësi 16;80 m, ku është dhe hyrja për në hajat, arkada përbëhet prej gjashtë harqesh. Ato mbështeten mbi dy pilastra në formën e shkronjës «L» në qoshet dhe pesë kolona të ndërtuara prej rrotullash guri në zonën ndërmjet tyre. Kolonat janë mbi bazamente guri në formën e një trungu piramide, ndërsa kapitelet janë pak më të zhvilluar. Ata kanë pjesën e sipërme në formë paralelopipedi dhe vazhdojnë më poshtë me një trung piramide me qoshet e prera. Harku që mbështetet direkt mbi kolonat është në formë gjysëm rrethi, i ndërtuar me gurë të skuadruar të vendosur sipas rezeve pak më brenda faqes së murit mbi të, duke rezultuar në këtë mënyrë i shkallëzuar. Harku qarkohet me një hark tjetër më të ngushtë me gurë të vendosur përgjatë perimetrit, i cili ndërsa në pjesën e sipërme është gjysëm rrethor, në pjesën e poshtëme është gdhëndur për tu dukur në formë lundre.

Arkada nga lindja, e gjatë 6.85 m, përbëhet prej tre harqeve dhe mbështetet në dy pilastrat anësore dhe dy kolona të ndërmjetme. Nga pilastri jugor deri tek muri i sallës së lutjeve ka dhe një hapësirë me hark që mbështetet direkt në këtë mur. Arkada nga perëndimi me gjatësi 9.35 m ka tre hapsira, duke përfshirë hajati dhe një dritare të sallës së lutjeve. Si dhe salla, hajati ka dysheme me rasat e gurit karakteristike të ndërtimeve të Beratit.

Në formulimin e jashtëm xhamia është rezultat i drejtpërdrejtë i ndërtimit në terenin e pjerët të la-

3) Kjo pikturë ka qënë objekt i një ndërhyrje restauruese në vitin 1971 H. Nallbani. **Punimet e restaurimit në pikturën e Xhamisë Beqarëve Berat,** Monumentet 3, 1972.

DO NOT COPY

Dozioni

gjes. E ndërtuar me të njëjtën vendosje në teren të pjerët është dhe xhamia e Pazarit në Gjirokastër (v. 1757)[4]. Kjo ka në anën e rrugës, pra jo si këtu edhe hyrjen në katin e sallës, që sigurohet nëpërmjet një shkalle të dyfishtë. Zgjidhja e krijuar pranë tregut që shtrihej në pjesën e poshtme të lagjes është mjaft e goditur dhe flet për aftësinë e ndërtuesve anonim të saj dhe për një shfrytëzim të mirë të terrenit, duke përdorur tërësisht pjesën e poshtëme të ndërtesës. Kjo ka prurë një lartësi jo të vogël të pjesës nën kat në anën jugore, që nuk ndihet për vetë zgjidhjen arkitekturale të ndërtesës.

Pjesa nën kat, që trajtuam dhe më lart, është në formën e një portiku tre pjesësh në anën jugore, ndërsa e mbyllur dhe sipas terenit në anët e tjera. Faqja jugore dhe pjesët mbi harqet e vegjël anësorë të portikut janë ndërtuar me gurë të gdhëndur me fuga të holla. Muret e tjera janë me gurë të papunuar shtresorë. Pjesa me gurë të gdhëndur ndahet nga pjesa mbi të që i takon sallës së lutjeve nëpërmjet një kornize guri. Kjo kornizë ndërpritet vetëm aty, ku ndërtuesit mbi një kamare kanë vendosur të gdhëndur në shkallë të vogël maketin e një minareje (Tab. II, 3).

Faqet e jashtme të mureve të sallës së lutjeve janë të suvatuara. Në pjesën e sipërme, kalon një brez i pikturuar nga nën streha deri pak nën dritaret. Ky brez është i ndarë në panele të veçantë të zbukuruar me motive floreale dhe peizazhe me pamje qyteti (tab. II, 2). Si zakonisht në ndërtimet e kultit mysliman dhe në banesat e kohës, piktura murale zë këtu pjesën nën strehë për të qënë e mbrojtur deri në një farë mase nga dielli dhe reshjet atmosferike. Në të njëjtën kohë vendosja e saj në pjesën më në dukje të ndërtesës, nëpërmjet shtimit të dekorit në të e kurorëzon atë, duke vlerësuar edhe më tepër dekorin. Pjesa tjetër e suvatuar është e bërë me llaç me ngjyrë okre, në të cilën është krijuar me vija të bardha idea e muraturës me gurë të skuadruar. Përsa i përket hajatit muratura e tij është me gurë dhe e pa suvatuar. Një element me vlerë është edhe minarja shumëfaqshe e ndërtuar me gurë dhe e suvatuar, e ulët dhe me dekorin karakteristik të stalaktiteve në pjesën nën kazanin (Tab. II, 4).

Si rezultat i cedimit të terenit në pjesën qëndrore të portikut tre pjesësh në anën e përparme të monumentit, dy kolonat e mezit kishin pësuar një ulje (Tab. I, 2). Kështu ishte ulur harku qëndror së bashku me pjesë të harqeve anësor që mbështeteshin në këto dy kolona si edhe muri mbi to. Muri i ulur kuptohej nga të çarat që pjertazi fillonin aty ku shkëputeshin harqet anësor nga pjesët që nuk kishin ulje. Këto të çara formonin një si trekëndësh që arrinte deri në mes dy dritareve të radhës së poshtëme të murit jugor. Të çara të tjera ishin pranë lidhjes së qemereve të galerive me këtë mur. (Tab. II, 1). Njëkohësisht muri mbi arkadën kishte bërë një bark kryesisht në zonën mbi dritaret. Prezenca e të çarave në qemeret si dhe deformimi nga vertikaliteti i murit të shpien në përfundimin se krahas cedimit të terenit kemi edhe shkarje të tij pjertazi. Kjo për mendimin tonë është mjaft e mundshme për formën e terenit. Me sa duket ka lëvizur pjesa aluvionale ndaj pjesës shkëmbore pikërisht në këtë vend. Shkaqe të kësaj mund të kenë qënë si filtrimet e ujrave sipërfaqësorë ashtu edhe ngjeshja e terenit nga mjetet e rënda që lëvizin në rrugën përpara xhamisë. Në se do të vështronim në aspektin sasior këto të çara, ato arinin deri në 5 cm ato të lëvizjes përpara dhe deri në 2-3 cm ato të uljes. Duke patur gjithashtu parasysh se ky deformim ndodhi në një kohë të shkurtër, u pa e nevojshme një ndërhyrje sa më e shpejtë përforcuese si për të shmangur dëmtimet e mëtejshme ashtu edhe për të rivendosur brënda mundësive gjëndjen e mëparshme.

Që në momentet e para të dallimit të dëmtimeve ishin vendosur një sërë pajantimesh për të siguruar ndërtesën (Tab. I, 5), të cilat u zevendësuan dora dorës që u vendosën përforcimet e reja. Për punimet që u ndërmorën u hartua projekti i restaurimit, i cili mbas aprovimit u vu në jetë. Qëllimi i ndërhyrjes restauruese përforcuese ishte mënjanimi i dëmtimeve të pësuara nga monumenti, rikrijimi i tërësisë strukturale të tij dhe ndalimi i dëmtimeve të mëtejshme. Për këtë u mendua të forcoheshin themelet e vjetra të dy kolonave qëndrore të portikut deri në rikrijimin e një themeli të sigurtë, kthimi në pozicionin e mëparshëm të pjesëve të ulura dhe marrja e masave që do shmangnin ulje të mëvonshme dhe shkëputje e pjesëve të reja nga të vjetra, pra, të çara të reja në kontaktin e tyre, gjë që do të ulte vlerat e pamjes së monumentit.

Le të shohim si u mendua për realizimin e secilës nga këto detyra. U mendua që për të përcaktuar mënyrën e përforcimit të themeleve do të nxireshin në dukje ata dhe do të gjykohej mbi dëmtimin e tabanit dhe të vetë themelit. Për të mënjanuar të çarat e pësuara si dhe uljet e harqeve dhe pjesëve të murit u mendua të ribëheshin harqet e dëmtuara në pozicionin e dikurshëm si dhe muri mbi to, duke rivendosur çdo gurë nga të fasadës në vendin e dikurshëm. Për shmangien e dëmtimeve të mëvonshme do të shërbenin si përforcimi i themeleve

4) E. Riza **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1978, Disertacion 34, fig. 39.

ashtu edhe lidhja me brez beton armeje e pjesëve të ribëra me ato të vjetra.

Me përcaktimin në vija të përgjithshme të ndërhyrjes përforcuese në monument u kalua në realizimin konkret të saj duke patur parasysh që gjatë punimeve restauruese do të vendosej për zgjidhjet e veçanta.

Punimet filluan me përforcimin e monumentit për të përballuar shtytjet që do të lindnin me heqjen e pjesëve të tij. Kështu në ndërtesat pranë u mbështetën përforcimet e ndërtuara në një plan me murin jugor për të përmbajtur shtytjet e arkadës. Për të mbajtur peshat u ndërtuan kallëpe harkor druri, sipas konfiguracionit të dikurshëm të harkut, të cilat u vendosën në dy harqet anësor të arkadës dhe në katër harqet që e lidhin atë me galeritë. Në mbështetjen e tyre në tokë u pat parasysh që do të gërmohej për themelet pjesa qëndrore nën arkadë. Mbajtja e murit jugor për të hequr pjesën e deformuar dhe rindërtuar atë, përbënte një problem më të vështirë. U zgjodh përforcimi në anën e jashtme me trarë të vendosur pjertas, kokat e të cilave ishin nën një jastëk – tra të shkurtër nën murin që do mbahej (Tab, I, 3, 4). Prerja u bë në zonën ndërmjet dy dritareve muri mbi të cilën rezultonte pa të çara të dukshme dhe pak i deformuar. Së pari u hapën vrima tej për tej ku u futën trarët që u lidhën me shtyllat, duke krijuar nëpërmjet pajandave një sistem të tërë. Mbështetja në tokë e shtyllave u bë mbi drasa të trasha të fiksuara në tokë në të dy anët e arkadës. Me krijimin e këtij sistemi mbajtës u kalua në prerjen e plotë të murit ndërmjet dy shtyllave anësore. Këto operacione ishin mjaft të vështira dhe u kryen me kujdesin më të madh dhe vrojtimin e vazhdueshëm të monumentit.

Ndërkohë ishin shënuar me numra të veçantë gjithë gurët e gdhëndur të murit dhe rrotullat e kollonave që ishin në pjesën që do të prishej, duke i fiksuar ato në një fotografi ballore me përmasa të mjaftueshme për këtë qëllim.

Procesin e riformimit të murit që u prish nga ne, qoftë edhe duke vendosur gurët e faqes së jashtëme në të njëjtat vende nëpërmjet shënimit të tyre, ne nuk e shohim si një ndërhyrje anastiloze. Rindërtimi i një strukture të monumentit me po ato materiale nuk është njëlloj si rikrijimi me anastilozë i një monumenti antik me gurë të mëdhenj të pa lidhur me llaç. Ky rindërtim krijon nga e para një element të ri, të domosdoshëm si për nga ana strukturale ashtu edhe në aspektin arkitektural të qenies dhe funksionit si një tërësi të ndërtesës, pra kemi të bëjmë me një ndërhyrje restaurimi kompletues. Vendosja e gurëve të faqes jashtëme nëpër vendet e mëparshme, u bë që të mos nevoiteshin gurë të rinj për të mbyllur secilin hark apo rresht që rindërtohej si dhe pranë harqeve, në rast se do të vendoseshin gurët e vjetër jo në vendet e tyre, që do të krijonte një efekt estetik jo të kënaqshëm.

Me prerjen e murit u kalua në prishjen e pjesës së poshtme nga lart poshtë duke ruajtur me rregull gurët e shënuar. Me arritjen në nivelin e tokës u vazhdua me nxjerrjen e themeleve të veçantë të kolonave. Ato rezultuan jo shumë në gjëndje të mirë, gjithashtu dhe tabani. Për këtë u vendos ndërtimi i një themeli të ri në thellësi më të madhe, i cili u mendua të jetë i vazhdueshëm, prej beton armeje, për të zvogëluar në maksimum presionin e strukturave në taban, që të mos kemi ulje të reja. Përmasat e tij qenë të kushtëzuara edhe nga konstruksioni mbajtës i murit dhe harqeve. Me ndërtimin e tij u kalua në riformimin e kolonave. Për to u përdor llaç me pluhur tullash e tjegullash i njëjtë në ngjyrë me llaçin e vjetër të fugave të kolonave. Kuotat e fillimit dhe përfundimit të kolonave të reja u morën të njëjta me ato të kolonave anësore, kështu që kallëpet për të ndërtuar harqet e reja ishin në nivele të njëjta me harqet përpara dëmtimit të arkadës dhe murit jugor. Me ndërtimin e kolonave filluam rindërtimin e harqeve dhe mureve ndërmjet tyre duke fiksuar paraprakisht tirandet e hekurta. Njëkohësisht me ngritjen e mureve u bë edhe lidhja me qemeret e galerive të nënkatit. Si për harqet ashtu edhe për murin me gurë të gdhëndur dhe kornizën mbi të u vendosën gurët sipas pozicionit të dikurshëm.

Për të siguruar kohezionin struktural të murit të ri me atë të vjetër, si dhe për të shmangur lindjen e ndonjë të çare eventuale në kontaktin e këtyre të dyve, u vendos një brez beton armeje në brendësi të murit të ri duke u futur për një farë distance dhe në pjesët e vjetra në kontakt me të. Ky brez u ndërtua pak nën nivelin e dyshemesë. Për të shmangur lëvizjen horizontale të murit, brezi u ankorua me disa shufra hekuri të vendosura nën dyshemenë me rrasa guri dhe të bllokuara me blloqe betoni në pjesët ndërmjet harqeve që mbulonin galeritë e nën katit. Më tej u vazhdua me ndërtimin e pjesës me mure të suvatuar deri në prerjen e murit. Pas kësaj kur u bindëm se muri kishte fituar rezistencën e nevojshme u prish struktura mbajtëse me trarë duke mbyllur dhe vrimat e tyre. Gjatë ndërtimit të këtij muri të fundit u muriduam që deri diku të mënjanonim harkun që muri i vjetër kishte krijuar. Për këtë u gdhënd për pak centimetra pjesa më e deformuar, duke krijuar një faqe të re me pak të deformuar. Sipas kësaj u ndërtua dhe muri i ri i suvatuar duke filluar që nga korniza. Me përfundimin e plotësimit të murit u bë suvatimi i tij, duke përdorur si mbushës rërë prej

DO NOT COPY

guri çmërsi për të patur të njëjtën ngjyrë me suvatimin e vjetër[5].

Me heqjen e përforcimeve të vëna, përfundoj dhe ndërhyrja e jonë (Tab. II, 4). U la për një kohë të dytë rindërtimi i çatisë për të siguruar zgjatjen e strehëve, që të mos dëmtohet piktura nën to, si dhe ndërtimi i tavanit të ri.

Tipologjikisht xhamia e Beqarëve bën pjesë në grupin e madh e mjaft të përhapur në vendin tonë të xhamive mbuluar me çati druri e tjegulla, të cilat fillojnë të ndërtohen që në periudhën e parë të pushtimit, për vetë lehtësinë e ndërtimit. Tipologjikisht këto xhami e kanë prejardhjen nga sallat me shumë kolona të xhamive të para të cilat me kohë ndjekin rrugën e thjeshtimit të hapësirës brendshme nëpërmjet paksimit të numurit të kolonave[6]. Ndërtimi vëllimor i kishave njënefshe të kthyera në xhami mund të shpjegojë deri diku përdorimin në shkallë të gjerë për xhamitë e vendit tonë të sallave mbuluar me çati druri, në të cilat kolonat përdoren vetëm në xhamitë e mëdha për mbajtjen e strukturave të çatisë pra jo për nevoja estetike.

Të këtij tipi janë sidomos faltoret e vogla të lagjeve dhe në përgjithësi mesxhidet. Këtij tipi i takojnë ndërtimet e para të ndërmara nga pushtuesi në vendin tonë, për të plotësuar nevojat e trupave të garnizoneve. Këto ndërtime të para nuk kanë arritur deri në ditët tona për shkak të materialeve të dobëta ndërtimore të përdorura[7]. Xhamia më e vjetër që njohim nga të dhënat burimore ka qenë ajo e Sulltan Mehmetit të II që ngrihej mbi kullën portë në kalanë e Elbasanit[8]. Nga këto xhami të para ruhet e rënuar xhamia në kalanë e Shkodrës duke transformuar rreth vitit 1479 për këtë kishën e shën Stefanit[9]. Një grup me rëndësi ndërtimesh përbënin xhamitë e ndërtuara në kohën e sundimit të Sulltan Bajazidit të II (1481--1512). Të tilla xhami ndërtohen në Elbasan, Berat, Shkodër, Durrës, Gjirokastër, Tepelenë, Delvinë, Përmet dhe kudo të mbuluara me tjegulla. Nga këto ndërtime, të parat e një farë rëndësie, ruhet xhamia Mbret në kala të Elbasanit, të cilën Çelebiu e emron xhami e Gazi Sinan Pashës[10]. Xhamia përbëhej nga salla e lutjeve, hajati dhe minarja[11]. Salla e lutjeve është drejtkëndëshe në plan me përmasa 11.52 x x 12,35 m. Për të lehtësuar mbulimin e saj me çati druri, janë vendosur tre shtylla druri, mbrapa të cilave ndodhet mafili mbi strukturë druri. Në murin jugor ndodhet mihrabi, pjesa e sipërme e të cilit është ndërtuar me stalaktite, ndërsa në të djathtë të tij mimbari i drunjtë. Në sallë hyet nga ana veriore, nëpërmjet një porte të ulët brënda një portiku mjaft të thjeshtuar. Salla relativisht e ulët ndriçohet nga 12 dritare të vendosura në dy radhë në muret lindor, jugor dhe perëndimor, si dhe dy dritare në murin verior anash hyrjes për në sallë. Dritaret e poshtme janë kuadratike dhe mbulohen me arkitra druri mbi të cilin ka një nike të murosur mbuluar me hark të mprehtë. Dritaret e sipërme janë mbuluar me hark. Në të dy rastet harqet janë ndërtuar prej tullash, duke patur pjesën e poshtëme hark të mprehtë dhe pjesën e sipërme hark në formë lundre.

Hajati i sotëm është i vonë dhe me sa duket ndërtuar mbi baza më të vjetra. Minarja është e ulët dhe jo elegante, por shquhet për punën e bukur të fundit të kazanit me stalaktite.

Me interes të veçantë është teknika e ndërtimit të mureve, kluasonazh me dy rreshta tullash të vendosura horizontalisht dhe dy tulla vertikale ndërmjet gurëve, teknikë e rregullt dhe e punuar pastër. Kjo mënyrë ndërtimi dëshmon për tradita ndërtimore vendase, sepse ndërkohë nuk përdorej nga arkitektura turke.

Datimi i saj mendojmë se mund të bëhet mbi bazën e të dhënave historike duke u nisur nga fakti që gjatë vitit 1492 Sulltan Bajaziti II ndodhet për disa muaj në Shqipëri[12], kështuqë justifikohet emërtimi i monumentit si dhe interesi i Portës për islamizimin e qyteteve të vendit kusht i domosdoshëm për qetësinë e garnizoneve ushtarake. Tre xhami të vjetra të këtij tipi ruhen në qytetin e Beratit. Dy prej tyre

5) Këto masa të mara na duket që e justifikuan vehten, për deri sa deri më sot nuk është vrojtuar ndonjë e çarë.

6) K. Aptullah **Basic Space and Form Concept in Early ottoman mosque architecture,** Atti del Secondo Congresso Internazionale di arte Turca, Napoli 1965, 181 S.K. Yetkin **L'architecture turque en Turquie,** Paris 1962, 5, 64, 66.

7) Gj. Frashëri, S. Dashi **Karakteristika arkitektonike të disa xhamive në vëndin tonë,** Monumente historike të vendit tonë, Tiranë, 1978, 42.

8) Evlia Çelebi **Shqipëria para 200 vjetësh,** Tiranë 1930, 102.

9) **Po aty** 156. E vitit 1479-80 ka qenë dhe xhamia në Shtëpanj të Elbasanit e djegur në luftrat ballkanike.

10) **Po aty,** 105.

11) A. Meksi, **Ndërtimet e kultit myslyman në Shqipëri.** Studime Historike, 4, 1979. (në shtyp).

12) M. de Hammer **Histoire de l'Empire ottoman,** Paris 1836, vëll. 4, 33, 34.

në gjëndje rrënoje në kala dhe njëra në qendrën e vjetër të qytetit, e emërtuar xhamia Mbret, që lidhet me emrin e Bajazitit, nga e cila ruhej vetëm minarja.

Në akropolin e kalasë ndodhet xhamia e emërtuar e kuqe, me minaren që ruhet deri në nivelin e fillimit të kazanit. Minarja ngrihet mbi një bazament tetfaqesh të ndërtuar me teknikën e kluasonazhit, edhe ky mbi një bazament me këtë teknikë. Kemi dy rreshta tullash të vendosura horizontalisht dhe një ose dy tulla të vendosura vertikalisht, me fuga të punuara dhe të ngjajshme me teknikën e kishave pranë. Si kalimi për në trupin e minares ashtu edhe ky i fundit janë ndërtuar me rreshta gurësh çmërsi dhe tullash që alternohen. Nga kazani ruhen disa radhë tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Është vështirë të përcaktosh kohën e ndërtimit të kësaj xhamie, në se i takon periudhës së Bajazitit, siç na thotë Çelebiu[13], apo një kohe më të hershme, gjë edhe kjo e mundshme. Sidoqoftë kemi të bëjmë po të nisemi nga teknika e mureve, me një ndërtim të sh. XV, që imiton mënyrën e ndërtimit të mureve të kishave pranë që i takojnë sh. XIII-XIV.

Xhamia Mbret ose e Bajazitit[14] ruante nga ndërtimi i vjetër minaren e hollë dhe të lartë me kalimin mjaft elegant nga trupi tek kazani, me gjithë që pa një studim të hollësishëm është e vështirë të përcaktohet ajo që ruhet në xhaminë ekzistuese nga ndërtimi i vjetër. Kuptohet se portiku duhet të jetë i ri së pakut në formën e sotme. Ai ndodhet në anën veriore dhe shtrihet më tepër se kjo faqe e xhamisë në drejtim të lindjes. Ai qarkohet nga tre harqe në anët më të ngushta dhe shtatë në anën veriore nga të cilat qëndrorja është e murosur dhe ka hyrjen për në portik. Në brëndësi portiku ka nga dy shtylla në të dy anët e korridorit që e lidh me portën e sallës së lutjeve.

Salla e lutjeve, formulimi i sotëm arkitektural i së cilës, duke u nisur nga dekori e struktura e tavanit duket se i takon periudhës ndërmjet fundit sh. XVIII dhe fillimit sh. XIX, është drejtkëndëshe në plan me mihrabin në fund. Me qënë se përmasat e sallës janë të mëdha, shtylla të tjera janë në brendësi për mbajtjen e strukturës së çatisë, duke përbërë një tërësi me vlerë me mafilin dhe tavanin.

Salla ndriçohet nga një numur i madh dritaresh të vendosura në mënyrë jo të rregullt në muret. Në sallë hyet dhe nga ana lindore ku me një palë shkallë hypet në mafil, si dhe nga ana perëndimore, pranë minares. Të këtij tipi janë dhe xhami të tjera që ndërtohen në qytetin e Beratit si psh ajo e Telelkave.

Ndërtim tjetër i vjetër i këtij tipi është xhamia në kalanë e Durrësit e ndërtuar në rrënojat e një bazilike mesjetare[15]. Ajo përbëhet nga salla e lutjeve, drejtkëndëshe në plan me një kolonë në mes dhe mbuluar me çati druri, që ndjek në përgjithësi linjat e mureve anësor të bazilikës; portiku i vonë dhe minarja me bazament ndërtuar me kluasonazh. Xhamia ruan në muret e saj gjurmët e shumë rindërtimeve. Ajo duhet të jetë ndërtuar rreth viteve 1501-1503, koha nga pushtimi deri tek rindërtimi i kalasë nga Turqit. Për këtë flet emri i saj Fetije (e deformuar më vonë në «e Fatihut) që do të thotë e pushtuar.

Të këtij tipi kanë qënë dhe dy xhamitë e vjetra të Krujës ajo e kalasë që thuhet të jetë ndërtuar me pushtimin dhe ajo e pazarit e ndërtuar në vitin 1533-34 nga Muret Beu[16]. Të dyja ato janë me planimetri drejtkëndëshe, me brinjë më të gjatë atë veri-jugë dhe me portikë përpara hyrjes. Në sallën e lutjeve, si gjykohet nga fotografi të vjetra, dritaret kanë qenë vendosur në dy rradhë, dhe jo në mënyrë të rregullt.

Për ndërtimet e këtij tipi të shekujve XVI-XVII një tablo interesante japin të dhënat e Çelebiut i cili viziton qytetet kryesore dhe një serë qëndrash të dorës së dytë. Prej tij mësojmë si për numurin e xhamive në këto qytete ashtu edhe përshkrime të tyre[17]. Kështu psh ai na përshkruan xhaminë e Bajazitit në Gjirokastër si një xhami mbuluar me rasa, 80 x 40 gjurmë (këmbë) me 4 shtylla në brendësi dhe tavan të punuar bukur dhe një minare të sistemit të vjetër)[18].

Duke qenë i lehtë në ndërtim ky tip pati përhapje mjaft të madhe. Ndërtime të tilla ka gati kudo si në qytete ashtu edhe në fshatra. Në mjaft prej tyre, që janë me përmasa të vogla, dallimi nga banesa popullore është i vogël. Ato kanë pamjen e një ndërtese

13) E. Çelebi, **vep. cit.** 62.

14) **po aty.**

15) A. Meksi **Dy bazilika mesjetare të panjohura,** Monumentet 13, 1977, fig. 1.

16) **Konf. II Stud. Alb...** 82.

17) E. Çelebi, vep. cit., kështu Shkodra ka 10 xhami, Elbasani mbi 40, Pogradeci 4, Gjirokastra 8, Berati rreth 30, Kavaja 4, Peqini 5, Tepelena 2, Libohova 2 etj.

18) E. Çelebi **vep. cit.** 31.

Dokument

dykatshe. Këto janë të ndërtuara përgjithësisht me gurë dhe në shumicën e rasteve kanë portikun në pjesën e përparme. Gjithashtu në çdo kala kemi xhaminë që i shërben garnizonit si dhe lagjes në se ka të tillë. Shumica e tyre në mungesë të të dhënave direkte është vështirë të datohet sepse i janë nënshtruar rindërtimeve por ka dhe që mund të datohen. Do të përmëndim ndër to xhami rënojë në kalanë e Lezhës, që duhet të jetë ndërtuar në kohën e Sulltan Sulejmanit, rreth viteve 1521-22, kohë në të cilën rindërtohet dhe kalaja siç rezulton nga mbishkrimi që dikur ndodhej në portën perëndimore.

Xhamia e Beqarëve përbën një ndërtim me vlerë arkitekturale dhe me një zgjidhje interesante në lidhjen me terenin. Ajo në pamjen e jashtme shquan ndaj lagjes dhe dyqaneve pranë për vëllimin masiv dhe minaren e ulët, arkadën e cila së bashku me murin me gurë të gdhendur luan rolin e një bazamenti për vetë xhaminë. E parë në tërësinë e zgjidhjes arkitekturale, xhamia e Beqarëve afrohet mjaft me arkitekturën popullore dhe për këtë ajo është pjesë përbërëse e ansamblit të lagjes. Jo më me pak interes është edhe hajati me arkadën e hijshme. E përfshirë në tërësinë e rrugicave të lagjes që në të dy anët kanë muret e ndërtesave apo oborreve, portiku bije një notë të veçantë mjaft me interes. Edhe brendësia është e zgjidhur mirë. Ajo në mjaft aspekte afrohet me atë të ambienteve të banimit, me sa duket për lartësinë e vogël të sallës.

DO NOT COPY

TAB I











DO NOT COPY













DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

RESTAURATION A DES FINS DE CONSOLIDATION DE LA MOSQUEE DES BEQAR A BERAT

RESUME

La Mosquée des Beqar (= célibataires) à Berat se trouve dans la partie inférieure du quartier Mangalem, le long de la rue principale de la ville, entourée des autres côtés par des petites ruelles. Comme l'indique clairement son nom, cette mosquée appartenait aux apprentis célibataires des différentes corporations de la ville. C'était là une association d'artisans célibataires qui effectuaient à la fois le service de police et de gardes de nuit du marché.

Construite sur une terrain escarpé c'est un édifice à demi-étage, la mosquée elle-même constituant le premier étage. Elle comporte deux volumes sous le même toit, dont le volume principal sur le côté sur comprend un portique à trois arcades dans sa partie inférieure et un hayat *à arcade sur le côté nord. L'étage de cet édifice comprend la salle des prières et le* hayat.

On accède à la salle des prières du côté nord à travers le hayat, *en traversant une ruelle qui se trouve au-dessous du niveau du plancher même du* hayat. *La porte de cette salle est accentuée à travers le traitement commun de la porte couverte d'un arc et de la fenêtre quadratique qui la surmonte. Leurs différents éléments sont travaillés soigneusement avec des pierres équarries. Cette salle était couverte d'un toit de bois, qui a été reconstruit en 1971; à l'époque le plafond manquait, mais on ne peut mettre en doute son existence car on pouvait voir encore des parties de la corniche crépie qui la reliait aux murs latéraux. Cette salle était divisée en deux parties par une arcade reposant sur des colonnes de bois à section carrée, en séparant comme d'habitude la partie destinée au mafil et où se trouve aussi le passage au minaret. Sur la face septentrionale se trouvent le mihrab et quatre fenêtres en deux rangées. Sur les faces orientale et occidentale aussi les fenêtres sont à deux rangées, mais à trois fenêtres dans chaque rangée. En ce qui concerne l'intérieur de la salle des prières, un rôle non insignifiant y joue la peinture murale disposée en deux bandes horizontales dans la partie supérieure des murs. La peinture décorative comprend des ornements végétaux, reproduits sur des panneaux qui sont séparés l'un de l'autre par des bordures colorées. La bande supérieure, qui est aussi la plus large, arrive jusqu'au point où commencent les fenêtres supérieures, alors que la bande inférieure dépasse légèrement les fenêtres inférieures. Par la répétition de motifs analogues, la peinture remplit un rôle non insignifiant dans l'uniformité de l'intérieur et facilite la perception de celui-ci.*

En direction nord, le hayat *s'étend au-delà du mur septentrional de la salle des prières, en accentuant la tendance à agrandir les portiques, que l'on relève à Berat et dans le portique de la mosquée Mbret, afin que le* hayat *est cerné d'arcades pleines sur les côtés nord, est et ouest, ainsi que par des arcs particuliers du côté sud, là où le volume de la salle se relie aux arcades.*

Quant à la formulation extérieure de cette mosquée, c'est un résultat direct de sa construction sur un terrain escarpé. On relève une inclination analogue dans la mosquée du Marché à Gjirokastra (1757). Mais dans ce dernier cas, à la différence de la mosquée de Berat, il y a du côté de la rue une entrée à l'étage de la salle, et cela à travers un escalier double. Cette solution à proximité du marché, qui s'étendait dans la partie inférieure du quartier, est assez réussie et témoigne de l'aptitude des constructeurs anonymes à tirer profit de la nature du terrain, en utilisant entièrement la partie inférieure de l'édifice. Cela a apporté une hauteur non insignifiante à l'étage au rez-de-chaussée du côté sud, que l'on ne perçoit pas en raison de la solution même architecturale de l'édifice.

La partie de l'édifice au rez-de-chaussée a la forme d'un portique en trois pièces du côté sud, mais elle est fermée et suit la nature du terrain des autres côtés. La face méridionale et les autres parties surmontant les petits arcs latéraux du portique sont construits de pierres équarries avec des joints fins. Les autres murs sont de pierres non travaillées. La partie en pierres équarries est séparée de la partie supérieure de la salle des prières par une corniche de pierres.

Les parements des murs de la salle des prières sont crépis. En haut, il y a une bande de peinture qui s'étend de l'auvent jusqu'au dessous des fenêtres. Cette bande est séparée par des panneaux qui sont agrémentés de motifs floraux et de paysages avec des vues de la ville. Comme d'habitude, dans les édifices de culte islamique et les autres habitations de l'époque, la peinture murale couvre la partie se trouvant au-dessous de

DO NOT COPY

l'auvent afin de la protéger dans la mesure du possible de l'effet négatif des rayons du soleil et des précipitations atmosphériques.

Par suite de l'éboulement du terrain dans la partie centrale du portique en trois pièces par devant le monument, les deux colonnes du milieu s'étaient affaissées. C'est ainsi que s'étaient affaissés l'arc central avec une partie des arcs latéraux qui s'appuyaient sur ces deux colonnes, ainsi que les murs qui les surmontaient. On pouvait s'apercevoir du tassement du mur par les fissures obliques qui commençaient juste au point où les arcs latéraux se détachent des parties qui ne s'étaient pas affaissées. Ces fissures constituaient un triangle rejoignant le centre des deux fenêtres de la rangée inférieure de mur méridional. D'autres fissures s'étaient produites au point de conjonction des cintres des galeries avec ce mur. Dans le même temps, le mur surmontant l'arcade avait fait ventre principalement dans la zone au-dessus des fenêtres. La présence de fissures dans le voûtes ainsi que la déformation du mur de sa position verticale témoignent du fait que nous avons affaire, outre à l'éboulement du terrain, à son glissement oblique.

A peine constaté la présence des premiers dégâts, pour assurer l'édifice une série d'étais ont été mis en place puis ils ont été remplacés graduellement. C'est à cette fin que fut élaboré un projet de restauration, qui, une fois approuvée, fut mis en oeuvre. L'intervention de consolidation visait à éliminer les dégâts enregistrés par notre monument, à recréer sa structure originale et à éviter d'autres dégâts. C'est pourquoi il a été jugé opportun de pourvoir au renforcerment des anciennes fondations des deux colonnes centrales du portique, en créant des fondation sûres, de faire retourner à leur position antérieure les parties affaissées et de prendre les mesures requises pour éviter d'autres glissements et d'autres séparations des pièces nouvelles d'avec les anciennes, soit l'apparition de nouvelles fissures à leur point de contact, ce qui aurait abaisser la qualité de l'aspect de notre monument.

L'intervention fut entamée par le renforcement du monument de manière à ce qu'il fut en état d'affronter les poussées qui résulteraient après avoir enlevé certains de ses éléments. C'est à cette fin que les structures de renforçage furent appuyées aux édifices avoisinants sur un même plan que le mur méridional, et cela pour contenir les poussées de l'arcade. Pour soutenir le poids des éléments, des coffres de bois arqués, selon l'ancienne configuration de l'arc, furent mis en place dans les deux arcs latéraux de l'arcade et dans les quatre arcs qui le rattachent aux galeries. Le fait de maintenir en place le mur méridional et de pouvoir le reconstruire pendant l'élimination de ses parties déformées, constituait un autre problème difficile à résoudre. A cette fin il fut procédé à son renforçage en posant obliquement de l'extérieur des poutres, dont les extrémités s'appuyaient à un coussin de bois peu long placé au-dessous du mur qui allait être renforcé. La coupure fut effectuée dans la zone entre les deux fenêtres, là où le mur qui les surmonte ne présentait pas des fissures évidentes et était peu déformé. On commença par ouvrir des trous de part en part pour y introduire les poutres puis celles-ci furent reliées aux colonnes, en créant de la sorte tout un système d'étails. L'appui des colonnes au sol fut réalisé à travers des planches épaisses fixées des deux côtés de l'arcade. Après avoir mis en place ce système de soutènement, on procéda à la coupure complète du mur entre les deux colonnes latérales. Ces opérations très difficiles furent effectuées avec le plus grand soin et en contrôlant constamment le monument.

Entre-temps, toutes les pierres équarries du mur et les tambours des colonnes qui se trouvaient dans la partie qui allait être détruite furent numérotés.

Le processus de reconstruction du mur que nous avions abattu, fut-ce en placant les pierres de la face extérieure à leur place suivant leur numérotage, ne constitue pas à notre avis une intervention d'anastilose. La reconstruction d'une structure du monument avec les mêmes matériaux ne diffère point de la recréation par anastilose d'un monument antique avec des grandes pierres qui ne sont pas liées avec du mortier. Cette reconstruction porte à la création totale d'un élément nouveau, indispensable tant du point de vue structural que sous l'aspect architectural de son existence et de sa fonction en tant qu'ensemble de l'édifice, donc nous avons affaire à une intervention de complétement. Les pierres de la face extérieure furent remises à leur place, afin d'éviter la nécessité de nouvelles pierres pour clore chacun des arcs ou des rangées qui allaient être reconstruits, ou auprès des arcs, si les anciennes pierres n'allaient pas être mises à leur place, et cela pour éviter un effet esthétique peu agréable.

Après la coupure du mur fut entamée la destruction de sa partie inférieure, de haut en bas, tout en conservant l'ordre les pierres numérotées. Une fois arrivé au niveau du sol, on découvrit les fondations des différentes colonnes. Ces fondations et le soubassement laissaient beaucoup à désirer, aussi décida-t-on de construire des fondations nouvelles à une plus grande profondeur, en béton armé et constituant possiblement un bloc unique, afin de diminuer au maximum la pression des structures sur le soubassement et, partant, d'éviter l'apparition de nouveaux affaissements. Une fois les colonnes construites, nous avons commencé la reconstruction des arcs et des murs intermédiaires en fixant préliminairement des tirants de fer. Dans le même temps, outre la construction des murs, on procéda à la liaison des voûtes des galeries de l'étage ou rez-de-chaussée. En se qui concerne les arcs, le mur de pierres équarries et la corniche qui le surmonte, les pierres furent remises en place selon leur position antérieure.

En vue d'assurer la cohésion structurale du mur nouveau avec le mur ancien et d'éviter l'apparition d'une fissure éventuelle à leur point de contact, une bande en béton armé a été introduite en profondeur dans le mur nouveau et dans les autres éléments avoisinants.

Notre intervention se termina par l'opération consistant à

enlever les éléments de renforçage qui avaient été mis en place. La reconstruction du toit et du nouveau plafond fut renvoyée à une seconde phase, afin de pouvoir assurer le prolongement des auvents, sans quoi les peintures qui se trouvaient au-dessous de ceux-ci risquaient de s'abimer.

Sur le plan de la typologie, la mosquée des Beqar rentre dans le grand groupe de mosquées couvertes d'un toit de bois et de tuiles, qui ont connu une grande diffusion chez nous et dont la construction fut entamée dès la première période de l'occupation turque. Ce fait s'explique par la facilité de construction de ce type d'édifice.

La mosquée des Beqar est un édifice de valeur architecturale elle se caractérise par une solution intéressante par rapport au terrain. Son extérieur se distingue dans le quartier où il se situe des autres édifices et des boutiques avoisinantes par le volume massif de sa construction et son minaret peu élevé, par son arcade qui avec le mur de pierres équarries remplit la fonction d'un soubassement pour la mosquée même. Considérant la solution architecturale dans son ensemble, la mosquée des Beqar se rapproche suffisamment de l'architecture populaire et s'est pourquoi elle est partie intégrante de l'ensemble du quartier. Non moins intéressant est son hayat pourvu d'une arcade attrayante. Encadrée dans l'ensemble des ruelles du quartier, où des deux côtés se dressent les murs des habitations ou des cours, le portique de cette mosquée y apporte une note particulière d'originalité. L'intérieur de ce monument aussi se caractérise par une solution intéressante. Sous plusieurs aspects, il a des similitudes avec les pièces des habitation, apparemment quant à la hauteur peu élevée de la salle des prières.

DO NOT COPY

Emin RIZA

ARKITEKTURA DHE RESTAURIMI I KULLAVE TË DERVISH ALIUT NË FSHATIN DUKAT (VLORË)*)

DO NOT COPY

Mbi një truall dominues, në qendër të lagjes së sipërme të fshatit Dukat[1] (rrethi i Vlorës) ngrihet një ansambël i madh ndërtimor, i cili shkëputet qartazi nga ndërtimet përreth, e madje përbën një shembull të vetëm, nga sa ruhen, në ndërtimet e Labërisë. Ky ansambël emërtohet nga banorët: «Kullat e Dervish Aliut». Është fjala për një figurë të njohur, njërin prej udhëheqësve në kryengritjen e madhe të fshatarësisë, gjatë viteve 1847, kundër pushtuesve turq[2].

Ansambli ndërtimor, që lidhet me emërin e Dervish Aliut, siç përmendëm përbën një rast të rrallë në arkitekturën e ndërtimeve fshatare, ku gjejmë të bashkuara organikisht njësi të veçanta ndërtimore me funksione të ndryshme, duke krijuar një kompleks pak a shumë të madh. Ndërtimi në fjalë nuk është rezultat i një faze të vetme ndërtimore, por ai është formuar shkallë-shkallë, duke shtuar ndërtime të reja, deri sa arriti në kompozimin që ruhet sot e kësaj dite. Vënja në mbrojtje shtetërore e këtij ansambli, për vlerën e dyfishtë arkitektonike dhe historike, krijoi kushtet për studimin e këtij monumenti dhe restaurimin e tij.

Në prag të vënjes në mbrojtje shtetërore, ky ansambël ishte i braktisur (fig. 1, 2) dhe në gjendje të keqe teknike. Ai në plan krijon një kontur të mbyllur, pakë a shumë në formën e një trekëndëshi (Tab. I), në tre kulmet e të cilit ngrihen tre ndërtimet kryesore, të ndërlidhura sipas dy brinjëve me ndërtime të tjera, ndërsa brinjën e tretë e formon muri rrethues.

Siç përmendëm kompleksi është rezultat i disa fazave të ndërtimit; por përpara se të japim kronologjinë e tyre po përshkruajmë ndërtimet formuese të ansamblit në gjendjen që u gjet monumenti në prag të venjes në mbrojtje shtetërore[3].

Banesa 1, është në gjendje rrënojë. Nga vrojtimi i gjurmëve që ruhen ende sot, kuptohet se kemi të bëjmë me një ndërtim tipik me gjysmëkat perpendikular, me shumë gjasë me një ambient të vetëm banimi. Gjurmët e hyrjeve nuk janë të qarta. Një trakt murature, përbri faqes nga rruga, të shtyn të mendosh se i përket sheshpushimit të shkallëve që të çonin në kat. Gjurmët e rrasave, në formë konsoli, në faqen e kullës 2, (fig. 3), tregojnë se banesa mbulohej me çati dyujshe, e cila më vonë është rindërtuar duke u ngritur niveli i saj.

*) Rilevimi është i autorit, L. Lazimit, B. Penxhës e F. Zarshatit, vizatimet të B. Penxhës, fotot të autorit. Projekti i restaurimit është hartuar nga autori, ndërsa punimet janë zbatuar nga Dega e Monumenteve të Kulturës Berat.

1) Fshati Dukat, është një vendbanim relativisht i lashtë, ai përmendet në regjistrin fiskal të vitit 1431-32, me 24 shtëpi me kryefamiljarë. Në shekujt e mëvonshëm ai është rritur vazhdimisht. Ashtu si në pjesën më të madhe të krahinës së Labërisë, në ekonominë e fshatit, blegtoria në të kaluarën zinte vendin kryesor. Sot një pjesë e mirë e banorëve është shpërngulur në një qendër të re banimi, Dukatin e ri, që shtrihet mbi një truall të rrafshët. Dukati i vjetër ruan një numër relativisht të vogël banesash të lashta. Ndërmjet tyre më e përhapur është banesa me gjysmëkat perpendikulare me dy ambiente banimi.

2) Mexhit Kokalari, **«Besëlidhja shqiptare» dhe kryengritja e madhe fshatare e vitit 1847»** në «Studime historike» 2/1974.

3) Ndërtimet formuese të ansamblit do ti emërtojmë, sipas renditjes kronologjike (numëri) dhe funksionit në: Banesa 1, Kulla 2, Kulla 2', Banesa 3, ndërtimi 4, ndërtimi 5.

DO NOT COPY



Fig. 1

Kulla 2, (fig. 3, 4, Tab. I, II) ruante në gjendje të mirë muraturën dhe elementet që përfshihen brenda saj, ndërsa nuk ruante dyshemenë e katit të dytë dhe elementet prej druri. Kulla 2, paraqet një zgjidhje disi të veçantë në gjininë e vet për arsye se volumi i saj ngrihet mbi një rrugë të fshatit. Ndërtimi nuk e ndërpret rrugën, duke qenë krejt volumi i katit përdhe një lloj tuneli, i cili shkon përgjatë krejt volumit, mbuluar me qemer cilindrik, Zgjidhje të tilla, të kushtëzuara nga ngushtësia e truallit ndeshen dhe në Gjirokastër, në lagjen brenda mureve rrethues të kalasë së Himarës e veçanërisht në fshatin Vuno (Vlorë)[4]. Kulla ngrihet si një volum i theksuar prizmatik, mbi qemerin e rrugës, në dy kate tjerë. Planimetria i afrohet mjaft katrorit (540 x 530 cm). Volumi thyhet vetëm nga një numër i vogël dritaresh, si dhe frengjitë e shumta, veçanërisht në katin e dytë. Hyrja e vetme për në kullë (fig. 3) është ndërtuar në faqen e prapme të saj. Siç duket ngjitja në të bëhej me shkallë druri, nga volumi i banesës 1. Gjurmë të qarta tregonin se pas hyrjes një ndarje e lehtë me konstruksion druri, krijonte një parahyrje. Në të djathtë të saj zhvillohej ambienti sanitar pjesërisht jashtë volumit të murit, në formë apsidoidale. Në krahun e kundërt; ishin ndërtuar shkallët e drurit për në katin e dytë, të cilat ishin dyrampshe me sheshpushim mbi hapësirën e derës. Në ballin kundrejt hyrjes ishte vendi i zjarrit me kamaren karakteristike pranë (fig. 5) që mbulohet me qemer. Anash dy dritare, ndërsa një e tretë, më e vogël shihte nga jugu. Ky ambient është i paisur me një numër frengjish për pushkë, prej të cilave për tu përmendur është frengjia treshe, që kontrollon ngjitjen e rrugës për në kalimin në formë qemeri. Niveli i shtresës, më vonë është rritur 40 cm. Kati i dytë formohej nga



Fig. 2

4) E. Riza «**Qyteti muze i Gjirokastrës**» monografi, ruhet në arkivin e I.M.K. E. Riza **Banesa popullore e Himarës,** ruhet në arkivin e I.M.K.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

një volum i vetëm, i cili në pjesën fundore ka shenja të një podiumi, për të lejuar shfrytëzimin më të volitshëm të frengjive, zgjidhje që të kujton banesën me kullë në fshatin rrënojë të Kamenicës[5]. Në faqen ballore, në të njëjtin aks me dritaret e katit të ndërmjemë, janë ndërtuar dy dritare, ndërsa në qendër hapësira e vendit të zjarrit me formën e njohur trekëndëshe në krye, e cila është mbyllur më vonë me



Fig. 5



Fig. 6

5) A. Meksi, E. Riza, «**Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës**», Monumentet 7-8/1974.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

tulla (fig. 6), duke krijuar një tambur të thjeshtë. Elementë të rinj në këtë ambient, janë tre kamare, dhe një sqoll në faqen fundore. Numëri i frengjive rritet në këtë ambient, duke arritur në 18 të tilla. Të dhënat gojore flasin për qenien e një tavani druri me rozetë në qendër.

Kulla 2′ është e ndërtuar (Tab. III) përbri skajit tjetër të banesës 1. Ajo është gjithashtu trekatëshe (fig. 7) por hedhja e saj në lartësi është më e theksuar për shkak të përmasave më të vogla të saj (348 x 323 cm). Kati përdhe, me një hyrje tjetër të ngushtë, mbulohet me qemer cilindrik. Kati i parë ka hyrje (fig. 8) nga faqja përngjitur ndërtimit 4. Ambienti është thuajse i errët, ai merr një fije dritë vetëm nga dy dritare në formë frengjie. Dy sqollet, janë ndërtuar njëri në çdo faqe që sheh nga rruga. Shkallë druri të çonin në katin e sipërm, ku të bie në sy një kamare zjarri, një sqoll, që del në formë konsoli, si dhe frengjitë e shumta, gjithësej 11 të tilla, të cilat gjithashtu si ato të ambientit të sipërm të kullës 2, duket se shërbeheshin nga një podium. Kjo kullë ruhej e mbuluar me rrasa guri, ndërsa dyshemeja i është shkatërruar ashtu si dhe një pjesë e qoshes juglindore.

Banesa 3 (Tab. I) formohet nga dy ambiente, katoi dhe ambienti i banimit, me të njëjtën shtrirje dhe me hyrje të veçantë. Në të sipërmin të çonin shkallë guri. Ambienti i banuar ka në faqen ballore oxhakun (fig. 9), anash, të cilit janë ndërtuar dy dritare të zmadhuara më vonë. Ambienti sanitar del në pjesën fundore, jashtë volumit të banesës. Banesa 3, ishte pa çati e dysheme, një pjesë e muraturës së ambientit sanitar ishte e rrënuar, ndërsa dyert dhe dritaret mungonin.

Ndërtimi 4 (Tab. I) ishte thuajse në të njejtën gjendje me ndërtimin 3. Ai formohet nga dy volume, ambientit përdhe dhe katit të sipërm, ku të çonin shkallë pjesërisht guri e druri. Ambienti i sipërm, fillimisht kishte oxhakun në faqen jugore, më vonë me ndërtimin pranë saj të dy volumeve të hapura, oxhaku origjinal dhe kamaret anash u murosën dhe u ndërtua një i ri (fig. 10) në faqen ballore. Në

faqen nga rruga, del një volum i vogël, brenda të cilit është ndërtuar furra, që shërbehet nga ky ambient.

Ndërtimi 5 (Tab. I) formohet nga volume të hapura, hajati poshtë dhe mbi të çardaku. I pari, ka në faqen ballore një harkadë me tre harqe, ndërsa i dyti një harkadë më të lehtë, prej pesë harqesh.

Të gjitha ndërtimet e mësipërme janë vendosur njëra pranë tjetrës, duke formuar një varg të thyer në plan, i cili mbyllet plotësisht me murin rrethues, që bashkon kullën 2 me banesën 3. Krijohet kështu një oborr relativisht i gjerë, hyrja për në të cilin është pranë hyrjes jugore të kalimit nën kullë. Një oborr i vogël, fill pas kësaj hyrje, shkëput kullën 2 dhe banesën 1 nga oborri kryesor, i cili i shërben ndërtimeve të tjera të ansamblit.

Siç përmendëm, kullat e Dervish Aliut në gjendjen që ruhen sot nuk janë rezultat i një faze të vetme ndërtimi, por i shumë fazave. E vetmja mbështetje për të arritur në përfundime mbi raportin kronologjik ndërmjet fazave të ndërtimit është vrojtimi i objektit, sepse të dhënat gojore, e aq më pak burimet e shkruara, nuk japin gjë, apo nuk e prekin këtë çështje. Pikërisht duke u bazuar mbi këtë vrojtim dhe faktin e njohur se ndërtimet e mëpasme lenë shpesh gjurmë të qarta për tu cilësuar të tilla, jemi përpjekur të ndërtojmë një kuadër të kronologjisë së fazave të ndërtimit të këtij ansambli. Është e kuptueshme se disa kalime mbeten në fushën e hipotezës, për mungesë të dhënash të sigurta, të cilat vështirë se mund të sqarohen. Afërsia në kohë e fazave të ndryshme të ndërtimit, si dhe kavat e ndryshme të rërës në terren shkëmbor, e bëjnë teknikën e ndërtimit një faktor mjaft të dyshimtë për të vendosur ndërtimet në kohë. Sidoqoftë me gjithë disa pika të dyshimta, që do ti theksojmë më poshtë, në këtë ansambël mund të dallohen pesë faza ndërtimi[6].

Zanafilla e ansamblit është padyshim banesa 1, e cila siç e përshkruam ruhet në gjendje rrënojë. Ajo i përket tipit të njohur në mbarë Labërinë me gjysmëkat perpendikular. Fazës së dytë i përket ndërtimi i dy kullave (Kulla 2, dhe kulla 2'). Që kulla 2 është më e vonë se banesa 1, shihet qartë nga takimi i këtyre dy ndërtimeve, pranë (fig. 11) hyrjes për në oborr. Duke qënë se kulla 2, i është mbështetur banesës 1, në sipërfaqen e kontaktit të të dy muraturave, pjesa që i përket kullës 2, është e pa punuar. Gjendja e sotme tregon dhe një fakt tjetër, duke qenë kulla 2, më brenda muraturës së faqes jugore të banesës 1, kuptohet se ndërtimi i kullës është



Fig. 9



Fig. 10

6) Lidhur me përcaktimin e fazave, një ndihmë të madhe na ka dhënë kolegu Faruk Zarshati, të cilin e falenderojmë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

bërë duke marrë një pjesë të vogël nga volumi i banesës. Kjo vjen e kuptueshme për shkak se rruga përbri banesës 1, nuk duhej prekur, kështuqë ngritja e kullës kërkonte domosdo marrjen e një pjese të sipërfaqes së banesës. Kujtesa popullore, tregon se Dervish Aliu, kërkoi leje nga fshati për ndërtimin e kullës mbi rrugë, leja e dhënë u kushtëzua me kërkesën për mos dhunimin e saj, e cila u arrit me qemerin e katit përdhe mbi të cilin ngrihet kulla 2. Mendimi se kulla 2′, është e njëkohëshme me kullën 2, nuk gjen argumentim të plotë. Në favor të këtij mendimi është mbështetja e murit jugor të kullës 2′′ mbi banesën 1, dhe nevoja për një ndërtim të tillë lidhur me personalitetin e Dervish Aliut, i angazhuar me kohë në përpjekjet antiturke. Kulla 2, duket qartë se bartte në radhë të parë funksionet e ndërtimit për miqt, por duke marrë parasysh rrolin udhëheqës të Dervish Aliut në përpjekjet kundër pushtuesve, kjo seli duhej të fortifikohej, prandaj u zgjodh në këtë rast tipi i kullës, ose i banesës së fortifikuar. Kulla 2′, për vetë pozicionin, përmasat dhe trajtimin duket se ishte një kullë roje, dhe pikë qëndrese, e cila së bashku me kullën 2, e bënte tepër të fortë kompleksin prej tre ndërtimesh. Lidhur me datimin e këtyre ndërtimeve mund të mendohet se kullat 2, 2′, i përkasin viteve rreth çerekut të parë të shek. XIX, ndërsa banesa 1, fundit të shek. XVIII.

Formulimi arkitektonik i ndërtimeve 4, 5, si dhe raporti i banesës 3 me ndërtimet e tjera të shtyjnë të mendosh se kjo e fundit përbën fazën e tretë të ndërtimit. Ngritja e kësaj banese, siç duket është dëktuar nga ngushtimi i banesës 1, prej së cilës madje dhe kalohej në kullën 2. Banesa 3, është një ndërtim me kat me katoin poshtë dhe ambientin e banimit sipër, me ambientin sanitar anash, jashtë konturit të planimetrisë. Hyrja në kat arrihej me shkallë të jashtme guri. Ndërtimi i kësaj banese presupozon ndërtimin e dy mureve rrethues, që lidhin respektivisht këtë me kullat 2, 2′. Pra që në fazën e tretë duhet menduar se u arrit të formohej ansambli me shtrirjen e tij të plotë. Me kalimin e kohës, pas vdekjes së Dervish Aliut[7] karshi ansamblit u ulën kërkesat mbrojtëse, së dyti shtimi numerik i familjes kërkonte ambiente të rinj, kështu që ngrihet ndërtimi 4, përbri kullës 2′, duke dëmtuar funksionet për të cilat ishte ngritur ajo. Ndërtimi 2, është dykatësh, duke patur katoin poshtë dhe një ambient banimi sipër, fillimisht me oxhak në faqen jugore. Me ngritjen e ndërtimit 5, ansambli krijon një lidhje të plotë funksionale ndërmjet kullës 2, ndërtimeve 4, 5 dhe banesës 3. Mbetja disi jashtë kësaj ndërlidhjeje e kullës 2, shpjegohet me funsionimin e saj si shtëpi miqsh. Harkada e çardakut të ndërtimit 5 me këtë formulim arkitektonik, takohet mjaft rrallë në banesat e Labërisë. Një rast i tillë ndeshet në fshatin e rrënuar të Tragjasit. Më vonë ansambli pëson ndryshime të tjera, si zmadhimi i dritareve në ambientin e katit të banesës 3, mbyllja e hapësirës së harkadave të çardakut (fig. 12), ndërtimi i shkallëve të reja për banesën 3 etj.

7) M. Kokolari, Art. Cit.



Fig. 13



Fig. 14

Ansambli ndërtimor i kullave të Dervish Aliut, përsa i përket teknikës së ndërtimit ruan në përgjithësi tiparet e ndërtimeve të krahinës së Labërisë.

Muratura e të gjitha ndërtimeve është punuar me gurë kave, të lidhur me llaç gëlqereje. Kullat 2, 2′, nuk kanë përforcime me breza druri, ndërsa ndërtimet e tjera qarkohen me breza druri, që dalin rrafsh vetëm me faqen e brendëshme të muraturës. Guri latohet vetëm në qoshet dhe në konturet e dyerve dhe dritareve. Çatitë janë me konstruksion druri, mbuluar me rrasa guri, kurse strehët janë relativisht të shkurtëra. Dyshemetë, në përgjithësi janë prej druri, ndërsa vetëm ambientet e katit të parë të të dy kullave 2, 2′ janë shtruar me harasan. Nga brenda, të gjithë ambientet e banuara janë të suvatuara. Kulla 2, është e suvatuar me dy shtresa, e para me llaç balte, dhe e dyta me patinaturë gëlqereje (fig. 6), ndërsa të gjitha ndërtimet e tjera, janë suvatuar me dy duar llaç gëlqereje. Nga jashtë kulla 2, ruan gjurmë suvatimi (fig. 4) me llaç gëlqereje, ndërsa banesa 3 (fig. 13) me harasan. Dyert, në përgjithësi mbulohen nga jashtë me hark guri, ndërsa nga brenda me arkitra druri. Ato përgjithësisht sigurohen me katarah. Me përjashtim të portës së jashtme, të tjerat kanë qenë njëflegërshe, të punuara thjeshtë. Dritaret janë të llojeve të ndryshme, në formë frëngjije në katojt, ndërsa me paturë në ambientet e banuara, mbuluar me arkitra guri në faqen e jashtme e druri brenda. Kulla 2, dhe ndërtimi 4 kanë mbi arkitrarët prej guri një hark shkarkues, brenda këtyre të fundit vendoset një pllakë guri, diçka më thellë për efektet dekorative. Dritaret mbylleshin me kapakë druri.

Për ndezjen e zjarrit janë përdorur dy lloj instalimesh, vend zjarri i hapur dhe hulli pa tambur. Me vend zjarri me kamaren karakteristike me qemer, është paisur ambienti i katit të parë të kullës 2, (fig. 5) dhe ambienti i katit të dytë të kulltës 2′. Përveç këtij instalimi, për ndezjen e zjarrit janë ndërtuar së bashku me to hulli pa tambur. Forma më e vjetër, është ajo me mbyllje në formë të mprehtë në majë (ambienti i katit të dytë (fig. 6) i kullës 2), ndërsa në ndërtimin 4, mbyllja në pjesën e sipërme (fig. 10) realizohet me hark. Më vonë balli i hullisë në kullën 2, është mbyllur duke marrë kështu formën e njohur të tambureve me faqe të rrafshta. Dhe balli i hullisë së banesës 3 (fig. 14) gjithashtu është mbyllur më vonë.

Shkallët ndërtohen të jashtme prej guri (banesa 3) të brendshme prej druri (kulla 2, 2′), ose pjesërisht guri e pjesërisht druri (ndërtimi 4). Për tu shënuar, është përdorimi i gjërë në brendësi të ambienteve i kamareve dhe dollapëve të mureve, ndërsa më rrallë janë ndërtuar dhe sqolle.

Një element me rëndësi dhe mjaft i përhapur në këtë ansambël janë frëngjitë e shumta në kullat 2 e 2′. Ato në plan, përgjithësisht kanë formë pyke, me majën nga faqja e jashtme e muraturës, ose në formë shiriti, me aks të pjerrur ndaj shtrirjes së murit. Pjesa e poshtme e frëngjisë, zakonisht është e rrafshët, por ka dhe frengji me bazë të pjerrur nga faqja e jashtme e muraturës, për qitje nga lartë poshtë. Shumica e frëngjive janë njëshe, ndërsa në një rast (kulla 2) (fig. 15) ndeshim dhe frengji treshe.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 15

*
* *

Venja në mbrojtje shtetërore e këtij monumenti, shtronte detyra të menjëherëshme restauruese, sepse gjendja e tij paraqitej mjaft e dëmtuar. Pikërisht për këto arsye Instituti i Monumenteve të Kulturës mori menjëherë masat për studimin e këtij ansambli, hartimin e projektit të restaurimit dhe më pas për kryerjen e këtyre punimeve.

Studimi i këtij monumenti dhe arritja në një kuadër deri diku të plotë e të bazuar të zhvillimit në kohë të ndërtimit bënë të mundur marrjen e vendimit restaurues, bazuar mbi kriteret e mëposhtëme:

1. Të ruhen fazat e ndryshme të ndërtimit, duke pasur parasysh se të gjitha këto faza, megjithë vecantitë dhe tiparet e ndryshme funksionale dhe arkitektonike, kanë kontribuar për formimin e këtij ansambli, i cili në gjëndjen përfundimtare paraqet vlera të rëndësishme.



Fig. 16

2. Të hiqen shtesat, që duke synuar qëllime thjeshtë utilitare, nuk kanë marrë parasysh dëmet që i kanë shkaktuar ambienteve ose elementeve të ndryshëm arkitektonikë. Kur ndryshimet nuk kanë qenë shtesa mbi strukturat origjinale, por janë arritur pas prishjes përfundimtare të elementeve të vjetër, për mungesë të dhënash është ruajtur gjendja e re.

3. Të zbatohet rindërtimi i elementeve mungues, duke ruajtur në maksimumin e mundshëm pjesët dhe elementet origjinale. Elementet e rindërtuar, të ndjekin format origjinale sipas gjurmëve ekzistuese, në rast të kundërt të zbatohet kriteri i analogjisë. Ky kriter të mos ndiqet për banesën 1, për arsye se gjendja e saj është mjaft e dëmtuar dhe gjurmët janë të tilla që lenë të pazgjidhura shumë çështje mbi formën e saj fillestare. Për këtë ndërtim u zbatuan punime konsoliduese të muraturës, si gjurmë të mjaftueshme për të hedhur dritë të plotë mbi historikun ndërtimor të ansamblit.

4. Për arsye se ky ansambël parashikohet të kthehet në muze etnografik u pranua, në ndonjë rast ndërtimi i shkallëve që lidhen me funksionin e ri të ansamblit, gjithë duke qenë këto të fundit njësi të shkëputura konstruktivisht nga ndërtimi origjinal.

Mbi bazën e këtyre kritereve u hartua projekti i restaurimit i cili u zbatua, gjatë viteve 1977-78, nga Dega e Monumenteve të Kulturës së Beratit. Sipas projektit të restaurimit u kryen punime në të gjitha ndërtimet e ansamblit.

Në banesën 1 për arsyet e përmendura u kryen vetëm punime pastrimi dhe konsolidimi të muraturës. Në kullën 2, u ndërtua çatia, shtresat, u plotësua suvatimi i rrëzuar dhe u ribënë dyert e dritaret si dhe tavani i odës së katit të sipërm. Meqë banesa 1, nuk u rindërtua u detyruam të ndërtojmë një palë shkallë për të shërbyer kalimin për në katin e parë. Në kulln 2', u kryen thuajse të njëjtat punime si në kullën 2. Në këtë ndërtim, u rindërtua dhe pjesa e dëmtuar e qoshes juglindore. Në banesën 3, u rindërtua muratura e rrëzuar e ambientit sanitar, si dhe të gjitha punimet e dyshemeve, suvatimeve, dyerve, dritareve dhe tavanit. Në volumin e shkallëve të jashtme prej guri, u hoq një soletë beton-arme e (fig. 16) e shtuar më vonë. Në ndërtimin 4, përveç punimeve të njëjta me ato të njësive të tjera, u bë rindërtimi i një pjese të muraturës në faqet lindore dhe perëndimore. Në ndërtimin 5, përveç konstruksionit të çatisë, dyshemeve, suvatimeve dhe tavanit, u kryen punime çlirimi, duke hequr

mbushjet e mëvonshme të harkadave të hajatit dhe çardakut. Për arsye të funksionit si muze, u ndërtuan një palë shkallë, që ndërlidhin hajatin me çardakun. Punime rindërtimi u kryen dhe në murin rrethues perëndimor. Krahas tyre, oborri u çlirua nga disa shtesa të vona, që cënonin unitetin kompozicional të veprës. Me kryerjen e këtyre punimeve restauruese, ky ansambël shpëtoi nga degradimi i mëtejshëm, duke i shtuar pasurisë kulturore në fushën e ndërtimeve popullore një shembull me vlera të rëndësishme.

Ansambli i kullave të Dervish Aliut, megjithëse i ndërtuar gjatë një periudhe relativisht të gjatë, është një ndërtim i goditur dhe homogjen. Mjeshtrat ndërtues, kanë respektuar ndërtimet pararendëse, duke ruajtur me mjeshtëri unitetin dhe njësinë e veprës, provë kjo e kulturës ndërtimore të tyre. Vepra shquan për lidhjen e përsosur me truallin. Diznivelet janë shfrytëzuar mjaft mirë për vendosjen e njësive të ndryshme ndërtimore, duke i dhënë kompozimit një zhdërvjelltësi e dinamizëm të spikatur. Ansamblin e sundojnë tre ndërtimet kryesore, ndër të cilat shquan kulla kryesore, si për vendin e saj në kompozim, ashtu dhe për hedhjen e saj në lartësi. Volumet e mbyllura, që deri diku thyhen vetëm nga ndërtimi i hapur me hajat e çardak, janë trajtuar me elemente të kursyer arkitektonikë duke mbisunduar masa e muraturës prej guri, që e kompozuar me volume të thjeshta, i jep ansamblit një pamje hijerëndë. Muri relativisht i lartë, nga perëndimi theksonte tepër karakterin e spikatur mbrojtës të ansamblit, i cili është tipari thelbësor i këtij ndërtimi. Kompozimi në formën e një unaze të mbyllur, me tre ndërtimet e dalluara, në tre këndet e konturit dy prej të cilave kulla të mirëfillta, shpreh qartë përkujdesjen e theksuar për mbrojtje, si në mbarë kompozimin e ansamblit, ashtu dhe në atë të ndërtimeve formuese të tij.

Ansambli ndërtimor që shqyrtojmë, tipologjikisht paraqet interes të veçantë në dy drejtime: së pari si një kompleks banimi i fortifikuar dhe së dyti për formulimin dhe funksionimin e dy kullave veriore. Shembulli në shqyrtim nga sa ruhen, paraqet një zgjidhje unikale të një ansambli banimi të fortifikuar në krahinën e Labërisë. Ndërsa ansamble të arritur me kohë pas shtesash të njëpasnjëshme, duke formuar konture të mbyllura pa tipare mbrojtëse, ndeshen mjaft rrallë në këtë krahinë[8]. Siç duket shkaqet shtytëse për krijimin e ansamblit të kullave të Dervish Aliut së pari kanë qenë lidhur me nevojën për fortifikimin e banimit, më vonë shtimi i nevojave jetësore të familjes ka kushtëzuar ndërtimin e ambienteve të tjerë, të cilat megjithëse në vetvete nuk paraqesin tipare mbrojtëse, janë kompozuar në mënyrë të tillë që nuk ligështojnë tiparet mbrojtëse të krejt ansamblit.

Të dy kullat e kompleksit, me shumë gjasë të fillimit të shek. XIX, paraqesin një rëndësi të madhe tipologjike për morfologjinë e kullave, që lidhen organikisht me komplekset e banuara. Të dy kullat hyjnë në kategorinë e kullave të veçuara. Por megjithëkëtë kulla kryesore, është e lidhur mjaft ngushtë nga ana kompozicionale, me banesën 1 zanafillën e ansamblit, prej së cilës madje kalohej në vetë kullën. Kjo zgjidhje të kujton banesën me kullë në fshatin Kamenicë[9], e cila është e një faze të vetme ndërtimi, dhe mjaft e hershme. Banesa me kullë me mjaft interes ruhen dhe në fshatin Vuno, njëra e datuar më 1785. Në të gjithë këta shembuj, kulla përveç funksionit të spikatur mbrojtës kryen dhe funksionin e shtëpisë së miqve. Shembujt e Labërisë disa prej të cilave relativisht të hershme, kanë interes të madh lidhur me larminë e ndërtimeve mbrojtëse të tipit kullë.

Funksionalisht kulla-roje, paraqet një dukuri relativisht të rrallë në Labëri së cilës mund ti shtohet një shembull i dhënë nga Hani në fshatin Golem[10]. Ajo për nga përmasat dhe vendi i saj në raport me ndërtimet e tjera të kujton «karakollet» e disa banesave të përhapura si në Shqipërinë e Veriut ashtu dhe në atë të Jugut.

Përsa i përket kompozimit dhe elementeve të ndryshëm arkitektonike, kullat e mësipërme nuk dallohen për ndonjë ndryshim, në krahasim me kullat e veçuara të krahinës së Labërisë. Ato shquajnë për volumin e pastër prizmatik, në të cilin në dallim nga banesat e fortifikuara të veriut nuk ndeshim në elementet e dalë karakteristikë prej druri dhe më pas prej guri. Ky fakt siç duket lidhet me prejardhjen e këtyre ndërtimeve, banesat e fortifikuara të veriut si krijime në rrugën e fortifikimit të banesave me tipare mbrojtëse[11], ndërsa kullat e Shqipërisë së jugut njësh me banesën, apo të veçuara si ndërtime të ndikuara më drejtazi nga ndërtimet mbrojtëse të tipit kullë pa funksione banimi.

8) E. Riza, **«Banesa popullore në fshatrat e rrethit të Vlorës»** Monumentet 15-16/1978.
9) A. Meksi, E. Riza, **Art. cit.**
10) J. G. Hahn, Albanesische studien, Jena, 1854, I, 205.
11) P. Thomo, **«Arkitektura e banesës fshatare shqiptare»**, «Studime Historike», 3/1974.

Fondi Arkivor

TAB I



DO NOT COPY

DO NOT COPY

KULLATE Dukatit



Pamja e faqes A.



Pamje e faqes B.



Pamja e faqes D.



Pamja e faqes C.

KULLA 2.



KULLAT E *Dukatit*



KULLA 2'

Pamje e faqes A.



Pamje e faqes B



Pamje e faqes "D.



Pamje e faqes "C.





DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE ET LA RESTAURATION DES TOURS DE DERVISH ALIU DANS LE VILLAGE DE DUKAT (VLORE)

RESUME

Sur un terrain qui occupe une position dominante, au centre du haut quartier du village de Dukat (district de Vlore), s'élève un grand ensemble d'édifices, qui se distingue nettement des bâtiments environnants et constituent même un exemplaire unique parmi les monuments de ce genre conservés en Labëri. Les gens du pays appellent cet ensemble «Les tours de Dervish Aliu». C'est là un personnage connu, un des dirigeants de la grande insurrection paysanne de 1847 contre les envahisseurs turcs.

Cet ensemble représente un exemplaire unique en son genre dans l'architecture des constructions paysannes, du fait qu'il relie organiquement des unités particulières ayant des fonctions différentes, en créant de la sorte un complexe plus ou moins grand de constructions. Son état actuel est le résultat de différentes phases de construction, chaque phase s'enrichissant de nouvelles unités. La prise en protection de cet ensemble de la part de l'Etat en raison des valeurs architectoniques et historiques qu'il comportait, a créé les conditions requises pour l'étude de ce monument et pour sa restauration.

Avant la prise en protection de la part de l'Etat, cet ensemble avait été abandonné à son sort et se trouvait dans un état technique laissant beaucoup à désirer. En projection horizontale, il représente un contour fermé, plus ou moins dans la forme d'un triangle, sur les trois sommets duquel s'érigent les trois constructions principales, reliées à travers les côtés à d'autres constructions, alors que le troisième côté est constitué par le mur d'enceinte.

La maison 1 est en ruine. Des traces restées sur place, il ressort que nous avons affaire à un bâtiment typique à demi-étage perpendiculaire, fort probablement à une seule pièce d'habitation.

En ce qui concerne la tour 2 (Figs. 3, 4, Tab.), la maçonnerie et les éléments se trouvant dans son intérieur sont conservés relativement bien, alors que le plancher du deuxième étage et les éléments de bois n'existent plus. Cette tour représente une solution quelque peu singulière du fait que son volume s'élève sur une des rues du village. La construction n'entrecoupe pas la rue, parce que l'étage au rez-de-chaussée constitue une espèce de tunnel, tunnel couvert d'une voute cylindrique, qui longe tout le volume de la construction. Des solutions semblables, conditionnées par l'étroitesse du terrain, nous les retrouvons à Gjirokastra, Himara et surtout dans le village de Vuno (district de Vlore), La tour s'élève comme un volume prismatique prononcé, au-dessus de la voûte de la rue, et comporte deux autres étages. La seule entrée de la tour se trouve dans sa partie postérieure; on y accédait fort probablement à travers un escalier de bois aménagé dans le volume de la maison 1. Des traces évidentes montrent que l'entrée était immédiatement séparée du vestibule par une construction légère de bois. A la gauche de cette entrée se trouvait le cabinet de toilette, en partie hors du volume du mur ayant la forme d'une apside. En face il y avait l'escalier de bois conduisant au deuxième étage. Cette pièce est munie de meurtrières pour des armes à feu, à retenir surtout la meurtrière à trois ouvertures qui contrôlait la partie de la rue conduisant au passage en forme de voûte. Le niveau de la couche a été élevée de 40 cm. plus tard. Le deuxième étage est plus élevé que le premier. Il constituait un volume unique, dont la partie terminale conserve les traces d'un podium rendant plus facile l'accès aux meurtrières. Dans cette pièce le nombre des meurtrières est plus grand, en tout 18.

La tour 2 s'élève à côté de l'autre extrémité de la maison 1. Elle est également à trois étages, mais semble plus haute en raison de ses petites dimensions. L'étage au rez-de-chaussée, dotée d'une entreé plus petite, est couverte d'une voûte cylindrique. On accède au premier étage à travers l'entrée aménagée sur la face contiguë de la construction 4. Un escalier de bois assurait la communication avec l'étage supérieur, où l'on relève tout de suite une niche à feu et un évier en forme de console, ainsi que de nombreuses meurtrières, 11 en tout, qui, comme au deuxième étage, sont desservies par un podium.

La maison 3 comporte deux pièces, la cave, et la partie destinée à l'habitation d'une extension analogue, ainsi qu'une entrée particulière. On accédait à l'étage supérieur à travers un escalier de pierre.

La construction 4 comporte deux volumes, le rez-de-chaus-

sèe et l'étage supérieur, auquel on y accédait à travers un escalier de pierre et de bois.

La construction 5 se compose d'un «hayat» et d'un «tchardak» qui le surmonte. La partie frontale de la première pièce a une arcade à trois arcs et celle de la deuxième une arcade plus légère à cinq arcs.

Toutes ces constructions sont placées l'une à côté de l'autre et constituent une ligne brisée horizontalement, qui est entièrement fermée par le mur d'enceinte reliant la tour 2 à la maison 3. C'est ainsi qu'on obtient une cour relativement spacieuse, dont l'entrée se trouve à côté de la tour 2. Une petite cour, tout juste après cette entrée, sépare la tour 2 et la maison 1 de la cour principale, qui est destinée aux autres constructions de l'ensemble.

Comme nous l'avons souligné plus haut, les tours de Dervish Aliu ne sont pas le résultat d'une seule phase de construction, mais de plusieurs phases. Toutefois, pour définir le rapport chronologique caractérisant les différentes phases de construction nous n'avions qu'une seule voie à suivre: l'étude attentive de l'objet, car les sources orales et d'autant plus les sources écrites ne sont d'aucune aide dans ce cas. C'est justement en nous basant sur l'observation directe du monument et sur le fait notoire que les constructions plus récentes laissent des traces bien évidentes, que nous avons pu construire un cadre chronologique des différentes phases de construction de cet ensemble. Il est compréhensible que certains passages restent dans le domaine des hypothèses et, en l'absence de données certaines, il sera difficile de les éclaircir. Bref, dans cet ensemble on relève cinq phases de construction.

La maison 1 en ruine, comme nous l'avons souligné plus haut, est à l'origine de cet ensemble. C'est le type d'habitation à demi-étage perpendiculaire bien connu dans la région de la Labëri. Deux tours appartiennent à la deuxième phase de construction, ce sont précisément les tours 2 et 2′. Que la tour 2 soit plus récente que la maison 1 cela apparaît clairement du fait que ces deux objets entrent en contact à proximité de l'entrée à la cour. La situation actuelle indique aussi un autre fait; étant plus retirée par rapport à la maçonnerie de la face méridionale de la maison 1, la tour 2 a dû être construite avec une petite partie du volume de la maison. Cela ressort aussi du fait que la rue à côté de la maison 1 ne devait pas être affectée, aussi l'on ne pouvait élever la tour sans prendre une partie de la surface de la maison. Les gens du pays racontent que Dervish Ali s'était engagé par devant les habitants du village à ne pas toucher à la rue en construisant la tour au-dessus de celle-ci, ce qu'il fit en édifiant la tour 2 au-dessus de la voûte placée au rez-de-chaussée. L'opinion selon laquelle la tour 2′ est contemporaine de la tour 2 n'est pas très convaincante. Toutefois, cette opinion est confirmée jusqu'à un certain point par le fait que le mur méridional de la tour 2′ s'appuie à la maison 2 et que la necessité de construire un ouvrage semblable se rattache à la personnalité de Dervish Aliu, qui ne cessai de combattre depuis longtemps contre les Turcs. La tour 2, en premier lieu, de par ses traits montre qu'il s'agit d'une construction destinée à la réception des amis, mais en considération du rôle dirigeant de Dervish Ali dans la lutte contre les occupants, il fallait procéder à la fortification de cette construction, ce qui a été réalisé en érigeant un type d'habitation fortifiée. La tour 2′, de par sa position, ses dimensions et son traitement, représente une tour de garde, un noeud de résistance, qui, avec la tour 2, rendait plus solide le complexe des trois édifices. En ce qui concerne la datation de ces constructions, il y a lieu de supposer que les tours 2 et 2′ appartiennent aux premières décennies du XIXe siècles, alors que la maison 1 doit être attribuée à la fin du XVIIIe siècle.

La formulation architectonique des constructions 4 et 5, ainsi que le rapport existant entre la maison 3 et les autres constructions, nous induisent à penser que celle-ci représente la dernière phase de construction. L'érection de cette habitation a été dictée, semble-t-il, par l'étroitesse de la maison 1, à travers laquelle on pouvait passer aussi à la tour 2. La construction de la maison 3 présuppose la construction de deux murs d'enceinte reliant entre elles respectivement les tours 2 et 2′. Donc il y a lieu de supposer que l'ensemble avait atteint son extension complète dès la troisième phase de construction. Avec le temps, après la mort de Dervish Ali, les exigences de la défense viennent à manquer, en plus la croissance numérique de sa famille impose la nécessité de construire de nouvelles pièces, ce qui est fait en mettant en place la construction 4, à côté de la tour 2′, qui de ce fait n'est plus en état de remplir ses fonctions de défense comme auparavant. La construction 4 est à deux étages, dont le premier se trouve au rez-de-chaussée et le deuxième comporte une pièce destinée à l'habitation et munie au début d'une cheminée sur sa face méridionale. Par suite de la construction de l'habitation 5, l'ensemble est dotée d'une liaison fonctionnelle complète à travers la tour 2, les constructions 4, 5 et la maison 3. Le fait que la tour 2 soit restée quelque peu hors de cette liaison, s'explique par sa fonction d'habitation destinée à la réception des amis de la maison.

En ce qui concerne la technique de construction, cet ensemble conserve en général les traits des constructions de la région de la Labëri.

Un élément d'importance et assez diffusé dans cet ensemble est le grand nombre de meurtrières dont sont munies les tours 2 et 2′. Généralement, en projection horizontale elles sont en forme de coin avec leur pointe dirigée vers la face extérieure de la maçonnerie, ou en forme de cordon avec leur axe incliné par rapport à l'extension du mur. Souvent la partie inférieure de la meurtrière est plate, il y a aussi des meurtrières dont la base est inclinée vers la face extérieure de la maçonnerie, ce qui consent de tirer de haut en bas. La plupart des meurtrières sont à une seule ouverture, sauf un cas (la tour 2) où elles sont à trois ouvertures.

La mise de ce monument sous la protection de l'Etat ne Pouvait pas ne pas poser des tâches urgentes de restauration,

DO NOT COPY

étant donné que son état de conservation laissait beaucoup à désirer. Aussi l'Institut des Monuments de Culture s'engagea immédiatement à étudier cet ensemble, afin d'en élaborer le projet de restauration et de l'exécuter par la suite.

L'étude de ce monument et la définition plus ou moins complète et fondée de son cadre de développement dans le temps, a rendu possible la décision de procéder à sa restauration selon les critères suivants:

1. Conserver toutes les phases de construction, bien que celles-ci présentent des traits différents sur le plan architectonique et fonctionnel, étant donné qu'elles ont contribué à la formation de cet ensemble dont l'état défini comporte des valeurs indiscutables.

2. Eliminer toutes les adjonctions faites à des fins utilitaires, sans prendre en considération les dommages qu'elles ont causé aux différentes pièces ou aux divers éléments architectoniques. Si les modifications ne consistent pas en des adjonctions faites sur les structures originales, mais réalisées après la disparition définitive des anciens éléments, en l'absence de données conserver l'état actuel.

3. Procéder à la reconstruction des éléments qui manquent, en conservant au maximum les parties et les éléments originaux. Que les éléments reconstruits se conforment aux formes originales selon les traces existantes, en l'absence de ces traces on procédera selon le critère de l'analogie. Ce critère ne sera pas appliqué dans le cas de la maison 1, étant donné que celle-ci est très endommagée et que sur la base des traces existantes on ne peut pas éclaircir plusieurs problèmes concernant sa forme initiale. En l'occurence on a procédé à des travaux de consolidation de la maçonnerie, qui comporte assez de traces pour éclaircir l'historique de l'édification de cet ensemble.

4. Etant donné que cet ensemble est destiné à devenir prochainement un musée ethnographique, dans certains cas on a permis la construction d'un escalier en fonction de sa nouvelle mission, en ayant soin toutefois que l'élément escalier constitue une unité de construction détachée de la construction originale.

C'est sur la base de ces critères qu'a été élaboré le projet de restauration, qui a été appliqué pendant les années 1977-78 par le Département des monuments de culture de Berat.

Dans la maison 1, en raison des motifs indiqués plus haut, on n'a effectué que des travaux de nettoyage et de consolidation de la maçonnerie. Dans la tour 2, on a procédé à la construction du toit et des différentes couches; le crépi endommagé a été remis en place et on a refait les portes et les fenêtres, ainsi que le plafond de la chambre du deuxième étage. On a opéré de la même manière dans la tour 2', mais ici nous avons réparé aussi l'angle du mur sud-est. Dans la maison 3 on a reconstruit la maçonnerie écroulée du cabinet de toilette ainsi que tous les éléments du plancher, le crépi, les portes, les fenêtres et le plafond. En ce qui concerne la construction 4, outre les travaux effectués dans les constructions susmentionnées, il a été procédé à la reconstruction de la maçonnerie des faces est et ouest. Dans la construction 5, outre la construction du toit, des planchers, du crépi et du plafond, on a effectué des travaux de déblayage, en éliminant les remplissages récents des arcades du «hayat» et du «tchardak». Des travaux de reconstruction ont concerné aussi le mur d'enceinte ouest, tandis que dans la cour ont été éliminées les adjonctions récentes qui affectaient l'unité de composition de l'ouvrage. Grâce à ces travaux de restauration, nous avons évité la dégradation ultérieure de cet ensemble, en ajoutant à notre patrimoine culturel dans le domaine des constructions populaires un exemplaire de grand intérêt.

L'ensemble des tours de Dervish Ali, bien que leur construction concerne une période relativement longue, représente une construction réussie et homogène. Il se distingue par une liaison parfaite avec le terrain. Les dénivellements ont été mis à profit avec maîtrise en y plaçant les différentes unités de construction, ce qui donne à la composition une agilité et un dynamisme hors de l'ordinaire. L'ensemble est dominé par trois constructions principales, dont la grande tour fait saillie soit par la place qu'elle occupe dans la composition, soit par sa hauteur. Les volumes fermés, et qui ne sont brisés que par les constructions ouvertes que sont le «hayat» et le «tchardak», ont été traités avec peu d'éléments architectoniques; on y relève une nette prévalence de la maçonnerie de pierre, dont la composition réalisée avec des volumes simples confère à l'ensemble un caractère vraiment monumental. Le mur relativement élevé du côté ouest exprime on ne peut mieux le caractère ouvertement défensif, qui est le trait essentiel de cet ensemble. La composition en forme d'un anneau fermé avec trois constructions, qui font saillie à chacun des angles du contour, dont deux sont des tours, exprime clairement le grand soin accordé à la défense tant dans la composition de l'ensemble, que dans celle des autres constructions qui en font part.

L'ensemble des constructions que nous sommes en train d'examiner présente un grand intérêt typologique dans deux directions: premièrement, en tant que complexe d'habitation fortifiée et deuxièmement par sa formulation et par la fonction exercée par les deux tours septentrionales. Cet exemplaire représente une solution unique pour un ensemble d'habitation fortifiée dans la région de la Labëri. Alors que les ensembles obtenus à travers des adjonctions successives, en formant des contours fermés n'ayant pas des traits défensifs, sont vraiment rares dans cette région. Apparemment, les motifs qui ont induit les bâtisseurs à créer l'ensemble des tours de Dervish Ali se rattachent, en premier lieu, à la necessité de fortifier l'habitation; plus tard, l'accroissement numérique des membres de la famille a conditionné la construction de nouvelles pièces, qui, bien que n'étant pas caractérisées par des traits défensifs, ont été composées de manière à ne pas détériorer la nature défensive de tout l'ensemble.

DO NOT COPY

Les deux tours de ce complexe, très probablement appartenant au commencement du XIXe siècle, présentent un grand intérêt typologique pour la morphologie des tours se rattachant organiquement aux complexes habités. Ces deux tours rentrent dans la catégorie des tours isolées. En dépit de ce fait, la tour principale se rattache très étroitement du point de vue de la composition à l'habitation 1, qui est à l'origine de l'ensemble et à travers laquelle on accédait à la tour même. Cette solution nous rappelle l'habitation «kulla» du village de Kamenica, attribuée aux XIVe-XVe siècles et appartenant à une seule phase de construction. Des habitations type «kulla» d'un grand intérêt sont conservées dans le village de Vuno aussi, dont l'une porte la date 1785. Dans tous ces exemplaires, la tour, outre la fonction décisément défensive, remplit la fonction de maison des amis. Les exemplaires de la Labëri, dont quelques-uns sont relativement anciens, présentent un grand intérêt en raison de la variété des constructions défensives type «kulla».

Du point de vue fonctionnel la tour-garde représente un phénomène plutôt rare dans la région de Labëri. Citons à ce propos l'exemplaire mentionné par J. Hahn; il se trouve dans le village de Golem et par ses dimensions et la place qu'il occupe parmi les autres constructions, il nous rappelle les «karakoll» (= poste de garde) de certaines habitations qui sont assez diffusés tant dans l'Albanie du Nord que dans l'Albanie du Sud.

Quant à leur composition et leurs éléments architectoniques, ces tours ne diffèrent pas des tours particulières de la région de la Labëri. Elles se distinguent par un volume prismatique net qui, à la différence des habitations fortifiées du Nord du pays, ne comporte pas les éléments caractéristiques en saillie d'abord de bois et puis de pierre. Apparemment, ce fait se rattache à l'origine de ces habitations. Les habitations fortifiées du Nord, en tant que créations dans la voie de la fortification des habitations, ont des traits défensifs, alors que les tours de l'Albanie du Sud constituent un tout avec l'habitation ou bien représentent un élément isolé en tant que construction directement influencé par les ouvrages défensifs du type «kulla» ne remplissant pas la fonction d'habitation.

DO NOT COPY

Valentin VOSHTINA

DY KULLA ME SHARAPOT NË RRETHIN E MATIT

DO NOT COPY

Në krahinën e Matit, siç dihet, është i përhapur gjerësisht ndërtimi i banesave të fortifikuara, kullave. Ato janë bërë objekt studimi veçanërisht në dhjetvjeçarin e fundit nga studjuesit tanë[1]. Një vend të veçantë në tipologjinë e banesës së fortifikuar të Matit ze dhe kulla me Sharapot, dy shembuj të së cilës do të jenë dhe objekti i kësaj kumtese.

Nga sa njihet deri më sot, ndërtimi i kullave përngjitur banesave është i njohur në truallin tonë që në shek. XIV[2]. Sipas të dhënave ndërtime të tilla kanë qenë përhapur deri në një farë mase dhe në krahinën e Matit. Sot në tërë krahinën ruhen vetëm dy ndërtime të tilla, të cilat i përkasin fillimit të dhjetëvjeçarit të dytë të shek. XX-të. Ndërtimet e mësipërme ndodhen njëri në fshatin Shkopet dhe tjetri në fshatin Kokërdhok (në afërsi të qytetit të Ulzës). Të dy këto ndërtime janë thuajse identike. Kulla në Kokërdhok është ndërtuar në vitin 1926 sipas modelit të kullës së Shkopetit, e ndërtuar në vitin 1921 sipas ndonjë modeli të ngjashëm akoma më të vjetër. Nga banorët vendas këto u quajtën kulla me sharapot (Tab. I).

Në zhvillimin e përgjithshëm planimetrik të banesës, sharapoti zë njërën nga qoshet e katërkëndëshit të zakonshëm të banesës. Pozicioni i vendosjes së tij kundrejt banesës, është i lidhur ngushtë, me pozicionin e vendosjes së banesës në terren. Zakonisht atij i lihet vendi nga ku mund ti afrohesh më lehtë banesës për ta sulmuar, pra, vëndi më delikat, duke parë këtë në drejtim të fortifikuar të kullës. Në planimetri sharapoti përfaqson një katërkëndësh që i afrohet katrorit me dimensione të jashtme 410 x 380 cm. Në trajtimin e përgjithshëm volumor të tërheq vëmëndjen vertikaliteti i theksuar i sharapotit i cili ngrihet një kat më lart se kulla e jetesës.

Në katin përdhe sharapoti lidhet me kullën (burgun) nëpërmjet një dere të lënë në murin që lidh këto dy ambiente. Ndërsa burgu shërbente për strehimin e bagëtisë, plani i poshtëm i sharapotit, ka luajtur funksionin e një depoje për veglat e punës. Ai nuk komunikon me ambientin e jashtëm, as me derë, dhe as me dritare. Për tu ngjitur në katin e parë të sharapotit përdoren shkallët e brendshme që të shpien dhe në katin e parë të kullës. Të dy këto kate ndodhen në të njëjtin plan. Ashtu si dhe në katin përdhe, ato lidhen me një derë 70 cm e cila në pjesën e sipërme mbyllet në formë harku. Kjo zgjidhje është diktuar më shumë nga arësye konstruktive se sa estetike. Nga e djathta pasi kemi ngjitur shkallët kalohet në odën e miqve nga e majta, përmes derës së përmendur më sipër, kalohet në katin e parë të sharapotit, i cili, nga ky plan, ashtu siç e përmendëm edhe në fillim zhvillohet i vetëm në volum. Oda e miqve, është një ambient tashmë i njohur[3] dhe ne nuk do ta përshkruajmë atë. Duke e parë këtë ambient, kryesisht në drejtim të fortifikimit, vëmë re, se mbrojtja është e organizuar nga dy sheshina të vendosura, njëra në mes të

1) B. Strazimiri, P. Thomo Monumentet 1, 1971, P. Thomo, **Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë,** Etnografia Shqiptare 4, Tiranë 1972.
2) A. Meksi, E. Riza, **Ndërtimet në fshatin – rrënojë të Kamenicës,** – Monumentet 7-8, 1974.
3) P. Thomo, **Art. cit.**

Quant à la formulation de l'extérieur de cette habitation, elle se caractérise par le modelage, la composition élancée et le caractère monumental qui la distinguent immédiatement des autres types de l'habitation albanaise; et en dernier lieu, cette habitation se distingue par son caractère défensif, plus ou moins prononcé dans les différentes maison. L'auteur du présent album souligne que cette habitation en tant que type ne constitue pas un phénomène architectonique isolé, du fait qu'il a existé dans un milieu relativement plus vaste dans le temps et l'espace.

Conformément à l'analyse historique-architectonique des composants essentiels de la vile, dont nous avons tenté d'illustrer les aspects les plus importants, l'auteur a donné la même orientation à la deuxième partie illustrée de l'album, comme nous aurons l'occasion de le montrer plus bas.

L'auteur souligne que les constructions de Gjirokastra, mises en place à travers les siècles, jusque tard avant la Libération, sont l'oeuvre des maitres bâtisseurs albanais, venus des districts de Kolonja et de Dangëlli. L'expérience séculaire et la remarquable intuition technique sont les facteurs qui ont conditionné la mise en place de constructions réussies avec deux matériaux de construction base, la pierre et le bois.

L'auteur aborde aussi le problème de la protection de cette ville par l'Etat et du grand travail qui a été accompli dans le domaine des études et de la restauration afin de mettre en évidence et d'apprécier toujours mieux les problèmes complexes qui se posent. Gjirokastra a été proclamé ville musée en 1961. En 1973 a été approuvé le Règlement portant sur la protection et l'administration de cette ville, sur sa répartition en zones et sur la définition des monuments de première catégorie. Ainsi, à l'heure présente nous relevons à Gjirokastra la «zone musée», «la zone placée sous protection» et «la zone libre»; quant aux monuments, en raison de leur valeur, ils sont répartis en «monuments de première catégorie» et «monumente de deuxième catégorie». Le texte de cet album comporte un bref aperçu sur la signification et le contenu de chaque zone et catégorie indiquées plus haut. Par ailleurs, il nous fait apprendre que des travaux de conservation et de restauration ont été effectués dans la forteresse et le marché de la ville, mais la plupart de ces travaux consernent les habitations. Ces travaux ont visé et visent toujours a conservé davantage les valeurs du monument, d'une part, et a amélioré les conditions d'habitation de la population, de l'autre, sans toutefois porter atteinte à la première condition. Ainsi donc les spécialistes et les restaurateurs ont toujours en vue l'idée que la ville doit se développer en conformité avec les temps que nous vivons, avec le nouveau socialiste, sans toutefois affecter les valeurs positives que nous avons héritées. En dernier lieu l'auteur met en relief le fait que Gjirokastra, de pair à son architecture, se distingue par le grand apport qu'elle a donné à l'histoire de notre peuple. Afin de refléter le mieux possible les importants événements historiques dont Gjirokastra a été témoin, par la sollicitude continue du Parti, dans cette ville aussi, comme dans tout le pays, ont été mis en place des musées, des monuments et des obélisques.

Enfin l'auteur relève que Gjirokastra ne cesse de croître et de devenir plus belle de jour en jour, et cela à des rythmes rapides dans toutes les directions.

Jusqu'à présent nous avons exposé les aspects fondamentaux qui ont attiré l'attention de l'auteur de cet album.

La deuxième partie de cet album, comme nous l'avions souligné plus haut, représente sa partie illustrée qui comporte 177 photos. Conformément aux quatre unités analysées dans le texte et reliées entre elles organiquement, le matériel photographique a été regroupé en quatre parties portant les titres suivants:

1. La ville avec 38 photos, dont 20 en couleurs;
2. Les habitations avec 80 photos, dont 28 en couleurs;
3. La restauration avec une carte de zonation de la ville et 13 photos, dont 2 en couleurs. Ce chapitre comporte aussi 8 photos relatives aux nouvelles constructions, dont 3 sont en couleurs;
4. Les monuments historiques avec 39 photos, dont 24 en couleurs.

o
o o

L'album «Gjirokastra ville musée» représente la première publication de ce genre consacrée à une ville particulière. C'est là une édition digne de ce nom, qui a été préparée en suivant des critères scientifiques solides. C'est le résultat logique d'un travail de longue haleine, qui a été entrepris par

DO NOT COPY

nos cadres, surtout après la proclamation de Gjirokastra ville musée (1961), de façon plus systématique et avec plus de tenacité dans le domaine des études, de la conservation et de la restauration, afin de mettre en évidence les grandes valeurs architectoniques-urbanistiques de cette ville.

Le contenu de cet album et le niveau de son élaboration témoignent, d'une part, que chez nous il y a de véritables trésors créés par le peuple et que, de l'autre, nos cadres. préparés et éduqués grâce aux soins paternels du Parti, sont maintenant en état d'entreprendre des études digne de ce nom, de n'importe quelle nature soient-elles, pour analyser et mettre en évidence le caractère multiforme de notre création populaire.

La thématique de cet album, ayant comme cheville ouvrière l'habitation populaire, nous semble assez réussie et non pas sans signification. La maison représente la création architectonique plus en masse de la ville. Elle a un caractère populaire prononcé et reflète fidèlement le mode de vie et son évolution dans le processus historique de la société, conformément aux conditions socio-économiques.

Malgré la place importante que l'habitation populaire occupe dans cet album, celui-ci n'est nullement monotone. Au contraire il se caractérise par des traits que sont la variété, la grande richesse et la fraicheur. Chaque objet représenté en entier ou en partie, constitue un document historique vivant qui nous convainc combien inépuisable est cette création. Cette variété, cette richesse et fraîcheur de notre belle Gjirokastra sont aussi inépuisables au point que même si nous avions préparé un album consacré à une seule habitation gjirokastrite, celui-ci n'aurait pas péché de monotonie.

Le sélectionneur du matériel, en tant que bon connaisseur de l'architecture populaire, et en particulier de cette urbaine, par son travail fructueux a réussi a préparé un album reposant sur des critères méthodiques et méthodologiques sains. De façon concise, avec un texte en peu de mots mais accompagné de beaucoup de photos, l'album permet au lecteur de se familiariser avec l'historique de la ville au point qu'en le feuilletant il a l'impression de se «promener» à travers la ville, de se trouver au «col du marché» ou sur la place de «Çeço», ou encore devant l'«obélisque», au Cimetière des martyrs, devant la Forteresse..., bref un peu partout.

Quant au texte, riche en idées, il dépasse les cadres d'un texte ordinaire d'album. C'est justement pourquoi nous pouvons affirmer qu'il ne s'agit pas simplement d'un indice illustrant les photos, mais d'une «directrice idéelle» de l'album. Aussi c'est là un ouvrage non seulement de caractère éducatif, mais encore de caractère scientifique. Il peut être utilisé par les hommes d'étude de toutes les catégories en tant qu'indicateur et source en relation surtout avec la nature de la ville pendant le bas moyen âge albanais. Donc, c'est la qualité scientifique du texte qui a conditionné la structure même de l'album.

La division de l'album en quatre unités et le classement du matériel nous semblent justes. Les trois premières parties, reliées entre elles du point de vue organique et logique, représentent les aspects d'un même phénomène: la formation historique de la ville, ses valeurs architectoniques-urbanistiques et le travail effectué pour sa conservation, sa protection et son renouvellement. Bien que chacune de ces unités aient une signification à soi, à notre avis elles sont reliées entre elles et fonctionnent organiquement au point qu'on a l'impression de «continuer» la visite à travers la ville, sans nullement ressentir le passage d'une partie à l'autre.

La quatrième partie de l'album, dont l'axe idéel est constitué par les paroles du camarade Enver Hoxha «Notre Gjirokastra est une ville-musée, en premier lieu, en raison de sa glorieuse histoire patriotique et révolutionnaire», de ce fait même élève particulièrement son niveau du point de vue politique-idéologique. C'est là une conclusion de grande signification. En d'autres termes, cela signifie que Gjirokastra-musée est rouge, qu'elle est avec le Parti et qu'elle restera telle à travers les siècles.

Il suffit de regarder attentivement les photos pour se rendre compte, d'une part, qu'elles reflètent la structure idéelle du texte et, de l'autre, que le photographe R. Veseli, désormais un spécialiste connu surtout dans le domaine des monuments de culture, ne s'est pas borné à «schématiser» la photo à la seule réalisation de l'exigence «scientifique» en tant que but à soi, mais s'est employé à reproduire l'objet, la rue, la maison ou l'ensemble, dans l'intégralité vivante du milieu, en élevant ainsi le niveau artistique de l'album et en le rendant plus accessible non seulement aux spécialistes, mais surtout au grand public, ce qui constitue une des tâches essentielles des publications de ce genre.

En ce qui concerne les dimension en général, les proportions de la formulation et de la composition en particulier, à notre avis cet album se trouve au niveau des exigences de l'époque, il est accessible et non surchargé. Il communique le général avec le particulier, il met en évidence ce qui est essentiel, sans toutefois négliger ce qui peut paraître moins important, et tout cela a été réalisé dans la mesure que le consentent une publication du genre de l'album et les critères qui ont été suivis dans sa rédaction.

Enfin, cet album nous permet de dégager la conclusion que Gjirokastra a été proclamée ville-musée à l'époque du Parti et, ce fait, à la différence des «villes-musée» du monde bourgeois-révisionniste, qui ont été converties en des «reliques» pour satisfaire la curiosité des touristes et assurer des profits, elle n'est pas seulement une ville-musée dans l'acception que ce terme acquiert dans un pays vraiment socialiste, comme l'est le nôtre, mais encore une ville industrielle, un important centre économique-social, un centre d'éducation et de trempe de l'homme nouveau dans l'esprit des idéaux du communisme.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

NDËRTIME TË VJETRA INXHINJERIKE NË KRUJË

Objektet e shumta të kulturës materiale të trashëguara nga e kaluara në rrethin e Krujës dëshmojnë për një traditë të pasur ndërtimi në këtë krahinë. Shumëllojshmëria e këtyre ndërtimeve të realizuara në periudha të ndryshme historike shpreh njohjen dhe aftësinë e mjeshtrave vendas në fushën e ndërtimeve.

Ndërmjet tyre, në Krujë ruhen ende ndërtime të vjetra inxhinjerike të periudhave të ndryshme si rrugë, ura, çezma, puse, etj. që përbëjnë objekte me interes. Nga gjurmët ekzistuese dhe nga burimet gojore rezulton se në Krujë që në kohë të hershme ka ekzistuar një rrjet rrugor mjaft i zhvilluar dhe me zgjidhje teknike të goditur. Këto rrugë që lidhnin Krujën me krahina të tjera dhe me malësinë e Krujës në shumicën e rasteve mbroheshin e kontrolloheshin nga pika të fortifikuara. Kalaja e Laçit (e Sebastjes) kontrollonte mirë rrugën Shkodër-Durrës, degëzimin e rrugës karvaneve që varion për nga Droja e Kruja si dhe rrugën e karvaneve nga Laçi për në Burrel nëpër Daul, gjurmë të vjetra të së cilës, kalldrëm me gurë të mëdhenj të papunuar, ruhen edhe sot.[1]



Kjo kala në këtë mënyrë kontrollonte rrugën e Selitës e të Shëna Noit dhe rrugët që vinin nga veriu për në Shqipërinë e Mesme dhe në Krujë e malësinë e saj[2]. Nga ana tjetër kalaja e Daulës afër asaj të Sebastjes, ngritur mbi një kodër të thiktë mbi bregun e majtë të Hurdhazës (degë e lumit Mat), dominon rrugën e luginës së Hurdhazës, nëpër të cilën nga Lezha e Mirdita mund të shkosh shumë shpejt në Krujë[3].

Rrugët e vjetra që qarkonin Krujën janë ndërtuar

1) Gj. Karaiskaj – A. Baçe, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në kohën antike, Monumentet 9, 1975, 21.

2) L. Bajo, Kalaja e Sebastjes (e Laçit) dhe e Daulës si hallka të sistemit mbrojtës të Skënderbeut, Konferenca II e Studimeve Albanologjike I, Tiranë 1969, 311.

3) Idem, 313.



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY

me kujdes dhe me zgjidhje teknike me interes. Në to shihen shtresa të rregullta kalldrëmi, kuneta (kanale) anësore dhe tërthore për shkarkim ujrash, breza tërthore (shkallare) në kthesat e pjerësitë e rrugëve për të penguar rrëshqitjen gjatë ecjes, etj. Një rrugë e vjetër që të çonte nga Fushë-Kruja në Krujë ka qënë rruga e Zidollit, e cila niste nga prroi i Zidollit, tek vendi i quajtur kroi i Fokës (ngjitur me mullirin), dhe që duke kaluar buzë tij dhe nëpër kodra dilte në lagjen Meçe të Krujës. Nga kjo rrugë e hershme që përdorej prej këmbësorëve dhe karvaneve sot ruhen disa fragmente kalldrëmi afër lagjes Meçe. Në këto gjurmë të ruajtura rruga arrin gjerësinë 1.7 – 2 m. Për arsye të pjerrësisë çdo 80 – 90 cm në kalldrëm janë ndërtuar breza guri tërthore në formë shkallareje të vendosur këlliç me ngritje 10 cm mbi rrafshin e kalldrëmit. fig. 1. Kalldrëmi është ndërtuar me gurë gëlqerorë kave dhe me gurë lumi në pjesën qëndrore ndërsa anash ai kufizohet nga gurë lumi të mëdhenj me brinjë 30 x x 40 cm. Kalldrëmi i vjetër ruhet dhe në vetë rrugën që kalon përmes lagjes Meçe. Ky kalldrëm ndjek pjerrësinë e terrenit të thyer ku ngrihet lagja dhe ka një zgjidhje teknike të ndryshme nga ai i Zidollit, duke qënë i shtruar me pjerrësi tërthore nga anët në qendër. Pjesa qëndrore është e punuar me gurë më të rregullt se pjesët anësore, ajo ka trajtën e një kanali tip kunete me seksion trekëndësh me thellësi në kulm 20 – 30 cm. fig. 2. Kalldrëmi është i çrregullt, ndërtim me gurë gëlqerorë me qoshe vendosur ratë dhe sipas ngushticës së rrugicës së lagjes, arrin gjerësinë 1,4 – 3 m. Rruga e vjetër që ka pas lidhur Krujën me Fushë-Krujën dhe që ka pas funksjonuar për qerre, sipas thënieve të vendasve, ka kaluar afërsisht në aksin e rrugës së sotme automobilistike, diku pranë gurores.

Rruga që ka lidhur në të kaluarën Krujën me malësinë dhe pikërisht me Bruz-Zallin, Rranxën, Cudhinë, etj. kalonte nga ana e kundër e rrugës së sotme që lidh Krujën me Qaf-Shtamën, nga gryka e Shkallës së Zezës, majtas malit të Krujës (me shpinë nga mali). Kjo rrugë që punon edhe sot për këmbësorët, nis majtas qytetit të Krujës, e rrëzë malit kalon nëpër Barkanesh dhe hyn në grykën e Shkallës së Zezë, djathtas rrjedhjes së lumit të Zezës. Nga fundi i grykës së Shkallës rruga e kalon lumin mbi urën e Abdyl Agës dhe vazhdon më lartë majtas lumit për në Bruz-Zall, Rranxë, Cudhi etj. Pikërisht në grykën e Shkallës së Zezës, nga Barkaneshi deri tek ura ruhen gjurmë të qarta të kalldrëmit të vjetër të kësaj rruge. Në këtë pjesë kalldrëmi të ruajtur qartë vërehen disa faza ndërtimi. Pak përpara urës së Abdyl Agës ruhen gjurmë të një kalldrëmi të hershëm. Nga pikpamja gjeografike gryka e Shkallës së Zezës është e vetmja grykë dhe më e përshtatshmja që në antikitet duhet të ketë lidhur ndërmjet tyre dy vendbanime ilire, kalanë e Zgërdheshit në Krujë dhe atë të Xibrit në Mat. Gjurmët e kalldrëmit më të hershëm që takojmë në Shkallën e Zezës nuk duhet ti takojnë periudhës së ndërtimit të këtyre kalave, shekujve të fundit para erës sonë. Për krahasim i referohemi trakteve të ruajtura të rrugës Egnatia në afër-

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 5

si të Elbasanit[4] dhe në Llëngë të Mokrës[5]. Rruga Egnatia e datuar në shekullin e fundit para erës sonë ka qenë ndërtuar me gurë blloqe guri më të mëdhenj e të vendosura formë pllakë të shtrirë. Këtu bordura anësore, është trajtuar shumë drejtë nga ana e jashtme, veç kësaj gurët në rrugën Egnatia janë vendosur më ngjitur njëri-tjetrit, pra vërehet një teknikë kalldrëmi me fuga jo shumë të theksuara. Në të kundërt kalldrëmi në gryken e Shkallës së Zezës është punuar jo me gurë aq të mëdhenj e të shtrirë, por ai është ndërtuar me gurë të mëdhenj e të çrregullt gëlqerorë me brinjë të mprehta, vendosur pa asnjë rregullsi. fig. 3. Fugat ndërmjet gurëve janë shumë të theksuara dhe qoshet e majat e gurëve lartësohen mjaft mbi rrafshin e kalldrëmit duke e vështirësuar ecjen. Bordura kufizuese anësore nga ana e lumit është me gurë të mëdhenj vendosur jo shumë të puthitur ndërmjet tyre por me boshllëqe. Madhësia e këtyre gurëve arrin 40-50 cm brinja. Duke qenë i ndërtuar me një teknikë të ndryshme nga ai i rrugës Egnatia, dhe nga kalldrëmi i periudhës turke me gurë të vegjël, si kohë datimi për kalldrëmin e hershëm të rrugës së Shkallës mendoj të pranojmë intervalin kohor antikitet i vonë – mesjeta e hershme, pra shekujt 6-7 deri në shekuit 10-11. Sipas terrenit ku kalon, gjerësia e këtij kalldrëmi arrin 2-3 m, gjë lejonte kalimin në të edhe të karvaneve me kafshë.



Fig. 4

Veç gjurmëve të kalldrëmit të hershëm, në këtë rrugë ruhen dhe rikonstruksione kalldrëmi të periudhës së pushtimit turk i ndërtuar me gurë lumi vendosur pa asnjë rregullsi gjeometrike. Sikurse dhe kalldrëmet e tjera të periudhës së tij, në vendet me pjerësi ai është zgjidhur me breza (shkallare) tërthore çdo 80 – 100 cm, që theksohen mbi kalldrëm

4) N. Ceka – L. Papajani, Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike, Monumentet, 1, 1971, 45.

5) V. Shtylla, Disa ura të vjetra në Shqipërinë e Jugut, Monumentet 14, 1977, 109.



Fig. 6



Fig. 7

dhe që ndihmojnë lëvizje duke mos lejuar rrëshqitjen gjatë ecjes. fig. 4. Në pjesë shumë të thikta, nga ana e lumit, ky kalldrëm është përforcuar me mure mbajtës me llaç gëlqere.

Ura e Abdyl Agës në Shkallën e Zezës e ndërtuar mbi lumin e Zezës është nga realizimet teknike me interesante të rrugës që përshkruam. tab. I. Nga burimet gojore rezulton se kjo urë është ndërtuar nga një krutan i quajtur Abdyl Aga i biri i Shim Keqit, në çerekun e parë të shekullit XIX, rreth viteve 1810-1820. Kjo urë lidh Krujën si dhe fshatrat e Rranxës (rrëza e malit), Këlcunjë, Buronjë, Lukaj, Mukaj, Rradhesh; Herraj me malësinë e Krujës (Cudhi, Bruz, Rranxë, etj.). Është ndërtuar në një vend piktoresk, në një grykë të ngushtë mbi lumin me brigje të larta e të thikta shkëmbore, e kufizuar në lartësi nga shpatet e maleve fqinje.

Ura Abdyl Agës të imponohet me ndërtimin e saj arkitektonik, me trajtimin racional konstruktiv. fig. 5. Ajo është harmonizuar me ambjentin natyror që e rrethon duke na dhënë një pamje mjaft tërheqëse. Kjo urë nga ana konstruktive është mjaft solide, me të gjitha elementet të lidhur mirë ndërmjet tyre. E ndërtuar me gurë të fortë dhe e mbështetur në brigje shkëmbore ura e Abdyl Agës paraqitet si një objekt mjaft i lidhur e me një muraturë shumë rezistente. Për këtë flet edhe fakti që deri në ditët tona ky objekt është ruajtur mjaft mirë dhe pa asnjë dëmtim si konstruksion.

Për arsye të disnivelit të brigjeve ura e Abdyl Agës ka një zgjidhje tipike për kohën e saj, ajo lartësohet me kuriz mbi kyçin e harkut kryesor e me pjerësi drejt brigjeve.

Ura përbëhet prej dy harqesh gjysëm rrethore, prej harkut kryesor mbi lum me hapësirë drite 7 m. dhe lartësi nga uji në kalldrëm 10,5 m dhe nga një hark i vogël majtas i hapur mbi bregun shkëmbor. Nga pikpamja teknike harqet janë realizuar me dyfish qemer. njeri sipër tjetrit, zgjidhje e njohur tek urat, që rrit qëndrueshmërinë e harqeve. Duke qënë i ndërtuar i tëri mbi brigje shkëmbore me lartësi rreth 5 m nga niveli i ujit, ura në kushtet e prurjes normale nuk ka fare kontakt me rrjedhjen e ujit gjë që ngjet ndoshta në rastet e prurjeve maksimale. Qemeri i poshtëm i harkut kryesor ka trashësi 46 cm, ndërsa qemeri i sipërm, i cili del me dhëmbë 8 cm jashtë rrafshit të të poshtmit, ka trashësi 42 cm. fig 6. Në fugat e gurëve të ballit të harkut të jashtëm janë vendosur ganxha metalike që mbërthejnë gurët ballore. Ruhen të pesë copët nga rrjedhja e poshtme dhe katër copa nga rrjedhja e sipërme. Ballët e qemereve janë punuar me gurë gëlqerorë të skuadruar me trashësi 20 – 30 cm. por tek-tuk në qemerin e sipërm ka dhe ndërfutje blloqe shtufi. Brendësia e qemerit është punuar me gurë pllake gëlqerore. Harku i vogël bregor majtas harkut kryesor me hapësirë drite 2,6 m është realizuar edhe ky me qemer dy rrjeshtash. Edhe në këtë hark qemeret janë punuar me blloqe gëlqerore me pak gurë shtufi në qemerin e sipërm. Faqet e mureve masive të urës janë punuar me gurë gëlqerorë kavo të kombinuar me gurë lumi shtufi. Faqet janë të mbushura me llaç sa që të krijojnë përshtypjen e një suvatimi të rëndomtë. Kalldrëmi i urës me gjatësi 18 m dhe gjerësi 3,2 m zbret me pjerrësi nga të dy brigjet, me 23 përqind nga bregu i djathtë dhe me 17 % nga bregu i majtë. Ai është një shtresë me gurë lumi e gëlqerorë kavoje kombinuar vendosur ratë dhe pa

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

ndonjë rregullsi shtrimi. Nga të dy ballët e urës kalldrëmi kufizohet me një bordurë me gurë pllake me gjerësi mesatare 45 cm që nga të dy anët përshkon kalldrëmin nga bregu në breg. Ana e jashtëme e bordurës me trashësi 14 cm. që del 7 cm me dhëmb ndaj rrafshit të murit ballor të urës është trajtuar me një profil të lehtë të kurbëzuar në pjesën e poshtëme. Në këtë mënyrë kjo bordurë e profiluar e kalldrëmit, që i vjen si kornizë kreut të urës nga të dy anët, ja rrit vlerat estetike urës. Në urën e Abdyl Agës ruhen gjurmë të parapetit të urës, sot i shkatëruar, i realizuar me një zgjidhje teknike që nuk haset shpesh në urat e tjera. fig. 7. Ai ka qenë ndërtuar me blloqe guri me trashësi 20 cm. vendosur në këmbë këlliç. Këto blloqe me lartësi 55 cm kapin një gjerësi deri në 50 cm. Blloqet të lidhura me llaç me fund me bordurën, në pika të ndryshme të gjatësisë së parapetit përforcoheshin me kolonçina guri që inkastroheshin në murin masiv të urës. Në këtë mënyrë parapeti paraqitej në formën e një muri mbrojtës në lartësi që formohej nga blloqe të renduara këlliç, paralel me faqet e urës. Nga ky parapet origjinal sot ruhet vetëm një fragment i vogël në anën e djathtë të urës nga ana e rrjedhjes së poshtme. Teknikisht ura e Abdyl Agës ru-



Fig. 10



Fig. 11

DO NOT COPY

het në gjendje të mirë, veçanërisht si konstruksion, kërkon vetëm disa ndërhyrje të vogla për riparimin e bordurës së kalldrëmit nga të dy anët dhe brigjet.

Një tjetër ndërtim inxhinjerik me interes në Krujë është ura e Emirajt në lagjen Emiraj të qytetit, e ndërtuar mbi prroin e Saxhës, që lidh këtë lagje me qytetin. tab. II. Dikur këtu kalonte dhe një variant i rrugës Fushë-Krujë-Krujë, gjurmë të së cilës ruhen edhe sot pranë urës, kalldrëm i çrregullt, me gurë lumi. Një variant i kësaj rruge ishte ai nga Zidolli që kemi përshkruar më sipër. Në unitet me mullirin ngjitur saj si dhe me kroin e Saxhes pak më lartë, kjo urë është pjesë përbërëse e një kompleksi hidraulik me interes, që nuk takohet shpesh.

Kjo është një urë e vogël, që përbëhet prej vetëm një harku me hapësirë drite 3 m. lartësi 3,3 m dhe gjerësi 2,4 cm. fig. 8. Paraqet interes në aspektin historik të ndërtimit të saj. Përpos burimeve gojore që e shtyjnë kohën e ndërtimit të saj në mbi 500 vjet, duke u bazuar në teknikën e ndërtimit të saj, e ndryshme nga ajo e urave tona të shekujve XVII-XVIII e lartë, mendojmë se ura e Emirajt duhet të jetë ndërtuar në periudhën mesjetare të para pushtimit turk, ndoshta në intervalin midis shekujve XII-XIV, kohë prej së cilës urat e ruajtura tek ne janë të rralla. Me teknikë të tillë janë punuar dhe dy ura të vogla në Bosnjë-Hercegovinë, ura e Mostaçit dhe e Bodezhanit të cilat edhe ato datohen si të mesjetës paraturke, në shekujt XIII-XIV[6]. Si formulim, madhësi dhe teknikë ndërtimi, ura e Emirajt ngjason me urën e vogël të Kasharajt në Lushnjë për të cilën burimet gojore shprehen gjithashtu se edhe koha e ndërtimit të saj i kalon të 500 vjetët. Ballët e dukëshme të qemerit të harkut janë punuar me blloqe smërçi, lloj formacioni shkëmbor që vëndasit e quajnë grac, me gjerësi deri në 50-60 cm. e me lartësi 36 cm. fig. 9. Blloqe të tillë vërehen dhe në pjesën e mbështetjes, në tri rrjeshtat e fundit mbi tokë. fig. 10. Pjesa e brendëshme e qemerit është punuar me gurë gëlqerorë pllake, Kjo teknikë me blloqe guri të mëdha nuk është përdorur në urat tona të shekujve XVIII-XIX, që janë dhe më të ruajturat[7]. Llaçi që lidh blloqet ndërmjet tyre është me gëlqere dhe ranë të ashpër me kokrriza deri në 10 mm.

Kalldrëmi, mbi urë, i rrafshët me gjerësi 2,4 m është ndërtuar me gurë lumi pllake e të rrumbullakët kombinuar, shtruar pa asnjë rregullsi. Konturet anësore të kalldrëmit janë trajtuar më me kujdes me blloqe shtufi ose graci (në kyç) me përmasa 20 x 30 cm. me trashësi 15 cm.

Duke qenë një urë e rrallë sa i takon periudhës së ndërtimit të saj, ura e Emirajt paraqet interes për vazhdimësinë kronologjike të ndërtimit të urave në vendin tonë dhe për karakteristikat e teknikës së ndërtimit të periudhës që përfaqëson.

Rruga e vjetër që ka pas lidhur Krujën me Mamurasin e Laçin si dhe më afër me fshatrat Shëmëri e Bret ka qenë ajo që kalonte nga ura e Drojes, në veri-perëndim të Krujës. Kjo rrugë, që përdoret ende për këmbësorë, sot ndjek deri në një farë vendi trasenë e rrugës së Qafë-Shtamës dhe pasi kalon kroin e Ballabanecit, zbret poshtë majtas tij, kalon tek kroi i Kryeshkozës dhe nëpër një kalldrëm të vjetër zbret në lumin e Drojës, të cilin sot e kalon me një urë druri. Në intervalin kroi i Kryeshkozës – Ura e Drojes ruhen gjurmë të kalldrëmit të vjetër të rrugës së Drojës, tek i cili vërejmë dy faza ndërtimi. Vënde-vënde shihen pjesë të një kalldrëmi më të hershëm, i ndërtuar me gurë lumi me madhësi mesatare vendosur në mënyrë të çrregullt. Në këtë fazë vemë re se një teknikë kalldrëmi, ku gurët janë vendosur pa asnjë trajtim e linjë gjeometrike, me fuga mjaft të theksuara ndërmjet tyre. fig. 11. Sipërfaqja e këtij kalldrëmi nuk është e rrafshët, përkundrazi, gungat e gurëve theksohen së tepërmi mbi



Fig. 12

DO NOT COPY

6) D. Çeliç – M. Mujezinoviç, Stari mostovi u Bosni i Hercegovini, Sarajeva 1969, 27, 238.
7) V. Shtylla Vep. cit. 101.

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

rrafshin e kalldrëmit. Kalldrëmi anash kufizohet me bordurë me gurë shtufi të rrumbullakët më të mëdhenj. Në dy-tre pika të kalldrëmit të kësaj faze që përshkruajmë janë ndërtuar kanale tërthorë me seksion trapezi me bazën e poshtëme 40 cm e lartësi 20 cm për shkarkimin e ujrave që vijnë nga shpati i kodrës, gjë që tregon për një njohje të thellë të teknikës së ndërtimit të rrugëve nga ana e ndërtuesve vendas. fig. 12. Ky kalldrëm i fazës më të hershme, me gjerësi sipas rastit 1,3 — 1,7 m duhet të jetë ndërtuar në periudhën e para pushtimit turk, në shekujt 13-14, pasi nga teknika e shtrimit ngjan me kalldrëmin e hershëm të Shkallës së Zezës, por realizuar me gurë më të vegjël.

Në pjesën më të madhe të rrugës së Drojes ruhen gjurmë kalldrëmi tipik të periudhës së pushtimit turk, gurë lumi të vegjël të rrumbullakët shtufi dhe gëlqerorë shtruar pa rregullsi me kornizë anësore me gurë lumi më të mëdhenj. Në kalldrëmin e kësaj faze ndërtimi, karakteristikë është se në kthesat me pjerësi, mbi rrafshin e kalldrëmit çdo 1 m theksohen 10 cm. lartë breza gurësh këlliç që luajnë rolin e shkallëve për të mos shkarë gjatë ecjes mbi kalldrëmin e lagur. fig. 13.

Nga ura e vjetër sot ruhet vetëm një fragment i mbështetjes në bregun e djathtë i ndërtuar me gurë lumi shtufor kryesisht formë pllake fig. 14. Kjo urë që ka ekzistuar deri në vitet e paraçlirimit, sipas një fotografie të vjetër del se ka qenë e tipit me kuriz mbi një hark të madh kryesor anash të cilit qenë dy harqe (dritare) të vegjël lehtësues me taban mjaft lartë shtratit të lumit. fig. 15. Në fshatin Shvan në rrugën Prizren — Gjakovë, deri para luftës II botërore mbi lumin Drin i Bardhë ka pas egzistuar një urë e vjetër guri identike me urën e Drojes, e ndërtuar në periudhën e pushtimit turk[8]. E kësaj kohe ngjan të ketë qenë dhe ura e Drojes dhe mundet pikërisht e shekullit XVIII, kohë kur ky tip ure



Fig. 15

8) N. Kataniç — inxh. M. Gojkoviç, Graça za prouçavanje starih kamenih mostova i akvedukata u Srbiji, Makedoniji i Crnoj Gori, Beograd, 1961, 16.



Fig. 16

njihej mjaft tek ne (ura e Katiut në Bënjë[9], e Muço Hysës në Këlcyrë, etj.[10]. Sot në aksin e urës së vjetër është ndërtuar një urë provizore me shtresë dërrasash mbi shina hekuri. fig. 16.

Veç urave dhe kalldrëmeve të tjera, në Krujë ruhen dhe mjaft (çezma) të vjetra, për të cilat Kruja ka qenë e njohur, si kroi i Saxhës në lagjen Emiraj, i Ballabanecit në rrugën për Qafë Shtamë dhe kroi i Kryeshkozës në rrugën e Drojes, të ndërtuara të gjitha pranë rrapeve shekullore në unitet me të cilat ruajnë vlera tipike ambjentale. Ka shumë mundësi që emri «Krujë» të ketë prejardhjen nga fjala shqip «krua--burim», kjo pasi Kruja ishte vendi i pasur me kroje e burime natyrore[11].

Kroi i Saxhës është ndërtuar në lagjen Emiraj, ngjitur me urën dhe mullirin e rrapin shekullor. fig. 17 Është një çezmë e thjeshtë me mur ballor prej guri graci e gëlqeror, tek-tuk dhe me tulla, lidhur me llaç gëlqere. Gjurmë të depozitës nga pas murit nuk dallohen. Çezma ka vetëm një lug për daljen e ujit, që është një gur i vetëm me një thellim për ujin në mes. Uji derdhet dhe grumbullohet në një koritë të madhe prej një guri të vetëm në trajtën e një govate me përmasa 0,8 x 1,2 m thellësi 0,4 m dhe trashësi të mureve 15 cm. Uji i koritës shkarkohet jashtë me



Fig. 17



Fig. 18

9) V. Shtylla, vep. cit., 104.
10) idem, 106.
11) S. Adhami, Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës, 87.

DO NOT COPY



Fig. 19

anën e një vrime me diametër 10 cm. çpuar në një qosh të koritës.

Kroi i Ballabanecit ndodhet ngjitur një rrapi, në dalje të Krujës, gjatë rrugës së Qafshatamës. fig. 18. Ka murin ballor me gjatësi 8 m lartësi 1,3 m e gjerësi 75 cm. Përbëhet nga dy lugje guri, por sot funksionon vetëm njëri me seksion trapezi me bri-

një 18 x 23 cm. me një thellësi 5 cm në mes për rrjedhën e ujit. Edhe në këtë krua uji nga lugu mblidhet në koritën e gurit poshtë me përmasa 0,9 x 1,25 m me thellësi 15 cm. e me trashësi muresh 16 deri 30 cm. Korita është një gur monolit gëlqeror i thelluar trajtë govate në mes. Kroi i Ballabanecit sikurse dhe i Saxhes duhet të ketë depozitë para daljes së ujit në lug.

Kroi i Kryeshkozës ndodhet në veri-perëndim të Krujës, në rrugën e Drojes. Është një krua tepër i thjesht pa depozitë dhe koritë grumbulluese. fig. 19, Uji me kanal vjen drejtë një burimi dhe shpërndahet në dy lugje të gurta. Përbëhet nga një mur ballor me gjatësi 3,4 m dhe lartësi 1,5 m. Dy lugjet me distancë 60 cm. midis tyre, dalin 25 m nga rrafshi i murit dhe kanë një thellim 6 cm në mes. Kroi i Kryeshkozës është pjesë përbërëse e një kompleksi hidraulik me interes ku përfshihen mulliri, tabakhanja e çezma, i cili kompleks hijeshohet nga rrapi shekullor pranë.

Krojet e Krujës janë të thjeshta, pa ndonjë trajtim të veçantë arkitektonik, si në rastin e çezmave me kupol apo qemer cilindrik. Gjithashtu muret e tyre ballore janë të rrafshta pa asnjë relief dekorativ apo mbishkrimor.

Këto ishin disa ndërtime të vjetra në rrethin e Krujës, që paraqesin interes për historikun e rrugëve të këtij rrethi si dhe hedhin dritë mbi një serë objektesh inxhinjerike dhe hidraulike të ndërtuara këtu nga dora e mjeshtrit popullor.

Nga pikpamja teknike këto objekte sot funksjonojnë, pra mirëmbahen nga vendasit. Një riparim të lehtë kërkon ura e Abdyl Agës në pjesët anësore të kalldrëmit nga të dy anët.

DO NOT COPY

TAB I

URA E *Abdyl Agés*
KRUJE



DO NOT COPY

DO NOT COPY

URA NE LAGJEN *Emiraj*
KRUJE



Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

DES ANCIENNES CONSTRUCTIONS D'INGENIERIE A KRUJA

RESUME

Les nombreux objets de la culture matérielle, que nous avons hérités du passé dans le district de Kruja, témoignent de la riche tradition des constructions dans cette région.

De leur nombre, à Kruja sont conservées encore d'anciennes constructions d'ingénierie appartenant à des périodes différentes (routes, ponts, fontaines, puits, etc.) et représentant des objets d'intérêt. Selon les traces existantes et les sources orales, il ressort que le district de Kruja possédait dans le passé un réseau routier bien développé et caractérisé par une solution technique réussie. Les routes, qui reliaient Kruja à d'autres régions et à sa zone montagneuse, étaient le plus souvent défendues et contrôlées par des points fortifiés.

Les anciennes routes cernant Kruja étaient construites avec soin et selon une technique intéressante. Elles étaient pourvues de couches régulières de pavage, des cuvettes latérales et transversales pour le déchargement des eaux, de bandes latérales (degrés) dans les tournants et les inclinaisons afin d'éviter la glissade des voyageurs, etc. Une ancienne route conduisant de Fushë-Kruja à Kruja est celle appelée la route de Zidoll, qui commençait au torrent de Zidoll, à l'endroit dénommé la fontaine de Foke (à côté du moulin), et qui, après avoir longé les collines, aboutissait au quartier Meçe de Kruja. L'ancienne route qui reliait dans le passé Kruja à Fushë-Kruja et était destinée à la circulation des chariots, selon les témoignages des gens du pays passait à proximité de l'axe de l'actuelle route nationale, quelque part à côté de la carrière.

La route qui reliait dans le passé Kruja avec les zone montagneuse et précisément avec Bruz-Zall, Rranxe, Cudhine, etc., passait du côté opposé de la route actuelle qui met en communication Kruja avec Qaf-Shtame, à travers le col de Shkalla e Zezë, du côté gauche du mont Kruja (avec son dos tourné vers la montagne). Cette route que les piétons usent encore, commence à la gauche de la ville de Kruja puis elle longe la montagne en traversant Barknesh pour s'introduire dans le col de Shkalla e Zeze, du côté droit du cours du fleuve Zeze. Vers la fin du col de Shkalla, la route traverse le fleuve sur le pont de Abdyl Aga et poursuit son parcours plus haut dû côté gauche du fleuve en direction de Bruz-Zall, Rranxe, Cudhi, etc. C'est précisément dans le col de Shkalla e Zeze, depuis Barknesh jusqu'au point, que sont conservées des traces évidentes de l'ancien pavage de cette route. Dans cette partie de pavé conservé on relève clairement différents phases de reconstruction. Quelque peu avant le pont de Abdyl Aga sont conservées des traces de l'ancien pavage. A des fins de confrontation, nous allons nous référer aux tronçons conservés de la voie Egnatia à proximité d'Elbasan et à Llenge de Moker. Etant d'une technique de construction différente de celle de la voie Egnatia et de la route pavée avec des petites pierres de la période turque, en tant que datation pour l'ancien pavage de notre route nous sommes d'avis qu'elle appartient à l'intervalle de temps allant de la basse antiquité au haut moyen âge, soit des VIe-VIIe siècles jusqu'aux Xe-XIe. Selon le terrain qu'il parcourt, la largeur de ce pavé atteint une largeur maximale de 2 à 3 m, ce qui permettait le passage aussi de caravanes de bêtes de somme.

Outre les traces de l'ancien pavage, cette route conserve d'autres se référant aux reconstructions qui y ont été effectuées pendant la période de l'occupation turque avec des pierres fluviatiles placées sans aucune régularité géométrique.

Le pont d'Abdyl Aga, qui franchit le fleuve Zeze à Shkalla e Zeze, est une des ralisations techniques la plus intéressante de la route que nous venons de décrire. Des sources orales il ressort qu'il a été construit par un habitant du pays appelé Abdyl Aga, fils de Shim Keqi, dans le premier quart du XIXe siècle, vers 1810-1828. Cette route mettait en communication Kruja et les villages de Rranxe, Kelcunje, Buronje, Lukaj, Mukaj, Rradhesh et Herraj à la zone montagneuse de Kruje (Cudhi, Bruz, Rranxe, etc.).

Le pont d'Abdyl Aga s'impose par sa construction architectonique, par son traitement rationnel sur le plan de la

Do not copy

construction. Il est en harmonie avec le milieu naturel environnant, en créant de la sorte un aspect attrayant.

Par suite du dénivellement des berges du fleuve, le pont d'Abdyl Aga se caractérise par une solution typique pour l'époque de sa construction: il s'élève en dos d'âne au-dessus de la clef de l'arc principal et est en pente vers les berges.

Ce pont comprend deux arcs semi-circulaires: l'arc principal sur le fleuve avec une ouverture de lumière de 7 m et une hauteur depuis le niveau de l'eau jusqu'au pavage de 10,5 m et un arc plus petit, à gauche, placé sur la berge rocheuse. Du point de vue technique les arcs sont à double voûté, l'une au-dessus de l'autre; c'est là une technique bien connue pour les ponts, qui accroit la stabilité de leurs arcs.

Le pont d'Abdyl Aga conserve aussi des traces de son parapet, dont la solution technique se caractérise par une réalisation plutôt rare. Il est construit de blocs de pierre d'une épaisseur de 20 cm. et placés debout.

Un autre ouvrage d'intérêt à Kruja est le pont d'Emiraj, dans le quartier Emiraj de la ville, qui, en franchissant la source de Saxhe, relie ce quartier à la ville. Autrefois ici passait aussi une variante de la route Fushe-Kruja – Kruja, dont les traces sont présentes de nos jours encore à proximité de ce pont, sur le pavage irrégulier avec des pierres fluviatiles. Une des variantes de cette route était celle de Zidoll, dont il a été question plus haut. En unité avec le moulin qui lui est contigu et la source de Saxhe un peu plus haut, ce pont était partie intégrante d'un complexe hydraulique d'un intérêt technique particulier.

Il s'agit d'un pont de petites dimensions, qui comprend un seul arc dont l'ouverture de lumière est de 3 m, la hauteur de 3.3 m et la largeur de 2.4 cm. Il présente de l'intérêt sous l'aspect historique de sa construction. Outre les sources orales qui font remonter sa construction à quelque 500 ans de cela, en nous fondant sur sa technique de construction, qui diffère de celle de nos ponts relevant des XVIIe-XVIIIe siècles et plus tard, nous pensons que le pont d'Emiraj doit avoir été construit pendant le moyen âge avant l'occupation turque, peut-être dans l'intervalle de temps entre le XIIe et le XIVe siècles. Les ponts correspondant à cette période et conservés encore chez nous sont vraiment rares. D'un technique de construction semblable sont deux petits ponts de la Bosnie-Herzégovine, le pont de Mostac et celui de Bodezhan, attribués, eux aussi, au moyen âge préturque, aux XIIIe-XIVe siècles. Quant à sa formulation, ses dimensions et sa technique de construction, le pont d'Emiraj ressemble au petit pont de Kasharaj, district de Lushnje, dont les sources orales font remonter la construction à plus de 500 ans de cela.

L'ancienne route qui reliait Kruja à Mamuras et a Laç ainsi qu'aux villages environnants de Shemeri et Bret, est celle qui traversait le pont de Droje, à N.-O. de Kruja. Cette route, qui est utilisée encore par les piétons, suit de nos jours jusqu'à un certain point le tracé de la route de Qafè-Shtame et, après avoir traversé la source de Ballabanec, descend à sa gauche, puis se dirige vers la source de Kryeshkoze et, à travers un ancien pavage, descend vers le fleuve Droje, qu'il franchit actuellement sur un pont de bois. Dans l'intervalle entre la source de Kreyshkoze et le pont de Droje sont conservées les traces de l'ancien pavage de la route de Droje, qui comporte deux phases de construction. Par endroits on relève des tronçons de pavage plus anciens, construits avec des pierres fluviatiles de dimensions moyennes et placées irrégulièrement. Ce pavage de la phase la plus ancienne, dont la largeur est parfois de 1,3-1,7 m, doit avoir été construit pendant la période d'avant l'occupation turque, aux XIIIe-XIVe siècles, puisque de par sa technique de construction il ressemble beaucoup à l'ancien pavage de Shkalla e Zeze, mais il est réalisé avec de petites pierres.

Dans la plus grande partie de la route de Droje en retrouve encore des traces du pavage typique de la période de l'occupation turque, avec des petites pierres fluviatiles arrondies de ponce ou calcarées qui sont placées irrégulièrement et encadrées latéralement de pierres fluviatiles de dimensions plus grandes.

De l'ancien pont on ne conserve aujourd'hui qu'un seul fragment de son appui sur la berge droite, en pierres ponces fluviatiles surtout en forme de plaques. Ce pont qui a existé jusqu'à quelques années avant la Libération, selon une photographie de l'époque résulte être du type à dos d'âne surmontant un grand arc principal, qui avait à ses côtés deux petits arcs (fenêtres) de déchargement reposant sur des fondations assez élevées du niveau du lit du fleuve. Dans le village de Shvan, sur la route Prizren-Gjakove, juste avant la Deuxième Guerre mondiale il y avait un ancien pont de pierres identique au pont de Droje et mis en place pendant l'occupation turque pour franchir le fleuve Drin i Bardhë. C'est à cette même période que doit appartenir le pont de Droje et peu-être justement au XVIIIe siècle, période de temps lorsque ce type de pont connaissait une grande diffusion chez nous (le pont de Katiu à Banje, le pont de Muço Hysa à Kelcyre, etc.). Actuellement, suivant l'axe de l'ancien pont on a construit un pont provisoire avec des planches de bois placées sur des rails.

Outre les autres ponts et pavages, à Kruje sont conservées plusieurs fontaines, anciennes, entre autres la source de Saxhe dans le quartier d'Emiraj, la source de Ballabanec sur la route conduisant à Qafe-Shtame et la source de Kryeshkoze sur la route de Droje. Ces fontaines sont construites auprès de platanes séculaires et en unité avec celles-ci préservent les valeurs typiques de l'environnement. Il se peut fort bien que le nom de «Kruje» tire son origine de la parole albanaise «krua-burim» (=source), car la ville de Kruja est un endroit riche en sources d'eau.

La source de Saxhe se trouve dans le quartier d'Emiraj, à côté du pont, du moulin et du platane séculaire. C'est une fontaine de facture simple dont le mur frontal est construit de pierres calcarées, entremelées par endroits à des briques et liées avec du mortier de chaux.

La source de Ballabanec se trouve à côté d'un platane, à la sortie de Kruja, le long de la route en direction de Qafe-Shtame. Son mur frontal a une longueur de 8 m, une hauteur de 1,3 m et une largeur de 75 cm.

La source de Kryeshkoze se trouve au N.-O. de Kruja, sur la route de Droje. C'est une source de facture très simple, sans réservoir et auge. Elle est partie intégrante d'un complexe hydraulique de grand intérêt comprenant le moulin, la tannerie et la fontaine, complexe qu'embellit le platane séculaire.

Les sources de Kruja sont de facture simple, sans un traitement architectonique particulier, comme c'est le cas des fontaines à coupole ou à voûte cylindrique. Leurs murs frontaux sont plats, sans aucun relief décoratif ou inscription.

C'était là quelques anciennes constructions du district de Kruja, qui présentent de l'intérêt en ce qui concerne l'historique des routes de cette région et jetent une lumière nouvelle sur une série d'ouvrages d'ingénierie et hydrauliques mis en plac par les maîtres constructeurs du pays,

Du point de vue technique ces objets fonctionnent encore de nos jours, ce qui signifie qu'ils sont entretenus par les gens du pays. Le pont d'Abdyl Aga exige cependant une petite réparation des parties latérales de son pavage.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KRONIKË E PUNIMEVE RESTAURUESE PËR VITIN 1978

RESTAURIMET NË MONUMENTET ANTIKE E MESJETARE

Bylis. Në krahinën e Mallakastrës, në veri të lumit të Vjosës ngrihet kodra shkëmbore e Hekalit, e cila me lartësinë e saj dominon mbi të gjithë zonën pranë. Maja e saj formon një rrafsh të zgjatur me drejtim veri jug. Në anën veriore kodra lidhet me kurrizin e kodrës fqije nëpërmjet një qafe të ngushtë, ndërsa ana jugore zbret në luginën e lumit me faqe të thikta shkëmbore. Ana lindore dhe perëndimore zbret me pjerrësi të madhe deri në një farë largësie, më tej kodra formon disa tarraca ku janë vendosur lagjet e fshatit Hekal.

Në majë të kodrës ka qenë vendosur Bylisi antik. Muret mbrojtës rrethojnë një sipërfaqe prej 27 ha afërsisht në formë të një trekëndëshi me bazë nga jugu.

Gjatë viteve 1975, 1976 dhe 1978 Instituti i Monumenteve të Kulturës, kreu punime pastrimi dhe restaurimi në muret rrethues të këtij qyteti. Punimet e pastrimit përveç pjesëve të murit dhe të kullave të ruajtura pjesërisht, në anën lindore nxorrën në dritë edhe tri hyrje të qytetit. Hyrja më e vogël është me ballë nga jugu, nga qyteti antik fqinjë mbi kodrën e fshatit Klos. Porta formohet nga zgjatimet paralele të dy drejtimeve të murit duke formuar midis dy mureve një koridor 1.30 m të gjerë dhe 3.5 m të gjatë. Nga punimet e pastrimit doli se në pjesën e përparme ajo ka qënë e mbyllur me një mur prej blloqesh të vendosur pa kujdes. Muri në krahun lindor doli i dëmtuar. Prej tij në pjesën ballore ruhet vetëm një rradhë blloqesh.

Në drejtim të veriut ndodhet një portë e dytë me hyrje nga veriu. Porta ka dalë e dëmtuar, prej saj ruhet në gjendje pak a shumë të mirë vetëm krahu nga kodra. Mundësitë për ndërhyrje restauruese në të janë të pakta mbasi blloqet janë grabitur me kohë. Përsëri po në këtë faqe muri, në jug të portës së parë, ndodhet edhe një portë e tretë e madhe edhe kjo ashtu si porta e vogël me hyrje të drejtuar nga jugu. Vendosja e këtyre dy hyrjeve me drejtim nga jugu tregon se në këtë faqe të kodrës duhet të ketë qënë një rrugë me drejtim nga qyteti i Klosit. Afërsisht në juglindje të kodrës, kjo rrugë duhet të jetë kryqëzuar edhe me rrugën tjetër për të cilën na bën fjalë mbishkrimi i madh në jug të qytetit, e cila kalonte në Astacia, ndoshta krahina e Mallakastrës.

Ashtu si porta e vogël edhe kjo portë formohet nga zgjatimet paralele të dy ekstremeve të murit rrethues. Në mes të dy mureve formohet një koridor me gjerësi 4 m dhe gjatësi 9 m. Në anën lindore të saj muri rrethues, që ruan edhe këtu gjerësinë e përgjithshme të tij 3.45 m duhet të ketë luajtur edhe rolin e kullës për të. Në ndryshim me hyrje të tjera në qytete të ndryshme të kësaj periudhe, si në Lezhë ku porta vendoset brenda koridorit, këtu shikohen gjurmë që dëshmojnë për vendosjen e saj në ballë. Një rast tjetër të vendosjes së portës në këtë mënyrë e shikojmë edhe tek hyrja e akropolit në Zgërdhesh.

Para punimeve të pastrimit kjo hyrje nuk njihej. Këto punime e zbuluan atë në gjendje tepër të dëmtuar. Faqja e jashtme e murit lindor ishte krejtësisht e rrëzuar, vetëm blloqet e rradhës së parë e ruanin deri në një farë mase vendin e tyre dhe drejtimin. Një pjesë e blloqeve të rradhëve të sipërme ruheshin aty pranë. Po kështu edhe blloqet e faqes së dukshme të murit nga kodra kanë rënë në koridorin e hyrjes. Punimet e pastrimit sqaruan edhe planimetrinë e saj. Në këtë portë me që një pjesë e blloqeve ruhet në vend Fig. 1 po kështu dhe bllo-



Fig. 1

qet e tjerë e ruajnë formën e tyre, egzistonte dhe mundësia e ndërhyrjeve restauruese.

Në të dy krahët porta fillon me nga një paturë të gjerë 0.90 m dhe të nxjerrë nga muri në njërin krah 0.48 – 0.50 m dhe në krahun tjetër rreth 0.65 m. Gjatësia e koridorit ndahet në dy hapësira nga një kontrafort që ndodhet 4.20 m nga patura në ballë të portës, ndërsa hapësira e dytë është më e vogël, 2.60 m e gjatë, dhe kufizohet përsëri me nga një kontrafort në të dy krahët. Kontraforti i mezit është i gjatë dhe i nxjerrë nga muri 0.43 m. Gjerësia e koridorit shkon në të gjithë gjatësinë e tij paralel në ndryshim me disa porta në qytete të tjerë, të cilët në thellësi ngushtohen. Hyrja me planimetri afërsisht të ngjashme me të ka pjesa antike e kalasë së Beratit.

Në murin e koridorit nga ana e kodrës, pranë kontrafortit të parë, ndodhet një vrimë e thellë në të cilën lëvizte trau (katarahu) që siguronte mbylljen e portës. Muret e hyrjes ashtu si edhe të giithë muret rrethues të qytetit janë të ndërtuar me blloqe të madhësive mesatare me përbërje gëlqerore, të butë. Në pjesën më të madhe janë me faqe kuadratike, në disa raste edhe me brinjët anësore pak të pjerrët që i japin formën e një trapezi. Faqen e kanë të sheshtë me shenja çukitje daltash, në anë nuk dallohet ndonjë prerje, por një vijë e drejtë pak e rrumbullakosur. Shkallëzimet janë shumë të rralla.

Përveç kësaj teknike që është më e vjetra në muret rrethuese të këtij qyteti dhe i takon shekullit IV p.e. sonë në portën e madhe vërehen edhe punime të më vona. Ndërtimet e kësaj periudhe janë kryesisht riparime dhe ngushtime të hapësirave të portës dhe janë pasojë e rënies së nivelit të jetës në qytet. Kjo periudhë duhet të lidhet me shek. III-IV të erës sonë kur veprimtaria e qytetit kufizohet në pjesën perëndimore dhe më të lartë të tij.

Punimet e kësaj faze ndërtimi i shikojmë në murin lindor dhe në mënyrë të veçantë në faqen e koridorit. Këto mure janë ndërtuar me blloqet e murit antik të vendosura pa kujdes, të lidhur me llaç dhe të mbushur anash me gurë të vegjël. Rindërtimet shikohen deri në kontrafortin në mes të gjatësisë së murit. Po në këtë fazë ndërtimi hapësira e portës prej 3 m ngushtohet me një mur që shtohet në anën lindore, duke lënë një kalim 1.20 m të gjerë. Po kështu edhe në fund të koridorit, murit nga kodra i është shtuar një mur tjetër me trashësinë e një bllоku duke e ngushtuar edhe këtu kalimin.

Përveç këtyre punimeve shikohen edhe gjurmë të mbylljes së plotë të portës me blloqe të vendosur pa kujdes. Mbyllja duhet të jetë bërë pas një periudhe të shkurtër nga punimet e fazës së dytë, ka të ngjarë mbas ndërtimit të murit mesjetar. Blloqet që ne gjejmë sot në koridorin e saj ka mundësi që të jenë hedhur nga muret pranë me qëllim që të pengohej mundësia e kalimit në të.

Ashtu si në të gjithë qytetet e tjerë ilirë edhe këtu punimet e restaurimit kanë kryesisht karakter anastiloze, por ndërhyrjet e punimeve të periudhave të ndryshme e vështirësojnë punën për gjetjen e vendit fillestar të çdo bllоku në mur.

Gjatë vitit 1978 filloi pastrimi i koridorit nga blloqet e rrëzuar duke synuar të vendosen në mur në vendet e tyre fillestare. Në murin nga kodra blloqet



Fig. 2

DO NOT COPY

u vendosën provizorisht mbasi ai kishte lëvizur që nga themeli duke u mënjanuar nga koridori Fig. 2. Pasi të përfundojë pastrimi do të rizbërthehet muri, do të vendoset themeli në vijë të drejtë dhe në nivel, dhe më tej do të vendosen blloqet në vendet e tyre përfundimisht. Kjo mënyrë pune nuk u ndoq në murin e krahut tjetër të koridorit, ku muri i takon fazës së dytë të ndërtimeve.

Gjatë pastrimit u gjetën disa blloqe afërsisht kubikë, të cilët, nga vëzhgim më i hollësishëm doli se ishin blloqe qemeri, i cili ka qenë mbështetur mbi dy kontrafortet në mes të gjatësisë së koridorit. Harku ka qenë formuar vetëm nga një rradhë blloqesh. U gjetën edhe disa blloqe që vendoseshin sipër atyre të harkut.

Në punimet e ardhëshme do të kryhet pastrimi i rregullt i koridorit dhe do të ringrihen, me aqë sa e lejojnë mundësitë, muret anësore të tij. Po kështu do të bëhen përpjekje edhe për ngritjen e qemerit.

L. Papajani

Dimal. Po gjatë vitit 1978 u kryen punime edhe në qytetin antik të Dimalit. Kryesisht ato ishin punime pastrimi dhe mirëmbajtje. Përveç pastrimit të përgjithshëm që ju bë monumenteve të zbuluar nga gërmimet arkeologjike u konsolidua një kanal me tjegulla helenistike, dëmtimi i mëtejshëm i të cilit rrezikonte zhdukjen e tij. Veç tyre u forcuan edhe disa mure dhe u restaurua një mur i vogël, që ishte rrëzuar pas gërmimeve. Përveç këtyre u kryen edhe disa punime pregatitore për punimet që do të kryhen vitet e ardhëshme.

L. Papajani

Apolloni. Në Apolloni u ndërhy në një banesë të shek. II të erës sonë, me oborr të brendshëm. Ambjentet e banimit komunikojnë me oborrin nëpërmjet një koridori të shtruar me mozaikë. Prej koridorit ruhet pjesa veriore dhe ajo lindore si edhe muret që e kufizojnë atë me ambjentet e banimit. Muret janë të lidhur me llaç. Me kalimin e kohës muri lindor dhe ai verior kishin pësuar dëmtime. Përveç shmangies nga linja e drejtë, në disa vende gurët ishin shkëputur nga muri dhe në shumë raste pjesë të tij ishin mënjanuar poshtë, në drejtim të koridorit, gati për të rënë. Disa prej dyshemeve të ambienteve mbrapa murit kanë nivel më të lartë nga ai i koridorit, gjë e cila ka influencuar në dëmtimin e tij.

Gjatë këtij viti u punua në murin verior. Për ti ruajtur gurëve pak a shumë vendin që kanë patur në mur, ata u çmontuan në pjesë të vogla. Gjatë



Fig. 3

punimeve u vu re se muri nuk kishte themel, ai fillonte në nivelin e dyshemesë me mozaikë të koridorit dhe mbështetej në një shtresë zhavori. Në vitet e ardhëshme puna restauruese dhe konsoliduese do të vazhdojë në të gjitha muret e banesës.

L. Papajani, G. Pani

Kalaja e Lezhës. Gjatë vitit të kaluar, në kalanë e Lezhës u kryen një sërë punimesh me karakter konsolidimi restaurimi dhe mirëmbajtje, si në kalanë mesjetare ashtu edhe në muret e rrethimit të qytetit të Lisit të lashtë.

Me punimet e kryera në kalanë mesjetare u arrit që të mënjanohet rrezikshmëria e shëmbjeve nga presioni i dherave dhe gurëve të grumbulluar në anën e brendëshme të murit rrethues dhe ambjenteve të banimit në anën veriore të kalasë mesjetare. Punimet me karakter mirëmbajtje që u kryen në të gjithë territorin, brenda dhe jashtë dhe në periudha të ndryshme e kanë mbajtur këtë monument gjithnjë në gjëndje të vizitueshme.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4

Në muret mbrojtëse të qytetit të Lisit gjatë gjithë vitit 1978 punimet e restaurimit u përqëndruan në traktin lindor të murit verior deri në kthesën e tij ku ndërpritet nga traseja e rrugës që të çon në portën veriore të kalasë mesjetare. Në këtë sektor, para fillimit të punimeve dalloheshin mbi sipërfaqe një sërë gurësh të rrëzuar njëri mbi tjetrin (Fig. 3). Punimet fillestare, me karakter pastrimi për të nxjerrë në dritë gjurmët e sistemit të fortifikimit të qytetit, ishin të domosdoshme për verifikimin e gjendjes në të cilin ndodhej muri i rrethimit në mënyrë që të bëhej një përcaktim i drejtë mbi masat konkrete që duheshin të merreshin për shpëtimin nga dëmtime të mëtejshme.

Nga këto punime u konstatua se gurët që dukeshin në sipërfaqe ishin kryesisht të rrëzuar nga faqja e jashtëme e murit të rrethimit fillestar të qytetit të Lisit. Nga sa u duk qartë në vënd, pjesa e sipërme e murit ishte rrëzuar nga presioni i dheut dhe rrëshqitja sipërfaqësore e tokës së kodrës, kurse themeli dhe rreshtat e parë të murit u gjetën në gjendje deri diku të mirë. Në gjithë gjatësinë e trasesë së murit të zbuluar ruhej drejtimi gjatësor i themelit kurse në drejtimin vertikal u konstatuan luhatje të blloqeve të gurëve të cilët në shumicën e rasteve ishin të mënjanuar jashtë ose të rrëshqitur nga muratura. Të mbështetur në këto të dhëna paraprake u arrit të konkretizohej detyra e restaurimit dhe masa e ndërhyrjes në këtë sektor gjithashtu u përcaktua edhe radha e proçeseve të punës. Fillimisht u larguan me radhë të gjithë blloqet e gurëve të rrëzuar duke i bashkërenduar simbas përmasave dhe radhës së tyre që zinin në murin e rrëzuar. Në vazhdim u krye çmontimi ose rrëzimi i të gjithë atyre gurëve që u gjetën gati të rrëshqitur nga mura-



Fig. 5

DO NOT COPY

tura. Rindërtimi i murit në këtë sektor lehtësohej shumë nga vetë fakti se pjesa e poshtëme e murit, siç thamë u gjet në vëndin e vet fillestar, kështu që nuk delte nevoja e konsolidimit të themelit dhe bazamentit mbështetës sikurse është vepruar në shumicën e rasteve të tjera. Në përfundimin e punimeve u arrit që të restaurohet tërësisht muri verior në një gjatësi prej rreth 100 m dhe në lartësi që luhat nga 2 deri në 4 m (Fig. 4).

Gjatë këtyre punimeve u përfituan të dhëna të reja teknike dhe një eksperiencë e mirë e cila do të ndihmojë pozitivisht në drejtim të zgjidhjeve dhe realizimit të detyrave restauruese që dalin në sektorë të tjerë, si nën sistemin e fortifikimit të Lisit, ashtu edhe në ato të qyteteve të tjera ilire.

K. Zheku

Kalaja e Gjirokastrës. Punimet në kalanë e Gjirokastrës u përqëndruan në sheshin në anën VL të kalasë ku u krye festivali folklorik. Në rradhë të parë u ringrit në lartësi dhe u plotësuan frengjitë e murit jugor të kalasë në një gjatësi 96 m. (Fig. 5). Në këtë anë ruhej shtegu i kalimit, ndërsa parapeti ishte i rrafshuar në nivelin e shtegut. Për të gjetur gjurmët ekzistuese u krye pastrimi i plotë i kësaj pjese. Nëpërmjet tij u zbuluan mjaft të fragmentuara dhe të dallueshme me vështirësi gjurmët e frëngjive të pushkës 1,8 – 2 m larg njëra tjetrës si dhe në largësi 20-25 m gjurmët e frengjive të topave me hapje jashtë. Zbulimi i tyre krijoj mundësinë e ringritjes së parapetit, të plotësuar me frëngjitë përkatëse. Plotësimi i frëngjive u bë i mundur nga ruajtja e 2 ekzemplarëve të plotë. Për ndërtim nga ana e brendshme u përdorën gurë të vjetër dhe gurë ranorë të cilëve ju dha forma dhe dimensionet përkatëse. Në brendi për lidhje më të mirë muri u punua me llaç çimentoje M.50 ndërsa në sipërfaqe me llaç bastard M.15. Parapeti u ngrit deri në një lartësi 1.20 m për të mos penguar shikimin. Nga larg ai u trajtua i njëjtë me murin ekzistues, ndërsa diferencimi u krye nëpërmjet vendosjes rrafsh dhe horizontalisht çdo 1 m të copave të xhamit 10-15 cm të gjata. Njëkohësisht u krye markimi i kësaj pjese me inicialet IMK dhe vitin 1978. Krahas kësaj u krye restaurimi i fragmenteve muralë në anën L, çlirimi i dritareve të ndërtesës në V të sheshit dhe restaurimi i shkallëve L të sarajit. Në këto të fundit u vendosën basamakët përkatës sipas gjurmëve dhe u plotësua pjesa e harqeve.

A. Baçe



Fig. 6

Theatri i Sofratikës. Theatri është ndërtuar rishmë në shek. e II e. s. në një terren fushor duke paraqitur ekzemplarin e vetëm të këtij lloji në vendin tonë. Mendojmë se i përket qytetit të Adrianopolit, rrënojat e të cilit janë mbuluar nga aluvjonet. Theatri ka diametër 61 m dhe kapacitet për rreth 4500 spek-



Fig. 7

tatorësh. Ndërtimi i tij i lirë paraqitet specifik për vëndet e Ballkanit. Theatri ruhet relativisht mirë në një lartësi maksimale 7-8 m. Ai paraqitet i dëmtuar nga hapja e 2 kanaleve kullues që vazhdonin ta dëmtonin më tej. Së Pari punimet u përqëndruan në devijimin e kanaleve 50 m larg konturit. Në gjendjen që ai paraqitej me struktura mbajtëse të dëmtuara dhe shkallare të shkarë, fillimisht paraqitej nevoja e çlirimit nga rrënimet. Për këtë u larguan rënimet nga pjesa e sipërme e kavesë dhe u zbuluan strukturat e saja mbajtëse, muret radiale e perimetrale të cilët u plotësuan me gurë të puqur në të thatë deri në stabilizimin e plotë të terrenit. Tabani midis tyre u nivelua me dhe të pastruar i cili u ngjesh. Po kështu u zbulua një nga shkallët për në kave Fig. 6. Për të arritur nivelin bazë të domosdoshëm për anastilozën e kavesë u krye një sondazh 1:80 x x 3 m deri në tabanin steril. Prej tij rezultoj se bllokqet e fundit janë ruajtur më mirë dhe është e mundur anastiloza për 7-10 rradhët e para. Po kështu u pastrua dhe ana e jashtme në 2 m thellësi deri 2 m larg mureve, për zbulimin e kontraforteve dhe mureve që ruheshin të plotë nën nivelin e dheut.

A. Baçe

Butrint. Në v. 1978 u ndërhy në 2 banjat dhe gjimnaz. Punimet patën për qëllim konsolidimin e strukturave murale. Më voluminoze ato qenë në termën në hyrje të Butrintit dhe në gjimnaz. Në termën afër kanalit u ndërhy në konsolidimin e strukturave, pa e kaluar lartësinë ekzistuese, dhe plotësimin e pjesëve të pakta ekzistuese në faqet e mureve, me tulla të po këtij formati dhe gurë (Fig. 7). Punimet nuk mund të quhen ende të përfunduara pasi pjesa e kaldajës (prefurni) nuk është zbuluar plotësisht. Po kështu dhe në gjimnaz u plotësuan muret anësorë në rrezik degradimi dhe nymfeu në pjesën qëndrore.

A. Baçe

Kalaja e Shkodrës është monumenti më i rëndësishëm në këtë qytet. E ndërtuar mbi substruksjone Ilire që dallohen akoma pranë hyrjes kryesore, kjo kala gjatë mesjetës ka patur një jetë intensive dhe për pasojë periudha të ndryshme ndërtimi të cilat mund të ndahen në katër periudha kryesore.

1. Periudha e principatave feudale shqiptare
2. » Venecjane
3. » Turke
4. » Bushatllinjve

Kalaja ndahet në tre oborre, duke filluar që nga pjesa më e lartë dhe e mbrojtur e kodrës deri tek hyrja kryesore. Në këtë kala janë kryer vazhdimisht punime restaurimi dhe konservimi që kanë patur për qëllim konsolidimin e mureve. Punimet konservuese gjatë vitit 1978 kishin për qëllim vazhdimësinë e mirëmbajtjes të mureve rrethuese dhe të kullave si dhe evidentimin e disa ambienteve të



Fig. 8

DO NOT COPY

mbuluara nga rrënimet në oborrin e tretë. Gjatë punimeve të konservimit është patur parasysh respektimi i gjithë fazave të ndërtimit dhe të veçorive të tyre teknike.

Gjatë vitit 1978 konsolidimet konsistuan në restaurimin e murit mbi portën kryesore. Restaurimi i disa frëngjive në murin verior. U konsoliduan harku i hyrjes për në oborrin e tretë. U restaurua pjesa e sipërme e murit verior të oborrit të III në të majtë të hyrjes që paraqiste rrezik shëmbje si dhe u kryen pastrime në oborrin e tretë.

Në përgjithësi gjendja statike e mureve të kalasë është e mirë. Kanë mbetur pa u prekur, muri jugor dhe pjesërisht muri i jashtëm i oborrit të tretë ku do të përqëndrohen punimet e restaurimit në vitet e ardhshme.

Tërmeti i 15 Prillit 1979 shkaktoi dëmtime të konsiderueshme edhe në kala dhe nxori në përgjithësi problemin e konsolidimit të mbulesave me qemere të gjithë kullave dhe ambienteve të tjera dhe kryesisht eleminimin e lagështisë.

Si pasojë e tërmetit u shëmb porta monumentale e ambienteve pranë kapitenerisë dhe muri në të djathtë të saj Fig. 8. Gjithashtu u shëmbën një pjesë e qemereve të ambienteve të mbuluara. U dëmtua muri jugor i kapitenerisë i cili ishte pregatitur më parë nga infiltrimi i lagështisë nga mbulesa. Dëmtime patën dhe qemeret e disa kullave të oborrit III si dhe të mureve perimetrale të tyre. Muri perëndimor i kishës së Shën Stefanit dhe bazamenti i minares pranë saj. Në punimet për eleminimin e pasojave të tërmetit u parashikua rikompozimi i hyrjes së ambienteve pranë kapitenerisë, rindërtimi i qemereve dhe hidroizolimi i tyre, si dhe riveshja e murit të Kapitenerisë Fig. 9. Vështirësi më të madhe paraqiste restaurimi i hyrjes pranë kapitenerisë. Pasi ajo ishte ndërtuar me blloqe masivë të skuadruar me mjeshtri dhe qarkohej me korniza të gurta të profiluara duke i dhënë portës një pamje monumentale. Për tja arritur qëllimit u pastruan rrënojat dhe u grumbulluan të gjithë gurët e skuadruar të portës si dhe fragmentet e kornizave. Gurët e thyer u ngjitën dhe krejt porta, në bazë të dokumentacjonit u rikompozua në tokë. Njeri nga gurët e harkut që mungonte u rigdhend. U konstatua se gurët e harkut të portës shtërngoheshin me pllaka plumbi, të cilat nuk u rivendosën gjatë restaurimit pasi origjinalet ishin shumë të dëmtuara.

Pas restaurimit Porta mori pamjen e dikurshme por dhe duke respektuar në kufijt e mundëshëm maksimalë materien e vjetër Fig. 10.

Gj. Karaiskaj



Fig. 9

Kisha e Shën Mërisë Zervat – Gjirokastër. Është kishë e tipit bazilikë me kupol, me hajat të hapur nga jugu, e ndërtuar në vitin 1583. Kisha e Zervatit ruan vlera artistike, arkitektonike dhe ambientale, ajo ndodhet në qendër të një gjelbërimi mjaft të freskët e të sistemuar. Nga ana teknike kisha është realizuar mjaft mirë. Mbulesa e çatisë është realizuar me rrasa guri të trasha të vendosura me një kujdes të veçantë. Nga pikpamja e gjendjes konstruktive, së jashtmi në murin e kishës, në skajin jug-lindor dallohen dy-tri plasje vertikale të pa konsiderueshme që nuk rrezikojnë monumentin. Nga ana e jonë u kryen punime në portikun mbuluar me



Fig. 10

DO NOT COPY

DO NOT COPY

rrasa e lëndë druri në hyrjen veri-perëndimore të kishës. Gjithashtu u sistemuan rrasat e mbulesës në kulmin gjatësor të kishës si dhe në tre apsidat nga lindja. U siguruan dritaret me rrjetë teli e u prenë pemët nga veriu që rrezikonin çatinë e kishës. Në këtë objekt, në hajatin jugor janë kryer punime edhe para disa vjetësh.

V. Shtylla

Kisha e Shën-Thanasit, Pecë — Sarandë. Është kishë e vogël njënefshe me çati druri e hajat të mbyllur nga jugu, e ndërtuar në vitin 1525. Ruan pikturë murale me interes si dhe ikonostas guri. Konstruktivisht kisha ka dëmtime. Muri verior ka plasje në lidhjet me murin perëndimor e atë lindor, gjithashtu muri perëndimor kishte fryrje nga jashtë. Para disa vjetësh në kishë u kryen punime, u ndërtua një kontrafortë në qoshen veri-lindore e një në qoshen veri-perëndimore si dhe u revizionua çatia e korpusit kryesor. Vitin e kaluar qe e nevojshme të ndërmereshin punime të tjera si ndërtimi i një kontraforti në qoshen nga lindja të murit verior, revizionimi i çatisë së kalbur të hajatit, riparimi i murit të gurit mbi arkitraun e derës së hajatit dhe kanalizimi i ujrave në anën veriore.

V. Shtylla

Kisha e Manastirit të Shën-Kollit, Dhivër — Sarandë. Kisha e Shën-Kollit është e tipit me planimetri trekonkëshe, me tre apsida, një lindore e dy nga veriu e jugu, me kupol me tambur të lartë. Ruan pikturë murale e ikona me interes në një ikonostas të ri. Kisha përbëhet prej dy volumesh, prej naosit, i mbuluar me qemerë e kupol, dhe prej narteksit, që mbulohet me çati druri. Nga ana konstruktive dy qemeret cilindrikë nga lindja e perëndimi ku mbështetet kupola kanë plasje të rrezikëshme aksiale. Morëm masa për përforcimin me kollona druri me jastekë thesi në pikturat, të plasjeve të qemereve. Kryem revizionimin e mesëm të çatisë së narteksit si dhe qeramosjen e çatisë me tjegulla të naosit, ku kish tjegulla të thyera.

V. Shtylla

Kisha e Shën Gjergjit Leshnicë e Sipërme — Sarandë. Ky objekt përfaqëson tipin e kishës njënefshe me çati druri me pikturë murale. Ndërtimi i saj i takon vitit 1525. Kisha ka hajat të hapur nga balli perëndimor. Punimet e kryera konsistuan në revizionimin e mesëm të çatisë me tre kullime të hajatit, në zbankimin e dherave nga lindja e jugu për evitimin e lagështisë në muret, në zëvendësimin e rrasave të thyera në çatinë e naosit si dhe në nivelimin e murit të dëmtuar të sofasë në perëndim të hajatit. Pas heqjes dherave ujrat u organizuan me kanale.

Veç këtyre punimeve, nga ana e Degës së Gjirokastrës u kryen punime dhe në kishat në Kameno e Labovë të Kryqit për ndrim rrasash në çati.

V. Shtylla



Fig. 11

Kisha e Shën-Gjergjit Libofshë — Fier, Është kishë me çati, tavan e kollona druri e dekoruar me pikturë murale. Nga tre anë rrethohet me hajat të mbyllur, spikat në aspektin volumor-arkitektonik, duke dalë në pah në majën e një kodre dominuese, ku lidhet në mënyrë harmonike me selvitë e larta që e hijeshojnë. Në këtë objekt zbuluam krejt çatinë e korpusit kryesor pasi i gjithë konstruksioni i saj ishte anuar nga lindja duke sforcuar e rrezikuar rrëzimin e kallkanit nga lindja, për pasojë edhe ky i anuar së jashtmi. Duke e rikthyer konstruksionin në pozicionin fillestar vertikal zëvëndësuan dhe elementë të kalbur të tij. Kryem dhe qeramosjen në hajatet, ku dhe siguruam dritaret me rrjetë teli. Në këtë objekt është punuar dhe para disa vjetësh për riparimin e çatisë së hajatit perëndimor e dëmtuar nga rrëzimi i këmbanores.

V. Shtylla

Kisha e Mesodhisë, Vuno-Vlorë. Kishë e vogël njënefshe me çati druri, që ruan pikturë murale me interes. Në këtë objekt revizionuam pothuaj krejt çatinë me tjegulla si dhe riparuam mbulesën me rrasa të apsidës. Ruajtëm teknikën egzistuese si në

konstruksion ashtu dhe në ruajtjen e rrjetit me rrasë guri në strehët e kallkaneve tërthore. Konsoliduam plasjet në qoshet veriore e jugore të murit perëndimor. Ndërtuam një kanal me rrasa në faqen veriore si dhe vendosëm derë të re.

V. Shtylla

Kisha e Ungjëllizimit, Kozarë-Berat. Kishë e madhe me çati druri, me pikturë murale, e cila është mjaft e dëmtuar për arsye të plasjeve të mureve perimetrale. Punuam për qeramosjen e hajatit verior, për uljen e nivelit të dheut në këtë anë, për përforcimin me pajante druri të apsidës së plasur e për paisjen me xhama të dritareve të kishës.

V. Shtylla

Kisha e Shën-Kollit, Perondi — Berat. Kishë bizantine e shekullit XIII. Restauruar para disa vjetësh. Punuam në qeramosjen e kishës, në zëvendësimin e dritareve të kalbura si dhe në sigurimin me rrjetë teli të dritareve të hajatit. Punimet e kryera në këto kisha i siguruan ato nga lagështia, nga rrëzime muresh, nga dëmtues të jashtëm të tjerë, etj. Theksojmë se si pasojë e dëmtimit të vazhdueshëm nga koha e nga faktorë të tjerë, punimet në objektet e kultit kanë karakter të përhershëm, kështu ato përsëriten pothuaj në çdo objekt në intervale disa vjeçare, sigurisht me një thellësi ndërhyrjeje që ndryshon sipas rastit dhe shkallës së dëmtimit teknik të monumentit, siç dhe ka ndodhur në praktikën tonë të restaurimit.

V. Shtylla

Punime restauruese në monumentet e artit

Apolloni. Në sektorin D përfunduan konsolidime në dy ambjente: në dhomën e «Aktorit» dhe në dhomën në anën perëndimore.

Në dhomën e «Aktorit» u bë një konsolidim i plotë duke zëvendësuar hapsirat boshe pa mozaikë me llaç horasan, i cili paraqitet i afërt me llaçin origjinal dhe njëkohësisht harmonizohet mirë me ngjyrën në tërësi të mozaikut (Fig. 11).

Konsolidime të pjesëshme u bënë në dhomën në perëndim të sektorit D.

Në sektorin G përfunduan konsolidimet në gjithë sipërfaqen me përjashtim të këndit verior që akoma nuk është gërmuar. Përfundoi rilevimi grafik në shkallën 1 : 10 për koridorin jugor, dokumentacioni fotografik dhe u bënë sondazhe në pika të



Fig. 12



Fig. 13

ndryshme të mozaikut të cilat na japin mundësi që për vitet e ardhëshme të planifikohet shkulja e këtij mozaiku e sidomos koridorit jugor në të cilin teserat janë shkëputur nga tabani origijnal.

U. Çikopano

Mozaiku pranë pallatit të Sportit në Durrës. Sipas një projekti të ri u krijua një mbulesë e lartë me skelet metalik e mbuluar me rezoluks për të eliminuar mbulesën e vjetër e cila disa pika mbështetje i kishte të vendosura mbi sipërfaqen me mozaikë.

U. Çikopano

Bazilika, e Tepes në Elbasan. Në këtë vit u krye shkulja në 12 fragmente të cilat u pastruan nga llaçi i vjetër dhe u betonuan duke respektuar cilësitë dhe markat e betonave si në zonat e betonuara vitet e kaluara. Fig. 12.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 14

Krahas montimit të 12 paneleve të betonuar, u shkulën dhe u rivendosën 4 pllaka shtufi dhe pllakat e tjera të koridoreve anësore. Konsolidimet në mure dhe plotësimi i vendeve boshe janë bërë pjesërisht për arësye të nji ndërhyrje më të gjërë që do të bëhet vitin e ardhshëm.

S. Kosta, U. Çikopano

Mozaiku i Linit. Në bazilikën e Linit në Pogradec u kryen konsolidime në tërë ambjentet, veçanërisht në dy apsidat anësore, edhe në shkallaren me 4 apsida në anën veriore të bazilikës.

Përforcimet e kryera pas gërmimit arkeollogjik u zëvendësuan me llaç harasan. Fig. 13.



Fig. 16



Fig. 15

Konsolidime u kryen edhe në muret e bazilikës, sidomos në vendet e rrëzuara, disa fugatura të murit u mbushën me llaç me ngjyrë të përafërt me atë të llaçit të vjetër.

U. Çikopano

Mozaiku i Shkodrës. Konsolidime në të u bënë paralelisht me gërmimin arkeologjik. Përfunduan konsolidimet në pjesën e gërmuar. Në të ardhmen pas gërmimit të pjesës tjetër do të vazhdojmë përsëri plotësime e konsolidime.

Vetëm në mozaikun e Polenës në Korçë për vitin 1978 nuk u ndërmorën punime dhe kjo nuk u realizua për arsye të mos gërmimit nga ana e Qendrës Arkeologjike veprime këto që do të koordinoheshin bashkërisht. Megjithëkëtë u kryen punime suplemen-



Fig. 17

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19

tare në shkuljen e dy kompozimeve në mozaikët e Mesopotamit në Sarandë. Fig. 14. Fill pas kësaj u shkulën edhe dy fragmente me mozaikë të qytetit antik Bylis. Fig. 15. mozaik ky i ndodhur jasht mureve të qytetit antik. Këta pas shkuljes u ambalazhuan në arka me jastekë tallashi për eliminimin e goditjeve gjatë transportit. Në sektor atyre ju kryen trajtimi i nevojshëm, plotësimi dhe betonimi. Fig. 16. Këta mozaikë do të shërbejnë për ekspozim në muzeun e artit mesjetar në Korçë dhe në muzeumin e qytetit të Fierit.

F. Hudhri

Katedralja e Shën Mërisë Voskopojë. Gjatë vitit 1978 sektori i artit ndërmori punime konservuese restauruese në kishën e shën Mërisë të fshatit Voskopojë të Rrethit të Korçës.

Katedralja e Shën Mërisë është një nga monumentet më të mëdhenj të vendit tonë (38 x 15.30 m). Ajo është ndërtuar dhe pikturuar rreth vitit 1712. Janë pikturuar me afresk të tre nefet, kupolat, harqet, apsida, niket, dhe gjithë muret e interierit. Kisha ka patur të pikturuar dhe hajatin që dikur përbëhej prej kollonadash të hijshme. Pak gjë ka mbetur nga ky afresk në skajin jug-lindor.

Dëmtimet që ka pësuar monumenti në konstruksionin arkitektonik janë bërë shkak i shumë dëmtimeve të afreskut. Fig. 17. Prishja e çatisë prania e gurëve porozë në harqet dhe kupolat ka sjellë si pasojë depërtimin e lagështirës në suva duke krijuar humbje aderence të arricios dhe intonakos si dhe dëmtime të shtratit piktural duke e pluhurëzuar atë dhe vende vende duke krijuar grumbullime kriprash. Edhe djegjet e monumentit kanë ndikuar në dëmtimin e monumentit. Punime restauruese janë ndërmarë në vitin 1961 dhe më pas këto kanë konsistuar kryesisht në konservimin e afreskut.

Gjatë vitit 1978 sektori i artit punoi në përgjithësi për konsolidimin e gjendjes ekzistuese. Kështu, në gjithë monumentin u përforcuan bordiurat e afreskut dhe u bënë pastrime të pjesëshme. Në disa zona



Fig. 20



Fig 21

si p.sh. në apsidë, u kryen edhe injektime për mbushjen e xhepave bosh duke përdorur kryesisht kazeatin e gëlqeres.

Në një nga harqet paraopsidal u shkëput një pjesë e konsiderueshme afresku me mënyrën e staccos. Piktura përfaqësonte një sipërafqe 2 x 1.5 m. Ajo ishte e shkëputur pothuaj plotësisht nga baza dhe varej poshtë duke krijuar një xhep mjaft të madh e të rrezikshëm. Për heqjen e afreskut u aplikua një pasing i njejtë si për strappo-t. Mbas një nivelimi të kujdesshëm duke përdorur për ringjitje një llaç të posaçëm u arrit që afresku të vendosej përsëri në vendin e parë por tashmë krejtësisht i shpëtuar. Punimet konservuese-restauruese në këtë monument të djegur të ish qytetit të Voskopojës do të vazhdojnë paskëtaj edhe vitet e ardhshme me piksynim që monumenti tu përcillet brezave që do të vinë në një gjëndje sa më të mirë.

A. Sadikaj

Kisha e Shën Mërisë (Maligrad) Liqenas – Korçë. Ndër objektet e pikturës murale ku u kryen punime konservimi dhe restaurimi ishte edhe kisha e shën Mërisë në ishullin e vogël të liqenit të Prespës pranë fshatit Liqenas.

Piktura e këtij monumenti të rëndësishëm të sh. XIV paraqet probleme të ndryshme të restaurimit. Ndër ato më shqetësues është ay i shkëputjeve të konsiderueshme dhe xhepave bosh që janë krijuar midis shtresës së pikturës dhe murit mbajtës. Kryesisht ky fenomen është më i ndieshëm gjatë brezit të drurit që lidh murin në mënyrë rrethore. Si rezultat i kalbëzimit të materialit të drurit muri mbajtës ka çeduar dhe ka shkaktuar lëvizje të pikturës. Masat e konservimit patën për qëllim të konsolidojnë pjesërisht pikturën në vendet më të dëmtuara kryesisht në brezin e pikturimit të medalioneve. Po ashtu në disa zona kishte shkëputje të plota të suvasë si dhe copëtime të ndieshme si është rasti i mbishkrimit në faqen jugore ose edhe i një portreti

DO NOT COPY



Fig. 22

gjithashtu në këtë anë. Fig. 19. Në një zonë tjetër të faqes veriore gjatë punimeve të ndryshme të kryera shumë vjet më parë nga vetë fshati ishin riintegruar pjesët e një portreti të faqes veriore, në mënyrë të gabuar.

Punimet e vitit 1978 ishin një vazhdim i punimeve të një viti më parë. Disa fragmente afreskash qenë shkëputur dhe duhet të riviheshin në vendet korespondues. Masat e mara nga ekspedita e këtij viti kishin për qëllim të plotësonin punimet e vitit 1977 si dhe të restauroheshin pjesët e dëmtuara të nivelit të brezit të drurit. Krahas punimeve që u kryen në këto pjesë u bë edhe fiksimi e konsolidimi dhe pastrimi i pikturës së pjesëve koresponduese duke fituar objekti një aspekt më të qëndrueshëm si në drejtim të konservimit ashtu dhe restaurimit e rivlerësimit të pikturës murale që paraqet një ndër vlerat më të arritura të pikturës mesjetare të sh. XIV në vendin tonë. Punimet e tjera restauruese që do të kryen vitet e ardhëshme do të synojnë të konservojnë krejt pikturën e dëmtuar edhe të pjesëve të tjera si dhe do shtrihen më thellë në drejtim të restaurimit e konservimit të pikturës së pjesës së brendëshme ashtu dhe asaj të jashtëme që paraqet nevojë dhe urgjencë për masa të tilla.

H. Nallbani

Punime restaurimi në banesën qytetare

Banesa e Nasi dhe Lili Vrahoritit në lagjen Mangalem – Berat. Banesa zë vend në brëndësi të lagjes Mangalem në një parcelë, që zë një si-



Fig. 23



Fig. 24

DO NOT COPY



Fig. 25

përfaqe të kufizuar dhe dallohet për një shfrytëzim racional të terrenit të fortë shkëmbor. Megjithë terrenin e shkallëzuar tarracor, disniveli në drejtim tërthor dhe gjatësor mjeshtri popullor ka ditur të krijojë më shumë sukses një kompozim të tillë volumor, i cili përmbledh të gjithë ambientet e nevojshëm. Faqja vertikale e shkallëzimit është përdorur si mur i dytë gjatësor për gjithë banesën, ndërsa mbi pjesën e sheshtë të tij ngrihen ambientet e banimit. Shkallëzimi i dytë shërben si taban për rrugën përbri murit fundor të banesës. Ky kompozim urbanistiko arkitektonik në terrenin e pjerrët, në formë tarracash, është karakteristik për gjithë lagjen. Banesa nga ana konstruktive ishte në gjendje të rëndë teknike, e cila na detyroi të ndërmarrim punime restauruese. Këto punime u kryen nga Ateljeja e Beratit në të dy pjesët e banesës gjatë vitit 1978. U prekën çatia konstruksioni i çatmave suvatimet, dyshemetë, elementet e drurit (Fig. 21, 22), punime të cilat eliminuan degradimin e mëtejshëm të banesës dhe nxorrën më në pah vlerat e saj arkitektonike.

Banesa e Haxhi Agiçit — Krujë. Banesa është monument i kategorisë së parë dhe ndodhet në qytetin e Krujës. Është e tipit perpendikular me një ambjent në pjesën e prapme përdhese dhe tre ambjente në pjesën përpara, dy katëshe.

Në trajtimin e jashtëm arkitektonik banesa na paraqitet me një volum të vetëm kompakt. Në pamjen kryesore, kati i parë prej guri trajtohet me dritare të vogla, ndërsa kati i dytë me çatma, trajtohet me shumë dritare (Fig. 23), duke krijuar një diferencim në trajtimin e jashtëm që reflekton dhe atë funksional të dy kateve. Banesa përfaqëson tipin e zakonshëm të banesave që u ndërtuan në qytetin e Krujës gjatë shek. XIX.

Gjëndja jo e mirë konstruktive e banesës na detyroi të ndërmarrim punimet restauruese në të, të cilat prekën konstruksionin e çatisë, të çatmave, dyshemetë, suvatimet dhe dritaret (Fig. 24).

Punimet e restaurimit u kryen nga Ateljeja e Tiranës gjatë vitit 1977 — 1978. Pas restaurimit banesa fitoj shumë duke u konsoliduar nga dëmtimi i mëtejshëm dhe plotësuar me elementet arkitektonik të dëmtuar ose që i mungonin.

L. Lazimi

Ura dhe ambienti mbi të në një rrugë të lagjes Dunavat — Gjirokastër. Dendësia e ndërtimeve në qytetet tanë mesjetarë e në fshat si dhe domosdoshmëria për të respektuar rrjetin rrugor kanë diktuar në disa raste ndërtimin e urave lidhëse ndërmjet dy banesave përbri njera tjetrës. Një rast tipik i kësaj zgjidhje është ajo që lidh dy banesa të së njëjtës familje në lagjen Dunavat. Në dallim nga një shembull i njëjtë në lagjen Palorto, i cili me qemerin në formë ure siguron ndërlidhjen ndërmjet dy banesave, në rastin e dhënë mbi kalimin është sajuar një ambient i vogël banimi. Gjendja teknike e këtij monumenti ishte në prag të rrënimit sepse qemeri kishte pësuar deformime mjaft të mëdha, gjithashtu struktura prej skelet druri mbi qemer ishte shumë e dëmtuar. Në këto rrethana ishte e pamundur konsolidimi i tij, prandaj u bë i domosdoshëm rikonstruksioni thuajse tërësor i këtij monumenti, duke ruajtur rigorozisht trajtimin dhe teknikat origjinale.

E. Riza

Banesa në Rr. «Pertef Kokona» Nr. 1, Lagja «Palorto» Gjirokastër. Kjo banesë paraqet një kompozim planimetrik të ndryshëm nga skemat e zakonshme. Një nga shkaqet duhet kërkuar në truallin relativisht të ngushtë. Ajo daton e vitit 1826, përkrah këtij mbishkrimi, një i dytë shënon datën 1891, i cili i përket një rindërtimi që ka prekur përveç ballit të banesës dhe ambientit të odës së miqve. Banesa është e kompozuar në volum me gjysmëkat. Në katin përdhe është vendosur nëndivani, katoi mjaft i gjerë dhe stera me marrje uji nga nëndivani. Shkallë të brendshme guri të çojnë në një divan të vogël prej të cilit kalohet në tre ambientet e banimit. Ambienti fundor ka qenë «shtëpia e zjarrit», ndërsa ai përbri «oda e miqve». Me interes është nyja e shërbimit pranë shtëpisë së zjarrit.

Banesa paraqiste gjendje jo të mirë teknike,

DO NOT COPY

duke pasur dëmtime serioze në strukturën e çatisë, ballin e banesës, si dhe përgjithësisht në elementet e drurit. Sondazhet para restaurimit saktësuan punimet e rindërtimit të vitit 1891 që kanë prekur ballin e katit të banuar, si dhe kanë prurë një sërë ndryshimesh në shtëpinë e zjarrit, së cilës i është mbyllur hyrja dhe oxhaku origjinal duke u ndërtuar të rinj në vendin e sotëm.

Punimet e restaurimit u kryen nga Dega e Gjirokastrës gjatë vitit 1977-78. Ato prekën konstruksionin e çatisë, ballin e ambientit të katit mbi nëndivan. (Fig. 25), një sërë punimesh të brendshme në dyshemetë, suvatimet si dhe tavanet. Punime restaurimi u kryen dhe në elementet dekorative prej druri të odës së miqve.

E. Riza

Punimet e restaurimit në banesën fshatare.

Banesa në fshatin Suhadoll Rr. i Dibrës. Kjo banesë është një nga shembujt më të vjetër në këtë fshat dhe në ato përreth, që përmban vlera të konsiderueshme tipologjike dhe arkitektonike. Tipologjikisht ajo bën pjesë në grupin e banesave me qoshk të Shqipërisë së Veriut. Nga të dhënat e ndryshme që na ofron monumenti dhe burimet gojore, rezulton se ajo është ndërtuar në fillim të shek. XIX. Në planin kompozicional ky ndërtim katërkatësh karakterizohet nga planimetria njëkthinëshe për çdo kat të vendosur këto njeri mbi tjetrin. Në brendësi zhvillohen shkallët prej druri që ndërlidhin katet e banesës. Shembulli në shqyrtim na paraqet një volum të mbyllur prizmatik me faqe të rrafshta në të cilin spikat kati i sipërm i gjallëruar nga qoshqet e dalura tej rrafshit të mureve. Në fund ky volum kurorëzohet nga çatia katërujshe me strehë të gjerë.



Fig. 26



Fig. 27

POOR COPY

DO NOT COPY



Fig. 28

Në katin përdhes rrinin shërbëtorët, kurse në të parin dhe të dytin banohej dhe në raste të veçanta përdorej dhe për miqtë, sepse duke qënë kjo nji familje që i përkiste një shtrese të pasur dhe me influencë kishte një rreth të gjerë. Kati i tretë që përmban odën e miqve e cila është një nga ambientet më paraqitës të banesës përdorej vetëm për pritjen e miqve. Banesa duke qënë prej kohësh e pa banuar dhe si pasojë e një tërmeti të rënë disa vjet më parë në këtë zonë në prag të punimeve restauruese ndodhej në gjendje të keqe teknike. (Fig. 26). Gjithashtu gjatë kohës ishin bërë disa ndryshime nga vetë banorët si pasojë e të cilave ishte cënuar në një shkallë të konsiderueshme ana funksionale dhe vlera arkitektonike e monumentit. Fillimisht u rindërtuan struktura e murit të qoshes juglindore dhe pjesërisht faqja ballore e odës së miqve (e shembur prej tërmetit). Duke qënë se egzistonte dokumentacioni grafik dhe fotografik për elementet e humbur në pjesët e mësipërme gjatë restaurimit nuk hasëm në ndonjë vështirësi të madhe. Konstruksioni i çatisë u restaurua plotësisht duke ruajtur formën e vjetër dhe një pjesë të elementeve origjinalë. Rindërtimi i dy qoshqeve në odën e miqve bëri që të arrihej formulimi origjinal i brendësisë së saj, duke qënë ky formulim tipologjikisht i përcaktuar. Ndërsa qoshku në pamjen jugore po në katin e sipërm që sipas të dhënave gojore shërbente si depo armësh nuk u rindërtua për mungesë të dhënash. U restauruan dyshemetë ndërmjet kateve duke ruajtur teknikën origjinale. Elementët përbërës të brendësisë së ambienteve të cilët ishin degraduar u restauruan duke pasur parasysh formën fillestare të tyre. Shkallët prej druri ku dy rampat e para kishin humbur plotësisht u rindërtuan dhe u vendosën në atë pozicion i cili u kushtëzua nga vendi që zinte rampa e katit të sipërm që megjithëse e degraduar ruante formën dhe pozicionin fillestar. Në pamjen veriore në pjesën që i përket katit të parë dukej qartë një derë e harkuar e murosur gjatë kohës. Sipas të dhënave të banorëve të shtëpisë rezulton se nga dera e mësipërme kalohej në një korridor të mbyllur i cili të çonte në shtëpinë e punëve të ndërtuar rreth 15 m larg banesës e rrënuar kjo disa vjet më parë. Nga shtëpia e punëve gratë binin ushqimin për burrat e shtëpisë dhe miqtë dhe e linin në një dollap i ndërtuar ky afër derës së mësipërme e cila duke qënë se sot nuk e kishte më funksionin fillestar u la e murosur. Në katin përdhes u hoq muri ndarës i ndërtuar më vonë dhe u suvatua meqënëse ruheshin ende gjurmët e shtresës së vjetër. Në këtë ambient



Fig. 29

u restaurua oxhaku dhe u çlirua dera e murosur që të çonte në ambientin sanitar, elementë këto që përcaktuan destinacionin e përmendur fillimisht për katin përdhes. Ndërtimi prej dy katesh që ishte bashkangjitur monumentit në anën jugore u hoq sepse ai ishte një shtesë pa vlerë e bërë kohët e fundit që dëmtonte rëndë vlerën arkitektonike të kësaj pamje. Mbas ndërhyrjeve restauruese të cilat qenë relativisht të mëdha u arrit që monumenti të rifitonte në maksimum vlerat e humbura. (Fig. 27), duke qënë ky një shembull me vlerë në gjininë e tij.

L. Suli

Banesa në fshatin Klos Katund Rr. i Matit. Ajo është ndërtuar në një terren të pjerrët. Ndërtimi është tre katësh dhe pjesërisht dy katësh. Në këtë shembull dallohen dy faza ndërtimi. Pjesa tre katshe që është më e vejtra përmban ahurin për strehimin e bagëtive, odën e zjarrit dhe odën e miqve në katin e sipërm. Koncepti funksional, skema kompozicionale dhe sidomos formulimi arkitektonik i jashtëm i pjesës së vjetër është i njejtë me atë të banesës së Çermenikës. Pjesa më e re përmban ahurin dhe ambientin e banimit në katin e parë. Në këtë shembull përveç interesit që paraqet ai në aspektin tipologjik ai shquhet përsa i përket kompozimit planimetrik dhe volumor i cili karakterizohet nga një lëvizje volumesh që influencojnë pozitivisht në rritjen e vlerës arkitektonike të banesës. Monumenti paraqitej në një gjendje jo të mirë konstruktive, duke bërë kështu të nevojshme ndërhyrjen restauruese (Fig. 28). Meqënëse muri perimetral lindor ishte degraduar vetëm në faqen e jashtme, ai u rindërtua në gjysmën e trashësisë së tij. Në këtë mënyrë u lanë të pa prekur elementët e faqes së brendshme, si oxhaku, kamaret dhe dollapët e murit. Muri jugor kishte humbur qëndrueshmërinë plotësisht prandaj u rindërtua thuajse i tëri duke iu përshtatur teknikës së vjetër. Në këto rindërtime gurët e rrëzuar që i përkisnin faqes së jashtme u vendosën përsëri në këtë faqe. Nga sondazhet e bëra rezultoi se dy dritaret e katit të banuar të pjesës shtesë ishin zmadhuar prandaj gjatë restaurimit ato u kthyen në madhësinë që kishin pasur fillimisht. U plotësua një pjesë e telizit të mbyllur me drrasa në katin e dytë në pamjen veriore. Kurse vazhdimi i tij në pamjet lindore dhe perëndimore megjithëse dukeshin gjurmët e trarëve konsol të dyshemesë nuk u rindërtua. U restaurua ambienti sanitar në pamjen lindore sepse gjurmët e mbetura dhe qenja e një elementi tjetër të këtillë i pa dëmtuar në këtë pamje, e bënte të mundur këtë restaurim. Duke qenë ky ambient i domosdoshëm nga ana funksionale. Rrjedhimisht me plotësimin e tij rritej vlera arkitektonike e pamjes lindore. Në odën e zjarrit të pjesës së vjetër u restaurua vatra ndërsa oxhaku u la i murosur sepse mungonin të dhënat e formës së tamburit. Në punimet restauruese u përfshinë dhe rindërtimi i pjesshëm dhe i plotë i elementeve të ndryshëm funksional dhe dekorativ që ishin degraduar ose kishin humbur plotësisht, duke u mbështetur në modelin origjinal. Një rëndësi e veçantë iu dha trajtimit të elementeve prej druri. U bë rikonstruksioni i çatisë duke ruajtur në maksimum elementin e vjetër. U ribënë thuajse në përgjithësi suvatimet e brendshme. U krye pastrimi i elementeve prej druri dhe lyrja e tyre me vaj lini. Ndërhyrjet restauruese bënë që të sigurohej gjendja teknike e monumentit dhe të dali në pah vlera arkitektonike e tij. (Fig. 29).

L. Suli

Banesa në fshatin Rranxë Rr. i Krujës. Banesa në shqyrtim përfaqëson një nga shembujt me vlerë të banesave të vjetra në malësinë e Krujës. Siç do ta shohim më poshtë pavarësisht nga prania e qoshqeve në ndonjerin prej ambienteve të banesës, zhvillimi planimetrik i saj është i ndryshëm nga ai që i karakterizon banesat me qoshk të Shqipërisë së Veriut. Në planimetri banesa ka formën e shkronjës L. Kati përdhes që përdorej për strehimin e bagëtive përbëhet nga katër ambiente të ndara ndërmjet tyre me mure të trashë. Secili nga këto ambiente ka hyrje të veçantë nga jashtë. Po këtë ndarje ka dhe kati i banuar. Nga sondazhet dhe vrojtimet e bëra gjatë studimit për restaurimin e saj rezulton se ndërtimi nuk është i njëkohshëm. Pjesa dykullëshe e çvendosur më në thellësi ku kati i sipërm i saj përmban odën e zjarrit që zë një sipërfaqe relativisht të madhe, një ambient banimi dhe një sallon në vazhdim të tij, është ndërtuar më përpara. Ndërsa volumi i dalur në plan të parë që përbën pjesën një kullshe të paisur me kullë mbrojtëse e ngjitur kjo një kat më shumë se vetë banesa është bërë në një fazë të dytë. Gjendja teknike e disa strukturave në prag të punimeve restauruese s'ishte e mirë. Gjithashtu u konstatuan disa ndryshime në ndonjerin prej ambienteve të banesës si pasojë e të cilave ishte tjetërsuar ana funksionale e tyre.

Fillimisht u kryen punimet për konsolidimin e strukturave të dëmtuara. Siç ishte rasti i rindërtimit të pjesshëm të murit perimetral lindor, zëvendësimi i elementeve të dëmtuar të konstruksionit të dyshemesë dhe të çatisë. U rindërtua tymari i shembur i oxhakut të odës së zjarrit dhe u suvatuan të gjithë tymarët e tjerë duke qenë se gjurmët e suvasë ishin të qarta. Fillimisht muri kufizues verior i sallonit ka

DO NOT COPY

qënë i ndërtuar me skelet druri dhe i veshur nga jashtë me drrasa dhe jo me parmak druri. Në veshjen me drrasa u ndërtuan dritaret që e ndriçonin dhe ajrosnin këtë ambient. Ndërsa muri i trashë prej guri i ndërtuar mbi atë të katit përdhes dallohet qartë se është bërë më vonë. Ky mur nuk u hoq sepse sot për sot ndikonte pozitivisht në kushtet e banimit dhe në të ardhmen mund të hiqej lehtësisht duke marrë kështu ambienti formën fillestare. U plotësuan gjithashtu elementët e dëmtuar siç ishin kanatat e dritareve fashaturat e sergjeneve, kapakët e dollapëve të murit e tjerë dhe u bë pastrimi dhe lyerja me vaj lini e tyre. Në të gjitha ambientet u krye suvatimi i brendshëm. Qepeneku i qoshkut të odës së miqve ku ngrihesh dhe kulla mbrojtëse u restaurua pjesërisht. U ndërtuan në disa ambiente të katit të banuar tavane provizore prej fibre. Ndërsa muri rrethues nga ana veriore u la të restaurohej në një të ardhme kur të krijohej mundësia e heqjes dhe e disa shtesave të bëra më vonë në anën lindore. Punimet e restaurimit në këtë monument dhe në ato që përshkruam më lart u zbatuan nga ateljeja e Monumenteve të Kulturës së Tiranës.

L. Suli

Banesa në fshatin Theth Rr. Shkodrës. Banesa është e tipit me gjysmëkat. Megjithëse ndërtimi është i hershëm për mendimin tonë ai nuk është shembulli më shprehës i arkitekturës së banesave popullore të ndërtuar në këtë zonë. Ajo është ndërtuar mbi një terren të pjerrët shkëmbor i cili është mjaft i aksidentuar nga ana veriore faktor pozitiv ky në rritjen e aftësisë mbrojtëse të saj dhe të impresionit arkitektonik të pamjes së mësipërme. Ahuri për strehimin e bagëtive zë të gjithë sipërfaqen e katit përdhes dhe ka hyrje të veçantë nga jashtë. Shkallët që të çojnë në katin e banuar janë në brendësi të një volumi i cili i mbështetet volumit kryesor në anën perëndimore. Në pjesën e sipërme të kësaj parahyrje është ndërtuar çaraniku prej druri për vendosjen e bulmetit. Nga parahyrja komunikon direkt me odën e zjarrit e cila ka sipërfaqe të barabartë me ahurin. Oda e zjarrit ndriçohet dhe ajroset nga dritare të vogla. Në faqet e mureve janë ndërtuar gjithashtu frengji për mbrojtje. Në mes të odës gjëndet një vatër e madhe e shtruar me dhe. Në vazhdim të odës së zjarrit nga ana veriore ndodhet oda e miqve e cila megjithëse ka sipërfaqe shumë më të vogël ka ndriçim dhe ajrim më të shumtë. Banesa gjatë kohës kishte pësuar një sërë dëmtimesh që kërkonin ndërhyrje restauruese. Gjatë studimit për restaurimin e saj vumë re që volumi ku ishin ndërtuar shkallët nuk kishte lidhje organike me murin perimetral perëndimor të volumit kryesor. Gjithashtu dhe trajtimi i teknikës së ndërtimit ndryshonte në një farë mase. Këto fakte na çuan në mendimin se ky ndërtim është bërë në një periudhë më të vonë. Ndërsa shkallët fillimisht kanë qënë të ekspozueshme. Megjithatë këtë shtesë nuk e hoqëm. Sepse së pari ajo shtonte aftësinë mbrojtëse të banesës por gjithashtu ndikonte pozitivisht në anën funksionale dhe në rritjen e vlerës arkitektonike të monumentit. Të çarat e shumta në brendësi të mureve u eleminuan me metodën e injektimit. U zëvendësuan elementet e dëmtuar të konstruksionit të dyshemeve, u zëvendësuan elementet prej druri të degraduara të çaranikut, kapakët e dollapëve të murit, sergjeni etj. Ndërsa elementet prej druri që ishin në gjendje të mirë u pastruan me sodë kaustike. Gjatë punimeve të restaurimit u bë rindërtimi i dy frengjive kryesore në odën e zjarrit të cilat u gjetën mjaft të dëmtuara. Duke qënë se çatija me dy kullime kishte pjerësi të vogël mbulesa me furde u zëvendësua me tjegulla vendi. Në brendësi u krye dhe suvatimi i mureve. Ndërhyrjet restauruese bënë që të sigurohej gjendja teknike e banesës dhe të dali në pah vlera arkitektonike e saj. Mbas restaurimit banesa u kthye në muze.

L. Suli

Banesa në fshatin Shoshan Rr. Tropojës. Ky ndërtim përfaqëson një nga shembujt e banesës së fortifikuar të malësisë së Gjakovës. Ajo është trekatëshe prej guri me dysheklëk po prej guri në pjesën e sipërme. Katin përdhes e ze ahuri për strehimin e bagëtive. Shkallët e jashtme të lidhin me katin e parë, në të cilin zhvillohet jeta e gjallë e familjes. Në kompozimin planimetrik të tij përfshihet oda e zjarrit divanhanja dhe qyleri në të cilin flejnë çiftet e rinj. Oda e miqve e paraprirë nga divanhanja përbën katin e dytë. Në këtë banesë u kryen këto punime restauruese. U konsoliduan pjesa e jashtme e mureve prej guri në pamjen jugore dhe perëndimore. Në odën e zjarrit u hapën dritaret që u gjetën të murosura. U zevendësuan elementet prej druri të dollapeve të murit të dritareve që ishin degraduar duke ruajtur formën dhe mënyrën e trajtimit të elementeve origjinale. Pjesërisht u zëvendësuan elementet e konstruksionit të dyshemeve në të dy katet. U plotësuan elementet përbërës të shkallës së jashtëme dhe asaj të mbrendëshme. Në të gjithë ambientet e dy kateve të sipërm u krye suvatimi i brendshëm. Konstruksioni i çatisë u restaurua pjesërisht. Punimet e restaurimit për këtë banesë dhe atë që përshkruam më sipërm u zbatuan nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës së Shkodrës.

L. Suli

BOTIMET

DO NOT COPY

CHRONIQUE DES TRAVAUX DE RESTAURATION POUR 1978

RESTAURATION DES MONUMENTS ANTIQUES ET MOYENAGEUX

Bylis. *Dans la région de Mallakastra, au sud du fleuve Vjosa, se dresse la colline rocheuse de Hekali, dont l'éminence domine toute la zone environnante.*

C'est au sommet de cette colline que se trouvait la Bylis antique. Les murs d'enceinte cernent une surface d'environ 27 ha de forme triangulaire, dont la base se trouve en direction sud.

Pendant les années 1975, 1976 et 1978, l'Institut des Monuments de Culture a effectué des travaux de nettoyage et de restauration dans les murs d'enceinte de cette ville. Les travaux de nettoyage ont mis à jour, outre les tronçons de mur et les tours en partie conservées, trois entrées de la ville. L'entrée la plus petite a sa partie frontale en direction sud, du côté de la ville antique voisine surplombant la colline du village de Klos. La porte est constituée par les prolongements parallèles des deux directions du mur, qui forment entre les murs un couloir d'une largeur de 1,30 m et d'une longueur de 3.5 m. Les travaux de nettoyage ont montré que sa partie antérieure était fermée par un mur de blocs disposés sans soin. Par ailleurs, on a constaté que le mur oriental était endommagé. A son état actuel, dans sa partie frontale il n'y a qu'une seule rangée de blocs.

En direction nord, il y a une deuxième porte à laquelle on accède du côté nord. Cette porte est endommagée, on n'en conserve actuellement dans un état plus ou moins satisfaisant que la seule aile en direction de la colline. Les blocs ayant été prélevés depuis longtemps, les possibilités d'intervention sont fort peu limitées. Toujours sur cette face du mur, en direction sud de la première porte, il y a une troisième porte plus grande, dont l'entrée, comme dans le cas de la porte plus petite, se trouve en direction sud. La disposition de ces entrées en direction sud indique que sur ce versant de la colline il doit y avoir eu une route conduisant à la ville de Klos. Approximativement au sud-est de la colline, cette route devait probablement se croiser avec l'autre route, dont il est question dans la grande inscription au sud de la ville et qui passait par Astacia, peut-être la région de Mallakastra. Les travaux de nettoyage ont éclairci aussi sa planimétrie. Cette porte se prêtait à des travaux de restauration, du fait qu'une partie de ses blocs se trouvaient sur place et les autres blocs conservaient encore leur forme.

Des deux côtés cette porte commence par des embrasures larges de 0.90 m, qui font saillie du mur 0.48-0.50 m d'un côté et environ 0.65 m de l'autre. La longueur du couloir est divisée en deux espaces par un contrefort qui se trouve à 4.20 m de l'embrasure, dans la partie frontale de la porte, alors que le deuxième espace est plus petit, d'une longueur de 2.60 m, et il est de nouveau limité par un contrefort des deux côtés. Le contrefort du milieu est long, il fait saillie 0.43 m du mur. La largeur du couloir ne subit aucune modification tout au long de sa longueur parallèle, à la différence de certaines portes dans d'autres villes, qui se retrécissent en profondeur. Une planimétrie presque semblable à celle-ci caractérise l'entrée de la partie antique de la forteresse de Berat.

Dans le mur du couloir du côté de la colline, à proximité du premier contrefort, il y a un trou profond où se déplaçait la poutre qui assurait la fermeture de la porte. Les murs de l'entrée, tout comme les murs d'enceinte de la ville, sont construits avec des blocs de pierre calcaire de dimension moyenne.

En 1978 fut entamé le nettoyage du couloir, en enlevant les blocs écroulés afin de les remettre à leur place initiale. Dans le mur en direction de la colline, les blocs furent placés provisoirement, car ses fondations s'étaient déplacées en s'éloignant du couloir. A l'issue des travaux de nettoyage, on procédera au désassemblage du mur, ses fondations seront orientées en ligne droite et nivelées puis les blocs seront placés définitivement à leur place. Cette méthode de travail n'a pas été suivie dans le mur qui se trouve de l'autre côté du couloir, car ce mur appartient à la deuxième phase des constructions.

Durant le nettoyage on a récupéré des blocs de forme presque cubique; un examen minutieux a montré qu'il s'agissait des blocs de la voûte, qui s'appuyait sur les deux contreforts au milieu de la longueur du couloir. L'arc ne comprenait qu'une seule rangée de blocs. On a trouvé aussi des blocs qui s'appuyaient sur les blocs de l'arc.

Au cours des prochains travaux, on procédera au net-

DO NOT COPY

